Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

ATLAS I BIMËVE TË KOSOVËS

Behxhet Berisha

Dr. Ferat Rexhepi

Mr. Xhavit Mala

Dr. Fadil Millaku



Prishtinë, 2021

© Ky dokument është pronë e MMPHI-së dhe ndalohet shumëzimi dhe ribotimi i pa autorizuar

Të nderuar lexues, dashamirës të natyrës,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), përmes Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka përkrahur realizimin e botimit të Atllasit të Bimëve të Kosovës. Ky atlas është rezultat i një pune hulumtuese disa vjeçare të ekspertëve vendor të botanikës dhe paraqet një publikim shumë të rëndësishëm në këtë fushë.

Në vitin 2012 ishte botuar Atllas i Bimëve të Kosovës, i cili në vete përmbante të dhëna për gjithsejtë 902 lloje bimore. Që nga ajo kohë ekipi i ekspertëve që ka marrë pjesë në hartimin e këtij atllasi, ka vazhduar hulumtimet në terren dhe tani sjellë fotografi dhe të dhëna edhe për 228 lloje tjera bimore, duke rritur kështu numrin në 1130 lloje bimore, dhe duke përfshirë 1/3 e bimëve të Kosovës, nga rreth 3.000 lloje bimore sa mendohet se janë në vendin tonë.

Ky dokument do të jetë i rëndësishëm për institucionet qendrore, lokale, si dhe ato akademike, sepse përmban të dhëna shkencore të rëndësishme për florën tonë. Këto të dhëna janë me vlerë të veçantë për Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës përkatësisht Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës pasi që mundësojnë plotësimin e bazës së të dhënave dhe krijimin e një inventari të detajuar për llojet bimore të Kosovës.

Në kuadër të llojeve të bimëve të përfshira në këtë atllas ka edhe llojet bimore endemike të Ballkanit dhe Kosovës, si dhe lloje të rralla e të rrezikuara. Andaj ky dokument dhe këto të dhëna do të jenë një bazë e mire edhe për hartimin e politikave, strategjive dhe planeve për mbrojtjen e llojeve të rralla e të rrezikuara bimore dhe habitateve të tyre.

Ngritja e vetëdijes për mbrojtjen e biodiversitetit ka një rol shumë të veçantë në mbrojtjen e tyre dhe në njohjen e rëndësisë që kanë llojet bimore. Ne vlerësojmë që botimet e ngjashme si ky atllas, do të kontribuojnë në rritjen e vetëdijes së të gjitha shtresave për njohjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit të llojeve bimore të vendit tonë. Po ashtu ky atllas do të ju hyjë në shërbim edhe institucioneve arsimore të niveleve të ndryshme si një material dokumentues dhe praktikë, që do të lehtësojë njohjen me llojet bimore të Kosovës dhe përhapjen e tyre.

Në kuadër të objektivave për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit institucionet qendrore dhe ato lokale, duhet ti japin rëndësi të veçantë kujdesit dhe mbrojtjes së trashëgimisë natyrore të Kosovës, përmes hartimit të politikave efikase për mbrojtjen e llojeve të rralla dhe të rrezikuara bimore dhe shtazore dhe konservimit të habitateve të tyre.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, do të angazhohet po ashtu edhe në thellimin e bashkëpunimit jo vetëm me institucionet relevante kombëtare që kanë përgjegjësi në ruajtjen e biodiversitetit, por edhe me organizatat ndërkombëtare, institucionet akademike dhe kërkimore si dhe me organizatat e shoqërisë civile, me qëllim të arritjes së synimit tonë të përbashkët për mbrojtjen e llojllojshmërisë sonë biologjike dhe trashëgimisë natyrore.

Fadil Bajraktari
Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës



Parathënie

Në vitin 2012 doli nga shtypi ATLASI I BIMEVE TE KOSOVES me 902 lloje nga autorët Behxhet Berisha, Xhavit Mala, Ferat Rexhepi dhe Fadil Millaku. Kjo ishte një ndërmarrje dhjetëvjeçare duke fotografuar bimë që rriten në Kosovë. Pas kësaj ne vazhduam të dilnim në terrene të ndryshme të Kosovës duke bërë fotografi të reja. Pas një pune 2 – 3 vjeçare fotografuam 228 lloje të tjera dhe kjo na nxiti të nxjerrim një atlas të ri më të zgjeruar me gjithsej 1130 lloje (902 +228). Kur kemi parasysh se bimësia e Kosovës ka një regjistrim prej rreth 3.000 llojeve, themi se ky atlas përfshin mbi 1/3 e florës së Kosovës.

Bota bimore është mjaft e larmishme. Janë të njohura rreth 500.000 specie të përhapura në mjedise të ndryshme të rruzullit tokësor. Ndahen në bimë të ulëta dhe të larta. Bimët e larta ose kormofitet ndahen në myshqe, fierna, farëzhveshura ose bimë halore, dhe farëveshura ose bimë me lule. Farëveshurat janë të përfaqësuara me rreth 250.000 specie, të ndara në rreth 400 familje.

Në këtë Atlas të bimëve të Kosovës, përveç myshqeve, janë përfshirë 1130 lloje kormofitesh: 16 fierna, 19 farëzhveshura dhe 1095 farëveshura. Mes farorëve ka edhe bimë të kultivuara që mbillen në parqe dhe kopshte si bimë zbukurimi dhe në këtë Atlas kemi përfshirë mbi 50 lloje të tilla.

Hapësira në të cilën banon një lloj quhet areal. Përveç arealit të llojit mund të flitet edhe për arealin e gjinisë, familjes dhe njësive tjera sistematike. Një lloj mund të jetë i përhapur pothuaj në të gjitha kontinentet. Këto quhen bimë kosmopolite. Kur një specie nuk ka shtrirje të gjerë, për të themi se është endemike; Barpezmi gjethemëndafshtë (Achillea holosericea) është endemike e Ballkanit, sepse është i përhapur në viset e Ballkanit; Ylli shqiptar (Aster balbanicus) është endemik i Kosovës dhe Shqipërisë sepse është i përhapur vetëm në këto vende; Bishtmiu i Kosovës (Micromeria albanica) është endemik i Kosovës sepse është i përhapur vetëm në Kosovë. Bimët endemike të Kosovës janë të përhapura në vende të caktuara dhe kryesisht me shtrirje të vogël hapësinore; shpesh ato janë dhe në numër të pakët individësh. Është në interés të Kosovës që këto të mbrohen me ligj nga zhdukja, sepse mund të rrezikohen nga padituria ose përdorimi pa kujdes.

Bimët endemike janë pasuri floristike; ato ndeshen kryesisht në Alpet Shqiptare dhe Malet e Sharrit. Këto bimë janë të rralla, por njëherësh edhe krenari e Kosovës. Prej tyre në këtë Atlas janë përfshirë 11 lloje: Stipa mayer, Bornmuellera dieckii, Achillea alexandri-regis, Potentilla doerfleri, Micromeria albanica, Wulfenia blecicii, Plantago dardanae, Tulipa kosovarica, Centaurea alberti, Solenanthus krasniqii dhe Cerastium neoscardicum. Ky Atlas përmban 103 lloje të bimëve endemike të Ballkanit dhe 18 lloje endemike të Kosovës dhe Shqipërisë.

Bimët me tipare të përbashkëta, individët e të cilave kryqëzohen lirshëm mes tyre, duke dhënë pasardhës pjellorë, kategorizohen në të njëjtin grup që quhet specie ose lloj, kurse emërtimi i tyre bëhet me dy emra: emri i parë, që shkruhet me shkronjë të madhe, i përket gjinisë, ndërsa emri i dytë i përket llojit dhe shkruhet me shkronjë të vogël, dhe të dyja shtypen me germa korsive. Përveç emërtimit në gjuhën shkencore, i qëndron pranë edhe emërtimi në gjuhën shqipe, kurse më poshtë është shënuar edhe familja së cilës i përket, p.sh.:
Lloji: Scilla bifolia L. – Boçka dygjethore
Familja: Liliaceae – Zambakore

Krahas fotove sa më cilësore të zgjedhura, secila bimë shoqërohet me një përshkrim të shkurtër, por tepër të qartë. Krahas shënimeve morfologjike dhe tipareve të tjera të organeve, kemi theksuar edhe kohën e lulëzimit të paraqitur me numra romakë sipas muajve të vitit.
Emërtimi i dyfishtë i propozuar nga Karl Line (1707-1778) vlen edhe për botën shtazore dhe është një zgjidhje e mirë orientuese për vendosjen e rregullit në gjithë njësitë përkatëse sistematike, në mënyrë që të lehtësohet gjetja e asaj bime që kërkohet.
Qëllimi i këtij Atlasi është të njihet lloji i bimës, të cilën e ndeshim në natyrë, pra si një letërnjoftim për identifikimin e tyre.
Urojmë që ky libër do të ndihmojë, si adhuruesit e florës, në njohjen e bimëve, ashtu dhe ata që profesionalisht merren me botanikë. Urojmë, gjithashtu, që në të ardhmen të dalin edhe të tjera botime të kësaj natyre. Kjo do të shtonte më shumë njohuritë mbi bimët që rriten në Kosovë.
Për përshkrimin e llojeve kemi shfrytëzuar këtë literaturë: Flora e Shqipërisë I – IV, 1988 - 2000, Balza, 1971, Bozhilova, 1992, Demiri, 1983, Hayek, 1927 – 1933, Horvat, et al. 1974, Jo, et Kozhuharov, 1963 – 1995, Krasniqi, 1979, Magdefrau, K., Ehrendorfer, 1978, Paparisto, et al. 1988 – 2000, Rexhepi, 1985, 1986, 1994, 1999, 2000, Millaku, 1999, Tahtazhan, 1980 – 1982, Tutin, T. G. etj. Flora Europaea. Vols. 1 5 Cambridge, 1964 – 1980. Coste, H. Flore descriptiven et ilustree de la France, de la Corse et des Contrees limitrophes. Vols. 1 – 3, Parisë 1900 – 1906. Fiori, A. Nuova Flora Analitica d'Italia, Vols. 1 – 2 , Firence, 1923 – 1929. Hayek, A. Von. Prodromus Florae Peninsulae balcanicae. Vols. 1 – 3. Dahlem bei Berlin, 1924 – 1933.

Falënderojmë nga zemra për konsultimet dhe sugjerimet të bëra nga Dr. Aleko Miho, Dr Mersin Mersinllari dhe Dr. Lulëzim Shuka të cilat kanë qenë të dobishme dhe i kemi mirëpritur, njëherit falenderojmë edhe Ministrinë e Mjedisit , Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës si dhe Ministrin Liburn Aliu për mbështetjen e botimit të këtij atlasi.

Behxhet Berisha

Autorët e fotografive:
Behxhet Berisha 1001
Xhavit Mala 59
Fadil Millaku 56
Ferat Rexhepi 14



Lycopodium selago L. – Likopodi selago
Lycopodiaceae – Likopodiore

Bimë barishtore shumëvjeçare, hollake, me rizomë të shogët. Kërcejtë të thjeshtë ose pak a shumë të degëzuar, 10 -60 cm të lartë. Brinjët të trasha, të ashpra. Hulliza 6 – 10. Këllëfët të gjelbër, pak të larguar nga kërcelli, me majë të zeshkët, me buzë cipëthatë të gjerë, me një brinjë.

Boqet 10 – 30 mm, shyta, ovoide – gjatore. Zhvillohen në majë të kërcellit.

Majë – verë.

Rritet në vende me lagështirë, me bar, në ara, e zakonshme. Bimë e helmët. Bar i keq i kulturave bujqësore.



Equisetum palustre L. – Këputja e kënetave
Equisetaceae – Kripthore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 35 cm e lartë. Kërcejtë të ngritur dhe të degëzuar.

Gjethet jo me gjuhë në bazë, të vogla, jo të diferencuara në llapë dhe bishtak, të mbuluara si tjegulla në shumë radhë; të sipërmet vizake – heshtore, zakonisht të hapura, 4 – 8 mm; shpesh në sqetullat e tyre gjenden bula në formë sythësh.

Sporangjet si veshkë të vendosura në bazë të faqes së brendshme të gjethes, zakonisht të zhvilluara mirë.

Verë.

Rritet në shkëmbinj me lagështi, pyje e kullota, të zonave të larta malore.

Bimë mjekësore.



Equisetum arvense L. - Këputja e arave
Equisetaceae - Kripthore

Bimë barishtore shumëvjeçare, kryesisht pranverore, mjaft hollake; me rizomë pushlore. Kërcejtë shterpë 10 – 80 cm, zakonisht me degëzim të dendur; degëzat zakonisht të përpjetme, ose edhe të ngritura, të thjeshta. Këllëfët të gjelbër. Kërcejtë pjellorë dalin përpara atyreve shterpë, zakonisht më të shkurtër, të thjeshtë, të murrmë – të çelët, që thahen pas pjekjes së sporeve. Këllëfë 4 – 6 , të murrmë – të çelët, me dhëmbë më të errët.

VI – IX.

Në vende me lagështirë, në livadhe, buzë rrugëve, në ara, deri në zonat malore, e zakonshme. Bimë e helmët dhe mjekësore.



Equisetum telmateia Ehrh. – Bargjani
Equisetaceae – Kripthore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë të trashë, zvarritëse të mbuluar dendësisht me luspa të murrme të çelëta.

Gjethet në grupe, të qëndrueshme edhe gjatë dimrit. Bishti gati sa llapa, i kuq – i murrmë i errët, i hollë si tel. Llapa pendore. Pendëzat të sheshta ose të palosura, përsipër të shogëta, përposh dendësisht me luspa të murrme, majëholluara – trekëndëshe.

VI – IX.

Rritet në vende me gur, shkëmbinj, sidomos serpentinor, kryesisht të zonave malore.



Cheilanthes marantae (L.) Domin. – Heilanta
Aspleniaceae – Aspleniore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shëndoshë, me rizomë pushlore. Prej tij çdo vit zhvillohen dy lloje të kërcejve: fertil dhe steril. Kërcejtë fertil (pjellorë) fillojnë të shfaqen gjatë muajit mars ose prill, pra përpara atyre shterpë, që thahen pas pjekjes së sporeve. Në majë të kërcejve fertil zhvillohen boçet me sporangje. Kërcejtë steril (shterpë) rriten deri 200 cm, me degëzim të dendur e të rregullt, të bardhë si fildishi; degëzat të gjelbra, të hapura, të tjeshta. Këllëfët të errët në majë dhe të çelët poshtë.

Pranverë.

Rritet në vende me shumë lagështirë, buzë kanaleve etj.



Botrychium lunaria (L.) Swartz – Sefiri
Ophioglossaceae – Ofioglosore

Bimë shumëvjeçare, me kërçep penjëzor, luspak në majë.

Gjethet 5 – 30 cm; llapa shterpë pa bishtak, gjatore, pendore me 3 – 9 çifte pendësh si freskore, me bazë si gjysmëhënë-pykore, shpesh gjysmërrotullare, të plota ose rrallë me majë të prerë, pa nervure kryesore; llapa pjellore kalli i përbërë , me sporangje gati pa bisht, të vendosura në dy radhë, zakonisht më e gjatë se llapa shterpë.

VII- VIII.

Në livadhe me lagështirë të zonave malore dhe subalpine.



Gymnocarpium robertianum (Hoffm.) New. –
Gimnokarpi i Robertit Aspidiaceae – Aspidiore

Bimë shumëvjeçare, me rizomë hollake, zvarritëse.

Gjethet zakonisht 15 – 60 cm. Llapa e gjelbër, opake, me bishta të shkurtër. Secili çift më i poshtëm pendësh më i vogël se pjesa tjetër e llapës

Soret të vendosura gati në anë të llapës, të rrumbullakëta ose të zgjatura. Mbulesa epidermike e soreve mungon.

Verë.

Në shkëmbinj gëlqerorë, në vende me hije etj. të zonave malore.



Polystichum lonchitis (L.) Roth. – Polistika heshtake
Aspidiaceae – Aspidiore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë të shkurtër dhe të trashë.

Gjethet 15 - 60 cm, të qëndrueshme, të ngurta, të tufëzuara. Llapa lëkurore, vezake – heshtore, pendore; 15 - 50 pendë në çdo anë, të përkulura në formë kose, me buzë të sharruara.

Soret rrotullare, në dy rreshta në anën e poshtme të gjethes, por vetëm kah maja e gjethes.

VI - VII.

Rritet në vende shkëmbore të zonave malore, e zakonshme. Në Kosovë e përhapur në Malet e Sharrit, Alpet Shqiptare etj.



Polystichum setiferum Woynar
Polistika me qime të kreshpëta Aspidiaceae – Aspidiore

Bimë shumëvjeçare me rizomë të trashë dhe të drunjëzuar.

Gjethet 30 - 120 cm të mëdha , të buta, zakonisht jo të qëndrueshme. Llapa 10 – 20 cm e gjerë, heshtore, dyfishpendore. Pendëzat të sharruara, qartësisht me shtijë, jo të stërgjatura, deri 40 në çdo anë. Soret rrotullare; induzia e hollë; shqytake, rënëse.

VI - VII.

Rritet në vende me hije, në pyje etj., deri në zonat e larta malore.



Dryopteris filix – mas (L.) Schott – Fieri mashkull Aspidiaceae – Aspidiore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Rizoma është e trashë dhe e gjatë 20 - 30 cm.

Nga rizoma dalin gjethet 2 herë pendore, 30 - 130 cm të gjata. Llapa gjatore heshtore, ngan-jëherë e përkulur në maje; pendëzat vizake deri gjatore- heshtore, pa bisht, thellësisht pendore të çara deri pendore. Bishtat të murrmë – të çelët, me pak luspa.

Soret në anën e poshtme të gjethes të shpërndara në dy rreshta paralele, induzia e shogët dhe nuk e mbulon në tërësi sorusin.

VIII - IX

Rritet në vende me hije të pyjeve gjetherënëse dhe gjethembajtëse.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 50 cm, me rizomë zvarritëse. Rizoma me luspa heshtore.

Gjethet e reja zhvillohen në fillim të verës; gjethet heshtore deri vizake – heshtore; pendët shyta ose paksa të mprehta, llapa pendore e çarë. Soret rrotullare, jo me induzi (mbulesë); parafizat mungojnë.

III - IX.

Rritet në shkëmbinj e pyje të lagëta, mbi drurë të vjetër, mure, kryesisht në zonën e ulët. Bimë mjekësore. Në mjekësinë popullore përdoren rizomat.



Pteridium aquilinum (L.) Kuhn – Fieri shqiponjë Hypolepidaceae – Hipolepidore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë nëntokësore,e cila është e mbuluar me qime. Gjethet të mëdha 50 - 300 cm, nga poshtë leshtore, nga sipër të shogëta ose me pak qime, trefishpendore. Bishti i gjethit i fuqishëm , i ndarë në bishta më të vegjël që bartin llapa gjethesh. Soret mbi nervurat anësore të mbuluara nga induzitë e qerpikëta dhe buzët e spërveshura të gjethes .

Verë.

Rritet në vendbanime të ndryshme, kryesisht në ahishtet e prera. Bimë shumë e përhapur, gati në tërë botën. Bimë e helmët.



Polypodium vulgare L. Fierguri i rëndomtë Polypodiaceae – Polipodiore



Asplenium adiantum - nigrum L. – Fieri i zi
Aspleniaceae – Aspleniore

Bimë shumëvjeçare, me rizomë të përpjetme ose shkurtimisht zvarritëse.

Gjethet 10 – 50 cm, me llapë deltoide, të gjelbër të errët, lëkurore, të shogët, dyfish – trefishpendore, të qëndrueshme edhe gjatë dimrit. Segmentet më të fundit heshtore, shyta në bazë, me dhëmbë të mprehtë. Bishti i gjethes gati sa llapa, i fryrë në vendin e bashkimit me rizomën, i kuqërremtë – i murrmë. Soret në afërsi të nervurave.

VI - IX.

Rritet në shkëmbinj, pyje, mure etj., deri në zonat malore.



Asplenium trichomanes L. – Fier guri
Aspleniaceae – Aspleniore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë tufore, me shirit qendror të errët.

Gjethet 4 - 20 cm të gjata, të shogëta, rrallë me qime gjëndërore. Llapa pendore, heshtore - vizake, relativisht e trashë. Pendët 0.4 – 1.2 cm, gjatore, të afruara, të plota ose me buzë ura -ura të sharruara, me bazë të cungët me majë të rrumbulluar.

Soret të vogla. Sporangjet kur piqen e mbulojnë pendën.

VII - IX.

Rritet në shkëmbinj dhe mure, prej zonës kodrinore - malore deri te ajo alpine.



Ceterach officinarum DC. – Bar gjarpri mjekësor
Aspleniaceae – Aspleniore

Bimë shumëvjeçare, me rizomë të shkurtër, të trashë.

Gjethet 5 – 25 cm, në tufa, të qëndrushme, gjatore. Llapa e gjethes lëkurore, nga sipër e blertë e hapur, nga poshtë e mbuluar me luspa të argjendta në ngjyrë ndryshku, të vendosura si tjegullat e çatisë. Midis tyre janë të fshehura grupet e sporangjeve. Segmentet e gjetheve të këmbyera, vezake ose gjatore, 9 – 12 në çdo anë, të plota ose me buzë ura-ura, të rrumbulluar në majë. Soret rreth 2 mm, vizake.

VIII - IX

Rritet në shkëmbinj, mure etj, deri në zonat malore, e zakonshme. Bimë mjekësore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë të shkurtër dhe të trashë.

Gjethet 10 - 60 cm të gjata dhe 3 - 6 cm të gjera, të qëndrueshme, të valëzuara, të plota . Bishti i gjethit gati sa gjysma e llapës.

Soret vizake, 8 - 18 mm të gjata, zakonisht mbulojnë më shumë se gjysmën e gjerësisë së llapës, të vendosura në dy rreshta paralele.

VII - VIII.

Rritet në vende me hije, buzë ujërave të rrjedhshme të zonave kodrinoro - malore, deri te subalpine.



Abies alba Mill. - Bredhi i bardhë
Pinaceae – Pishore

Dru halor deri 50 m i lartë. Degëzat e reja me push të dendur dhe me sythë pa rrëshirë.

Gjethet në trajtë halash. Në pjesën e poshtme kanë dy vija paralele të bardha, kurse përsipër janë me ulluk.

Boçet 10-20 X 3-4 cm, shfaqen gjatë pranverës. Boçet femërore të ngritura, piqen gjatë verës dhe bien në fillim të vjeshtës.

IV - V.

Rritet në zona të larta shpesh i përzier me ah dhe pishë të zezë. I përhapur në Evropën e Mesme dhe Jugore.



Phyllitis scolopendrium (L.) Newman – Tjegullore
Aspleniaceae – Aspleniore

Dru deri 40 m i lartë. Në fillim kurora në formë piramidale. Lëvorja e murrme, me të çara. Degët në fillim të drejtuara pjerrtazi, kurse më vonë horizontalisht.

Halat në tufa nga 30 – 40, të gjelbër – të mbyllët, 15 – 35 mm të gjata.

Boçet të drejta, me rrëshirë, në formë fuçie, në majë pak të kupëzuar ose të rrafshët. Luspat fertile deri 5 cm të gjera.

VIII - IX.

I përhapur në Liban, Turqi dhe Siri. Tek ne i kultivuar si dru zbukurimi.



Cedrus libani (Trew) Laws. – Cedri i Libanit
Pinaceae – Pishore



Picea omorika – (Panc.) Purk. – Hormoqi i Pançiqit
Pinaceae – Pishore

Dru shtatlartë 30 – 40 m i lartë. Degët e holla, në pjesën e poshtme të kërcellit të drejtuara teposhtë, të mesit horizontal, kurse më lartë përpjet.
Halat vizake, 2 cm të gjata, nga sipër të gjelbra – të kaltra, me dy vijëza të bardha përposh.
Lulet mashkull të kuqe-gështenje, ato femër të kuq-të verdhë. Boçet deri 6 cm të gjata, duke u pjekur marrin ngjyrë kafe ose kafe – të kuqe.
Lul V – VII, fryt. IX – X.
Lloj endemike- relikte e pjesës lindore të Ilirisë. Në vende tjera i kultivuar si dru zbukurimi



Larix decidua Mill. – Larshi gjetherënës
Pinaceae – Pishore

Bimë drunore, 20 – 40 cm e lartë; degët të holla të varura teposhtë. Lëvorja e përhime, me të çara të thella. Rritet shpejtë dhe jeton deri 600 vjet.

Gjethet në tufëza me nga 20 – 60; në vjeshtë marrin ngjyrë të verdhë dhe bien. Maja e tyre nuk është therëse.

Larshi është bimë monoike. Lulet në boçe. Boça femër purpur – e kuqe, aromatike. Lulet mashkull me ngjyrë të verdhë – të çelur. Boçet vezake, 5 – 6 cm të gjata; kur janë të reja kanë ngjyrë të gjelbër, kur piqen bëhen të përhime – të çelur.

Lul. herët në pranverë; fr. vjeshtë. Në fillim i përhapur në Europën qendrore; me kalimin e kohës është shtrirë edhe në pjesët tjera të Europës. Mbillet nëpër pyje, parqe dhe oborre.



Picea abies (L.) Karst. – Hormoqi
Pinaceae – Pishore

Hormoqi është dru deri 60 m i lartë.

Gjethet në faqen e poshtme të degëve të vendosura djathtas e majtas si krehëri, të blerta të errëta, 15 - 25 mm të gjata dhe deri 1 mm të gjera, therëse.

Boçet 10 - 15 cm të gjata, 3 - 4 cm të gjera, të përkulura, me luspa të papalosura. Farat me flatra anësore.

IV - V.

Rritet në pyje halore. Në Kosovë është i përhapur në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare.

Dru i lartë 20 - 30 m, me lëvore të përhime e të çarë pllaka - pllaka të vogla. Sythat pa rrëshirë.

Gjethet dyshe, 6 - 8 cm të gjata, 1.5 mm të gjera.

Boçet 7 - 8 cm të gjata, 2.5 cm të gjera, me nga një thumb të drejtë dhe shumë të vogël në mes. Farat me flatra.

V - VI.

Rritet kryesisht në male të larta, sidomos gëlqerorë. E ndeshim në Malet e Sharrit, Alpet Shqipëtare si dhe malet e Ballkanit dhe Kalabri të Italisë.

Dru deri 50 m i lartë. Në fillim lëvorja e lëmuar, më pastaj bëhet me të çara. Degët e reja shumë të holla.

Halat pesëshe, 2 – 3 vjet të qëndrueshme.

Boçet 1 – 3, të ngritura, cilindrike, shpesh të harkuara, në vitin e dytë bëhen të pjekura.

V.

E kultivuar, zakonisht nëpër parqe.



Pinus strobus L. – Pisha e Vajmutit
Pinaceae – Pishore



Pinus heldreichii Christ – Arneni i kuq
Pinaceae – Pishore

Shkurre 3 - 4 m e lartë. Degët të trasha, të shtrira ose të drejta. Degëzat në fillim të blerta, më vonë bëhen të murrme. Sythet vezake – cilindrike, me shumë rrëshirë.

Halat dyshe, të blerta - të çelëta.

Boçet 2 - 5 x 1.5 - 2.5 cm, shyta, gati pa bisht, të shndritshme, apofiza me një gjemb të imët në mes.

V - VI.

E pranishme në zonat subalpine dhe alpine të Alpeve Shqiptare dhe Maleve të Sharrit.



Pinus mugo Turra – Dredhaku
Pinaceae – Pishore

Dru deri 45 m i lartë me lëvore të çarë thell për së gjati, me ngjyrë të përhime deri e murrme - e errët. Degëzat e vitit të parë të shogëta ngjyrë të murrme të zbehtë ose të murrme portokalli. Sythet vezakë, majëmprehtë, me rrëshirë.

Gjethet halor. Halat dyshe, pak të përdredhura ose të lakuara. Boçet 5 - 8 cm të gjata, me mëlluga të murrme në të zezë në faqen e brendshme. Farat 5 - 8 mm, piqen vitin e dytë e të tretë.

IV - V.

Pisha e zezë formon formacione të veçanta pyjesh.

Nga pisha e zezë nxirret rrëshirë që përdoret në industri dhe mjekësi sikur dhe poleni.



Pinus nigra Arnold - Pisha e zezë
Pinaceae - Pishore

Dru 20 - 30 m i lartë, me kurorë piramidore dhe me lëvore të çarë pllaka - pllaka të vogla e me ngjyrë të përhime të murrme. Sythet pa rrëshirë dhe kanë formë vezake.

Gjethet në tufa nga 5, të forta, majëmprehta, në prerje trekëndore, të afruara nga degët.

Boçet e pjekura cilindrike, të verdha në kafe, deri 10 cm të gjata me bisht të shkurtër.

V - VI.

Rritet në substrate silikate të zonave subalpine dhe alpine. Ndeshet në Malet e Sharrit, Alpet Shqiptare. Bimë endemike e Ballkanit.



Pinus peuce Griseb. - Arneni i bardhë
Pinaceae – Pishore

Dru deri 25 m, me lëvore dy ngjyrash: të murrme të mbyllur në pjesën e poshtme të trungut, të kuqe në të verdhë në pjesën e sipërme.

Halat dyshe, të rimta sidomos në faqen e rrafshët, shpesh të përdredhura, 3 – 8 cm të gjata.

Lulet mashkull janë të mbledhura 10 e më tepër rreth boshtit të boçës, ngjyrë të verdhë të qelur. Lulet femër janë më të vogla se ato mashkull, të kuqe. Boçet të murrme të verdheme, pa shkëlqim.

Lul. V – VI; fryt. X – XI.

Spontane dhe e kultivuar.



Pinus sylvestris L. – Hartina
Pinaceae – Pishore

Dru monoik përherëblertë, deri 30 m, por që n'atdheun e vet bëhet deri 100 m, me kurorë piramidore të gjerë.

Halat të vendosura në spiral, majëlakuara, me nga dy vijëza të bardha përposh, me erë të fortë po të fërkohen.

Lulet mashkull në sqetullat e halave. Boçet të varura, me mëlluga të qëndrueshme, me brakte me tri gjuhëza në majë mjaft më të gjata se mëllugat.

Lul. IV – V, fryt. IX – X.

E kultivuar. Me origjinë nga perëndimi i Amerikës Veriore (Oregon).



Pseudotsuga menziesii (Mirbel) Franco – Pisha e Oregonit Pinaceae – Pishore



Juniperus communis L. – Dëllinja e zezë
Cupressaceae – Qiparisore

Shkurre ose dru, dioike, 7 - 8 m e lartë. Ka lëvore të lëmuar, të murrme të përhime.

Gjethet në qerthuj nga 3, vizake, të forta, majëtherëse. Nga ana e sipërme me një rripth të bardhë të përhime.

Boçëzat vezake ose rruzullore, me pluhurizë. Piqen vitin e dytë ose të tretë. Kur piqen bëhen të zeza ose ngjyrë qielli të errët.

IV - V.

Rritet në pyje dhe shkorrete të zonës kodrinore malore. E përhapur. Bimë aromatike dhe mjekësore.



Juniperus nana Willd. - Dellinja e kërrusur
Cupressaceae - Qiparisore

Shkurre dioike, e degëzuar, jo më e lartë se 1 m, e shtrirë gati për toke.

Gjethet më të shkurtra se 10 mm, jotherëse, të përkulura përpjetë.

Boçëzat vezëngjashme ose rruzullore, me pluhurizë, 7 - 10 mm. Farat të mbështjellura me arilus (boça si rrushk mishnor).

Lul. V; fryt. IX - X

Rritet kryesisht në zona subalpine, sidomos në substrate silikate dhe serpentine. Bimë aromatike dhe mjekësore.



Juniperus oxycedrus L. – Dëllinja e kuqe
Cupressaceae – Qiparisore

Shkurre 4 - 5 m e lartë, dioike.

Gjethet të qëndrueshme, të vendosura në qerthuj trishë. Kanë formë halash dhe mbarojnë me maje të mprehtë e të fortë. Në pjesën e sipërme me dy rriptha të rimtë.

Lulet mashkull janë boçe të vogla. Në faqen e poshtme të luspave kanë strajca të polenit. Lulja femër është poashtu një boçe. Fryti i rremë ka pamjen e një rrushku. Sa janë të reja të verdhme dhe me pluhurizë, kur piqen bëhen të kuqërreme, me dy ose tri fara.

IV – V.

Rritet në vende të thata, boka. E zakonshme.



Cupressus arizonica Greene - Selvia e Arizonës
Cupressaceae –Qiparisore

Selvia e Arizonës është selvi autoktone e Amerikës jugperëndimore, e përhapur në shtetin e Arizonës, Meksikën e Re, jug të Kalifornisë etj. Janë të njohura 5 varietete të këtij lloji. Struktura e tyre dhe ngjyra ndryshon varësisht nga mosha. Rritet në lartësi 10 – 15 m.

Gjethet 2 – 5 mm të gjata, në faqen e poshtme mëllugëngjashme, të mbështetura pas degëve njëra mbi tjetrën.

Lulet mashkull me 12 – 20 thekë. Thekët me 4 – 6 strajca të polenit. Lulet femër më të trasha se lulet mashkull. Në stinën e vjeshtës 2 vjet pas pjalmimit bien farat.

Lul. I – II; fryt. IX – X.

Bimë zbukurimi.



Juniperus sabina L.- Jermësinë
Cupressaceae – Qiparisore

Shkurrëz ose shkurre deri 3 m, dioike. Degëzat me gjethe me 4 qoshëza të dalluara mirë.

Gjethet të gjitha mëllugore, të vendosura kryq, shyta ose gati majëmprehta, me nga një gjëndër eliptike në shpinë, me erë shumë të rëndë kur shtypen.

Boçëzat 4 – 6 mm, në trajtë rruazash, zakonisht të shtypura, ngjyrë blurreme të zezë, me pluhurizë; piqen në vjeshtë të vitit të parë ose në pranverë të vitit të dytë.

Lul. IV – V; fryt. X.

Ndeshet rrallë në malet e Kosovës.



Thuja orientalis L. – Tuja
Cupressaceae Qiparisore

Dru monoik deri 8 – 10 m, shpesh shkurrengjashëm, me kurorë vezake ose konike të dendur. Shumica e degëve të ngritura gati vertikalisht. Degëzat katërkëndëshe të shtypura.

Gjethet në trajtë mëllugash shumë të vogla të përkundërta, duke mbuluar njëra – tjetrën si tjegullat, të përherëblerta, ose të blerta të verdha.

Lulet në boçëza skajore. Boçëzat të zgjatura, me pluhurizë të blurremët, me 6 – 8 mëlluga me nga një thumb të lakuar në majë.

Lul. II – IV; fr. IX – X.

Në këtë gjini bëjnë pjesë 5 lloje. Ndeshet shpesh nëpër parqe, lulishte e kopshte. Bimë zbukurimi.



Taxus baccata L. - Tisi
Taxaceae – Tisore

Shkurre ose dru halor e cila rritet shumë ngadal dhe mund të arrijë lartësi 15 – 20 m. Halat vizake, me majucë, përsipër të blerta e të ndritshme.

Lulet mashkull të përbëra prej 6 – 14 luspash me 4 – 8 qeskëza pjalmore në faqen e poshtme. Lulja femër përbëhet nga një bosht i shkurtër me luspa në majën e të cilit qëndron një vezës e vetme. Fryti rrushk i rremë, me mish të kuqërremtë (aril).

III - IV.

Rritet në pyje me lagështi dhe hije. Ka përhapje të pakët në Kosovë. I ngrënshëm vetëm arili, pjesët tjera janë mjaft helmuese.



Magnolia grandiflora L. – Manjola lulemadhe
Magnoliaceae – Manjolore



Magnolia liliiflora Desr. – Manjola lulezambak
Magnoliaceae – Manjolore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me erë të keqe, e shogët e me kërcell nëntokësor zvarritës dhe të degëzuar, 30 - 70 cm e lartë.

Gjethet të këmbyera, të plota, pjesa bazale e tyre si zemër.

Në sqetull të gjetheve zhvillohen disa lule, 2 - 7. Rrethlulja e verdhë, e çrregullt, në fund e fryrë për të vazhduar në gypin e hapët me gjuhëz gjatore ose vezake,të gjatë sa gypi ose pak më e gjatë. Fryti kapsulë me shumë fara. Ka formë të dardhës dhe qëndron i varur.

V - VIII.

Rritet në vende barishtore, djerrina e shkorrete. Bimë helmuese dhe mjekuese.

Bimë drunore deri 20 m e lartë. Degët me push ngjyrë ndryshku.

Gjethet kanë formë eliptike, të trasha e të lëmuara, nga ana e sipërme të shkëlqyeshme, kurse nga ana e poshtme kanë ngjyrë ndryshku. Qëndrojnë edhe gjatë dimrit.

Lulet të vetmuara, të mëdha, të bardha e me erë limoni. Rrethlulja e thjeshtë, e përbërë prej 9 fletëzave të njëjta të vendosura në tre qerthuj me nga tri. Thekët të shumtë. Fryti rrëshekth.

VI - IX.

E kultivuar gati në tërë botën si bimë dekorative. Ka prejardhje nga Amerika Veriore.

Shkurre 2 - 3 e nganjëherë deri 5 m e lartë. Ka kurorë të rrumbullakët. Lëvorja e degëve e përhime.

Gjethet të gjera dhe eliptike, 15 - 20 cm të gjata. Në bazë kanë formë pykore, kurse në majë pak të mprehta.

Lulet nga ana e brendshme të bardhëreme, kurse nga ana e jashtme ngjyrë lejla - trëndafili.

Lulëzon para se të gjethojë. Lulëzimi mund të përsëritet gjatë verës dhe vjeshtës.

Ka prejardhje nga Kina Qendrore. Tek ne e kultivuar nëpër parqe ose pranë shtëpive si bimë dekorative.



Aristolochia clematitis L. – Petriku kulpër
Aristolochiaceae - Petrikore



Aristolochia pallida Willd. – Petriku i zbehtë
Aristolochiaceae – Petrikore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me zhardhok të rrumbullakët, 5 - 12 cm e lartë, e përhimtë – e blertë.

Gjethet në pjesën e mesme të kërcellit janë të gjera trekëndore – si zemër.

Lulet në sqetullën e gjetheve, të vetmuara, me bishta shumë të shkurtër. Pjesa e poshtme e periantit e fryrë në fund, e ngushtuar më sipër, në maje në formë gjuhe. Gryka ka ngjyrë të verdhë – të blertë, përgjatë dejve vjollce e mbylltë.

V - V.

Endemike e Kosovës dhe Shqipërisë. Lokaliteti ku rritet është i rërët – guror, me shkurre dhe toka ka përbërje gjeologjike serpentine. Është zbuluar në vitin 1985 nga botanisti gjerman W. Greuter dhe slloven E. Mayer.



Aconitum vulparia Rchb. – Akonita e verdhë
Ranunculaceae – Zhabinore


Bimë barishtore shumëvjeçare, me zhardhokë rruzullorë. Kërcelli 15 – 50 cm.

Gjethet 2 – 7 cm, vezake – veshkore.

Lulet të vetmuara, të vendosura në sqetullën e gjetheve. Rrethlulja 3 – 6 cm, e shogët, e blertë, e verdhë ose kafe e çelët; gypi i drejtë; gjuhëza gjatore – heshtore, shytë, pak më e shkurtër se gypi, kafe ose kafe e errët. Fryti kapsulë vezake – gjatore, e varur.

V – VII.

Në shkurrnaja, vende me bar etj.



Aristolochia merxmuelleri Greuter et Mayer – Petriku i Merksmylerit - Aristolochiaceae – Petrikore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 – 150 cm e lartë. Rizoma cilindrike, shpesh e degëzuar.

Gjethet pëllëmbore të ndara në 5 – 7 pjesë. Gjethet e poshtme me bisht të gjatë.

Lulet kanë ngjyrë të verdhë të çelët. Braktetë të thepëta. Fryti i shogët, 10 -20 mm i gjatë. Farat të zeshkëta.

VI – VII.

Rritet në lëndina të pyjeve mezofile dri në zonën alpine.



Aristolochia rotunda L. – Bar zemre
Aristolochiaceae – Petrikore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me zhardhok 1 – 2 cm të trashë. Kërcelli 15 – 40 (-60) cm.
Gjethet gati pa bisht, në fund në formë zemre, kërcellpushtuese, vezake – rrotullare.
Lulet të vetmuara, të vendosura në sqetullën e gjetheve. Rrethlulja e verdhë; gjuhëza gjatore, gati aq e gjatë sa gypi ose më e gjatë, ngjyrë kafe. Fryti kapsulë rruzullore.
IV – VI.
Në kullota, shkurrishta, vende me bar.

Bimë barishtore shumëvjeçare leshtore, me rizomë zvarritëse të trashë e të degëzuar. Kërcejtë të shkurtër 2 – 5 (-10) cm, lusporë me 2 – 5 gjethe.
Gjethet në trajtë veshke deri rrotullare, më të gjera se të gjata, në fund të ngrëna si zemër, bishtaku më i gjatë se llapa.
Lulja në formë kambane, kafe e errët, e vetmuar skajore. Thekë 12, me fije të lira. Fryti kapsulë, në majë me rrethlulen e qëndrueshme.
V – VI.
Në pyje të freskëta me hije, buzë ahishteve. Bimë mjekësore



Asarum europaeum L. – Kopedani
Aristolochiaceae – Petrikore



Actaea spicata L. – Aktea me kalli, rrush i egër
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 65 cm, e shogët, me kërçep të trashë të zeshkët. Kërcejtë të thjeshtë, të zhveshur në bazë.

Gjethet e bazës të mëdha, dyfishtreshe ose dyfishpendore, me gjethëza vezake; kërcelloret më të vogla, të dhëmbëzuara.

Lulet të vogla, të bardha, në vile. Segmente të rrethlules 3 – 5, petëlngjashme. Gjethe mjaltore 4 – 10, të vogla. Fryti rrushk ovoid, i zi kur piqet.

V – VII.

Në pyje, sidomos me ah, të zonave të larta malore. Bimë e helmët dhe mjekësore.



Adonis aestivalis L. – Adonisi i verës
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore njëvjeçare, 20 - 50 cm e lartë. Kërcelli i thjeshtë ose i degëzuar, i shogët ose me pak qime.

Gjethet e poshtme me bishta, të sipërmet pa bishta, pendore të ndara.

Sepale 5, të gjelbër të çelët. Petale 6 - 8, dy herë më të gjata se sepalet, të kuqe ose rrallë ngjyrë limoni, në bazë me ose pa njolla të zeza. Thekët të shumtë. Fryti aken, 5 - 6 mm i gjatë.

V - VI.

Rritet në ara, livadhe etj. E përhapur.



Adonis flammea Jacq. - Adonisi i flaktë
Ranunculaceae - Zhabinore

Bimë barishtore njëvjeçare e cila mund të arrij një lartësi prej 20 - 40 cm. Ka rrënjë penjëzor.

Gjethet trefishpendore me segmente vizake

Lulet me diametër 20 - 30 mm, zakonisht me 5 sepale, kurse petale 5 - 8. Petalet me ngjyrë gjaku të flakët dhe kanë formë vizake - gjatore. Thekët të shumtë. Fryti akenë.

V - VI.

Ndeshet në vende me bar dhe toka të punuara, kryesisht në zona deri diku të larta.

I përhapur në Evropën e Mesme dhe Jugore. Bimë e helmët.



Adonis vernalis L. – Adonisi pranveror
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 40 cm e lartë. Ka rizomë të fuqishme me ngjyrë të murrme të mbyllët. Kërcelli i padegëzuar. Në fillim me qime e më vonë i shogët.

Gjethet dy deri katër herë pendore. Vrigujt e gjetheve të ngushta dhe lineare.

Në majë të kërcellit qëndrojnë lulet e vetmuara. Ato janë 3 - 7 cm në diametër. Kupa me 5 sepale. Numri i petaleve sillet prej 10 – 20, me ngjyrë të verdhë - ari. Fryti aken.

III - IV.

Rritet në vende të thata me diell në toka gurishtore me natyrë karbonate.



Adonis microcarpa DC – Adonisi frytvogël
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 – 100 (-200) cm e lartë. Nga rrënja e trashë zhvillohet kërcelli i drejtë, i degëzuar dhe i shëndosh.

Gjethet pëllëmbore thellë të ndara në 5 – 7 pjesë; të shogëta. Gjethet më të larta të ndara në më pak pjesë.

Lulesa e dendur, me qime. Lulet zigomorfe. Petalet me ngjyrë të kaltër - të mbyllur.

VII – IX.

Rritet afër rrjedhave të ujit të viseve malore, livadhe me lagështi etj. Të gjitha pjesët e bimës janë shumë helmuese; 2 gr. të rrënjës shkakton vdekjen.



Aconitum napellus L. – Akonita e kaltër
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore njëvjeçare, 10 – 40 cm e lartë.

Gjethet trefishpendore, me segmente vizake.

Lulet me diametër 15 – 25 mm. Sepalet të shogëta, vezake. Petale 5 – 8, shyta, gjatore, të kuqe të errët.

IV – V.

Rritet në toka të punuara, livadhe etj. Ka përhapje sporadike.



Anemone narcissiflora L.– Fillikatja lulenarcisi
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë shumëvjeçare pushlore.

Gjethet thellësisht të prera në segmente vizake të ngushta. Në pjesën e poshtme gjethet kanë bishta të gjatë.

3 - 8 lule sajojnë lulesë ombrellore. Segmente të rrethlules 5 - 6, në trajtë vezake. Pjalmoret të verdha.

VI - VIII.

Rritet në vende shkëmbore të zonave alpine dhe subalpine. Bimë e helmët.



Anemone halleri All. – Fillikatja e Halerit
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 12 - 25 cm e lartë. Ka rizomë të zhardhokët e të zeshkët.

Zhvillon 1 - 3 gjethe. Ato janë zakonisht dyfish të ndara tresh. Bishti i tyre hollak dhe i gjatë.

Lulet të vetmuara dhe kanë ngjyrë blu. Anteret e thekëve të verdheme ose të bardhë. Fryti aken. Ka formë eliptike.

III - IV.

Rritet në vende me bar, shkorrete etj.



Anemone apeninna L. – Fillikatja e Apenineve
Ranunculaceae - Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 5 – 30 cm e lartë. Kërcelli i ngritur dhe shumë leshtor.

Gjethet leshtore në të dyja anët që është përshtatje në kushte të ftohta, 5 – 7 cm të gjata.

Lulet të kuqe ose të kuqërreme e nganjëherë edhe të bardha që dalin para gjetheve ose së bashku me to.

V – VII.

Në zona subalpine ose alpine. E përhapur në jug të Francës dhe Zvicrës, në Itali, Poloni e deri në Greqi, Bullgari dhe Ukrainë.



Anemone nemorosa L – Fillikatja e pyjeve
Ranunculaceae - Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë të murrme, zvarritëse dhe të mishtë, 10 - 30 cm, me kërcej hollakë pak pushlorë.

Gjethet e bazës një deri dyfish të ndara tresh, me bisht të gjatë. Gjethet kërcellore të ngjashme me të bazës, por më të vogla.

Lulet të vetmuara. Segmentet e rrethlules ngjyrë trëndafili ose purpur në pjesën e poshtme, përsipër të bardha. Thekët të verdha. Fryti akenë. Akenët e kërrusur dhe pushlorë.

IV - VI.

Ndeshet në pyje, sidomos me ah, në vende me hije të zonave malore. Bimë e helmët.



Anemone ranunculoides L. – Fillikatja si zhabinë
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 7 - 30 cm e lartë. Rizoma ka vendosje horizontale, e murrme. Kërcelli i drejtë, gati i shogët.

Gjethet bazale me bishta të gjatë. Kërcelli me një qerthull me 3 gjethe; gjethet të ndara në 3 segmente. Segmentet me buzë thellësisht të dhëmbëzuar.

Lulet të vetmuara ose nga dy, rrallë 3 - 5. Rrethlulja ka 5 fletëza me ngjyrë të verdhë portokalli. Thekët të shumtë.

IV - V.

Rritet në pyje mezofile. Bimë tipike e pyjeve gjetherënëse.



Aquilegia vulgaris L. – Kanilqyqja e zakonshme
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcej luleshumë, 50 – 100 cm, gati të shogët deri leshtakë.

Gjethet e bazës dyfishtreshe. Gjethëzat të çara dysh ose tresh, të shogëta përsipër dhe leshtake përposh.

Lulet njëngjyrëshe, të kërrusura, zakonisht manushaqe, rastësisht të kuqe ose të bardha. Rrëshekthet gjëndërore – pushlore.

VI – VII.

Në vende me hije të paktë, vende gurishtore të zonave të larta malore. Bimë e helmët, sidomos farat. Kultivuesit e mbjellin si bimë zbukurimi.



Caltha palustris L. – Lëpushtra
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejt të shogët, zvarritës dhe rrënjëlëshues, ose të ngritur.

Gjethet në formë zemre ose veshke; të poshtmet me bisht, të sipërmet pa bisht.

Lulet kanë ngjyrë të verdhë të çelët. Thekët të shumtë.

IV - VIII.

Rritet në vende me shumë lagështirë, buzë ujërash të rrjedhshme të zonave malore.

Bimë e helmët.



Clematis alpina (L.) Mill. – Kulpra alpine
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë shumëvjeçare, 1 – 2 m e lartë. Kërcelli zvarritës, i drunjëzuar.

Gjethet e kundrejta të thjeshta deri dyfishpendore. Gjethëzat vezake – heshtore, ura – ura të sharruara.

Lulet të vetmuara. Bishtaku i lules i gjatë. Segmente të rrethlules 4 (5), manushaqe deri të kaltra të çelët, rrallë herë të bardha.

V – VI.

Në zona të larta pyjore, shkurrnaja etj.



Clematis integrifolia L. – Kulpra gjetheplotë
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 70 cm. Kërcejtë zakonisht të thjeshtë.

Gjethet të përkundërta, deri 9 x 5 cm, të thjeshta, vezake, të mprehta, të plota.

Lulet manushaqe të mbyllët deri blu, të vetmuara, rrallë 2 – 3, skajore, të kërrusura, kambanore – në formë ylli. Shtyllëzat të qëndrueshme, puplore dhe të gjata (si në foto).

VI – VII.

Në kullota alpine; e kemi hasur në Pashtrik. Bimë e helmët.



Clematis recta L. – Kulpra e drejtë
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë tulor. Kërcelli i drejtë, jo kacavjerrës, rrallë herë degëzohet, 1 – 1.5 m.

Gjethet të kundrejta, tekpendore. Gjethëza 3 – 7 rrallë 9, vezake, të plota, me 3 - 5 nervura.

Lulesa melth me shumë lule. Rrethlulja 4 – pjesëshe. Segmentet e rrethlules vezake të ngushta, ngjyrë qumështi; thekët të verdhë. Frytet gati të shogëta, me shtyllëza deri 2 cm të gjata.

VI – VII.

Rritet në pyje kodrinore (pyje të qarraziut).



Clematis vitalba L. – Kulpra e egër
Ranunculaceae - Zhabinore

Shkurre kacavjerrëse pak a shumë e drunjëzuar, me degëzime të holla që përdridhen në një bimë tjetër, kërcelli i hollë, 3 - 4 (8) m i gjatë.

Gjethet njëfishpendore, me 3 - 9 gjethëza vezake, dhëmbë – dhëmbë, ose gati të plota.

Lulet të bardha të grupuara në melth luleshumë. Segmentet e rrethlules pushlore në dy faqet. Thekët të shumtë. Fryti aken paksa i shtypur. Në kohën e frytëzimit shtyllëzat puplore.

V - VII.

Ndeshet nëpër gjerdhe, pyje e shkorrrete. Të gjitha pjesët e kulprës së egër janë helmuese me përjashtim të luleve. Bimë mjekësore. Lulet pëlqehen nga bletët.

Bimë njëvjeçare. Kërcejtë deri 50 cm të lartë, shumë të degëzuar, të shogët ose me qime të rralla.

Gjethet të ndara në segmente vizake.

Lulesa si melth i dendur ose shumë i çlirët. Të gjitha braktetë vizake, të plota. Segmentet e rrethlules zakonisht ngjyrë qielli të mbyllët ose manushaqe – qielli të çelët. Shpori 12 – 25 mm. Fryti rrëshekth. Farat të zeza.

VI – VIII.

Bar i keq në kulturat e të lashtave, e zakonshme.



Consolida orientalis (Gay) Schrodinger
– Konsolida e lindjes
Ranunculaceae - Zhabinore

Bimë shumëvjeçare, 5 - 30 cm, e degëzuar, e shogët. Rrënjët disa penjëzore, disa të trashura si zhardhok boshtor.

Gjethet gjerësisht vezake - si zemër, me buzë ura - ura ose rrallë dhëmbë – dhëmbë, të shogëta, ma qepujkëza në sqetulla.

Lulet me 3 (shumë rrallë deri 5) sepale barishtore. Petalet me ngjyrë të verdhë. Fryti aken. Akenët ovoidë, të fryrë, me karenë.

III – IV.

Në pyje dhe shkorrete, toka të punuara e vende me lagështirë. Bimë e helmët.



Consolida regalis S. F. Gray Konsolida mbretërore
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë njëvjeçare me kërcej të thjesht ose të degëzuar, deri 100 cm të lartë.

Gjethet e bazës të ndara në segmente vizake - gjatore, kurse ato kërcellore me segmente vizake.

Lulesa vile, relativisht e dendur. Braktetë e poshtme të prera. Braktezat zakonisht të puthitura me bazën e lules dhe e arrijnë ose e kalojnë atë. Segmentet e rrethlules purpur - manushaqe. Shpori 10 - 12 mm. Nektaroret me tre virguj; i sipërmi i çarë dysh. Fryti rrëshekth. Farat të kuqërremta.

VI - VIII.

Në toka të papunuara.



Ficaria verna L. – Lulari
Ranunculaceae – Zhabinore



Helleborus odorus W. et K. – Shpendra
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë mirë të zhvilluar, deri 60 cm e lartë.

Gjethet e bazës me 9- 15 segmente të ndara gati deri në bazë në 3-12 vriguj vizakë; e kalojnë dimrin. Gjethet e kërcellit për nga ndërtimi janë të ngjashme me gjethet e bazës, vetëm se më të vogla. Lule 2 - 3, të mëdha. Segmente të rrethlules 5, të gjelbra të çelëta. Gjethet mjaltore 8 - 12, në formë hinke. Fryti rrëshekth me disa fara.

II - IV.

Në vende me bar, pyje dhe shkorrete, deri në zonat malore, e zakonshme. Bimë e helmët.



Helleborus purpurascens W. et K. – Shpendra e kuqe purpur
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 35 cm e lartë.

Gjethet bazale nuk dimërojnë, pëllëmbore të ndarë gati deri në bazë në 5 segmente. Segmentet të ndarë në 2 – 5 vriguj të vegjël, përposh në fillim me qime.

Lulet 3.5 – 7 cm në diametër. Segmentet e rrethlules nga ana e jashtme ngjyrë vjollce të mbyllët, nga ana e brendshme të blertë – vjollce.

III – IX.

Në vende me shkurre, çeltira pyjesh të zonës subalpine dhe alpine. Në Kosovë ndeshet në Majën e Strellcit dhe Pleçe (Alpet Shqiptare).



Pulsatilla vulgaris Mill. – Pulsatila e zkonshme
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare; rizoma e fuqishme, e drejtë. Në kohën e lulëzimit kërcelli deri 15 cm i lartë, në atë të frytëzimit deri 40 cm.

Gjethet e poshtme zhvillohen pas lulëzimit; dy – trefish tekpendore; të sipërme vizake, me qime; bishtaku i gjatë.

Lulet të vetmuara, të drejta ose të lakuara. Gjethet e involukrumit me qime të argjendta – të bardha. Segmentet e rrethlules ngjyrë manushaqe – të mbyllur ose manushaqe – të çelur.

V – XI.

Në vende të thata dhe gurishtore, çeltira pyjesh etj.



Hepatica nobilis Miller – Hepatika fisnike
Ranunculaceae – Zhabinore

Shumëvjeçare, me kërçep të shkurtër, të trashë e të zeshkët.

Gjethet shpesh purpur përposh, si zemër në bazë, me 3 vriguj vezakë, me qime të mëndafshta kur janë të reja;

bishti 5 – 15 cm.

Lulet trëndafil, rrallë të bardha, në bazë me 3 brakte nënpetëlngjashme.

III – V.

Në pyje, sidomos me ah. Bimë e helmët.

Bimë barishtore shumëvjeçare, l0 – 30 cm. Rizoma e hollë, e degëzuar. Kërcelli i drejtë, i hollë, i butë, në pjesën e sipërme i degëzuar.

Gjethet bazale me bisht, të shogët, 2 – herë trishe. Gjethëzat ovale të gjera, me vriguj të sharrëzuar. Gjethet tjera të ngjashme me ato bazale. Më të sipërmet me dy ndajgjethëza të bardha lëkurore.

Lulet të vetmuara në bishta të gjatë e të hollë. Segmentet e rrethlules gjatore – vezake, të bardha.

III – IV.

Rritet në pyje mezofile, sidomos të ahut.



Izopyrum thalictroides L. – Vathtarja
Ranunculaceae – Zhabinore



Nigella arvensis L. – Nigela e arave
Ranunculaceae - Zhabinore



Nigella damascena L. – Nigela e Damaskut
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare , e shogët ose me qime të shtrira, me kërçep të cungët, ose me rizomë të trashë e plotë me pejza. Kërcejtë të ngritur, fyl.

Gjethet e bazës zakonisht shumë të ndara në segmente të ngushta, shpesh me njolla purpur të mbyllët.

Lulet të shumta. Sepalet të hapura, pushlore. Gjethet mjaltore me ngjyrë të verdhë ari. Akenët me buzë të theksuara; sqepi i shkurtër, grremçak.

V – IX.

Rritet në livadhe e kullota, në pyje e buzë rrugësh, më shpesh të zonave malore. Bimë e helmët dhe mjekësore.

Nigela e arave është bimë me kërcej të ngritur, 10 - 30 cm e lartë. Degëzat të gjata dhe të stërhapura.

Gjethet dyfish deri trefish pendore të prera me segmente vizake.

Lulet nuk rrethohen nga një pështjellë gjethore si te Nigela e Damaskut. Lulet janë me diametër 20 - 30 mm. Segmentet e rrethlules ngjyrë blu. Fryti rrëshekth i cili ka 3 nervura.

V – VII.

Rritet në ara, bregore të rrahura nga dielli deri në zonat malore.

Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcej të thjeshtë ose të degëzuar, deri 40 cm e lartë.

Gjethet dyfish deri trefish pendore. Në pjesën më të sipërme të kërcellit gjethet formojnë një pështjellë nën lulen.

Segmentet e rrethlules vezake – gjatore, me ngjyrë si në blu. Gjethe mjaltore 5. Thekët të shumtë. Fryti rrëshekth.

V – VII.

Në vende me bar, në bregore të rrahura nga dielli. Bimë mjekësore.



Ranunculus acris L. – Zhabina e mprehtë
Ranunculaceae - Zhabinore



Ranunculus bulbosus L. – Zhabina me qepujkë
Ranunculaceae - Zhabinore



Ranunculus degenii Kummerle et Jav. – Zhabina e Degenit
Ranunculaceae – Zhabinore



Ranunculus lanuginosus L. – Zhabina pushatake
Ranunculaceae - Zhabinore

Bimë shumëvjeçare deri rreth 50 cm, pushlore ose leshtore. Baza e kërcellit e fryrë si qepë; rrënjët jo të fryra, ose të trasha, të mishta, boshtake deri cilindrike.

Gjethet shumë a pak leshtake përsipër; të bazës të ndara tresh; segmenti i mesit me bisht të gjatë; të sipërmet pa bishtak.

Lulet me diametër 20 – 30 mm. Sepalet leshtore. Shtrati lulor pushlor, gati rruzullor deri i zgjatur konik.

IV – VII.

Në vende me bar, në kullota e vende me lagështirë, deri në zonat malore. Bimë e helmët dhe mjekësore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë zvarritëse. Kërcelli i shogët, me 1 – 3 lule.

Gjethet e jashtme të bazës me buzë ura – ura, veshkore.; kërcelloret gjithnjë të ndara thellë, me segmente të plota ngushtësisht heshtore të përmbysëta.

Lulet të vetmuara. Sepalet leshtake. Petalet të verdha. Shtrati lulor pushlor ose i shogët, paksa të shtypur, me karenë, me sqep të grremçuar.

VI – VIII.

Pranë vendeve që burojnë, në zonat alpine. Ballkanike.

Bimë shumëvjeçare, 30 – 50 (-60) cm, me kërçep të cungët. Kërcelli me qime të gjata të hapura, fyl, i degëzuar.

Gjethet pushlore; të bazës zakonisht sa të gjata të gjera, me dhëmbë të çrregullt; kërcelloret të ngjashme me ato të bazës, por më të vogla.

Lulet me diametër (15-) 20 – 30 (-40) mm. Gjethet mjaltore me ngjyrë portokalli - të verdhë.

IV – VIII.

Në pyje të rralla e livadhe.



Ranunculus crenatus W. et K. – Zhabina ura – ura
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Rrënjët anësore të shumtë, të shkurtër, dyformëshe; bimë me stolone. Kërcelli 20 – 50 cm i lartë, i drejtë, jo i degëzuar ose i degëzuar. E tërë bima me qime të argjendta – të murme.

Gjethet bazale me bisht dhe të ndarë në tre pjesë ose segmente. Segmentet vizake

- heshtore. Në pjesën e sipërme të kërcellit gjethet jo të ndarë.

Lulet të drejta. Sepale 5, vezake – heshtore. Petalet të verdha – ari. Akenët të shumtë.

V – VI.

Ndeshet në lëndina të thata me rërë, kodrina të vogla, kullota etj.



Ranunculus illyricus L. – Zhabina e Ilirisë
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë shumëvjeçare, e shogët, 4 – l0 cm.

Gjethet e bazës gati rrotullare, me bishtak, lehtësisht si zemër, me buzë ura – ura, nganjëherë me 3 vriguj në majë; kërcelloret l – 2, heshtore deri vizake.

Lule l – 2. Sepalet ngushtësisht vezake. Petalet të bardha, ovale ose të rrumbullakëta

VI – VII.

Rritet në vende ku shkrihet bora, në shkëmbinj të zonave alpine. Në Kosovë ndeshet në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare.



Ranunculus arvensis L. – Zhabina e arës
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë njëvjeçare, 15 – 60 cm, shumë a pak pushlore ose e shogët, e ngritur përpjetë, e degëzuar.

Gjethet e poshtme të thjeshta, të tjerat me 3 vriguj ose të prera tresh, shpesh të ndara përsëri në segmente të ngushta.

Lulet gjelbëroshe – të verdha. Sepalet të hapëta, pushlore.Fryti aken i gjembtë ose kokrrizor.

V – VII.

Në vende me lagështirë, buzë ujërash dhe si bar i keq në të mbjella.



Ranunculus millefoliatus Vahl. – Zhabina mijëgjethesh
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e ngritur, e thjeshtë ose e bigët, shumë a pak pushlore, –10 - 30 cm. Një pjesë e rrënjëve të trashura në formë zhardhoku.

Gjethet dyfish deri trefishpendore të prera, me vriguj të mprehtë, vezake – heshtore të shkurtër. Bishti i lules i trashë.

Lule l – 2. Sepalet të shogëta, të hapura. Gjethet mjaltore të verdha në dy faqet. Fryti aken. Akenet të rrumbulluar, me karen të gjerë në kurriz.

IV – VI.

Rritet në vende me bar, në toka të papunuara etj., kryesisht të zonave të ulëta.



Ranunculus montanus Wild – Zhabina e malit
Ranunculaceae - Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 5 – 50 cm e lartë. Kërcelli i drejtë, me qime ose i shogët.

Gjethet të shogëta ose gati të shogëta. Të poshtmet me bisht dhe të ndarë në 3 – 5 pjesë ose segmente. Gjethet kërcellore thellë të ndarë në 3 – 5 pjesë vizake – ovale, gati pa bisht.

Lulet të verdha – ari, l – 3 në krye të kërcellit. Sepalet leshtore. Fryti aken me sqep të shkurtër

V – VIII.

Rritet në livadhe malore subalpine. Në Kosovë ndeshet në Malet e Sharrit, Alpet Shqiptare etj.



Ranunculus psilostachys Griseb. – Zhabina kallivogël Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e thjeshtë ose pak e degëzuar, me rrënjë zhardhokore.

Gjethet, sidomos të rejat, me qime të mëndafshta krysisht përposh, të prera tresh, me segmente pykore – rombike të çara në 2 deri 3 vriguj të mprehtë.

Lulet të verdha. Sepalet të spërveshura në kohën e lulëzimit. Shtrati lulor i zgjatur, pak a shumë cilindrik në kohën e frytit.

VI – VII.

Rritet në vende me bar, kullota shkëmbore gëlqerore.



Ranunculus repens L. – Zhabina zvarranike
Ranunculaceae – Zhabinore



Ranunculus serbicus Vis. – Zhabina e Serbisë
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 30 cm, e thjeshtë, e shogët. Rrënjët të trashura në formë zhardhokësh.

Gjethet të rimta, të shogëta, më të gjera se të gjata, zakonisht 2.5 – 13 cm e gjerë, e plotë në bazë; gjethet e bazës të reduktuara në luspa; kërcelloret e sipërme të vogla, heshtore, kryesisht me 3 vriguj.

Lule 1 deri disa, të verdha. Sepalet të shogëta. Akenët të paktë, gati rruzullor.

VI – VII.

Në pyje të zonave subalpine, në kullota dhe shkëmbinj të zonave alpine. Bimë e helmet.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 15 – 60 cm, gati e shogët, me stolone të gjata rrënjëlëshuese. Kërcejtë shpesh të kuqërremtë.

Gjethet pushlore ose si të shogëta; të bazës trekëndëshe – vezake, të ndara tresh, segmenti i mesit me bisht të gjatë; kërcelloret më të vogla dhe më pak të ndara.

Lulet me sepale të hapura, pushlore. Shtrati lulor pushlor. Petalet e verdha në ar. Fryti aken.

III – V.

Në vende me lagështirë, buzë ujërash të rrjedhshme deri në zonat malore. Bimë e helmët dhe mjekësore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 100 cm, me rizomë të gjatë e të trashë.

Gjethet me qime të mëndafshta sidomos të rejat; të bazës të ndara në 3 segmente pykore, zakonisht me bisht; kërcelloret të ngjashme me ato të bazës, por më të vogla.

Lulet me diameter 15 – 25 mm. Nënpetlat të hapura. Shtrati lulor i shogët. Akenët të shtypur; sqepi gati i drejtë, më i shkurtër se akeni.

VI – VIII.

Në pyje të zonave subalpine.



Ranunculus thora L. – Zhabina tore
Ranunculaceae – Zhabinore



Ranunculus velutinus Ten. – Zhabina si kadife
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rrënjë penjzorë. Kërcejtë 40 – 80 cm, të ngritur, fyl, të degëzuar, të kreshpët ose nga baza leshtorë me qime të hapura.

Gjethet të mbuluara me qime të buta si kadife dhe me bisht pushlor. Të bazës vezake të gjera, të çara thellësisht tresh; kërcelloret të vogla, vizake ose vizake heshtore.

Lulet me diameter 15 – 25 mm, të verdha. Shtrati lulor i shogët. Nënpetlat të spërveshura nga poshtë.

IV – VI.

Në vende me lagështirë, në livadhe e vende me bar, deri në zonat malore.



Thalictrum aquilegifolium L. – Pipanolla me gjethe akileg
Ranunculaceae - Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të drejtë dhe të degëzuar, të shogët, me hulliza, 40 – 150 cm e lartë.

Gjethet dyfish – deri trefishtreshe me ndajgjethëza të vogla. Gjethëzat vezake dhëmbë – dhëmbë.

Lulet të vogla, të shumta, të grupuara në melth të degëzuar. Fijet e thekëve të gjera sa anteret me ngjyrë intensive violet ose jargavan. Fryti aken.

V – VII.

Rritet në shkorrete, në pyje të rralla dhe çeltira pyjesh. Bimë helmuese (sidomos rrënjët) dhe ngjyruese.



Thalictrum alpinum L. – Pipanolla e alpeve
Ranunculaceae – Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të shkurtër dhe të shtrirë. Kërcelli 5 – 15 (-20) cm, në bazë me mbetje të gjetheve të thata.

Gjethet zakonisht në rozetë, dy deri tre herë pendore të ndara; gjethëzat të rrumbullakëta ose vezake të ndara në 3 vriguj, të shogëta, lëkurore.

Lulet të vogla, të blerta – lila, të vetmuara ose të grupuara në lulesë.

VII – VIII.

Në vende shkëmbore të zonës alpine dhe subalpine. Në Kosovë ndeshet në Malet e Sharrit (Brod – Gjimibeg, Duska Reka etj.).

Bimë shumëvjeçare tufore, 60 – 120 cm.

Gjethet kryesisht pa bishtak, dyfish deri trefishpendore, jo me ndajgjethëza të vogla; gjethëzat të gjitha të plota, në faqen e sipërme të lëmuara; ato të gjetheve të poshtme vezake-pykore deri vizake-gjatore, ato të gjetheve të sipërme heshtore deri vizake.

Lulesa ovoide, degëzat e lulesës arrijnë gati në një lartësi të barabartë; lulet të verdha të zbehta, me erë. Thekët të drejtë, të verdhë të zbehtë, me pjalmore shytë.

VI – VIII.

Në vende me bar dhe me lagështirë deri në zonat malore.



Thalictrum minus L. – Pipanolla më e vogël
Ranunculaceae – Zhabinore



Trollius europaeus L. – Troli i Europës
Ranunculaceae - Zhabinore



Thalictrum lucidum L. – Pipanolla e ndritshme
Ranunculaceae - Zhabinore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, 25 – 120 cm, gati tufore ose me rizomë.

Gjethet e bazës trefishe deri katërfishe; gjethëzat gati rrotullare ose gjerësisht vezake, me vriguj të çrregullt ose dhëmbë – dhëmbë në gjysmën e sipërme.

Lulesa me degëza të gjata. Lulet në fillim të kërrusura, më pas të ngritura.

V – VII.

Në pyje, kullota e livadhe të zonave malore. Bimë e helmët.

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të padegëzuar, 30 – 60 cm e lartë.

Gjethet në pjesën e poshtme të kërcellit me bisht të gjatë, të ndara në 3 – 5 vriguj pykor (të vrigulluara thell dhe me dhëmbë si të sharrës). Në pjesët më të larta të kërcellit gjethet më të vogla, dhe pak a shumë pa bisht.

Lulet e verdha me diametër 3 – 5 cm, rruzullore. Gjethet mjaltore (thek të shnderruara në nektare) janë të gjata gati sa thekët dhe përbrenda kanë gjëndra mjaltore. Fryti rrëshekth me sqep. Farat të zeza.

V – VIII.

Rritet në livadhe me lagështirë të zonave malore.



Chelidonium majus L. - Tamblagjaku
Papaveraceae - Lulëkuqore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 - 90 cm e lartë.Kërcelli dhe pjesët tjera të bimës përmbajnë një lëng qumështor ngjyrë portokalli.

Gjethet e poshtme janë valë – valë pendore të ndara, kurse të sipërmet pendore të çara.

Lulesa është ombrellë e thjeshtë, zakonisht me 2 – 6 lule. Sepale dy, të verdheme. Petale 4, me ngjyrë të verdhë të çelët.Fryti kapsulë e zgjatur.

IV – verë.

Rritet në vende me hije, gjerdhe, shkorrete ranishtore etj. Bimë e helmët dhe mjekësore.



Corydalis bulbosa (L.) DC. – Koridali bulboz
Papaveraceae – Lulëkuqore

Bimë barishtore shumëvjeçare me zhardhok fyl ose të mbushur, zakonisht rrruzullor. Kërcelli 10 – 35 cm, jo me luspë nën gjethen më të poshtme.

Gjethet dyfishtreshe, të rimta të gjelbra, me gjethëzën e mesit pykore të zgjatur ose me bisht të gjatë.

Lule 10 – 20, në vile shumë a pak të dendur. Braktetë vezake, të plota. Kurora me shpor të përkulur në majë, ngjyrë si purpur, rrallë e bardhë, e bardheme deri krem ose e verdhë.

IV – V.

Rritet në pyje, shkorrete etj., kryesisht të zonave malore.



Corydalis ochroleuca Koch – Koridali verdhosh
Papaveraceae – Lulëkuqore

Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 40 cm, me rizomë.

Gjethet trefishpendore, të rimta në dy faqet, me bishtakë me flatër të ngushtë të qartë; gjethëzat zakonisht pykore – vezake të përmbysëta, të paktën disa të ndara në 3 vriguj.

Vilet deri me 14 (-22) lule të dendura. Braktetë gjatore – heshtore. Kurora krem (e verdhë e çelët), e verdhë në majë, me shpor si trastë.

IV – IX.

Në shkëbinj të zonave malore.



Bimë barishtore shumëvjeçare, 15 – 20 cm e lartë. Kërcelli dukshëm i degëzuar dhe merr pamje tufore.

Gjethet 2 – 3 fishpendore; segmentet vezake.

Lulet në vile shumë a pak të dendura, ngjyrë të verdhë – limoni.

V. IX.

Në shkëmbinj gëlqeror të zonave malore.

Corydalis lutea (L.) DC. – Koridali i verdhë
Papaveraceae – Lulëkuqore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me zhardhok të mbushur. Kërcelli zakonisht i vetmuar dhe i thjeshtë, l0 – 30 cm, me luspë vezake nën gjethen më të poshtme.

Gjethet krysisht dyfishtreshe. Segmentet më të fundit gjatore ose vezake të përmbysëta të ngushta ose vizake – heshtore.

Vilja me (4-) l0 – 20 lule. Të gjitha braktetë të vrigulluara. Kurora si purpur, me shpor paksa të përkulur. Fryti i kërrusur kur piqet.

IV – VI.

Rritet në vende me bar të zonave malore.



Corydalis solida (L.) Swartz. – Koridali i plotë
Papaveraceae – Lulëkuqore



Fumaria officinalis L. – Fomi mjekësor
Papaveraceae – Lulëkuqore

Bimë njëvjeçare e gjelbër ose e rimtë, nganjëherë kacavjerrëse, l5 – 30 cm. Gjethet dy deri trefishpendore të prera, me segmente të ngushta gjatore – vizake.

Vilja më e gjatë se bishti i saj, me l0 – 20 lule ose më shumë. Sepalet me dhëmbë të çrregullt. Kurora si purpur në trëndafili. Flatrat e petales së sipërme dhe maja e petaleve të brendshme të zeshkëta të kuqe. Fryti më i gjerë se i gjatë, gati anëngrënë.

III – IX.

Buzë gjerdheve, arave deri në zonat malore, e zakonshme. Bimë e helmet dhe mjekësore.



Papaver dubium L. – Lulëkuqja e dyshimtë
Papaveraceae - Lulëkuqore

Bimë barishtore njëvjeçare, e grathët dhe me qime, 20 – 60 cm. Kërcejtë të degëzuara.

Gjethet pothuajse të rimta, bazale pendore të prera me segmente të mprehta, në pjesën e sipërme vijnë duke u zvogëluar.

Lulet me bishta të grathët dhe me qime të shtrira. Sepale dy, të lira dhe rënëse. Petalet gati rrotullare, të kuqe të zbehta, rrallë të bardha, nganjëherë me njollë të zezë në bazë.Fijet e thekëve të holla dhe të purpurta. Anteret manushaqe. Fryti kapsulë ovoide. Disku krezor me 7 – 9 rreze.

III – VII.

Në vende barishtore, toka të punuara e të papunuara.



Papaver rhoeas L. - Lulëkuqja
Papaveraceae - Lulëkuqore

Bimë barishtore njëvjeçare, me lateks (lëng). Lëngu si qumësht i bardhë. Zhvillon kërcej të degëzuar, të grathët, 25 – 90 cm të lartë.

Gjethet 3 – 15 cm, njëfish deri dyfish-pendore. Në pjesën e poshtme të kërcellit gjethet me bisht, më sipër pa bisht.

Lulet të mëdha, me bishta të gjatë të pajisur me qime. Petale 4, rrotullare, të kuqe me njollë të errët në bazë. Fijet e thekëve të holla, purpur. Fryti kapsulë. Kapsula vezake ose rruzullore. Disku i krezës me (5 -) 8 – 12 (- 18) rreze.

IV – VII.

Rritet nëpër grunaja, vende me gurë e shkëmbinj, deri në zonat malore. Bimë e helmët dhe mjekësore.



Papaver somniferum L. - Hashashi
Papaveraceae - Lulëkuqore

Bimë barishtore njëvjeçare, gati e shogët, me kërcej fyl, pak të degëzuar, 100 (- 150) cm e lartë.

Gjethet 7 – 12 cm, të shogëta dhe të mbuluara me pluhur të rimtë; të pjesës së sipërme të kërcellit kërcellpushtuese.

Lulet e mëdha me petale të bardha deri purpur të cilat kanë njollë të zezë në fund. Kapsula ovoide, me vrima të vendosura rreth e përqark nën diskun krezor.

V – VII.

E kultivuar si bimë mjekësore.



Mahonia aquifolium Nutt. – Mahonia gjetheashje
Berberidaceae – Mëlqinore

Shkurre deri 2 m e lartë, përherë e blertë.

Gjethet tekpendore me 5 – 9 gjethëza. Gjethëzat lëkurore, nga sipër të shndritshme, anash valë – valë që mbarojnë me gjemb.

Lulet në lulesa vile dhe kanë ngjyrë të verdhë. Fryti rrushk, afër 8 mm në diametër, ngjyrë të kaltër në të zezë që përmban lëng të kuq.

II – V.

E kultivuar si shkurre dekorative dhe mjekësore me prejardhje nga Amerika Veriore.



Platanus orientalis L. – Rrapi
Platanaceae – Rrapore

Dru me lëvore të bardhë që ndahet pllaka – pllaka. Mund të rritet në lartësi deri 40 m.

Gjethet të këmbyera, pëllëmbore të çara thellë në 5 – 7 pjesë heshtore.

Lulet në lulesa njëseksore. Lulesat kanë trajtë sferike. Ato të gjinisë femërore 3 – 6, të varur në një bisht të gjatë.Frytet joçahëse të grumbulluara në lëmshuk.

IV – V.

Rritet në zalle lumenjësh, buzë ujërash në përgjithësi. Dru zbukurimi



Castanea sativa Miller – Gështenja
Fagaceae – Ahore

Dru monoik, gjethërënës, 30 (- 40) m i lartë, me lëvore të murrme të përhime me shumë të çara dhe me kurorë të gjerë madhështore.

Gjethet heshtore – gjatore, majëmprehta, me dhëmbë të mprehtë, me 12 – 20 palë nervura anësore.

Lulet mashkull dhe femër në të njejtën lulesë; të parat në pjesën e sipërme, të dytat përfundi. Lulet mashkull me rrethlule 6 pjesëshe dhe me 8 – 20 thekë; ato femër me rrethlule 5 – 8 –dhëmbëshe, zakonisht me 6 – 8 thekë shterpë. Fryte 1 deri 3, në një pështjellëz të mbuluar me gjemba.

V – VI.

Rritet në pyje shpeshherë duke formuar formacione më vete dhe e kultivuar.



Fagus moesiaca (K. Maly) Hayek – Ahu
Fagaceae – Ahore

Dru deri 30 m i lartë, me kërcell të drejtë e të plotë. Lëvorja e lëmueshme dhe e përhime.

Gjethet të plota, me majë të shkurtër, me 5 – 9 palë nervura anësore, rënëse, nga sipër të blerta të errëta, buzëve dhe mbi nervura me qime.

Lulet mashkull në lëvarëz me bisht deri 5 cm të gjatë. Lëvarëza me shumë lule. Lulet femër në lulesa 2 – 3 lulëshe me bisht të trashë e të shkurtër. Frytet trekëndore, gjembore dhe të drunjëzuara.

IV – V.

Rritet në pyje të pastërta (ahishte) ose në pyje të përziera. Çmohet për drurin me vlerë industriale.



Betula verrucosa Ehrh. – Mështekna
Betulaceae – Mështeknore



Quercus cerris L. – Qarri
Fagaceae – Ahore



Quercus frainetto Ten. - Shpardhi
Fagaceae – Ahore

Dru monoik gjetherënës deri 20 m me lëkurë të bardhë. Sythët me disa mëlluga të renditura si tjegulla. Degët e reja hollake, të shogëta, të varura, të pajisura me lythe rrëshinore të shumta.

Gjethet trekëndëshe ose rombike, majëgjata, me dhëmbë dyfish të sharruar, të shogëta, ngjitëse kur janë të reja.

Lulesat (gathët) mashkull formohen në vjeshtë. Lulesat femër me 3 lule pa kupë.

Lul. III – IV; fryt. VII – VIII.

Në pyje me lartësi mbidetare prej 700 – 1400 m. Si dru industrial përdoret për prodhim orendish bujqësore e shtëpiake, veglash sporti etj. Mbillet në parqe e rrugë si dru zbukurimi.

Dru deri 25 – 30 m i lartë, me lëvore të murrme të errët të çarë thellë për së gjati. Degët e reja të ashpra me qime të murrme ngjyrë ndryshku.

Gjethet gjatore – vezake të përmbysëta, të rrumbulluara ose gati si zemër në bazë, me 4 – 7 palë vriguj ose dhëmbë.

Lulet mashkull me 4 – 5 thekë pushlorë, në lëvarë deri 8 cm. Lulet femër dyshe ose edhe më shumë, në lulesa pushlore. Frytet piqen vitin e dytë, të vetmuara ose dy deri katër në një bosht. Gishtja me luspa të holla. Lendet me një thumb në mes.

IV – V.

Në pyje gjethegjerë.

Dru deri 30 m, me lëvore ngjyrë gështenje, të çarë pllaka-pllaka. Degët e reja pushbuta.

Gjethet të grumbulluara nga maja e degës, vezake të përmbysëta, me veshëza ose si zemër në bazë, thellësisht pendore, me 7 - 9 palë segmente shpesh të vrigulluara.

Lulet mashkull zakonisht me 5 - 10 thekë, në lulesa deri 12 cm. Lulet femër të shkurtra. Frytet 2 - 8 së bashku. Gishtjet pushlore. Lendet me majë shytë ose të cunguar.

Lul. IV – V; fr. IX – X .

Rritet në pyje aty - këtu duke formuar edhe formacione më vete.

Dru deri 20 m i lartë, me lëvore të përhimtë të errët të çarë pllakëza - pllakëza. Degët njëvjeçare të kuqërreme, leshtake.

Gjethet zakonisht vezake e të përmbysëta, me 3 - 7 vriguj, zakonisht të rrumbulluar në majë, me bisht 5 – 12 mm.

Lulet mashkull me 5 - 8 vriguj dhe me 8 thekë, në lulesa 5 – 10 cm. Lulet femër në lulesa lulepaka. Frytet 1 - 4 së bashku, pa ose gati pa bisht. Lendet cilindrike – vezë-ngjashme.

Lul . IV – V; fryt. IX – X.

Rritet në vende e kodra të thata.



Quercus pubescens Willd. - Bungëbuta
Fagaceae - Ahore

Dru gjetherënës i cili mund të rritet deri 40 m, me kurorë të gjerë dhe të degëzuar. Lëvorja në fillim e lëmuar më vonë me të çara.

Gjethet të shogëta, me 5 – 7 palë vriguj, me po aq nervura kryesore dhe të ndërmjetme.

Lulet mashkull në gathë 2 – 5 cm të gjata. Lulet femër me nga 3 kreza, të kuqe të zeza, të vetmuara ose në grupe deri në 5. Frytet me bisht të gjatë.

Lul.IV – V; fryt. IX – X.

Në pyje fushore, tjetërkund sporadike.



Quercus robur L. – Rrënja
Fagaceae – Ahore

Dru 15 – 18 m i lartë, me kurorë gati piramidore, dhe me lëvore të çara pllakëza – pllakëza.

Gjethet thahen në dimër dhe bien në pranverë, vezake - të përmbysëta - gjatore, gjirake – dhëmbë – dhëmbë, majëgjata; përsipër të shndritshme dhe gati të shogëta.

Lulet mashkull me 3 – 5 thekë, lulet femër me 4 – 5 shtyllëza. Frytet piqen vitin e dytë. Gishtja me mëlluga të shtrënguara në bazë, të përthyera në mes dhe të ngritura ose të lakuara në pjesën e sipërme.

IV – V.

Rritet në vende të thata gëlqerore me klimë mediterane dhe submediterane.



Quercus trojana Webb – Qarrazi, bujgër
Fagaceae – Ahore



Celtis australis L. - Caraca
Ulmaceae – Vidhore



Ulmus minor Miller – Vidhi
Ulmaceae – Vidhore



Alnus glutinosa (L.) Gaertner – Verri i zi
Betulaceae – Mështeknore

Druri deri 18 – 20 m, me lëvore të përhime dhe me kurorë të rrumbullakuar. Degët njëvjeçare pushlore, me sythë dimërues të vegjël.

Gjethet heshtore deri heshtore – vezake, majëgjata, me dhëmbë si të sharrës, përsipër të ashpra, përposh pushlore.

Lulet hermafrodite njëshe, ose dyshe. Lulet mashkull të tufëzuara, me 5 thekë të verdha. Frytet rruzullore, ngjurë vjollce të errët kur piqen.

Lul. III – IV; fryt. IX – X.

I rëndomtë nëpër ledhe arash, shkorrete e pyje të ulët të krahinave me klimë mesdhetare. Në Kosovë i rrallë. Ne e kemi ndeshur në hyrje të Studençanit (Therandë). Druri i tij përdoret për rrota qerresh, ski, rrathë, rrema, qyta pushkësh etj.

Druri deri 20 m, me kurorë të çrregullt, të gjerë, të çlirtë.Trungu pak a shumë cilindrik, me lëvore të murrme të përhime të errët, me të çara të thella për së gjati.

Gjethet zakonisht vezake të përmbysëta, vezake, asimetrike në bazë, me 7 -12 palë nervura anësore.

Lulet në tufa të ngjeshura, me 4 – 5 thekë dhe me kreza zakonisht të bardha. Frytet vezake të përmbysëta, me farë mbi qendrën e frytit.

Lul. II – III; fryt. V – VI.

Ndeshet si në kodra ashtu edhe në fusha

Druri deri 20 m i lartë, me lëvore të çarë, të murrme të errët. Degët e reja ngjitëse dhe të shogëta.

Gjethet eliptike – vezake të përmbysëta deri gati rrotullare, majëngrëna, nga fytyra të blerta të errëta, nga shpina kanë tufa qimesh të verdheme në sqetullat e nervurave.

Lulesat të formuara nga grupe lulesh. Lëvara mashkull me cima 3 lulëshe. Lëvara femër më e shkurtër. Frytesa vezëngjashme, 3 – 5 (-6) në çdo vile Frytet me flatra të ngushta.

Lul. II – III; fryt.IX – X.

Rritet në vende me lagështi, gjatë përrenjëve e lumenjve.

Dru deri 10 m i lartë, me lëvore të lëmuar. Degët e reja me push.

Gjethet vezake – heshtore, majëgjata, me dhëmbë të dyfishtë, pykore ose të rrumbulluar në bazë, nga ana shpinore pushbuta, të paktën kur janë të reja.

Gathët me fryta 3 – 5 në çdo vile, vezëngjashëm ose gati rruzullorë. Farat me flatra.

Lul.II – III; fryt. IX – X.

Rritet gjatë shtretërve të rrëkeve, përrenjve dhe lumenjve.



Ostrya carpinifolia Scop. - Mëllëza
Betulaceae - Mështeknore



Carpinus betulus L. – Shkoza e bardhë
Betulacae - Mështeknore



Alnus incana (L.) Moench – Verri i bardhë
Betulaceae – Mështeknore

Dru 10 - 12 m i lartë, me lëvore të murrme e të çarë. Degët e reja në fillim me qime, pastaj të shndritshme.

Gjethet rënëse, vezake - heshtore, me majë të shkurtër, por të mprehtë, me dhëmbë të dyfishtë si të sharrës.

Gathët mashkull cilindrik,të varur në tufa; ata femër skajorë, në trajtë boçeje. Frytesa gati cilindrike. Frytet akenë vezëngjashme. Pështjella frytore e plotë që mbaron me majë.

Lul . IV – V; fr. VIII – IX.

Rritet në pyje gjethegjera.

Dru deri 20 m i lartë, me lëvore të lëmuar ngjyrë hiri.

Gjethet vezake, majëgjata, në bazë gati si zemër, me dhëmbë të mprehtë të dyfisht si të sharrës. Kanë 11 – 14 palë nervura anësore.

Lulesat të varura, deri 5 cm të gjata. Frytesat 5 –14 cm. Pështjella frytore me tre vriguj nga të cilët i mesit shumë më i madh se anësorët. Fryti aken. Akenët vezëngjashme.

IV – VI.

Rritet e përzier me drunj të tjerë gjethegjerë.



Carpinus orientalis Miller – Shkoza e zezë
Betulacae - Mështeknore



Corylus avellana L. – Lajthia
Corylaceae - Lajthiore



Corylus colurna L.- Lajthia e egër
Corylaceae – Lajthiore

Shkurre ose dru i vogël me trung zakonisht të shtrembër e të brinjëzuar.

Gjethet 2 – 5 (7) cm të gjata, vezake të zgjatura, me maje të shkurtër por të mprehtë, në bazë të rrumbullakosura, më rrallë në trajtë zemre, me dhëmbë të dyfisht si të sharrës. Në pjesën e sipërme të shogëta, përposh me pak qime gjatë dellit kryesor.

Frytesa 3 - 5 cm e gjatë. Pështjella frytore trekëndëshe, me dhëmbë të imët.

III – V.

Rritet në pyje e shkorrete deri në lartësinë 1200 m.

Shkurre 2 – 4 m e lartë. Lëvorja ka ngjyrë të murrme dhe është e lëmuar.

Gjethet rrotullare, majëgjata, si zemër në bazë, me dhëmbë të dyfishtë si të sharrës. Në anën e poshtme me qime, sidomos në nervura.

Lulet shfaqen para gjethimit. Lulet mashkull të grumbulluara në lëvarë me ngjyrë të verdhë. Lëvarët qëndrojnë të varur. Lulet femër në formë të sytheve të dendura. Fryti aken. Frytesat me 1 – 4 fryte.

Lul.II – III; fryt. VIII – IX.

E hasim shpesh dhe gati kudo në kodra, male e gjerdhe.

Dru deri 20 (-20) m, me lëvore të përhime të verdheme dhe me kurorë të gjerë. Degët dyvjeçare të thyeshme, me lëkurë të tapëzuar dhe të ashpër.

Gjethet rrotullare, vezake të gjera ose vezake me majucë të zgjatur, si zemër në bazë, me dhëmbë të dyfishtë si të sharrës ose ura – ura, me 6 – 7 palë nervura anësore.

Lulesat të varura, deri 10 – 12 cm të gjata. Frytesat me 3 – 8 fryte.

Lul. II – IV; fryt. IX – X.

E rrallë, por gati kudo në male gëlqerore. Frytet janë të ngrënëshme dhe çmohet për drurin me ngjyrë të bukur që përdoret në zdrukthëtari.



Portulaca oleracea L. – Burdullaku
Portulaceae – Burdullakore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcej të dobët pushlorë deri 120 cm. Në pjesën e sipërme ngjitëse, me degëza të stërhapura.

Gjethet vezake, të thepëta, të plota, me bisht të shkurtër.

Lulet me këmbëza të shkurtra, në lulesë dypjellëse. Kupa gjerësisht kambanore, me 5 dhëmbë të gjatë shyte, të përveshur në kohën e frytit. Petale 5, gjelbëroshe - të bardha. Fryti si rrushk kur piqet, i zi, rruzullor.

VI - IX.

Rritet në vende me lagështirë, gjerdhe, shkorrete, kryesisht në zona të ulëta.



Cucubalus baccifer L. - Kukubali
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë njëvjeçare, l5 – 50 cm. Kërcelli i shogët, i mishtë, i degëzuar qysh në bazë, i kuqërremë.

Gjethet pa bisht, gjatore vezake të përmbysëta, shyta, të mishta, të shkëlqyera.

Lulet të vogla, të vetmuara ose nga 2 – 3. Sepale dy, të pabarabarta, barishtore, në bazë të ngjitura në një gyp të vogël. Rrethlulja 5 pjesëshe, e verdhë.

VII – IX.

Rritet në vende me bar, buzë rrugëve, në të mbjella si bar i keq i kulturave prashitëse. Gjethet e reja përdoren si sallatë.



Agrostemma githago L. - Egjra
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë barishtore njëvjeçare, me qime të bardha e të buta. Kërcelli 30 - 100 cm i lartë, i ngritur, i thjeshtë ose i ndarë në dy degë të barabarta

Gjethet zakonisht vizake, të mprehta, ose shyta vetëm të poshtmet.

Lulet e mëdha dhe të vetmuara. Sepale 5, vizake, më të gjata se petalet. Petale poashtu 5, ngjyrë trëndafili.

IV - IX.

Rritet në toka të punuara. Në kulturat e të lashtave bar i keq. Bimë e helmët



Dianthus armeria L. – Karafili armeria
Caryophyllaceae – Karafilore



Dianthus cruentus Griseb. – Karafili ngjyrëgjaku
Caryophyllaceae – Karafilore



Dianthus deltoides L. - Karafili deltoid
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë një ose dyvjeçare, 20 – 60 cm, pushlore ose rrallë e shogët, me kërcej të degëzuar ose rrallë të thjeshtë, të fortë.

Gjethet të holla, të sheshta, pushlore, zakonisht 1 – 3 mm të gjera, me 3 – 5 nervura; gjethet e bazës gjatore; kërcelloret vizake – të ngushta.

Lulet të vogla, gati pa këmbëza, në tufëza të dendura, me nga 2 – 8, të rrethuara me brakte barishtore si gjethe, të gjata sa lulet. Kupa pushlore, e gjelbër ose si purpur. Llapa e petlave të purpurta me pika të kuqe.

V – VII.

Në pyje, kodrina e vende me bar, në shkorrete e vende shkëmbore, kryesisht në zonat e larta malore.

Bimë shumëvjeçare, deri 100 cm, zakonisht si e rimtë.

Gjethet vizake, të sheshta, të shogëta. Këllëfët disa herë më të gjatë se diametri i kërcellit.

Lulet në kokë të dendur. Braktetë pushpaka, me hale, deri gati sa kupa. Luspat e mbikupës të kuqërremta – të murrme, me halë 5 – 10 mm. Kupa zakonisht e kuqërremtë – purpur. Llapa e petlave dhëmbë – dhëmbë., purpur e mbyllët.

VI – IX.

Në vende me bar, në shkorrete, vende me gurë etj. kryesisht të zonave të larta malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare,gati tufore, e gjelbër ose e rimtë, (10 -) 15 - 45 cm, me kërcej pushpakë, të degëzuar, të përpjetëm, me gjethe të dendura.

Gjethet të buta, pushlore. Gjethet e kërcejve jolulebartëse vizake - heshtore; ato të kërcejve lulebartës vizake, të mprehta.

Lulet të vetmuara, në melth të degëzuar. Llapa e petaleve me qime, dhëmbë – dhëmbë, trëndafil e mbyllët dhe me njolla të çelëta.

VI - VIII.

Në livadhe, vende me bar e kullota të zonave malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, me buca të rralla dhe bisqe të shkurtra. Kërcelli deri 30 cm, në pjesën e sipërme katërfaqësor.

Gjethet vizake, të ashpra, të shkurtra.

Lulet të vetmuara. Luspat e kupës së dytë gjethore, me majë të gjatë. Kupa e vërtetë me 5 dhëmbë që mbarojnë me gjemba të shkurtër. Petlat e kurorës të bardha, jo të dhëmbëzuara.

VI – VIII.

Në vende shkëmbore të zonës subalpine. Endemike e Ballkanit. Në Kosovë është e përhapur në Malet e Sharrit (Oshlak, Luboten) dhe Alpet Shqiptare.



Dianthus integer Vis. – Karafili i padhëmbëzuar
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare me buca të dendura dhe me rrënjë të drunjëzuara. Kërcelli 1 – 10 cm, pa gjethe ose me 1 - 2 palë gjethe.

Gjethet e poshtme 1 – 2 cm të gjata, 1,2 - 1,5 mm të gjera, pa majë.

Lulet zakonisht të vetmuara. Kupa e dytë me dy luspa, pak e larguar nga kupa e vërtetë lëkurore. Kurora me ngjyrë të purpurt.

VII – VIII.

Rritet në vende shkëmbore dhe me bar të zonës subalpine dhe alpine. Bimë endemike e Ballkanit.



Dianthus microlepis Boiss. - Karafili i vogël
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, tufore, 30 – 65 (-90) cm. Kërcelli lulor cilindrik, i shogët, në pjesën e sipërme i degëzuar.

Gjethet vizake – heshtore, të shogëta.

Lulesa melth, aromatike. Luspat e kupës së dyfishtë ovale. Nënpetlat gradualisht ngushtohen drejt majës. Petlat 20 mm të gjata, trëndafili të zbehta deri të kuqërremta, penjëzore të ndara.

VI – VIII.

Në livadhe të thata dhe me lagështi të zonë subalpine dhe alpine.



Dianthus superbus L. – Karafili madhështor
Caryophyllaceae – Karafilore



Saponaria sicula Rafin. – Sapunqyqja e tharë
Caryophyllaceae – Karafilore



Saponaria officinalis L. - Lule sapuni
Caryophyllaceae - Karafilore



Dianthus sylvestris Wulfen – Karafili i pyjeve
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë shumëvjeçare tufore, e drunjëzuar në bazë. Kërcejtë 5 – 60 cm, të shogët poshtë.

Gjethet ngushtësisht pallake deri vizake – heshtore, zakonisht të ashpra anash.

Lulesa zakonisht me degëza të këmbyera, leshtake. Kupa leshtake, me ngjyrë si më të kuqërremtë. Kurora e kuqe. Kapsula gjatore.

VI – VII.

Në kullota të zonave të larta malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërçep të shtrirë. Kërcejtë 30 - 90 cm, të ngritur, zakonisht të shogët, të thjeshtë ose të degëzuar sipër.

Gjethet vezake deri vezake - heshtore, me tre nervura.

Lulet të mëdha, të merme, të mbledhura në lulesa dypjellëse. Kupa gypore - cilindrike, e gjelbër ose e kuqërremtë, me dhëmbë trekëndësh të mprehtë. Kurora ngjyrë trëndafili të çelur (rrallë të bardha). Kapsula gjatore. Farat të rrudhëta me kokrriza të vogla.

VI - VIII.

Në shkorrete, shtrate lumenjsh e përrenjsh, deri në zonat malore. Bimë e helmet dhe mjekësore.

Bimë shumëvjeçare, tufore e dendur, 5 – 30 (-60) cm, si e rimtë ose e gjelbër. Kërcejtë të shogët ose pushpakë, sidomos poshtë.

Gjethet e bazës zakonisht të shumta, të gjelbra, hollake dhe shpesh të përkulura.

Lulet jo ose pak të merme.. Luspat e mbikupës 2 – 6, gjerësisht vezake – të përmbysëta, të cungëta ose majëholla, lëkurore. Kupa afërsisht cilindrike. Llapa e petlave e shogët, zakonisht trëndafil, dhëmbë – dhëmbë deri e plotë.

VI – VIII.

Në vende shkëmbore dhe të thata, në kullota të zonave malore, e zakonshme.



Lychnis coronaria L. - Lulengjitësja me kurorë
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcej të ngritur, shpesh të degëzuar, 30 - 100 cm e lartë.

Gjethet vezake deri vezake - heshtore, të mprehta.

Lulet të mëdha, me bishta të gjatë, 5 pjesëshe. Kupa gjatore, me 10 nervura të pabarabarta dhe me dhëmbë. Llapa e petales e purpurt, e plotë ose majëngrënë. Kapsula gjatore.

V - VIII.

Ndeshet në pyje, në vende me bar, me gur ose shkorrete, deri në zonat malore.



Lychnis flos-cuculi L. – Luleqyqe
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë shumëvjeçare me kërçep stolonbartës. Kërcejtë 20 – 90 cm, shpesh të degëzuar, veshtullorë, pak të kuqërremtë sipër.

Gjethet e bazës gjatore – pallake, me bishtak, shpesh të qerpikta në bazë; kërcelloret vizake – heshtore, të kundërngjitura në bazë.

Lulet me cimë dypjellëse të çlirët. Kupa kambanore e shkurtër, shpesh e kuqërremtë. Petalet me llapë të çarë në 4 ose 2 vriguj, zakonisht purpur të çelët ose të bardha.

IV – VII.

Në livadhe me lagështirë, deri në zonat malore.



Lychnis viscaria L. - Lulengjitësja
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 15 - 90 cm e lartë. Kërcelli në pjesën e sipërme veshtullor ose ngjitës.

Gjethet kryesisht bazale, vizake deri vezake - heshtore, me bisht të shogët, zakonisht me qerpikë në buzë.

Lulet në lulesa dikaze. Kupa kambanore - gypore me ngjyrë të kuqe të mbyllët. Kurora e purpurt, shumë rrallë e bardhë. Thekë 10; 5 janë diçka më të gjatë. Fryti kapsulë.

V - VIII.

Rritet në kopshte, vreshta, livadhe të thata, pyje të dushkut dhe të pishës.



Melandrium album (Mill.) Garcke - Melandra e bardhë
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare ose nganjëherë njëvjeçare. Kërcejtë deri 1 m të lartë, të degëzuar, zakonisht me qime të dendura dhe të buta.

Gjethet vezake ose vezake - heshtore, ato të kërcellit pa bishta.

Lulet të bardha, rrallë trëndafili, aromatike, hapen pas dite. Kupa e luleve mashkull zakonisht gjatore, me 10 nervura, ajo e luleve femër me 20 nervura. Fryti kapsulë.

IV - IX.

Rritet në gjerdhe, toka të punuara ose të papunuara, deri në zonat malore.



Minuartia verna (L.) Hiern - Minuarta pranverore
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare tufore. Kërcejtë të ngritur ose të përpjetëm, sipër me push gjëndëror, 5 - 20 cm të lartë.

Gjethet vizake - heshtore, të kreshpëta, me nervura, të plota.

Lulet në cima të çlirëta. Cimat me nga 1 deri me shumë lule. Bishtat e luleve më të gjata se sepalet. Sepalet me 3 nervura. Petalet sa ose më të gjata se sepalet. Anteret të verdha ose si purpur. Fryti kapsulë.

VI - VII.

Rritet në kullota, shkëmbinj gëlqeror të zonave të larta malore.



Moehringia muscosa L. – Mëhringa myshkore
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët. Kërcejtë 8 – 30 cm, të dobët, shpesh të shtrirë.

Gjethet ngushtësisht vizake deri në formë filli, të mprehta, me 1 – 3 nervura.

Lulet zakonisht 4 – pjesëshe, në cima (2-) 3 – 6 lulëshe. Nënpetlat heshtore, të mprehta, me buzë të gjerë cipëthatë. Petlat më të gjata se nënpetlat.

V – VIII.

Në shkëmbinj, mure e vende me lagështirë të zonave malore. Bimë zbukurimi e shkëmbinjve të lagur.



Cerastium pumilum Curtis – Cerasti shkurtabiq
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë njëvjeçare deri 14 (-20) cm, nganjëherë si e kuqërremtë, me kërcej të hapur ose të ngritur, me qime të shumta gjëndërore dhe me disa të tjera jogjëndërore.

Gjethet 4 – 15 mm, leshtake.

Lulet të vogla në cima të çlirëta. Bishtat e lules më të gjata se nënpetlat. Nënpetlat të mprehta, me buzë cipëthatë, me qime gjëndërore dhe jogjëndërore. Petlat sa ose paksa më të gjata se nënpetlat, të çara dysh deri në 1/ 4 e gjatësisë së tyre.

IV – VIII.

Në lëndina, në toka ranore, më shpesh në zonat malore.



Cerastium neoscardicum Niketic – Cerasti i Sharrit
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 12 – 30 cm, kërcelli me qime të gjata të buta.; pak a shumë e drunjëzuar në pjesën e poshtme. Gjethet e kërcellit eliptike të zgjatura ose heshtore, të gjelbra me qime të buta.

Lulesa dikaze e përbërë nga 3 – 10 (15) lule. Sepalet vezake – të zgjatura, të mprehta, me qime të dendura. Petalet të bardha, dy herë më të gjata se sepalet, të çara dysh.

VI – VIII.

Rritet në substrat serpentinor, vende me bar, kullota të zonave malore subalpine dhe alpine. Stenoendemike e Kosovës. Ndeshet në Malet e Sharrit – Ostrovicë (Maja e Pashallarëve).



Paronychia kapela (Hacq.) Kerner - Zgjonjobar kaptinor
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcej shumë të degëzuar, të shtrirë ose të përpjetëm, 5 - 15 cm.

Gjethet të afruara, shytë, me faqe të shogëta e buzë të qerpikta. Ndajgjethëzat vizake – heshtore.

Lulet në tufëza. Braktetë si argjend. Kupa me vriguj barishtorë, në kohën e frytit të përkulur.

VI - VII.

Ndeshet në vende të thata shkëmbore e gurishtore të zonave malore dhe alpine.



Silene asterias Griseb. - Klokëza yllore
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë shumëvjeçare, e shogët, e rimtë. Kërcejtë mund të rriten deri 100 cm të cilët janë të thjeshtë dhe në pjesën e sipërme veshtullorë.

Gjethet e bazës pallake. Gjethet kërcellore të pakta, heshtore, zakonisht të kundërngjitura.

Lulesa rruzullore, me brakte vemesore. Kupa cilindrike, e shogët, e kuqërremtë, me dhëmbë të mprehtë. Petalet me llapë gjatore, purpur të mbyllët. Fryti kapsulë.

VI - VII.

Në vende me bar të zonave subalpine.

Endemike e Ballkanit.



Silene nemoralis W. et K. – Klokëza e pyllit
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë barishtore shumë-vjeçare, shumë a pak pushlore, sidomos posht, veshtullore sipër. Kërcejtë 20 – 80 cm, të degëzuar.

Gjethet e rozetës heshtore – pallake; të sipërmet heshtore deri gati vizake.

Lulesa e çlirët, zakonisht luleshumë. Kupa gjëndërore – pushlore. Petalet zakonisht krem të bardha ose të bardha përsipër, të kuqërremta ose gjelbëroshe përposh.

IV – VII.

Rritet në pyje me lagështi, vende me bar, shkorrete e shkëmbinj.



Gypsophila spergulifolia Griseb. – Gjipsofila me gjethe spergule Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, dendësisht tufore. Kërcejtë 5 – 25 cm, shumë të degëzuar, të shogët poshtë, dendësisht gjëndërore – pushlore në lulesë.

Gjethet 5 – 15 x rreth 0.5 mm.

Kupa me qime gjëndërore të rralla. Petalet 2 herë më të gjata se kupa, purpur të çelët ose të bardha. Farat me kokrriza të fryra.

VI – VIII.

Në shkëmbinj të zonave alpine dhe subalpine. Endemike e Ballkanit. Në Kosovë është konstatuar në serpentinet e Mushtishtit (Bokat e Baçevcit) dhe në Guriç (Malishevë).



Silene ciliata Pourr. – Klokëza me qerpikë
Ccaryophyllaceae – Karafilore


Bimë barishtore shumëvjeçare, 5 – 15 cm. Kërcelli drunor.

Gjethet në rozetë, deri 15 cm në diametër, në formë karakteristike të jastekut.

Lule 1 – 5, të shogëta. Petalet janë karakteristike me një kthinë në majë si një lakesë.

IV – VI.

E përhapur në Gadishullin Iberik dhe Gadishullin Ballkanik



Silene conica L. - Klokëza konike
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë njëvjeçare, pushlore, me kërcej 5 – 50 cm.

Gjethet e poshtme gjatore ose vezake të përmbysëta deri vizake heshtore, të mprehta ose shyte.

Lulesa zakonisht në cima të dyzuara, me 5 – 30 lule. Kupa me 30 nervura, 8 – 18 mm, pushlore me qime të shkurtra, gjëndërore ose jo, cilindrike ose konike Llapa e petales trëndafil, rrallë e bardhë, e çarë dysh ose majëngrënë. Kapsula ovoide – konike.

IV – VII.

Në vende barishtore të thata, ranishte bregdetare, në shkëmbinj deri në zonat malore.



Silene exscapa All. – Klokëza kërcellshkurtër
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare e vogël, tufore me kërcej të shumtë të shkurtër njëlulesh.

Gjethet të gjitha bazale ose me një çift të gjetheve kërcellore vizake.

Lulet pa bishtak ose me bishtak të shkurtër. Sepalet të kuqërreme me dhëmbë heshtor. Petalet trëndafili të mbyllur.

VI – VIII.

Në zona të larta alpine të pyjeve shkëmbore.



Silene macrantha (P.) Neumayer – Klokëza Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcej deri 15 cm, gjëndëror – leshtakë.

Gjethet vezake të përmbysëta – heshtore; të bazës të vogla.

Lulet relativisht të mëdha. Kupa pak leshtake. Petalet zakonisht trëndafil, rrallë të bardha, me llapë vezake të përmbysët, të cungët, të plotë ose paksa majëngrënë.

VI – VII.

Në shkëmbinj të zonave alpine dhe subalpine.



Silene vallesia L. – Klokëza e Valais
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare tufore, me rizomë të drunjëzuar. Kërcejtë deri 15 cm, gjëndërorë- pushlorë, të thjeshtë ose të degëzuar.

Gjethet pushlore, vizake, 1 – 2 mm të gjera.

Lulesa me 1 – 3 lule. Kupa e zgjatur në formë çomange, gjëndërore – pushlore, me dhëmbë heshtorë – shytë. Petalet zakonisht të bardha, të çara dysh. Kapsula gjatore – konike.

VI – VIII.

Në shkëmbinj të zonave subalpine dhe alpine.



Silene paradoxa L. – Klokëza paradoksale
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e drunjëzuar në bazë, deri 60 cm e lartë. Kërcelli i degëzuar, i shogët ose pushlor, shpesh i rimtë, kërçepi me shumë koka prandaj nganjëherë tufore.

Gjethet vezake deri vizake, të shogëta, me qerpikë anash.

Lulet të vetmuara ose në cima, shpesh të kërrusura. Sepalet të bashkuara në formë gypi të fryrë, me 20 nervura. Petalet të bardha. Fryti kapsulë me shumë fara.

III - VIII.

Ndeshet në vende me bar dhe shkëmbore, në tokë të re përgjatë hekurudhës. Bimë mjekësore.



Silene vulgaris (Moench) Garcke - Klokëza e rëndomtë
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me push të hollë ose gati të shogët, ngjitëse në pjesën e sipërme. Kërcejtë 20 – 50 cm, të thjeshtë ose pak të degëzuar.

Gjethet e bazës heshtore deri heshtore – pallake; të sipërmet vizake.

Lulesa deri me 5 lule të ngritura. Kupa gjëndrore – pushlore, me dhëmbë heshtorë të mprehtë. Petlat të verdheme përsipër, të bardha përposh. Kapsula e gjatë, konike e ngushtuar në majë.

VI – VIII.

Në vende të thata, me gurë, në shkëmbinj të zonave malore.



Silene pusilla W. et K. - Klokëza shumë e vogël Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë deri 15 cm, të dobët, zakonisht të përpjetëm, sipër veshtullorë.

Gjethet vizake ose vizake - heshtore, 1 - 2 (-4) mm të gjera.

Lulesa zakonisht vile e thjeshtë, me lule të vogla, mbi bishta të gjatë dhe hollake. Kupa e shogët, me dhëmbë zakonisht shytë. Petalet të bardha, rrallë trëndafil ose jargavan.

VI – VII.

Rritet në shkëmbinj, buzë burimeve me ujë të zonave malore.



Petrorhagia saxifraga (L.) Link – Petrohagia iriqëz
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët ose pushlore e ashpër. Kërcejtë deri 45 cm, hollakë, të hapur – të ngritur.

Gjethet vizake – të fëndyellta, shumë a pak të zgjeruara në bazë.

Lulesa e çlirët, rastësisht e tufëzuar. Lulet zakonisht me 4 brakte. Kupa e shogët; dhëmbët gjatorë, shytë, me 1 nervurë. Petlat të bardha ose trëndafil, me llapë të ngushtuar gradualisht në thonjëz.

V – X.

Në vende të thata barishtore.



Petrorhagia glumacea (Bory & Chaub.) – Petrorhagia
Caryophyllaceae – Karafiklore

Bimë barishtore njëvjeçare deri 50 cm, e shogët, shumë a pak e thjeshtë. Gjethet zakonisht vizake - të mprehta, me këllëf gati sat ë gjatë të gjerë.

Lulet të vogla, në lulesë si kokë, me brakte shyta. Kupa gypore. Petalet me llapë të plotë, me buzë ura – ura ose e rripëzuar, purpur. Kapsolla zakonisht eliptike.

V – VIII.

Rritet në vende shkëmbore, kryesisht të zonave të ulëta ose mesdhetare.



Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë, 15 – 40 cm e lartë. Gjethet vezake-heshtore ose eliptike.

Lulesa me pak ose shumë lule. Petalet më të shkurtër se sepalet, të bardha, të ndarë në dy pjesë pothuajse deri në bazë. Thekë 10. Kapsula ndahet në 6 pjesë.

V – VII.

Në ahishte, hendeqe etj.

Stellaria alsine Grimm – Stelara ligatinash
Caryophyllaceae – Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të gjatë e të hollë. Bisqet sterile të shkurtër, kurse ato lulor të shumtë, 15 - 35 (-60) cm të lartë, të thjeshtë ose të degëzuar në pjesën e sipërme.

Gjethet 3 - 9 cm të gjata, heshtore deri heshtore - lineare.

Lulet në lulesa dikaze me brakte të gjelbër, anëve me qerpikë. Fletëzat e kupës 5. Kurora e bardhë me petale dy herë më të gjata se sepalet, gati deri në mes të ndara në dy pjesë. Fryti kapsulë.

IV - VI.

Rritet në pyje mezofile të dushkut.



Stellaria holostea L. - Stelara më e madhe
Caryophyllaceae - Karafilore



Stellaria media (L.) Vill. - Stelara e ndërmjeme
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me qime në pjesën e sipërme, 10 - 120 cm. Ka një kërcell të kërrusur, të thyeshëm, i cili në pjesën e poshtme lëshon rrënjë, kurse në pjesën e sipërme zhvillon degë lulor dhe jolulor.

Gjethet të brishta dhe të buta, vezake, të mprehta; të poshtmet me bisht, të sipërmet pa te.

Lulet e bardha dhe mjaft të mëdha, në lulesë dypjellëse. Sepalet të gjata pothuaj sa petalet.

V - IX.

Në vende me lagështirë, gjerdhe etj.



Nuphar lutea (L.) Sibth. et Sm. – Lëkoi i verdhë
Nymphaeaceae – Nimfeore

Bimë zakonisht njëvjeçare. Kërcejtë të rrumbulluar, të kërrusur ose të përpjetëm, deri 60 cm të lartë.

Gjethet e sipërme më të mëdha se të bazës, shumë a pak pa bisht; të poshtmet vezake, të mprehta ose të thepëta, me bisht të gjatë.

Lulesa me pak ose shumë lule. Sepalet gjatore. Petalet sa ose paksa më të shkurtra se sepalet, thellësisht të çara dysh. Kapsula ovoide. Farat me kokrriza konike, të kuqë -

rremta – të murrme.

II - X.

Në vende barishtore dhe djerrina, buzë rrugëve, kudo.



Stellaria aquatica (L.) Moench. -
Stelara ujore
Caryophyllaceae - Karafilore

Bimë barishtore ujore shumëvjeçare, me rizomë.

Gjethet notuese vezake, me bisht të gjatë, me gji të thellë në bazë; gjethet e zhytura të holla.

Lulet të vetmuara që dalin jashtë ujit. Sepale 4 – 6, të verdheme, 3 herë më të gjata se petalet. Petale 5 – 6, të verdha.

V – VIII.

Rritet në ujëra të ndenjura, këneta të cekëta, buzë liqenesh.



Chenopodium album L. - Minueri i bardhë
Chenopodiaceae - Kenopodiore



Chenopodium bonus – henricus L. – Pjerza
Chenopodiaceae – Kenopodiore



Polygonum alpinum All. – Nejca alpine
Polygonaceae – Nejcore

Bimë barishtore njëvjeçare. Kërcelli 10 - 150 (- 200) cm, i ngritur, i thjeshtë ose i degëzuar, pak a shumë i mbuluar me pluhur si miell.

Gjethet 2 herë më të gjata se të gjera, zakonisht të mbuluara me pluhur miellor, gjirake - të dhëmbëzuara, rrallë shumica të plota.

Lulet hermafrodite të grumbulluara në melth të ngushtë si kalli ose të hapura me degë vastakore. Thekë 5. Kreza 2. Farat të vendosura horizontalisht.

VII - X.

Në gërmadha, vende të shkreta, në ara si bar i keq në të gjitha zonat bujqësore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli i drejtë ose i përpjetëm, rrallë i degëzuar në bazë.

Gjethet të këmbyera, të mëdha, në bazë heshtake – shigjetore, zakonisht të plota.

Lulet hermafrodite ose vetëm femër, të grumbulluara në një lulesë piramidore të ngushtë. Rrethlulja me 4 – 5 pjesë, nuk e mbulon plotësisht frytin. Thekë 2 – 5.

V – VIII.

Bimë ruderale në kullota e livadhe subalpine, pranë staneve dhe vathave. Gjethet dhe kërcelli i ri mund të përdoren për ushqim si spinaqi.

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizoma të shkurtra, të trasha. Kërcejtë të shumtë, të drejtë, 30 – 80 (-120) cm, sipër të degëzuar.

Gjethet vezake – heshtore, në majë gradualisht të ngushtuara, me qerpik anash.

Lulet të bardha ose trëndafil të hapët, të vendosura në një melth të gjerë, të hapur pa gjethe. Fryti trefaqësh, i lëmuar, me brirë të mprehtë, 4 – 5 mm.

VI –VII.

Në vende të lagëta, shkëmbore me bar, buzë burimeve të zonës subalpine dhe alpine.



Polygonum aviculare L. – Bar pate
Polygonaceae – Nejcore

Bimë njëvjeçare. Kërcelli 20 – 80 cm, i shtrirë ose i drejtë, i thjeshtë ose i degëzuar, i blertë ose vjollcë i kuq, shpesh me njolla të kuqe, të theksuara.

Gjethet vezake deri vizake – heshtore, majëmprehta, pykore, që përfundojnë me bishtak 1 – 3 cm; faqja e sipërme shpesh me njollë kafe.

Lulet të bardha – bleroshe ose trëndafil, në kallinjë cilindrik, të ngritur ose më në fund të përkulur. Fryti në formë thjerrëze.

V – X.

Në vende me lagështirë, buzë kanaleve, zakonisht të zonave të ulëta



Polygonum lapathifolium L. - Nejca gjethelëpjetë
Polygonaceae - Nejcore

Bimë njëvjeçare. Kërcelli 20 – 60 cm, i drejtë , i shtrirë ose hipës, shumë i degëzuar.

Gjethet e kërcellit kryesor më shpesh 1.5 – 2 herë më të gjata se gjethet në sqetullën e të cilave vendosen lulet.

Lulet të vetmuara ose në tufa nga 2 - 6 në sqetullën e gjethes. Rrethlulja e çarë gati deri në fund në 5 pjesë, bleroshe me buzë ngjyrë trëndafili ose të bardha.

VI – IX.

Bimë ruderale, nëpër rrugë në vende me bar që shkelen. Bimë mjekësore. Frytet përdoren si ushqim për shpendët, si bar kullotet nga shpendët, sidomos nga patat.



Polygonum bistorta L. – Nejca e përdredhur
Polygonaceae - Nejcore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizoma të trasha, të përdredhura në formë të germës S. Kërcelli i drejtë, jo i degëzuar, i shogët, 10 – 100 cm.

Gjethet rrënjake gjatore – vezake ose gjatore – heshtore, shyta, bishti 4 – 30 cm; të mesit më të vogla, me bisht të shkurtër ose pa bisht.

Lulet trëndafili, të vendosura në kalli të dendur gjator dhe shyt.

V – VIII.

Në livadhe me lagështirë, në shpate gurishtore të lagëta, pranë burimeve me ujë të zonës subalpine. Bimë mjekësore.



Polygonum persicaria L. – Nejca gjethepjeshke
Polygonaceae – Nejcore

Bimë barishtore njëvjeçare. Kërcelli 2 - 80 (-120), i drejtë ose i përpjetëm, zakonisht i blertë, kur vjetrohet i kuqërremtë.

Gjethet gjatore ose gjatore – heshtore, më të gjera në mes, ngushtohen gradualisht në bazë në formë pyke, me bisht të shkurtër ose pa bisht, nga sipër me njollë kafe.

Lulet të vendosura në kallinj të dendur, cilindrikë ose gjatorë. Rrethlulja trëndafil, rrallë e zbardheme. Fryti trefaqësh ose në formë thjerrëze, i zi.

VI – IX.

Në moçalishte, buzë kanaleve, buzë rrugëve, në përgjithësi në vende me lagështirë.



Polygonum viviparum L. – Nejca gjallëpjellëse
Polygonaceae – Nejcore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Rizomat të trasha, në fund të mbështjella me mbeturina gjethesh. Kërcelli i drejtë, 5 – 40 cm, jo i degëzuar

Gjethet deri 10 cm, por zakonisht më të vogla, me buzë të kthyera; rrënjaket dhe të poshtmet eliptike, me bisht, kërcelloret heshtore, pa bisht.

Lulet të bardha ose trëndafili, në kalli skajor, të drejtë; në pjesën e poshtme në vend të luleve zhvillohen qepujka vezake, kafe, më rrallë e gjithë lulesa me qepujka.

VI – VIII.

Në kullota, livadhe e shpate subalpine.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 40 (60) cm. Kërcelli i vetmuar ose nga rizoma dalin kërcej të drejtë. Kërcelli nga mesi e sipër i degëzuar, nganjëherë i kuqërremtë.

Gjethet shigjetore ose vizake si shigjetë, të ndara tresh, të sipërmet shumë më të vogla se ato të mesit.

Lulesa melth i hapur. Flegrat gati të barabarta ose pak më të mëdha se fryti, vezake. Fryti trefaqesh, kafe i hapur, i lëmuar.

IV - VIII.

Në vende me bar, buzë rrugëve, në kullota e livadhe, e zakonshme.



Rumex acetosella L. - Uthëllnike
Polygonaceae - Nejcore



Rumex balcanicus Rech. F. – Lëpjeta e Ballkanit
Polygonaceae – Nejcore



Rumex acetosa L. - Lëpjeta e thartë
Polygonaceae - Nejcore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të drejtë e të lartë 30 - 100 cm.

Gjethet bazale dhe ato të pjesës së poshtme të kërcellit heshtake dhe me bishta të gjatë, pak të lëngshme. Ato më të sipërmet pa bisht dhe kërcellpushtuese.

Lulet njëseksore, të grumbulluara në qerthuj tuforë në degët e lulesës, kurse bima është dioike. Flegrat vezake si zemër e gati rruzullore, në fund me një lyth të vogël.

V - VII.

Në vende barishtore e shkëmbore të freskëta.

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të ngritur 60 – 120 cm; vetëm në pjesën e sipërme e degëzuar.

Gjethet mishnore të shogëta, të poshtmet pykore ovale – heshtore; të sipërmet të rralla, të ngushta pothuaj pa bisht.

Lulesa pa gjethe, ngjyrë të bardhë – trëndafili. Bishtat e luleve më të gjata se lulet.

Lul. VIII; fryt. VIII – IX.

Rritet në vende me lagështi të zonës subalpine. Bimë endemike e Ballkanit.



Rumex alpinus L. - Lëpjeta alpine
Polygonaceae - Nejcore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërçep të gjatë zvarritës. Kërcelli me bazë të drunjëzuar, i degëzuar qysh nga fundi, dredhak, i rimtë,20 – 25 cm.

Gjethet e bazës dhe ato të pjesës së poshtme të kërcellit heshtake, trekëndëshe, afërsisht aq të gjata sa të gjera.

Lulet poligame (në të njejtën bimë gjenden njëkohësisht lule hermafrodite dhe njëseksore), të vendosura nga 1 – 3 në tufëza mbi degët e lulesës në formë melthi pak të degëzuar. Lulet mashkullore të kuqërreme.

V – VIII.

Në vende shkëmbore të zonave subalpine dhe alpine.



Rumex scutatus L. – Lëpjeta shqyte
Polygonaceae – Nejcore

Bimë shumëvjeçare me rizome të shtrira horizontalisht. Kërcelli 50 - 100 cm.

Gjethet e bazës aq të gjata sa të gjera, anash lehtësisht të valëzuara, në bazë thellësisht si zemër, në majë të rrumbulluara; të sipërmet më të vogla.

Lulesa melth i dendur dhe mjaft i degëzuar. Lulet hermafrodite. Flegrat si zemër, jargavan të kuqërremta, pa lytha.

VI - VIII.

Buzë burimeve e përrenjve të zonave subalpine dhe alpine.



Rumex crispus L. – Lëpjeta kaçurrele
Polygonaceae – Nejcore

Bimë shumëvjeçare. Kërcelli 30 – 150 cm, i shogët, shpesh me ngjyrë kafe, i thjeshtë ose i degëzuar në pjesën e sipërme.

Gjethet valë – valë e me anë si kaçurrela, 4 – 5 herë më të gjata se të gjera, deri 30 (-35) cm; ato rrënjaket gjatore si heshtë, të ngushtuara ose të cunguara në bazë.

Lulet hermafrodite. Flegrat pak më të gjata se të gjera, vezake si zemër dhe majëmprehta, ngjyrë kafe – portokalli.

VI – VII.

Në vende me bar, buzë tokave të punuara e livadhe të zonave të ulëta.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 – 90 cm, me kërçep zhardhokor, me rrënjë të mishta.

Gjethet të ndara në shumë segmente. Segmenti skajor i gjethes 2 – 3 herë i çarë me dhëmbë të mëdha. Faqja e poshtme pak leshtore, përsipër me kreshta shumë të imëta përgjatë nervurave kryesore.

Lulet të mëdha 7 – 13 cm, të kuqe dhe në formë kupe. Fijet e thekëve po ashtu të kuqe. Fryti rrëshekth.

V – VII.

Në pyje të rralla dhe vende me bar të zonave malore.



Armeria alpina Willd. - Armeria e alpeve
Plumbaginaceae - Plumbaginore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rozetë. Kërcelli i fuqishëm dhe i drejtë, 30 - 40 cm i lartë.

Gjethet lineare me 3 nervura.

Lulesa e dendur, me formë rruzullore. Braktetë e pështjellës cipëthata. Kurora ngjyrë trëndafili, e përbërë nga 5 pjesë të ngjitura pak në fund.

VII - VIII.

Rritet në vende shkëmbore dhe me bar të brezit alpin.



Paeonia peregrina G. Anderson – Bozhure shtegtare
Paeoniaceae – Bozhurore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërçep zhardhokor, me rrënjë të mishta.

Gjethet dyfishtreshe ose me disa pak gjethe të ndara; segmente 9 – 16, ngushtësisht deri gjerësisht eliptike ose vezake, përposh të shogëta.

Lulet me diametër 8 -14 cm, të kuqe. Rrëshekthet 3 – 5, zakonisht pushlore, të rrumbulluara në majë, me krezë pa bisht.

V – VI.

Në vende me bar dhe kullota të zonave të larta malore.



Paeonia mascula (L.) Miller – Bozhure mashkull
Paeoniaceae – Bozhurore



Hypericum alpigenum Kit. – Lulebasani i alpeve
Hypericaceae – Hiperikore

Bimë shumëvjeçare, e shogët. Kërcejtë të fortë , cilindrikë, 10 – 50 cm, të ngritur nga një bazë zvarritëse e rrënjëzuse.

Gjethet të shumta e të afruara, vezake deri trekëndore – vezake ose eliptike, të pabisht, nganjëherë kër-cellpështjellëse, të plota.

Sepalet të thepëta, me shumë rruvi e pika të zeza sipërfaqësore. Petalet të verdha, me shumë pika të zeza në tërë sipërfaqen. Thekët të shumtë.

VI – VIII.

Në livadhe subalpine e alpine dhe pyje halore të rralla.



Hypericum barbatum Jacq. – Lulebasani mjekërosh
Hypericaceae – Hiperikore

Bimë shumëvjeçare, e shogët. Kërcejtë 10 - 40 cm, të shtrirë pastaj të ngritur.

Gjethet heshtore deri vizake hes-htore, të pabisht ose me bisht shumë të shkurtër.

Lulesa vastak. Sepalet të mprehta, me buzë thek - thekë, me shumë pika e rruvi të zeza. Petalet 1 - 2 herë më të gjata se kupa, me pika të zeza sipër-faqësore.

VI - VII.

Rritet në lëndina dhe vende me gur. Bimë e helmët.



Hypericum perforatum L. – Lulebasani
Hypericaceae – Hiperikore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 - 100 cm e lartë. Kërcelli në pjesën e sipërme shumë i degëzuar.

Gjethet zakonisht vezake deri vi-zake, të pabisht ose me bishtak të shkurtër. Në sipërfaqe kanë disa pika të shndritshme.

Lulesa vastak shumëlulor. Sepalet heshtore ose vizake. Petalet dy herë më të gjata se kupa, me pak pika të zeza anësore. Thekët më të shkurtër se petalet. Fryti kapsulë.

VI - VIII.

Rritet në shkorrete e kullota. Kudo e zakonshme. Bimë e helmët, ngjyruese dhe mjekësore.



Tilia platyphylos Scop. – Bliri gjethegjerë
Tiliaceae – Blinore

Shumëvjeçare barishtore pushlore deri 180 cm.

Gjethet të vrigullta pëllëmbore, shpesh deri në bazë, me 3 – 5 segmente heshtore ose vizake, të dhëmbëzuara jorregullisht dhe nganjëherë të vrigullta.

Lulet të vetmuara ose në grupe, mbi bishta lulorë sqetullorë. Segmentet e kupës vizake – heshtore. Sepalet vezake, të thepëta, të ngritura në frytë. Petalet të trëndafilta, 2 – 3 herë më të gjata se kupa. Pjalmoret të purpurta të kuqe.

V – VII.

Në vende me lagështirë, shkorrete, toka të punuara, djerrishte etj.



Althaea cannabina L. – Mullanjadhe kërpe
Malvaceae – Mëllagore

Dru deri më 40 m, me degë të hapura.

Gjethet të buta, gjerësisht vezake me majë të mprehtë, me dhëmbë si të sharrës, pushlore ose gati të shogëta, në sqetull të dellëzimeve të faqes së poshtme me tufa qimesh të bardheme.

Lulesa cimë e varur me 2 – 5 lule, zakonisht me 3. Fryti gati rruzullor, me perikarp drunor, pushlor, me 5 brinjë gjatësor.

Lul. V – VII; fryt. VIII – IX.

Në pyje me lagështi, lugina, shpesh me vidhe, frashër, ah. Bimë mjekësore dhe mjaltëse.



Althaea officinalis L. - Mëllaga e bardhe
Malvaceae - Mëllagore

Shumëvjeçare barishtore deri 200 cm, me push të dendur e të përhimtë.

Gjethet trekëndore - vezake të mprehta, me buzë ura - ura si sharrë, të pandara ose me vriguj pëllëmborë.

Lulet të vetmuara ose të grupuara në lulesa sqetullore dhe skajore. Sepalet vezake, të mprehta, të përkulura mbi fryt. Petalet lila të zbehtë në të bardhë. Pjalmoret të purpurta – të kuqe.

VI – IX.

Në vende me lagështirë, gjerdhe etj. Bimë mjekësore.



Althaea rosea L. – Mëllaga ngjyrë trëndafili
Malvaceae – Mëllagore



Hibiscus syriacus L – Hibisku i Sirisë
Malvaceae – Mëllagore



Hibiscus trionum L. – Bamja e qeve
Malvaceae – Mëllagore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli l – 3 m, pothuajse i shogët ose me qime kreshtake të rralla e të spërveshura, pjesët më të reja pushbuta.

Gjethet si zemër – rrotullare, me 3 – 5 vriguj të cekët.

Lulet të mëdha, gati të pabisht, në vile skajore kallingjashme. Segmentet e kupës deltoide deri trekëndore – heshtore. Petalet zakonisht të trëndafilta, por nganjëherë të bardha ose manushaqe.

V – VII.

E kultivuar si bimë zbukurimi dhe e natyralizuar.

Shkurre e ngritur, e degëzuar, 2 – 3 m e lartë.

Gjethet rënëse, 4 – 7 cm, rombike, dhëmbë – dhëmbë në gjysmën e sipërme dhe zakonisht me 3 vriguj, përposh me qime pushlore yjore të rralla.

Lulet e vetmuara në sqetull të gjetheve. Sepalet të bashkuara në gjysmën e poshtme. Petalet lila ose të bardha, me një njollë të purpurt të errët në bazë.

Lul. V – VII; fryt. VII – IX.

Bimë zbukuruese e parqeve.

Bimë barishtore njëvjeçare, pjesërisht e grathët. Kërcelli 10 – 50 cm,i ngritur, i degëzuar.

Gjethet 4 – 7 cm, të ndara pak a shumë deri në bazë në 3 (- 5) vriguj gjatorë – heshtorë dhe thellësisht pendorë të çarë.

Sepalet të bashkuara në shumicën e gjatësisë së tyre, me nervura të dallueshme të purpurta të errëta, shumë rritëse, membranore dhe si qeskë në fryt. Petalet të verdha të zbehta e me një njollë të purpurt të errët në bazë.

VI – IX.

Në toka të punuara si bar i keq i kulturave bujqësore.

Bimë barishtore njëvjeçare pak a shumë e grathët me qime të thjeshta dhe të bigëta. Kërcejtë deri 200 cm, të ngritur.

Gjethet bishtakgjata, me kontur si zemër deri rrotullare, me 5 – 7 vriguj dhëmbë – dhëmbë.


Lulet të vetmuara në sqetullat e gjetheve. Kupa gypore që çahet nga njëra anë gjatë lulëzimit dhe bie përpara pjekjes së frytit. Petalet të verdha të shndritshme, me një njollë të purpurt të errët në bazë. Fryti kapsulë 6 – 25 cm, vizakegjatore, e grathët.

V – VI.

E kultivuar si perime.



Hibiscus esculentus L. – Bamja
Malvaceae – Mëllagore



Abutilon theophrasti Medicus. – Pambuk i egër
Malvaceae – Mëllagore

Bimë barishtore njëvjeçare e ngritur, 50 – 150 cm, me pjesë më të reja pushbuta dhe ato më të vjetra pushlore me qime të thjeshta dhe yjore.

Gjethet 8 – 15 cm, bishtakgjata, si zemër – rrotullare, të thepëta, me buzë lehtësisht ura – ura.

Lulet në cima të vogla në sqetullat e gjetheve të sipërme. Sepalet të bashkuara në gjysmën e poshtme. Petalet të verdha. Fryti skizokarp. Merikarpet të zeza, të kreshpëta, zakonisht çahëse.

VI – IX.

Në toka të punuara si bar i keq dhe ruderale.



Malva sylvestris L. - Mëllaga e pyjeve
Malvaceae - Mëllagore

Bimë dyvjeçare ose shumëvjeçare deri 120 cm e lartë, me kërcej të ngritur ose të shtrirë, të drunjëzuar në bazë.

Gjethet kërcellore me 5 - 7 vriguj të thellë të llapës e me buzë ura - ura. Ato janë me madhësi të ndryshme.

Lule 2 - 6, në sqetullën e gjethes. Petalet 3 - 4 herë më të gjata se kupa, të trëndafilta deri të purpurta me nervura më të errëta.

V - VIII.

Rritet në djerrina, buzë rrugësh, kullota si dhe vende barishtore. Parapëlqen vende të thata dhe të pasura me azot. Bimë ngjyruese, mjaltëse, aromatike dhe mjekësore.



Ficus carica L. – Fiku Moraceae – Manore



Malva moschata L. - Mëllaga erëmyshku
Malvaceae - Mëllagore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e ngritur, 20 - 60 (- 80) cm e lartë. Kërcejtë në pjesën e poshtme me qime të kreshpëta, në pjesën e sipërme pushlore.

Gjethet e poshtme si zemër - rrotullare, me vriguj pak të thellë. Gjethet e sipërme pëllëmbore të prera, me 5 - 7 vriguj.

Lulet e poshtme të vetmuara në sqetullën e gjetheve. Sepalet vizake deri vezake të ngushta. Petalet të trëndafilta të çelëta, 20 – 35 mm. Gypi thekor me qime të gjata.

VI - IX.

Ndeshet në çeltira pyjesh, vende me bar e kullota të zonave malore.

Bimë drunore ose shkurre, 5 – 6 m e lartë. Lëvorja e leskosur, e përhime e çelët.

Gjethet të mëdha, të trasha, të ndara në 3 – 5 vriguj, në fund në formë zemre.

Lulesa me bisht të shkurtër e vendosur në sqetullën e gjethes, në formë dardhe. Lulet njëseksore, të mbyllura në një shtrat mishtor. Lulet mashkullore zënë pjesën e sipërme të shtratit dhe përzihen shpesh me lulet femërore në pjesën e poshtme të shtratit. Lulet femërore perigonin e kanë me 5 ndarje. Frytet akenë, të vendosura në shtratin mishtor të lulesës nga ana e brendshme (fryti i rremë).

V – VIII.

Bimë mediterane si natyrore ose e kultivuar.



Maclura pomifera (Raf.) C.K. Schneider – Maklura
Moraceae – Manore

Dru gjetherënës, 15 – 20 m. Degët me lëvore të blertë, me gjemba 1 – 2 cm.
Gjethet të lëmuara, të blerta, vezake, të plota, të thepëta, 5 – 12 cm, në fillim me qime të buta pastaj të shogëta.

Lulet femër të grumbulluara në një lulesë rruzullore. Sinkarpi (fryti) gati rruzullor, i përngjashëm me atë të portokallit, por me rrudha në sipërfaqe.

Lul. V – VI – fr. VIII – IX.

E kultivuar si dru zbukurimi; ka prejardhje nga Amerika Veriore (Teksas). Në Europë është sjell në vitin 1818.



Morus alba L. – Mani i bardhë
Moraceae – Manore

Dru deri 15 m i lartë, me degë të hapët, ngjyrë kafe.

Gjethet vezake, në majë të mprehta, në pjesën bazale të rrumbulluara deri lehtësisht në formë zemre. Faqja e poshtme e gjethes e shogët, vetëm në nervurë me qime.

Lulet të grumbulluara në lëvarë ose gath të ngjeshur e të shkurtër. Rrethlulja dhe kreza të shogëta. Frytet të bardha me bisht të gjatë.

IV – V.

I kultivuar. Ndeshet aty – këtu edhe i natyralizuar.



Morus nigra L .- Mani i zi
Moraceae - Manore

Dru deri 15 m. Degët të kuqërremta.

Gjethet në formë zemre, si të lëkurta, sipër të ashpra, poshtë pushlore, nganjëherë të vrigujta, anash me dhëmbë shytë, 6 – 20 cm.

Lëvara mashkull rreth 2,5 cm, ato femër sa gjysma e gjatësisë së tyre. Sinkarpet 2 - 3 cm, purpur të errëta, me bishta zakonisht të shkurtër. Frytet kanë shije të thartë - të ëmbël, hahen të freskëta, përdorën gjithashtu për pekmez e sidomos për raki.

Lul. IV – V; fr. VI – VII.

Kultivohet më pak se mani i bardhë.

Bimë barishtore shumëvjeçare deri 2 m e lartë. Rizoma zvarritëse. Kërcelli i drejtë katërfaqësor. Kërcelli dhe gjethet me qime gjëndërore që kanë qeliza përcëlluese.

Gjethet vezake, anëve të dhëmbëzuara.

Bimë dioike me individ vetëm me lule femërore dhe individë vetëm me lule mashkullore. Lulet mashkull në lulesa të drejta, kurse lulet femër në lulesa të kthyera teposhtë. Kanë kupë me 4 sepale dhe një gjinece. Fryti është një kokërr e vogël, vezake e shtypur.

V – IX.

Rritet me shumicë pranë banesave, në djerrina e pyje; ka përhapje të zakonshm. Bimë ushqimore dhe mjekësore.



Urtica dioica L. - Hithra
Urticaceae – Hithërore



Comandra elegans (Rochel) Reichenb. – Komandra
Santalaceae – Santalore

Gjysmëshkurre 15 – 30 (-50) cm me rizomë zvarritëse të drunjëzuar.
Gjethet vizake – eliptike deri heshtore.
Lulesa skajore me pak lule hermafrodite, me nga një braktezë; pjesët e rrethlules me ngjyrë si në krem të gjelbërt deri më të bardheme.
Fryti vezak i gjerë ose sferik.
Lul. V – VI; fr. X.
Në vende të thata me bar të zonës së makies dhe të dushkut, e rrallë.



Parietaria officinalis L. – Karafileigjen mjekësor
Urticaceae – Hithërore

Bimë shumëvjeçare. Kërcelli 30 – 100 cm, i ngritur, jo ose pak i degëzuar, pushlor.

Gjethet heshtore, eliptike ose vezake – heshtore, majëgjata, të plota, të shogëta nga sipër, me qime nga poshtë dhe anash; bishtat më të shkurtër se llapa; braktezat të lira.

Lulesa rruzullore shumëluleshe; lulet e poshtme femër, të tjerat hermafrodite ose mashkull.

V – X.

Në shkorrete shumë a pak me lagështirë, gërmadha e mure të zonave të ulëta. Bimë mjekësore.



Humulus lupulus L. – Sumbullari
Cannabaceae – Kërpore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë të gjatë. Kërcelli dredhës, 3 – 8 m.

Gjethet të përkundërta, pëllëmbore me 3 –5 vriguj ose të sipërmet të plota, në fund si zemër.

Bimë dioike.Lulet mashkull me rrethlule 5 pjesëshe, të grumbulluara në një melth të hapët. Lulet femër me rrethlule në trajtë qeske që rrethon vezoren, të grumbulluara në lulesë në trajtë boçeje.

VI – IX.

Rritet në gjerdhe të freskëta të zonës së ulët dhe e kultivuar. Boçet përdoren në industrinë e birrës dhe mjekësi.



Arceuthobium oxycedri (DC.) Bieb. – Velli
Loranthaceae – Evullore

Shkurrëz e vogël deri 20 cm. Tërë bima ka ngjyrë të blertë në të verdhë. Kërcejtë të degëzuar në pjesë të shkurtra, gjegjësisht shumë herë dikotomik.

Gjethet të vogla, trekëndëshe, në trajtë luspash.

Lulet mashkull të vetmuara, në majë të degëzave të shkurtra. Lulet femër 1 - 2, skajore dhe sqetullore.

VI - VIII.

Bimë gjysmëparazite mbi dëllinjën e kuqe e të zezë.



Loranthus europaeus Jacq. – Evulla
Loranthaceae – Evullore

Shkurrëz e vogël, 15 – 50 cm e gjatë dhe e degëzuar.

Gjethet rënëse, 1 - 5 cm të mëdha, të plota, lëkurore, me ngjyrë të blertë të errët.

Lulet njëseksore dhe aktinomorfe. Ato mashkull kanë 4 - 6 thekë të ngulur në bazën e petaleve. Fryti rrushk me lëngë ngjitës; i verdhemë, me diametër deri 10 mm.

V - VIII

Bimë gjysmëparazite e cila rritet mbi degët e dushkut, gështenjës ose pishës.

Barishtore shumëvjeçare, me kërcej 15 - 40 cm.

Gjethet vezake deri heshtore, me buzë ura - ura. Ndajgjethëzat të qerpikëta, pendore të çara.

Lulet hermafrodite, të vetmuara. Sepalet të gjera në bazë, të qerpikëta. Kurora e verdhë me shpor hollak e të drejtë. Shtyllëza bërrylake në bazë, e kokët, me një të hapur të gjerë krezore.

VI – VII.

Në livadhe e kullota malore dhe subalpine. Endemike e Ballkanit.

Shkurre deri 100 cm.Kërcelli i degëzuar në mënyrë dikotomike, i blertë në të verdhemë.

Gjethet të lëkurta, vezake – gjatore ose heshtore, gjithmonë të blerta, 2 8 cm, me 5 – 6 nervura paralele.

Lulet njëseksore, të verdha të blerta, të grumbulluara në cima pa bisht ose me bisht shumë të shkurtër. Fryti me diameter 6 – 10 mm, sferik, i bardhë, rrallë i verdhë, ngjitës.

Lul. III – V; fryt. X..

E zakonshme në zonat e ulëta dhe subalpine. Bimë gjysmëparazite mbi drurë, mbi pisha, bredha, dushqe etj. Bimë mjekësore.



Viscum album L. – Veshtulla
Loranthaceae – Evullore



Viola aetolica Boiss. et Heldr. – Manushaqja e Etolisë
Violaceae – Manushaqore

Shumëvjeçare barishtore, 5 – 15 cm, me rizomë të shkurtër. Nxjerrin stolone të gjata, hollake, të përpjetme, jorrënjëzuese, të cilat lulëzojnë në vitin e dytë.

Gjethet vezake, si zemër në bazë, të qëndrueshme gjatë dimrit. Gjethet pranverore reth 5 cm, ato verore 10 – l5 cm. Braktetë vendosen në mes ose mbi mesin e bishtit lulor.

Lulet aromatike, të bardha ose vjollcë. Petalet anësore mjekëroshe, të drejtuara nga poshtë. Shtyllëza me sqep në majë. Kapsula rruzullore.

III – V.

Rritet në çeltira pyjesh dhe shkorrete.



Viola alba Besser. – Manushaqja e bardhë
Violaceae – Manushaqore

Barishtore njëvjeçare, 10 – 40 cm, e degëzuar, pak a shum e ngritur.

Gjethet gjatore - pallake, me buzë ura - ura. Ndajgjethëzat pendore të çara, me segmentin skajor heshtor.

Lulet me petalet e poshtme krem deri të verdha, ndërsa të tjerat krem deri kaltëroshe - manushaqe. Sepalet heshtore. Fryti kapsulë, i shogët.

III - IX.

Në toka të punuara, vreshta etj.



Viola arvensis Murray – Manushaqe arash
Violaceae – Manushaqore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli 20 – 40 (50) cm i lartë, i drejtë dhe i fuqishëm.

Gjethet 3 – 7 x 1 – 2 cm, vezake – shigjetake. Ndajgjethëzat të mëdha, 2 – 3 cm të gjata.

Lulet zhvillohen në sqetull të gjetheve dhe arrijnë lartësinë e tyre. Sepalet shigjetake. Petalet me ngjyrë të kaltër – të çelët.

V – VI.

Në livadhe me lagështi, gëmusha etj.



Viola elatior Fr. – Manushaqja e lartë
Violaceae – Mamushaqore



Viola biflora L. – Manushaqja me dy lule
Violaceae – Manushaqore

Bimë barishtore shumëvjeçare 5 – 20 cm e lartë. Kërcej 1 ose 2, të shogët, me 2 – 4 gjethe.

Gjethet bazale me bishtak 4 – 12 cm, veshkore të gjera, baza si zemër e thellë; gjethet kërcellore me bishtak të shkurtër, llapa vezake ose veshkore.

Lulet të vogla; bishti i lules 2 – 3 cm. Sepalet heshtore. Petalet ngushtësisht vezake të përmbysëta, të verdhërreme.

V – VI.

Në shkëmbinj, në vende të papërshtatshme malore me lagështi të zonave subalpine dhe alpine. Tek ne e përhapur në Alpet Shqipëtare.



Viola dukadjinica W. Becker et Kosanin – Manushaqja e Dukagjinit
Violaceae – Manushaqore

Bimë barishtore shumëvjeçare tufore, e shogët, me kërcell të shtrirë 5 – 10 cm.

Gjethet vizake ose gjatore – pallake, 1.5 – 3 cm, të plota. Bishtaku i shkurtër. Ndajgjethëzat si gjethe, por më të shkurtra, të plota, rrallë me 1 – 2 rripëza në majë.

Lulet të mëdha, rreth 2 cm të gjera, të verdha. Petalet anësore të drejtuara nga lartë. Shpori 10 – 20 mm, hollak, i verdhë ose manushaqe.

VII – VIII.

Në kullota dhe shkëmbinj serpentinor të zonës subalpine dhe alpine. Endemike e Kosovës dhe Shqipërisë. Në Kosovë tash për tash është vënë re vetëm në Bjeshkët e Mushtishtit (Ostrovicë).



Viola elegantula Schott. – Manushaqja pak elegante
Violaceae – Manushaqore

Shumëvjeçare barishtore 10 – 30 cm, e shogët ose pak pushlore.

Gjethet e poshtme rrotullare, të sipërmet vezake – heshtore ose heshtore. Ndajgjethëzat vezake , të ndara pendore, me 4 – 10 segmente në anën e jashtme dhe 2 – 4 segmente në anën e brenshme.

Petlat jo shumë të gjera, ngjyrë manushaqe ose të verdha, anësoret të drejtuara nga lart. Shpori i drejtë ose lehtësisht i përkulur, hollak.

VI – VII.

Në kullota subalpine dhe alpine.

Endemike e Ballkanit.



Viola kitaibeliana Schultes – Manushaqja e Kitaibelit
Violaceae – Manushaqore

Bimë barishtore njëvjeçare, 2 – 10 cm e nganjëherë deri 20 cm e lartë.

Gjethet e poshtme kanë formë rrotullare. Të tjerat gjatore - pallake, me buzë ura - ura si vriguj dhe me segmente anësore të vogla.

Lulet të vogla. Sepalet heshtore, më të gjata se petalet. Petalet krem deri të verdha, të sipërmet të bardha ose vjollcë. Shpori është pak më i gjatë se shtojcat e kupës.

III - VI.

Rritet në vende të thata barishtore.



Viola odorata L. – Manushaqja
Violaceae – Manushaqore

Bimë shumëvjeçare barishtore, 5 - 15 cm e lartë; stolonet të gjata e të holla, të shtrira e të rrënjëzuara.

Gjethet rrotullare - veshkëngjashme, thellësisht si zemër në bazë.

Lulet aromatike, ngjyrë vjollce të errët. Sepalet vezake. Petalja e poshtme me shpor. Fryti kapsulë rruzullore.

III - VI.

Rritet në shkorrete, gjerdhe dhe vende barishtore.



Viola orphanidis Boiss - Manushaqja e Orfanidhit
Violaceae - Manushaqore

Shumëvjeçare barishtore , leshtake. Kërcejtë deri 50 cm, të shumtë, të përpjetëm.

Gjethet 2 – 4 cm, vezake ose rrotullare, nganjëherë gati si zemër, me buzë ura - ura ose të sharruara. Ndajgjethëzat 1 – 2 cm, vezake, të pjerrëta, thellësisht të dhëmbëzuara ose të ndara gati pendore me segmetin skajor më të madh se të tjerat.

Lulet 2 cm. Petalet blu, e poshtmja me një njollë të verdhë, anësoret të drejtuara nga lart. Shpori hollak dhe i përkulur.

VI – VII.

Rritet në kullota subalpine dhe alpine. Endemike e Ballkanit.



Viola reichenbachiana J. Ex B. – Manushaqja e Reikenbakut
Violaceae – Manushaqore

Shumëvjeçare barishtore 10 – 20 cm, me kërcell qendror të shkurtër, rozetë gjethesh bazale dhe kërcej lulorë sqetullorë.

Gjethet 2 – 4 cm, gati aq të gjata sa edhe të gjera, si zemër në bazë, gati të mprehta. Ndajgjethëzat e gjetheve kërcellore heshtore të ngushta, thekë – thekë.

Lulet 1.2 – 1.8 cm. Sepalet të mprehta. Petalet të ngushta, ngjyrë manushaqe shpesh më të errëta në bazë. Shpori hollak, i drejtë, manushaqe i errët.

IV – VI.

Në pyje fletore dhe vende me hije.



Viola riviniana Reichenb. – Manushaqja e Rivininit
Violaceae – Manushaqore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 20 cm e lartë. Ka gjethe bazale dhe kërcell qendror të shkurtër, rozetë gjethesh bazale dhe kërcej lulorë sqetullorë.

Gjethet nga shumë të vogla deri rreth 4 cm, si zemër në bazë, gati të mprehta. Ndajgjethëzat e gjetheve kërcellore heshtore, thekë – thekë.

Lulet me sepale të mprehta. Petalet të gjera, kaltroshe – manushaqe. Shpori i bardhemë ose i purpurt i çelët.

IV - VII.

Rritet në pyje gjethegjerë dhe kullota.



Viola tricolor L. – Manushaqja tringjyrëshe
Violaceae – Manushaqore



Passiflora caerulea L. – Lule sahati
Passifloraceae - Pasiflorore



Fumana bonapartei Maire et Petitm. – Fumana e Bonapartit
Cistceae – Mënishtore

Bimë një ose dyvjeçare, 10 – 30 cm e lartë, me kërcej të shtrirë në fund, pastaj të ngritur përpjetë.

Gjethet e poshtme si zemër, me buzë ura - ura, të sipërmet vezake deri heshtore, me buzë ura - ura.

Lulet ngjyrë manushaqe, të verdha, ose të përlyera. Petalet anësore të drejtuara nga lartë. Shpori deri dy herë më i gjatë se shtojcat e kupës.

V - VII.

Rritet në vende me bar, shkorrete e çeltira pyjesh deri në zonat alpine. Bimë mjaltëse, aromatike e mjekësore.

Shkurre kacavjerrëse, 2 – 8 m, e shogët, me kërcej dredhës, me loze sqetullore.

Gjethet të qëndrueshme, të këmbyera, lëkurore dhe të shkëlqyeshme përsipër, me llapë pëllëmbore të përbërë nga 5 – 7 vriguj.

Lulet hermafrodite, të vetmuara. Sepalet të lira ose të ngjitura në bazë. Petalet të bardha ose ngjyrë trëndafili të zbehtë. Kurorëza, e formuar ndërmjet petaleve dhe thekëve, nga 1 ose më shumë rrathë gjethesh të holla, në ngjyrë të purpurt të zbehtë në bazë, të bardhë në mes, si të purpurt – blu në majë. Thekë 5, me pjalmore të mëdha.

VII – IX.

E kultivuar në kopshte e parqe. Amerikanojugore.

Bimë gjysmëshkurre, me lartësi 5 – 20 cm, e degëzuar që nga baza. Degët e vjetra të shtrira, ndërsa ato të rejat të ngritura, në pjesën e poshtme të mbuluara me qime të shkurtëra.

Gjethet të këmbyera, të ngushta, lineare, të drejta.

Lulesa me 3 - 7 lule të verdha. Thekë shumë. Fryti kapsulë e cila hapet me tri të çelura dhe përmban 6 fara të rrudhura.

VI - VII.

Rritet në vende të thata, kullosa, shkorrete me natyrë serpentinore. Bimë endemike e Ballkanit.



Fumana procumbens Gren. et Gord. – Fumana e shtrirë
Cistaceae – Mënishtore

Gati shkurrëz, 8 – 20 (-40) cm, me rizomë të drunjëzuar dhe degë të shtrira – të hapura.

Gjethet të këmbyera, pa ndajgjethëza, vizake, të mprehta.

Lulet të vetmuara në sqetull të gjetheve të zakonshme. Petlat të verdha. Fryti kapsulë e përkulur me 8 - 12 fara.

V – VII.

Në vende gurishtore e vende të thata dhe shpate me gurë.



Helianthemum alpestre (Jacq.) DC. – Heliantema e alpeve
Cistaceae – Mënishtore

Gati shkurrëz. Kërcejtë në përgjithësi 3 – 10 cm, të drunjëzuar në pjesën e poshtme.

Gjethet me llapë të sheshtë, 6 – 15 x 2 – 5 mm, majërrumbullakuar; ato të bisqeve shterpë shumë më të mëdha se të tjerat.

Lulet në cima të thjeshta, të verdha. Cimat me 2 – 8 lule. Nënpetlat pak leshtake, të gjelbra ose pak a shumë të kuqërreme.

VI – VIII.

Nëpër kullota alpine e subalpine.



Helianthemum nummularium (L.) Mill. –
Heliantema e zakonshme Cistaceae – Mënishtore

Gjysmë shkurre, me kërcell të drunjëzuar në bazë, të grathët e të rrudhët. Degët të shtrira ose të ngritura.

Gjethet vezake deri vezake - heshtore, nga sipër të blerta, nga poshtë të hirta ose me shtresë qimesh të bardha. Ndajgjethëzat janë të zgjatura deri lineare - të zgjatura.

Lulet të verdha, të vetmuara ose në lulesë njëanësore cimozike. Fryti kapsulë. Bishtat e fryteve të përkulura teposht.

V - IX.

Rritet në vende të thata, livadhe, kullota, pyje, shkurrnaja etj.



Bryonia alba L. – Stërkungulli
Cucurbitaceae – Kungullore

Bimë barishtore shumëvjeçare dioike me kërcej të degëzuar, kacavjerrës, L - 4 m.

Gjethet 5 – l0 cm, vezake, si zemër në bazë, me kënde ose pëllëmbore me 5 vriguj. Vrigulli qendror shumë më i gjatë se të tjerët.

Lulet gjelbroshe – të bardha, në melthe vilore. Kupa e luleve femër zakonisht aq e gjatë sa kurora. Kurora me 5 vriguj të qartë. Fryti rruzullor, i lëngshëm, i zi.

V – VI.

Në gjerdhe e shkurrnaja. Bimë e helmët dhe mjekësore.



Echinocistis lobata (Michx) T. et .A. -Kastraveci me gjemba
Cucurbitaceae - Kungullore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell kacavjerrës, deri 5 m.

Gjethet rreth 5 cm të mëdha. Llapa e vrigulluar. Vrigujt mirë të dallueshëm; ai skajor pak më i gjatë se të tjerët.

Lulet zhvillohen përgjatë kërcellit në sqetull të gjetheve. Vrigujt e kupës dhe kurorës trekëndor. Petalet të bardha, mbesin edhe një kohë gjatë frytëzimit. Fryti vezak, i mbuluar me gjemba të butë të shpërndarë pa ndonjë rregull të caktuar.

VIII – IX.

Rritet nëpër gjerdhe si bimë kacavjerrëse. Ka prejardhje nga Amerika Veriore.



Populus alba L. – Plepi i bardhë
Salicaceae – Shelgore


Dru deri 30 m me kurorë të gjerë të rrumbulluar dhe me lëvore të përhime të bardhë e të lëmuar sa është i ri.

Gjethet dy trajtash; ato të bisqeve të gjata përposh pushbuta të bardha, me 3 – 5 vriguj të dhëmbëzuar; ato të bisqeve të shkurtër përposh pushpërhime, më të vogla, vezake - gjatore, jo të vrigulluara, me dhëmbë ura – ura.

Lulesat të varura; ato mashkull 4 – 8 cm, ato femër 3 – 5 cm.

Lul. III – IV; fr. IV – V.

Takohet shpesh sidomos buzë lumenjve dhe vende të lagëta.



Populus tremula L. – Plepi i egër
Salicaceae – Shelgore

Dru deri 20 m i lartë, me lëvore të lëmuar për një kohë të gjatë, tek ekzemplarët e moçëm të përhime të zezërreme e të çarë.

Gjethet gati rrotullare, me buzë të dhëmbëzuara në formë valësh, pak të rimta, ato të reja me qime kadife të mëndafshta, të vjetrat të shogëta.

Lulesat 3 – 8 cm. Thekë 5 – 12 me pjalmore purpur. Frytesat der 12 cm.

Lul. III – IV; fryt. V – VI.

Në pyje dhe shpate gëmushore subalpine.

Shkurre deri 5 – 6 m. Degët hollake, të gjata , të hapura ose të ngritura.

Gjethet vizake të ngushta deri shumë të ngushta, të ngushtuara në bazë në trajtë bishtaku të shkurtër, përposh me push të dendur të bardhemë.

Lulesat deri 6 x 0.8 cm, bishti deri 1 cm. Thekë 2, me fije të ngjitura në bazë ose deri në mes.

Lul. IV – V; fryt. V.

I zakonshëm dhe gati gjithkund buzë ujërash e në shtrate rrjedhash. Përdoret në shkallë të gjerë për të përgatitur kosha, shporta etj.



Salix elaeagnos Scop. – Shelgu i butë
Salicaceae – Shelgore



Salix alba L. – Shelgu i bardhë
Salicaceae - Shelgore

Dru deri 20 m i lartë, me lëkurë të përhime dhe me degë të shumta të shpërndara, majëvarura.

Gjethet heshtore, 5 deri 7 herë më të gjata se të gjera, me 12 - 15 nervura anësore.

Lulesat cilindrike të ngjeshura, rreth 4 – 6 cm, dalin njëkohësisht me gjethet. Thekë 2, të lira, me antere të verdha. Lulet femër me vezore konike, me krezë të shkurtër, zakonisht me një gjëndër nektarore.

IV – V.

Ndeshet gjithkund jo vetëm buzë ujërash, por edhe në vende me lagështirë.

Shkurre 4 – 5 m e lartë. Degët e reja hollake, të drejta, të shogëta, të shndritshme, në fillim zakonisht të purpurreme, më vonë të përhime – bleroshe.

Gjethet kanë trajtë vezake të përmbysëta gjatore. Llapa me dhëmbë si të sharrës, e shogët.

Lulesat cilindrike, të hapura ose gati të ngritura, me lule të ngjeshura. Dalin para gjetheve. Lulja mashkull me dy thekë. Pjalmoret në fillim të kuqërreme, gjatë pjalmimit të verdha, pastaj të zeza. Vezorja vezëngjashme, pushlore.

III – IV.

Rritet buzë ujërash e në pyje me lagështirë.

Shkurre ose dru i vogël deri 10 m, me degë dyvjeçare të shogëta, ngjyrë të murrme të kuqe të shndritshme (ato të ekzemplarëve femër zakonisht të blerta).

Gjethet vezake të gjera deri vezake të zgjatura, në bazë të rrumbulluara, përsipër të shogëta duke filluar qysh nga vera, përposh dendësisht pushbuta.

Lulesat gati pa bishta, dalin para gjetheve. Braktetë heshtore, leshtore. Lulet me një gjëndër nektarore. Thekë 2, me antere ngjyrë ari.

III - IV.

Në pyje të zonave të larta (kati i ahishteve).



Salix caprea L. - Shelg i egër
Salicaceae - Shelgore



Salix purpurea L. – Shelgu i kuq
Salicaceae – Shelgore

Shkurrëz 30 – 40 cm, me kërcell zvarritës, rrënjëzues. Degëzat me kënde, të shogëta.

Gjethet vezake deri rrotullore, shyta ose lehtësisht majëngrëna, në bazë si zemër, të plota, lëkurore, përsipër të blerta të errëta, përposh të bardheme, me dellëzim rrjetor.

Lulesat në krye të degëve, 2 – 3 cm, me gjethe, me bishta deri 25 cm, dalin pas gjetheve. Braktetë të murrme të çelëta, vezake. Thekë 2, me qime nga mesi e poshtë; vezorja pushbutë, pa këmbëz dhe me shtyllëz të shkurtër.

Lul. V –VI; fryt. VI.

Ndeshet në brezin subalpin dhe alpin. Në Kosovë është e përhapur në Koritnik.



Salix reticulata L – Shelgu i rrjetëzuar
Salicaceae – Shelgore

Dru deri 15 m i lartë. Dallohet nga degëzat njëvjeçare të holla dhe të gjata, të varura teposhtë, të verdha të blerta.

Gjethet heshtore të ngushta, majëgjata, të dhëmbëzuara imët, 8 – 15 cm të gjata.

Lulesat të lakuara; ato mashkull deri 4 cm; ato femër deri 2 cm. Lulet mashkull me dy thekë, me nga dy gjëndra.

Lul. III – IV; fryt. V.

I kultivuar nëpër parqe si dru zbukurimi. Ka prejardhje nga Kina.



Salix babylonica L. – Shelgu pikëllues
Salicaceae – Shelgore



Aethionema saxatile (L.) Br. – Etionema e shkëmbijve
Brassicaceae – Kryqore

Bimë një deri shumëvjeçare. Kërcelli 10 - 30 cm i lartë. Në bazë i degëzuar, i pajisur me gjethe të shumta.

Gjethet lëkurore me bisht shumë të shkurtër. Ato të sipërme kanë formë heshtore.

Lulet të bardha, trëndafil ose të kuqe të errët e të grupuara në vile. Sepalet të ngritura. Fryti silikëz. Ka trajtë vezake deri rrotullare, majëngrënë.

V - VI.

Rritet në vende shkëmbore.



Alliaria petiolata (Bieb.) Cavara et Grande – Bar hudhra mjekësore Brassicaceae – Kryqore

Bimë dyvjeçare me erë hudhre kur shtypet, 20 - 120 cm e lartë.

Gjethet e shogëta ose me pak qime tek nervurat. Të poshtmet me bisht të gjatë, veshkëngjashme, me buzë me ura, të sipërmet vezake trekëndore, me bisht më të shkurtër.


Lulet të bardha. Nënpetlat të ngritura; anësoret me gungë të lehtë në fund. Fryti silik.

IV - VI.

Rritet në pyje e shkorrete me hije. Bimë foragjere, mjaltore e mjekësore.



Alyssum markgrafii O.E. Schulz - Serica e Markgrafit
Brassicaceae – Kryqore



Alyssum repens Baumg. – Serica zvarritëse
Brassicaceae – Kryqore

Bimë dyvjeçare, e degëzuar sipër. Kërcelli 35 – 80 cm, sipër i shogët, poshtë me qime.

Gjethet kërcellore të shumta, të afruara, në fund qartësisht si zemër ose me veshëza të hapura, me qime gjëndërore mbi sipërfaqen e llapës.

Lulet të bardha. Silikët të ngritur. Farat me flatra të ngushta të paktën në majë.

V – VII.

Në shpate të thata gëlqerore, kryesisht të zonave malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli lulor i ngritur 20 - 50 cm, me qime yjore.

Gjethet të blerta nga sipër dhe të përhime nga poshtë, me formë heshtore të përmbysëta. Gjethet kërcellore më të mëdha se të bazës.

Lulet në vile me ngjyrë të verdhë. Fryti silikëz çahëse, gati rotullare, e shogët. Farat me flatra.

V - VI.

Rritet në vende malore gurishtore, në terrene me natyrë serpentinore.

Bimë shumëvjeçare me qime të gjata të hapura e të trazuara me qime yjore të puthitura. Kërcejtë lulorë të shtrirë në fund, pastaj të ngritur përpjetë ose të ngritur, shpesh të drunjëzuar në bazë, deri 50 cm.

Gjethet e bazës vezake të përmbysëta – pallake; kërcelloret leshtore, më të gjata.

Lulesa me qime të gjata të hapura dhe yjore të puthitura. Kupa rënëse. Petlat të verdha të arta, majëngrëna. Silikëzat rrotullare – vezake të përmbysëta.

VI – VII.

Në shkëmbinj e kullota të zonave subalpine, e zakonshme.



Arabis sagittata (Bertol.) DC. – Arabëza shigjetake Brassicaceae - Kryqore

Bimë dy ose shumëvjeçare, leshtore e grathët. Kërcelli 10 – 80 cm i lartë, shpesh i degëzuar.

Gjethet e bazës vezake të përmbysta, gjirake me dhëmbë, me bisht të gjatë. Gjethet kërcellore të shumta, kërcellpushtuese.

Lulet të bardha verdhake. Petalet disi të ngushtë, të ngritura. Frytesa e zgjatur.

V - VI.

Në vende me gurë, pyje, kullota etj.

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, me kërçep të fryer – të mishtë, me stolone. Kërcelli rreth

1 m, fyl, me hulliza, i degëzuar në majë.

Gjethet e bazës shumë të mëdha 30 – 50 cm, vezake – gjatore, ura – ura si sharrë. Të sipërmet heshtore të plota ose me dhëmbë si të sharrës.

Lulet të bardha. Silikëzat gati rrotullare.

VI – VIII.

E kultivuar dhe e natyralizuar. Bimë ushqimore dhe mjekësore.



Barbarea balcana P. - Barbarea ballkanike Brassicaceae – Kryqore



Arabis turrita L. – Arabëza në formë kulle
Brassicaceae – Kryqore



Armoracia lapathifolia Gilib. – Kren
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët. Kërcelli deri 70 cm.

Gjethet e poshtme lirake - pendore të çara, me vrigullin skajor si zemër - vezak; të sipërmet pendore të çara.

Lulet të verdha, në vile vastakore. Petalet 7 – 8 mm. Silikët 15 – 25 mm.

V – VII.

Rritet në vende të lagëta e burime; e rrallë. Bimë endemike e Ballkanit. Në Kosovë është e përhapur në Alpet Shqiptare (Kurvallë, Bistricë eLoçanit, Gjeravicë) dhe Malet e Sharrit

Bimë brishtore shumëvjeçare. Kërcelli 20 – 45 cm, i shogët ose me qime në bazë.

Gjethet e bazës të shogëta; llapa me qime yjore që zhduken më vonë; gjethet kërcellore të shogëta, por me qerpik anëve. Lulet të bardha. Silikët të puthitur pas boshtit të frytesës.

IV – VII.

Në livadhe e shkëmbinj të lagët të zonave alpine. E rrallë; ne e kemi hasur në Restelicë. Endemike e Ballkanit.



Arabis allionii DC. – Arabëza e Alionit
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore njëvjeçare. Kërcelli i drejtë, 10 – 20 cm, jo i degëzuar ose i degëzuar që nga baza.

Gjethet bazale gjatore; kërcelloret vizake – heshtake.

Lulet me ngjyrë të verdhë – të çelët në vile të dendura. Sepalet heshtore, jo të qëndrueshëm. Petalet pykore – heshtore, majëngrëna. Fryti vezak – i rrumbullakët, majëngrënë.

IV – V.

Në shpatije të thata e të rrahura nga dielli, vende shkëmbore – ranore.



Alyssum desertorum Stapf – Serica dezertore
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore shumëvjeçare, shpesh e drunjëzuar në bazë. Kërcelli 15 – 40 (-50) cm, i degëzuar.

Gjethet pushbuta me qime të degëzuara të zbardheme; ato të bazës në rozetë, vezake të përmbysëta; të sipërmet heshtore, shpesh dhëmbë – dhëmbë.

Lulet të verdha. Petalet majëngrëna ose të çara dysh. Silikëzat eliptike ose gati rrotullore.

V – VI.

Në vende me gurë e shkëmbinj të zonave malore.



Alyssum saxatile L. – Serica shkëmbore
Brassicaceae – Kryqore



Brassica rapa L. – Rrepa
Brassicaceae – Kryqore

Bimë një ose dyvjeçare; rrënja boshtore ose zhardhokore. Kërcelli i degëzuar kur është i zhvilluar mirë, 20 – 100 cm i lartë.

Gjethet e bazës me qime të shpërndara kreshtake, lirake; të tjerat të shogëta, të rimta, vezake ose heshtore, kërcellpushtuese.

Lulesa e dendur, me lule të verdha. Sepalet të hapura. Silikët të ngushtuar në një sqep. Farat në një rresht.

III – X.

Bar i keq i kulturave bujqësore. Bimë ushqimore, foragjere dhe vajore (farat).



Bunias erucago L. – Brokra
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore një ose dyvjeçare, gjëndërore, me qime të ashpra. Kërcelli 20 – 60 cm, i degëzuar.

Gjethet e poshtme pendore të çara; të sipërmet të plota, gjatore, pa bishtak.

Lulet të verdha. Sepalet jo me gungë në fund. Petalet rreth 2 herë sa sepalet, pak majëngrëna. Silikëzat jo çahëse, 4 – faqëshe, në çdo brinjë zakonisht me flatra të ndërprera dhe lythe.

IV – VII.

Në ara, livadhe e djerrina, kudo, kryesisht në zona të ulëta; e zakonshme.



Bunias orientalis L. – Brokra orientale
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore dyvjeçare, rrallë shumëvjeçare, 25 – 120 cm e lartë. Kërcelli i drejtë, në pjesën e sipërme i degëzuar, i shogët.

Gjethet bazale në rozetë, deri 25 cm të gjata, shpesh deri në mes pendore të ndara; kërcellorët me bisht ose pushtojnë kërcellin, në majë e thepisur.

Lulesa vile. Sepalet vezake. Petalet vezake – të përmbysëta, të verdha.

V – VIII.

Në livadhe, në të mbjella me drithëra, pranë rrugës, hekurudhës etj.



Cardamine amara L. – Kardamina e hidhur
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore shumëvjeçare, zakonisht e shogët, 10 – 60 cm e lartë. Rrënja primare pak qëndron dhe zëvëndësohet me rizomë horizontale nga e cila zhvillohen kërcejtë.

Gjethet pendore të ndara në 5 – 9 segmente. Segmenti skajor më i madh se të tjerat, vezak ose i rrumbullakët; buza e gjetheve me qime të pakëta.

Lulesa vile me 10 – 20 lule. Sepalet vezake, të gjelbra. Petalet të bardha, më rrallë të kuqe ose trëndafili. Anteret të kuqe – manushaqe.

IV – VII.

Rritet skaj burimeve, vija uji, këneta etj.



Cardamine carnosa Waldst. Et Kit. – Kardamina mishnore
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli 20 – 30 cm, i degëzuar, me qime në pjesën e sipërme.

Gjethet të mishta, me qime të puthitura, pendore, me 3 – 7 palë gjethëza të plota vezake të përmbysëta – pykore.

Lulet të bardha; sepalet me majucë. Silikët me hulliza. Farat rreth 3 mm.

IV – VI.

Në shkëmbinj malorë. Endemike e Ballkanit.



Diplotaxis muralis (L.) DC. – Diplotaksa muresh
Brassicaceae - Kryqore

Bimë barishtore një – dy – ose shumëvjeçare, zakonisht me shumë kërcej. Kërcej të të përpjetëm, gati të zhveshur, me gjethe vetëm në bazë, të shogët ose pak të grathët në bazë, 10 -50 cm.

Gjethet të grumbulluara gati të gjitha në bazën e kërcellit, me bishtak, gjirake dhëmbë – dhëmbë ose pendore të çara, nganjëherë pallake të plota.

Lulet të verdha, nganjëherë bëhen vjollcë me erë të mirë. Sepalet të ngritura.

II – X.

Në djerrina, mure, vende me gur të zonave të ulëta.



Erysimum cuspidatum (Bieb.) DC. – Purthiderthi i thepët
Brassicaceae – Kryqore

Bimë një ose dyvjeçare, me qime gati të gjitha yjore. Kërcelli deri 70 cm, i thjeshtë ose i degëzuar.

Gjethet e blerta, gjatore të përmbysëta ose vezake – heshtore, lehtësisht gjirake – dhëmbë – dhëmbë.

Lulet ngjyrë squfuri. Sepalet lehtësisht gungaqe ne fund. Silikët të shtypur anëve, me qime të bardha dhe kënde të blerta, të shogët.

VI – VII.

Në shkorrete, shkëmbinj e gërmadha, deri në zonat malore.



Erysimum helveticum (Jacq.) – Purthiderthi i Zvicrës
Brassicaceae – Kryqore

Gjysmëshkurre shumëvjeçare deri 50 cm e lartë. Rrënja mjaft e trashë, boshtore. Kërcelli i drejtë ose në pjesën e poshtme i lakuar.

Gjethet bazale vizake – heshtore, buzëplota; gjethet kërcellore vizake, në bazë të ngushtuara në bishtak.

Lulet të verdha të ndritura; sepalet vizake, me qime. Petalet vezake të përmbysëta.

VI.

Në vende shkëmbore me diell, gëmusha dhe shkrepa gëlqerore dhe silikate



Hesperis tristis L. – Hesperida
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore dyvjeçare ose shumëvjeçare, 35 – 60 cm e lartë. Kërcelli i drejtë me qime të gjata gjëndërore.

Gjethet bazale vezake, menjëherë të ngushtuara në bisht, pushlore; gjethet kërcellore kërcellpushtuese, vezake – të ngushta.

Lulesa vile. Sepalet vizake. Petalet të verdha – të gjelbra me nervaturë rrjetore të gjelbër, me gungë në fund.

IV – VI.

Në livadhe të thata, djerrina dhe vende rënore.



Cardamine glauca Sprengel – Kardamina e rimtë
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore një – deri shumëvjeçare, e shogët dhe shumë e rimtë kur është e freskët. Kërcejtë 5 – 25 cm, shpesh të shumtë dhe dredhakë.

Gjethet më të poshtme jo në rozetë, me bishtak të gjatë, të plota ose vrigullore; vazhdueset pendore me 1 – 3 palë gjethëza anësore eliptike ose vezake shyta.

Petalet të bardha, majëngëna. Silikët të shogët.

V – VII.

Në gurishte, vende me bar e pyje të zonave malore; e zakonshme



Lunaria annua L. – Lunare njëvjeçare
Brassicaceae - Kryqore

Bimë njëvjeçare, e shogët ose me pak qime të thjeshta, me rrënjë të trashë. Kërcelli 40 – 100 cm, i degëzuar, pushlor në pjesën e sipërme.

Gjethet vezake ose heshtore-si zemër, me dhëmbë të gjerë të çrregullt; të poshtmet me bishtak; të sipërmet gati pa bishtak.

Lulet të purpurreme, rrallë të bardha, pa erë. Petalet të plota. Silikëzat të rrumbulluara në të dy skajet. Farat me flatra.

IV – V.

Në shkorrete e shkëbinj të zonave të ulëta deri malore. Shpesh e kultivuar si bimë zbukurimi sidomos për paretet e qëndrueshme të silikëzës.



Sisymbrium orientale L. – Cucubina
Brassicaceae – Kryqore

Bimë njëvjeçare. Kërcelli me qime të buta, 10 – 60 cm, i degëzuar.

Gjethet me bishtak; të poshtmet ferrake me vriguj anësorë vezakë, skajori heshtor – trekëndor; të sipërmet të thjeshta ose m 3 vriguj; vrigulli skajor vizak ose heshtor.

Lulet të verdha të zbehta, të gjitha pa brakte. Silikët të kreshpët.

IV – VI.

Në djerrina, gërmadha e buzë udhëve.



Barbarea vulgaris R. Br. – Barbarea e zakonshme
Brassicaceae – Kryqore



Bornmuellera dieckii Deg. – Bornmulera e Degenit
Brassicaceae – Kryqore

Bimë dyvjeçare, e shogët ose pushpakë. Kërcelli 40 – 120 cm, i degëzuar.

Gjethet të blerta të rimta; kërcelloret pa bishtak, kërcellpushtuese, me dy veshëza të mprehta.

Lulet të verdha, të shumta, në vastak të përbërë. Nënpetlat të hapura. Petlat të vogla. Frytet silikëza joçahëse, gjatore vezake.

V – VII.

Në toka gurishte, vende të shkreta, kullosa të zonës së ulët malore deri subalpine.

Bimë një ose shumëvjeçare, e shogët ose pak me qime, me shije të keqe. Kërcelli 20– l00 cm, me vana.

Gjethet e poshtme lirake – pendore të çara, me 2 – 5 vriguj në çdo anë; të sipërmet pa bisht, të thjeshta, vezake, me dhëmbë.

Lulet të verdha, në vile të zgjatura, pa brakte. Silikët l5 – 30 mm, të shogët, të hapur.

V – VII.

Rritet në vende të lagëta, fusha, livadhe e pyje; e rrallë. Bimë ushqimore, mjaltore e mjekësore.

Bimë gjysmëshkurre.

Gjethet gjatore - vezake, nga sipër të shogëta, nga poshtë me qime të rralla dykrahësh.

Lulet të vendosura në vile, të bardha. Lulesa e degëzuar, ndërsa ajo e pjekur e dendur. Thekët në bazë me dhëmbë të zgjeruar. Frytet në trajtë vezake, diçka të shtypura, të shogëta, rreth 4 mm të gjata.

VI – VI.

Bimë endemike e Kosovës. Është zbuluar në vitin 1900 nga botanisti hungarez A. Degen në terrenet serpentine në afërsi të Mushtishtit (Maja e Bajrakut).



Isatis tinctoria L. – Isatis i ngjyrosur
Brassicaceae – Kryqore



Erysimum pectinatum Bory et Chaub. – Purthiderthi
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore shumëvjeçare, tufore. Kërcelli 10-25cm, i drunjëzuar në bazë dhe i mbuluar me funde gjethesh.

Gjethet e përhime, vizake - heshtore.

Lulet të bardha, në vile që zgjatet tek frytesa. Fryti silikëz, rruzullor ose vezak i përmbysët, me diametër 6 mm.

VI – VII.

Në vende shkëmbore të zonave të larta, e rrallë.



Ptilotrichum rupestre Boiss. – Ptilotriku i shkëmbijve
Brassicaceae - Kryqore

Bimë barishtore shumëvjeçare, rrallë dyvjeçare, me rizomë cilindrike të degëzuar. Kërcelli i thjeshtë ose i degëzuar lart, 10 – 60 cm.

Gjethet e bazës heshtore të zgjatura, gjirake – pendore të çara; kërcelloret thellë pendore të çara.

Lulet të verdha. Bishti i lules shumë më i shkurtër se kupa. Fryti silik, 3 – 4 cm i gjatë, i mbuluar me qime dykrahëshe.

V – VII.

Në vende shkëmbore subalpine; e rrallë. Bimë endemike e Ballkanit.



Hesperis matronalis L. – Hesperida matronale Brassicaceae – Kryqore

Bimë dy ose shumëvjeçare, me qime gjëndërore ose jogjëndërore, rrallë e shogët. Kërcelli 40 – 100 cm, i degëzuar në majë.

Gjethet me shumë qime të bigëta; të poshtmet heshtore, me bisht, dhëmbë – dhëmbë ose lirake; të sipërmet të plota ose me dhëmbë, me bisht të shkurtër ose gati pa bisht.

Lulet purpur ose trëndafil, shpesh me erë të mirë. Frytesa vile e gjatë, me pak fryte.

V – VII.

Buzë pyjeve, në vende me hije ose të lagëta. E kemi ndeshur në Pashtrik.



Erysimum diffusum Ehrh. – Purthiderthi degëngatërruar
Brassicaceae – Kryqore

Bimë dyvjeçare ose shumëvjeçare jetëshkurtër. Kërcelli 20 – 120 cm, i degëzuar.
Gethet bardhoshe ose të blerta, vizake të ngushta deri vizake-heshtore, të plota ose të dhëmbëzuara.
Lulet ngjyrë squfuri. Sepalet pa gungë ose lehtësisht gungaqe në fund. Petalet dyfish më të gjata se kupa. Silikët katërkëndorë.
V – VII.
Në gurishte e djerrina të zonave të ulëta.

Bimë një ose dyvjeçare, 5 - 60 cm e lartë. Kërcelli i thjeshtë ose i degëzuar.

Gjethet bazale janë në rozetë, të plota ose të dhëmbëzuara ose pendore të çara. Gjethet kërcellore me veshëza kërcellpushtuese.

Lulet të bardha, të vogla dhe pa erë. Sepalet të ngritura, kurse thekët të thjeshtë. Fryti silikëz çahëse. Ka trajtë trekëndore dhe i ngjanë trastës së bariut.

III - XII.

Rritet në vende të thata e me bar, kullota,ugare etj. Bimë mjekësore.



Calepina irregularis (Asso) Thell. – Kalepina jo e rregullt
Brassicaceae – Kryqore

Bimë një ose dyvjeçare, e shogët. Kërcejtë 30 – 80 cm, të shtrirë në fund, pastaj të ngritur përpjetë.

Gjethet e bazës të plota, gjirake – dhëmbore ose lirake, me bishtak; kërcelloret pa bisht, të plota ose me dhëmbë të largët, me veshëza të mprehta në fund.

Lulet të bardha. Petlat të pabarabarta; 2 të brendshmet pak më të mëdha. Silikëzat ovoide të fryra, me 1 farë.

III – VI.

Në toka të punuara ose djerrina. Bimë e keqe e arave, kryesisht e zonave të ulëta.



Capsella bursa - pastoris (L.) Med. – Strasjca e bariut
Brassicaceae - Kryqore



Cardamine enneaphyllos (L.) Crantz. – Dhëmbora
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Rizoma me diametër deri 6 mm, e mbuluar me luspa shumë të vogla. Kërcelli l5 – 30 cm i lartë.

Gjethe 2 – 4, të afruara shumë a pak në qerthull dhe të çara tresh, me segmente vezake - heshtore, dy herë të dhëmbëzuara si sharrë.

Lulet të verdha të zbehta ose të bardha. Thekët me antere të verdha.

IV – VII.

Rritet në pyje e vende me hije të zonave malore.



Cardamine hirsuta L. – Kardamina qimeashpër
Brassicaceae – Kryqore

Bimë njëvjeçare, me rrënjë boshtore, hollake. Kërcejtë 3 – 40 cm, të shogët ose me qime të pakta, të degëzuar vetëm nga fundi, me gjethe të pakta 1 – 3.

Gjethet pa veshëza pendore të prera, me 1 – 5 palë gjethëza; rrënjoret të shumta, me gjethëza vezake të përmbysëta deri gati rrotullare të plota; skajorja më e madhe.

Lulet të bardha; bishtat e luleve 1 – 2 mm. Silikët të ngritur.

II – VI.

Në vende me bar e shkëmbinj, kryesisht të zonave të ulëta.



Cardamine impatiens L. – Kardamina e padurueshme
Brassicaceae – Kryqore

Bimë një ose dyvjeçare, me rrënjë boshtore. Kërcelli 10 – 60 cm, me shumë gjethe, shpesh i degëzuar, i shogët ose me qime të pakta.

Gjethet e rozetës të paqëndrueshme; kërcelloret me veshëza në fund, pendore të prera, me shumë gjethëza vezake, të pabarabarta, të vrigulluara –me dhëmbë ose të plota.

Lulet të bardha. Pjalmoret bleroshe.

IV – VI.

Në vende me lagështirë e hije të zonave malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të zgjatur dhe me nyja. Kërcelli 30 – 70 cm, i shogët, i shëndoshë, i thjeshtë ose i degëzuar në majë.

Gjethet të mëdha, lirake, me bisht të gjatë me 2 - 4 palë gjethëza anësore; gjethëza skajore më e madhe, gati rrotullare.

Lulet jargavan të mbyllur, rrallë të bardha. Anteret të verdha. Frytesa e gjatë dhe e çlirët.

V – VII.

Rritet në burime e vende të lagëta të zonave malore.



Cardamine raphanifolia Pourr. - Kardamina gjetherrapanidhe
Brassicaceae - Kryqore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Zhvillon kërcej lulor dhe shterp, prandaj shfaqet si tufore. Kërcelli zakonisht jo i degëzuar, 5 – 10 (30) cm i lartë, i shogët.

Gjethet bazale me bisht, të rrumbullakta – vezake; kërcelloret vezake deri shigjetake, kërcellpushtuese.

Lulet të bardha. Sepalet eliptike, skajet e tyre të bardha. Lulesa në pjekuri zgjatet.

V – VI.

Në vende shkëmbore, kullosa, në zona alpine ku bora shkrinë



Thlaspi alpinum Crantz – Tlaspi alpin
Brassicaceae - Kryqore

Bimë barishtore shumëvjeçare me filiza gjethorë të shkurtër, me rozeta gjethore të ngjeshura dhe me dy ose me shumë kërcej lulorë.

Gjethet e rozetës me bishtak të shkurtër, gjatore të përmbysëta ose vezake, të plota ose dhëmbë – dhëmbë; kërcelloret gjatore me veshëza kërcellpushtuese.

Lulet në vile. Petlat 5 – 8 mm, të bardha që zverdhen kur thahen; pjalmoret të verdha. Silikëzat si zemër të përmbysëta – pykore, me flatra, gjerësisht majëngrëna ose gati të cunguara.

V – VII.

Në vende malore me bar.



Thlaspi ochroleucum B. et H. - Tlaspi verdhosh
Brassicaceae – Kryqore



Thlaspi perfoliatum L. – Tlaspi i përgjethuar
Brassicaceae – Kryqore



Thlaspi praecox Wulfen - Tlaspi i hershëm
Brassicaceae – Kryqore



Cheiranthus cheiri L. – Sheboja
Brassicaceae – Kryqore

Bimë njëvjeçare, e shogët, e rimtë. Kërcelli 5 – 20 (-30) cm, shpesh dredhak.

Gjethet të plota ose dhëmbë – dhëmbë; ato të bazës në rozetë, vezake të përmbysëta, me bishtak; kërcelloret e sipërme vezake – si zemër, pa bishtak, me veshëza shyta, ose gati të mprehta, kërcellpushtuese.

Lulet të bardha. Thekët me pjalmore vezake, të verdha. Silikëzat me flatra që zgjerohen lart, majëngrëna.

III – V.

Në djerrina e vende shkëmbore e gëlqerore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, dendësisht tufore, me rizomë të shkurtër. Kërcejtë 10 – 20 (-35) cm, të shogët.

Gjethet të plota ose me dhëmbë të largët; ato të rozetave me bisht, gjatore deri si zemër të përmbysëta ose vezake – pykore deri pallake, zakonisht vjollcë – purpur në pjesën e poshtme; kërcelloret pa bisht, në bazë me veshëza, të mprehta.

Lulet në vile. Nënpetlat vjollcë në majë. Petlat të bardha ose jargavan të hapur.

IV – VII.

Në çeltira pyjesh, shkurrnaja dhe shkëmbinj pak a shumë të lagësht.

Bimë barishtore shumëvjeçare me qime të degëzuara dhe të shtrira. Kërcelli 10 – 90 cm, i drunjëzuar në bazë, i degëzuar.

Gjethet të plota, të trasha, heshtore, të ngushtuara në një bisht të shkurtër.

Lulet të verdha ose të murrme, në vile, me erë. Sepalet të ngritura, të brendshmet me gungë në fund. Petalet me thonjëz të gjatë. Silikët vizakë, të shtypur - katërkëndor, flegrat me një nervurë kurrizore.

III – V.

E kultivuar si bimë zbukurimi.



Cardamine bulbifera L. Crantz. -
Dhëmbore me qepujka
Brassicaceae – Kryqore

Bimë njëvjeçare, me qime të degëzuara dhe yjore. Kërcelli 2 – 20 cm, i padegëzuar, pa gjethe.

Gjethet në rozetë në bazën e kërcellit, heshtore – pallake, të plota ose me dhëmbë të rrallë.

Lulet të bardha, në vile të dendur që zgjatet në frytifikim. Petalet të çara dysh, më të gjata se sepalet. Fryti silikëz vezake e përmbysët, eliptike ose heshtore e përmbysët.

II – V.

Në vende barishtore e livadhe.

Bimë një ose dyvjeçare, me qime të shkurtra. Kërcejtë 20 – 60 cm, të thjeshtë ose të degëzuar sipër.

Gjethet e bazës me bishtak, vezake ose vezake të përmbysëta, të plota ose gjirake dhëmbë – dhëmbë; kërcelloret vezake ose gjatore, pa bishtak, me veshëza në fund, kërcellpushtuese.

Lulet të bardha. Petlat pak më të gjata se nëpetlat.

IV – V.

Në djerrina, gërmadha e vende me bar, kryesisht të zonave të ulëta deri malore. Bimë mjekësore.

Bimë shumëvjeçare me rizome të mbuluara me luspa dhe të mishta. Kërcelli 30 - 70 cm, i thjeshtë, i shogët.

Gjethet të këmbyera. Të poshtmet pendore të prera, të sipërmet në fillim me 3 segmente, pastaj të thjeshta, me qepujka të murrme - purpur në sqetullën e tyre.

Lulet trëndafil ose të purpurreme, rrallë të bardha. Frytesa e shkurtër e llojit silikë. Bimë me frytifikim të rrallë.

IV - VI.

E ndeshim në pyje me hije të zonave malore, sidomos në ahishte.



Erophila verna (L.) Chevall – Erofila pranverore
Brassicaceae – Kryqore



Lepidium campestre (L.) R. Br. – Djegësi i fushës
Brassicaceae – Kryqore



Lepidium draba L. - Boshti i plakës
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me push ngjyrë hiri ose gati e shogët. Zhvillon kërcej të degëzuar dhe me shumë gjethe.

Gjethet gjatore - vezake. Gjethet kërcellore kërcellpushtuese - me veshëza.

Lulet të bardha, të grumbulluara në një melth në formë vastaku (melth vastakor). Sepalet të hapura. Fryti silikëz joçahëse, më e gjerë se e gjatë, e fryrë, si zemër në fund, e shogët. Farat ovoide.

III - VI.

Rritet në ara, buzë rrugëve, hedhurina, deri në zonat malore.



Lunaria rediviva L. - Lunare e përtëritur
Brassicaceae - Kryqore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli 40 – 140 cm, i degëzuar në majë.

Gjethet vezake - si zemër, majëgjata. Buza e llapës e dhëmbëzuar. Dhëmbët e hollë të pabarabartë.

Lulet jargavan të zbehta, me erë. Sepalet në fund me gungë. Petalet 12 – 20 mm. Fryti silikë, eliptik, i ngushtuar në të dy skajet, flegrat me dellëzim të rrjetëzuar.

V - VI

Rritet në pyje malore e vende të lagëta. Bimë zbukurimi e mjaltore.



Peltaria alliacea Jacq. – Peltare
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, e blertë – e rimtë, me rizomë të degëzuar, me stolone. Kërcelli 20 – 60 cm, me shumë gjethe, i thjeshtë ose i degëzuar lart.

Gjethet të plota ose me dhëmbë të largët; të poshtmet vezake të përmbysëta, me bisht; të sipërmet pa bisht, kërcellpushtuese, me dy veshëza në fund.

Lulet të bardha, në melth ose vastak vilesh. Nënpetlat të hapura. Petlat 2 herë sa nënpetlat, me thonjëz.

V – VII.

Në pyje e vende shkëmbore të zonave malore, e zakonshme.



Myagrum perfoliatum L. – Miagrum me gjethe pushtuese
Brassicaceae – Kryqore

Bimë njëvjeçare, e shogët dhe e rimtë. Kërcelli 20 – 100 cm, i degëzuar sipër.

Gjethet e bazës me bishtak, lirake ose gjirake me dhëmbë; kërcelloret pa bishtak, me veshëza kërcellpushtuese, të plota ose të dhëmbëzuara.

Lulet të verdha. Nënpetlat të ngjitura. Fryti silikëz, joçahës, gati trekëndorë.

IV – VI.

Në ara e vende të lagëta, zakonisht në djerrishte dhe buzë rrugëve.



Rorippa lippizensis (Wulf.) Rchb. – Roripa e Lipicës
Brassicaceae – Kryqore

Bimë shumëvjeçare. Kërcejtë 10 – 20 cm.

Gjethet e bazës në rozetë, të plota ose lirake – pendore, me vrigullin skajor të madh dhe me anësorët të ngushtë; kërcelloret pa bishtak, pendore – të çara me segmente vizake - heshtore, me veshëza të ngushta kërcellpushtuese në fund.

Lulet të verdha, në vile të shkurtra.

V – VI.

Në vende me bar, shkurreta.



Sinapis arvensis L. - Sinapi i arave
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore njëvjeçare. Kërcelli i degëzuar, i lartë 40 - 80 cm.

Gjethet e poshtme me bisht, lirake; të sipërmet pa bisht, gjirake me dhëmbë.

Lulet në vile të cilat zgjaten gjatë frytifikimit. Zhvillohen gjatë verës dhe vjeshtës në renditje poshtë - lartë, ashtu edhe çelin. Petalet kanë ngjyrë të verdhë të ndritshme me thonjëza të gjata. Fryti silik i zgjatur dhe çahës me 3 - 5 nervura. Farat të murrme të lëmuara.

V - IX.

Rritet në toka të punuara. Konsiderohet si bar i keq i të lashtave. Bimë mjaltore dhe mjekësore.



Sisymbrium officinale Scop. - Sisimbra mjekësore
Brassicaceae – Kryqore

Bimë barishtore një ose dyvjeçare, e shogët ose me qime. Kërcelli 30 - 60 cm, me degë shumë të hapura.

Gjethet me bisht. Të poshtmet ferrake - pendore të çara me vrigullin skajor të madh. Të sipërmet heshtore tre vrigullore.

Lulet të vogla, të verdha të zbehta, pa brakte, të vendosura në vile të cilat zgjaten gjatë frytifikimit. Fryti silik.

III - VIII.

Rritet në djerrina, gërmadha, oborre e buzë udhëve, e zakonshme. Bimë mjekësore.

Shkurrëz 20 – 60 cm e lartë. Kërcejtë të shtrirë për tokë.

Gjethet të këmbyera, me ngjyrë të gjelbër të çelët deri në fund të gushtit, më pas skuqen dhe gjatë vjeshtës thahen. ; llapa e rrjetëzuar përsipër, me buzë të dhëmbëzuara.

Lulet 3 – 6 bashkë në vile të shkurtra, të ngritura. Braktetë të bardheme. Kurora e bardhë – gjelbëroshe. Fryti rruzullor, në fillim i gjelbër, më vonë kuqalosh dhe në pjekuri blu – i zi.

Lul. VI – VII; fryt. VIII – XI.

Nëpër kullota e vende me gurë të maleve të larta. Ne e kemi ndeshur vetëm në vendin e quajtur Rrasa e Zogut dhe Koprivnik.

Kërcelli 15 – 30 cm, i përpjetëm, i thjeshtë.

Gjethet eliptike, urëza – urëza ose dhëmbëza – dhëmbëza, me nervura që nuk trashen në majë dhe me të njëjtën ngjyrë në të dyja faqet; bishti më i shkurtër se llapa; kërcelloret të reduktuara në luspa të vogla.

Vilja me 15 – 20 lule. Nënpetlat trekëndore – vezake, majëmprehta. Petlat të bardha të trëndafilta. Thekët pak a shumë paralelë me shtyllëzën.

V – VII.

Në pyje, mbi toka acide, të freskëta e me lagështi.



Pyrola minor L. – Pirola më e vogël
Pyrolaceae – Pirolore



Arctostaphylos alpinus (L.) Spreng. – Rrush i alpeve
Ericaceae – Shqopore



Arctostaphylos uva - ursi (L.) Spreng. - Rrush arushe
Ericaceae - Shqopore

Shkurre deri 150 cm e lartë. Degët të shumtë, jo të ngritur që formojnë një shtrirje të dendur, të reja me push.

Gjethet janë të qëndrueshme, plot me qime të imëta, me llapë heshtore të përmbysët.

Lulet 2 - 3 bashkë në vile skajore pak a shumë të varura. Kupa me vriguj gati rrotullarë. Kurora e bardhë ose pak a shumë e skuqur në majë. Fryti sferik, i kuq i shkëlqyeshëm kur piqet.

V - VI.

Rritet në shkëmbinj, toka të pjerrta e të rrjepura me gurë të maleve të larta. Bimë mjekësore.



Bruckenthalia spiculifolia Reichenb. - Brunkentalia
Ericaceae - Shqopore

Shkurre 10 - 15 cm e lartë, degëzat e reja me push.

Gjethet vizake, majëmprehta, të qëndrueshme, nga 2 - 3 në qerthuj.

Lulet të vogla, kanë formë kambanore, ngjyrë trëndafili të kuqe, në një lulesë vile skajore cilindrike të shkurtër ose rruzullore. Kupa me vriguj të gjatë sa gypi. Fryti kapsulë e shogët.

V - VIII.

Rritet në shkurre dhe pyje subalpine në substrate acidofile. Në Kosovë është e përhapur në Alpet Shqipëtare dhe Malet e Sharrit.



Rhododendron ferrugineum L. - Rododendroni ngjyrë ndryshku
Ericaceae - Shqopore

Shkurre përherë e blertë, 1 - 2 m e lartë. Degët e reja kanë ngjyrë ndryshku.

Gjethet vezake ose eliptike - vezake, buzëplota. Sipër janë të blertë, nga poshtë me gjëndra ngjyrë ndryshku.

Lulet nga 6 - 12 në bishta gjëndëror. Kupa me segmente të dhëmbëzuara. Kurora ngjyrë trëndafili - të kuqe.

VI - VIII.

Rritet në pyje e shkorrete të zonës subalpine. Në Kosovë gjendet e përhapur në Malet e Sharrit.



Vaccinium myrtillus L. - Thrashegra mërsinëz
Ericaceae - Shqopore

Shkurrëz gjetherënëse, 15 - 35 (- 60) cm. Kërcejtë të ngritur, të degëzuar, me qoshe të mprehta.

Gjethet zakonisht vezake, me majë të mprehtë, me buzë të sharrëzuara, me të dyja faqet të blerta.

Lulet të vetmuara, në sqetull të gjetheve të varura. Kurora gjelbëroshe me njolla ngjyrë trëndafili. Fryti i zi, me pluhurizë, i ëmbël, me pjesë të brendshme të kuqe të errët.

V - VII.

Rritet në pyje, livadhe e kullota me tokë humusore të thartë të zonave malore. Bimë ushqimore e mjekësore.



Vaccinium uliginosum L. – Thrashegra ligatinash
Ericaceae – Shqopore

Shkurre gjetherënëse deri 75 cm e lartë. Kërcejtë të ngritur, shumë të degëzuar.

Gjethet vezake të përmbysëta – pallake, të plota, gatipabisht, të blertëerrëta dhe të rimta përsipër.

Lulet 4 ose 5-pjesëshe, nga 1 – 3 bashkë. Kupa me vriguj të rrumbullakuar, cipëthatë dhe të kuqërremtë. Kurora e bardhë, zakonisht me njolla ngjyrë trëndafili. Rrushqet të rrumbullakët deri elipsoidë, të zinj në blu.

Lul. V – VI. Fryt. VI – IX.

E rrallë në kullota e livadhe të larta.



Empetrum nigrum L. - Empetra e zezë
Empetraceae – Empetrore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 8 – 12 cm e lartë, me zhardhok gati rruzullor ose rruzullor i shtypur, që rrënjëzon në pjesën e sipërme.

Gjethet të thjeshta, bazale, në trajtë zemre, që dalin në vjeshtë pas lulëzimit, me bisht të gjatë 4 - 5 cm. Llapa shpesh me kënde ose vriguj, buzëdhëmbëzuar, përposh zakonisht e purpurt, përsipër me njolla të bardha.

Lulet të vetmuara, të varura, me erë. Kurora me një gyp të trëndafiltë, me 5 vriguj ngjyrë trëndafili të çelët.

VIII - XI.

Rritet në toka gëlqerore të pasura me humus, sidomos në pyje gjetherënëse. Bimë e helmët.



Cyclamen neapolitanum Ten - Bukëderri
Primulaceae - Aguliçore

Shkurrëz 10 – 45 cm, me kërcej të shtrirë deri të përpjetëm.

Gjethet vizake gjatore deri eliptike të ngushta, gjëndërore kur janë të reja, të shogëta më vonë, me buzë të kthyera, përposh të bardheme.

Lulet të vetmuara në sqetullat e gjetheve të sipërme. Kurora gjelbëroshe deri e kuqërremtë e purpurt. Thekët dalin shumë nga kurora. Frytet të zeza me lëng të kuq.

IV – VI.

Në vende shkëmbore me lagështi të zonave malore.



Anagallis arvensis L. - Barcapoi i arave
Primulaceae - Aguliçore

Bimë barishtore njëvjeçare, 6 - 50 cm, me kërcej katërkëndësh, të përpjetëm ose të ngritur.

Gjethet të përkundërta ose rrallë qerthullore, të pabisht, vezake deri heshtore. Gjethet e sipërme më të ngushta se ato të poshtme.

Lulet në sqetulla të gjetheve të sipërme. Bishti i lules përkulet në frytëzim. Kurora ngjyrë tjegulle në portokalli, me qime gjëndërore.

V - X.

Rritet në vende barishtore, kullota e ara të punuara.



Androsace villosa L. – Androsaka leshtore
Primulaceae – Aguliçore

Bimë barishtore shumëvjeçare tufore, me kërcell të degëzuar në bazë, 3 – 5 cm e lartë, me shumë rozeta gjethesh.

Gjethet gjatore - heshtore, të plota, në të dyja anët e mbuluar dendur me qime të gjata e të bardha.

Lulet të bashkuara nga 3 – 7 së bashku në lëmshukë skajore. Kurora 5 – 7 mm, e bardhë ose e trëndafiltë.

VI – VIII.

Në kullota alpine me shkëmbinj. Euroaziatike.

Bimë shumëvjeçare pushpakë, me rizomë. Kërcejtë të ngritur, 20 – 65 cm, me pak degë në bazë.

Gjethet vizake – heshtore deri pallake, të këmbyera, të rimta; të sipërmet pa bisht.

Lulesat në kallinj skajorë. Kurora e purpurt – e errët; me vriguj të zgjatur, pallake. Thekët më të gjatë se kurora.

V – VII.

Në toka të thata e ranore. Ballkanike. E kemi ndeshur në Bokat e Baçevcit (Mushtisht).



Lysimachia atropurpurea L. – Lisimaka purpur e errët
Primulaceae – Aguliçore



Lysimachia nummularia L. – Bargjergji
Primulaceae- Aguliçore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët. Kërcejtë 10 – 50 (-60) cm, të shtrirë; katërkëndësh dhe që rrënjëzojnë në nyje.

Gjethet të përkundërta, me bishtak të shkurtër, vezake të gjera gatirrotullare, shyte, me pikla gjëndërore.

Lulet të vetmuara në sqetullën e gjetheve të mesit. Kupa me vriguj vezakë. Kurora e verdhë, me vriguj gati vezakë. Kapsula rruzullore.

IV – VIII.

Buzë ujërave, në vende me lagështirë etj.



Primula minima L. – Aguliçja e vogël
Primulaceae - Aguliçore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 2 – 5 cm e lartë.

Gjethet më të gjata 0.5 – 3 x 0.3 – 1 cm, pykore, lëkurore, anash buzëplota ndërsa në majë të cunguara ose pak a shumë të rrumbulluara e me dhëmbë.

Shtija 0.2 – 4 cm, me 1 – 2 lule. Kurora e trëndafiltë e shndritshme, me vrigull të ndarë thellë në trajtën e germës V; gryka me qime gjëndërore. Kapsula e gjatë sa gjysma e kupës.

VI – VII.

Në kullota alpine, atje ku shkrihet bora. Endemike – Europianejug– lindore.



Lysimachia punctata L. - Lisimaka pikaloshe
Primulaceae - Aguliçore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të hollë. Kërcelli me 6 brinjë, 35 - 90 cm i lartë.

Gjethet heshtore deri eliptike me majë të mprehta, të përkundërta ose 3 - 4 në një qerthull. Llapa me qerpikë dhe në pjesën e poshtme me pikla gjëndërore.

Lulet 5 - pjesëshe në lëmshuk sqetullorë. Kupa me vriguj gati heshtorë, me qerpikë. Kurora e verdhë, me vriguj vezakë deri heshtorë. Fryti kapsulë.

VI - VIII.

Në vende me lagështirë, shkorrete e pyje.



Primula elatior (L.) Hill. - Aguliçja e ngritur
Primulaceae - Aguliçore

Bimë barishtore shumëvjeçare, l2 – l8 cm e lartë, miellore.


Gjethet 2 – 8 x 0.5 – 3 cm, gjatore – vezake të përmbysëta, përposh miellore, me dhëmbëz të imtë.

Shtija 8 – l2 cm, me 2 – l2 lule. Kurora me diametër l5 – 20 mm, ngjyrë jargavani,

Me gyp 20 – 30 mm, 2 – 3 herë më të gjatë se kupa. Kapsula cilindrike.

V – VI.

Rritet në livadhe dhe të çara shkëmbinjsh të zonës alpine.



Primula halleri J.F. Gmelin – Aguliçja e Hallerit
Primulaceae - Aguliçore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 30 cm e lartë.

Gjethet në rozetë të çlirët, gatirrotullare deri gjatore ose eliptike, me buzë ura-ura deri si dhëmbë ose të plota.

Shtija lulore zakonisht me qime. Lulesa ombrellë me 3 - 12 lule. Braktetë vizake deri vezake. Kupa me vriguj heshtorë ose trekëndorë. Kurora e verdhë, nganjëherë portokalli në grykë.

V – VI.

Haset në pyje e vende me bar të zonave malore.



Primula veris L. - Aguliçja e vërtetë
Primulaceae - Aguliçore

Bimë barishtore shumëvjeçare me shtije, 15 - 25 cm e lartë.

Gjethet në rozetë bazale. Kanë formë vezake deri vezake gjatore, shytë, menjëherë të ngushtuara në bisht me flatra.

Shtija me qime. Lulesa ombrellë me 5 - 15 lule. Kupa kambanore. Kurora e verdhë e shndritshme. Fryti kapsulë, më e shkurtër se kupa.

V - VI.

Rritet në vende me bar, kullota, pyje e shkorrete. Bimë mjekësore.



Primula vulgaris Huds. - Aguliçja e zakonshme
Primulaceae - Aguliçore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 20 cm e lartë.

Gjethet janë në rozetë bazale. Kanë trajtë lopate që ngushtohen gradualisht në një bisht me flatra. Buza dhëmbë - dhëmbë.

Lulet të vetmuara mbi bishta të gjatë që dalin nga rrënja. Pra shtija mungon. Bishti i lules me qime të gjata. Sepalet dhe petalet janë të ngjitura. Kurora e verdhë e zbehtë. Numri i thekëve 5. Ato janë të ngjitura në gypin e kurorës.

II – IV.

Rritet në pyje, shkorrete e vende me lagështirë.



Spiraea media Fr. – Spirea e ndërmjemë
Rosaceae – Trëndafilore

Shkurre, 1 – 2 m e lartë. Degët të forta, të drejta, në fillim pak me qime, të murrme – të verdha, pasataj bëhen të përhime.

Gjethet eliptike - të gjera, në bazë pykore, me bishta të gjatë 1 – 2 mm.

Lulesa vastak me shumë lule të bardha. Fryti rrëshekth.

VI – VII.

Rritet në pyje kodrinore – malore, shkorrete. Gjithashtu edhe e kultivuar.



Spiraea vanhouttei (Briot) Zabel – Spirea e Vanhutit
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë shumëvjeçare 50 - 150 cm e lartë, me rizomë. Kërcelli me qime të gjata të hapura dhe të shkurtra dredhake.

Gjethet pendore të prera me 4 - 5 çifte gjethëzash kryesore dhe 2 - 3 çifte më të vogla ndërmjet tyre. Gjethëzat vezake ose eliptike, urëza - urëza, përsipër të gjelbra të errëta, përposh të bardheme ose të përhimta pushbuta.

Lulet në vile skajore si kalli. Kupëza mungon. Kurora me petale të verdha - ari, vezake të përmbysëta. Fryti aken.

V - VII.

Rritet në shkorrete dhe pyje. Bimë ngjyruese, aromatike e mjekësore.



Agrimonia eupatoria L. – Rodhëza
Rosaceae – Trëndafilore

Shkurre deri 2 m, me kërcej të harkuar.

Gjethet gjatore ose gjatore – rombike, të mprehta, të prera – të sharruara, dhe zakonisht me 3 – 5 vriguj.

Lulesa ombrellë e thjeshtë, me bisht. Petlat të bardha, dy herë më të gjata se thekët.

III – VI.

E kultivuar nëpër lulishte e parqe si bimë zbukurimi.



Agrimonia agrimonoides L. –
Agrimona si rrodhëz
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë shumëvjeçare me rizomë. Kërcelli 5 - 2O cm, hollak, me rozetë gjethesh bazale.

Gjethet 10 – 15 cm, zakonisht me 2 – 3 çifte gjethëzash kryesore; gjethëzat vezake të përmbysëta, ura-ura si dhëmbë.

Lulesa cimë, me 2 - 3 lule 5-pjesëshe. Çdo lule ka pështjellë me 8 - 12 vriguj. Kupa e ndarë në segmente. Petalet të verdha – ari, vezake të përmbysëta.

V - VII.

Rritet në pyje e shkorrete.



Amelanchier canadensis (L.) Medik – Sqapthi kanadez
Rosaceae - Trëndafilore

Shkurre ose dru i vogël 0.5 – 8 m e lartë, me kurorë të vogël dhe të ngushtë.

Gjethet të këmbyera, ovale deri ovale – gjatore, majëmprehtë apo gjysmë të mprehtë, përposh me push.

Lulet zhvillohen herët në pranverë. Lulesa vile skajore me 4 -10 lule. Petalet vizake deri gjatore – vezake, të bardha; thekë 10 – 20. Fryti kaltërosh – i zi, i ngrënshëm..

Lul. III – IV; Fryt. VI – VII.

Bimë zbukurimi me origjinë nga Kanada. Bimë mjekësore.



Cotoneaster integerrimus Med. – Borbulli
Rosaceae – Trëndafilore

Shkurre 0.5 – 1.5 m, me gjethe rënëse. Degët e reja pushbuta që shpejt bëhen të shogëta.

Gjethet gati rrotullare deri vezake, përsipër të shogëta, përposh me push të përhimtë, me bishtak.

Cimat të shkurtra me 3 – 5 lule. Kupa e shogët dhe me push në buzët. Petalet të bardha deri të trëndafilta. Fryti rruzullor, i shogët, i kuq.

Lul. V – VI; fryt. VIII – IX.

Në vende të thata dhe shkëmbore të zonave malore. Euroaziatike.



Alchemilla monticola Opiz – Alkemila e maleve
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 – 50 cm, shumë e shëndoshë. Bishtakët, gjethet dhe kërcejtë me qime të dendura e të hapura, kurse këmbëzat të shogëta.

Gjethet rrotullare, të bazës me bishtakë 10 20 cm, dendësisht pushbuta në të dyja faqet, Vrigujt 9 – 11, pak a shumë gjysmërrethorë, me 7 – 9 dhëmbë pak a shumë të barabartë e të mprehtë.

Lëmshukët të dendur. Lulet rreth 3 mm të gjera.

VI – VIII.

Në kullota të zonave subalpine dhe alpine. Eurosiberiane.



Alchemilla alpina L. – Alkemila e alpeve
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare.

Gjethet pëllëmbore, të ndara deri në bazë. Segmentet heshtore ose gjatore, në majë të dhëmbëzuara, nga sipër të shogëta, nga poshtë të mbuluara me qime.

Lulet të grumbulluara në lulesa vile - melthore. Bishtat e luleve më të shkurtër se lulet.

VI - VIII.

Rritet në vende shkëmbore dhe me bar të zonës alpine. Në Kosovë ndeshet në Malet e Sharrit (Lubo-ten) dhe Alpet Sqiptare.



Aruncus dioicus (Walter) Fernald – Arunku dioik
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 2 m e lartë. Rizoma është e drunjëzuar, e fortë, shumë e degëzuar dhe me rrënjë adventive.

Gjethet e përbëra, deri 1 m të gjata, dy herë pendore. Gjethëzat vezake, me dhëmbë të mprehtë dy herë të sharruara.

Lulesa e gjerë piramidale. Lulet zakonisht të një gjinie, gati pa bisht. Petalet të bardha ose të verdhëreme – të bardha.

V - VI.

Rritet në pyje të ahut deri në zonat subalpine.



Crataegus monogyna Jasq. – Murrizi njëbërthamësh
Rosaceae – Trëndafilore

Shkurre ose dru i vogël, 5 - 6 m e lartë, me gjemba e gjethe rënëse.

Gjethet vezake të përmbysëta, me 3 - 5 vriguj të plotë ose me pak dhëmbë në majë, gati lëkurore. Ndajgjethëzat të plota, heshtore.

Lulet në vastak. Petalet të bardha. Frytet rruzullore, të kuqe të errëta, me një bërthamë.

IV - V.

Rritet në shkorrete, gjerdhe e pyje, e zakonshme. Bimë mjaltëse dhe mjekësore.



Crataegus pentagyna Waldst. et Kit. –
Murrizi pesëbërthamësh Rosaceae – Trëndafilore



Filipendula ulmaria(L.) Maxim. – Shtalbës i egër
Rosaceae – Trëndafilore



Filipendula vulgaris Moench. - Filipendula e rëndomtë
Rosaceae – Trëndafilore

Shkurre ose dru i vogël 4 – 5 m. Gjembat rreth 10 mm.

Gjethet gati rombike – vezake deri vezake të përmbysëta, lëkurore, përsipër të gjelbra të errëta e pothuajse të shogëta, përposh të gjelbra të çelëta e me qime të merimangëta të rralla. Vrigujt 3 – 7, të sharruar, të gjerë, me gjire të mprehta.

Vastaku i përbërë, me shumë lule. Fryti rruzullor – elipsoid, i kuq i errët në të zezë, me 3 – 5 bërthama.

Lul. V – VI; fryt. VIII – IX.

Buzë pyjesh.

Shumëvjeçare barishtore me rizomë, pushlore deri pushbutë. Kërcejtë deri 200 cm të lartë, të thjeshtë ose të degëzuar, me gjethe.

Gjethet pendore, me 2 - 5 palë gjethëza. Gjethëzat e mëdha vezake deri vezake - gati-rrotullare, ura - ura të sharrëzuara, të mprehta, përposh me push të bardhë të rrallë deri të dendur.

Lulesa melth cimor, e çlirët, skajore. Kupa me vriguj të spërveshur. Petalet ngjyrë krem të zbehtë . Fryti kokë akenësh të përdredhur si spiral.

V - VII.

Në livadhe me lagështi si dhe çeltira pyjesh të lagëta.

Bimë barishtore shumëvjeçare. Rrënjët me rizoma zhardhokore ovoide. Kërcejtë deri 80 cm, të thjeshtë e me pak gjethe.

Gjethet pendore me 8 - 25 palë gjethëza të mëdha. Gjethëzat pendore të çara, vrigujt shpesh dhëmbë-dhëmbë. Ndajgjethëzat me dhëmbë të prerë dhe kërcellpështjellëse.

Lulesa melth cimor, 3 - 10 cm, më e gjerë se e gjatë. Kupa me vriguj. Kurora zakonisht me 6 petale të purpurta nga jashtë. Thekët gati të barabarta me petalet. Akenët të ngritur, pushlorë.

V - VII.

Rritet në livadhe e kullota të thata. Bimë aromatike.



Cydonia japonica Hort. – Ftoi japonez
Rosaceae – Trëndafilore

Shkurre 1 - 3 m e lartë.
Gjethet vezake, me buzë të sharruara, të shogëta.

Lulet me diametër 2.5 – 3.5 cm.Petalet ngjyrë trëndafili. Së pari shfaqen lulet, pastaj gjethet.Thekë 40 – 60. Fryti gati rruzullor; i pasur me vitaminë C.

Lul. III – IV; fryt. IX – X.

E kultivuar si shkurre zbukurimi; e përshtatshme për mur të gjallë. Aziatikolindore (Japonia, Kina).



Fragaria moschata Duchense – Luleshtrydhe erëmyshku
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare pa ose me pak stolone,deri 40 cm e lartë.
Gjethet me 3 gjethëza, në rozetë bazale; gjethëzat vezake të përnbysëta deri rombike, të sharruara trashë, përposh me push ose qime të mëndafshta.
Bishti lulor (shtija) deri 40 cm, me qime pushlore të hapura. Lulet të bardha, zakonisht njëseksore. Sepalet të hapura ose të spërveshura në frytëzim. Shtrati lulor i dalë, i kuq dhe i shogët
V – VI.
Në pyje, gjerdhe e vende me bar. Europianoqendrore.



Malus florentina (Zuccagni) C. K. Schneid. – Molla florentine
Rosaceae – Trëndafilore

Shkurre ose dru i vogël 1 – 4 m, pa gjemba.

Gjethet vezake të gjera, të vrigulluara dhe dhëmbë – dhëmbë, të cunguara ose si zemër në bazë, me push të bardhë përposh.

Lulet të bardha; sepalet rënëse. Fryti elipsoid i gjerë, i kuq, me qeliza gurore.

Lul. IV – V; fryt. IX – X.

Mesdhetareverilindore.



Potentilla argentea L. – Zorrëca e argjendtë
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 50 cm e lartë. Kërcelli i drejtë ose i përpjetëm me qime të bardha, i kuqërremt, me shumë gjethe.
Gjethet të gishtëzuara, përposh me qime të mëndafshta.
Lulet zakonisht të shumta. Sepalet trekëndore – heshtore. Petalet të verdha.
VI – VII.
Pranë rrugëve, në vende gurore, livadhe, pyje të degraduara etj.



Prunus cerasifera Ehrh. – Kumbulla qershimbajtëse
Rosaceae - Trëndafilore

Dru i vogël 3 – 8 m, me degë të holla dhe të hapura, pa ose me pak gjemba. Degët e reja të shogëta.
Gjethet gjatore-vezake të përmbysëta, pykore në bazë, të thepëta, me dhëmbë të thjeshtë ose të dyfishtë.
Lulet dalin së bashku me gjethet, të vetmuara ose edhe nga dy, varen sa fillon lulëzimi. Kupa e shogët. Petalet të bardha. Fryti bërthokël, rruzullor ose eliptik, i varur, i shogët, i kuq ose verdhak kur piqet, me tul të lëngët, i thartë.
Lul. III - IV; fr. V – IX.
Nëpër gjerdhe e pyje, e rrallë. Mbillet si bimë zbukurimi. Ballkanike.



Prunus cerasifera var. pissardii (C.) Koehne –
Kumbulla gjethekuqe Rossaceae – Trëndafilore

Dru i vogël 3 – 8 m, me degë të holla dhe të hapura, pa ose me pak gjemba
Gjethet gjatore – vezake të përmbysëta, pykore në bazë, me dhëmbë të thjeshtë ose të dyfishtë; të kuqe purpur.
Lulet dalin së bashku me gjethet, të vetmuara ose edhe nga dy. Petalet trëndafili. Frytet të kuqe të errëta.
Lul. III – IV; fryt. VI – IX.
Mbillet si bimë zbukurimi.



Prunus laurocerasus L.– Dafina si qershi
Rosaceae – Trëndafilore

Shkurre gjethembajtëse, 1.5 m e lartë në kushte natyrore; e kultivuar arrin lartësinë deri 7 m. Gjethet 8 – 15 (- 20) cm të gjata, 4 – 8 cm të gjera; ngjasojnë me gjethet e dafinës (Laurus nobilis); kur shtypen lëshojnë erë bajame (Prunus amigdalus).

Lulesa në vile skajore. Lulet dyseksore, aromatike, të bardha. Një lulesë përmban 30-40 lule. Fryti bërthokël, në fillim i gjelbër, më vonë merr ngjyrë të zezë.

Lul. IV – V; fryt. VIII – IX.

Mbillet për të zënë ndonjë shteg, gardh. Bimë helmuese përveq fryteve mirë të pjekura. Ka prejardhje nga Azia e Vogël.



Rubus saxatilis L. – Manaferra e shkëmbinjve
Rosaceae – Trëndafilore

Gati shkurrëz me kërcej 10 – 40 cm. Kërcejtë vegjetativë të shtrirë, leshtorë, të pajisur me thumba të vegjël e të drejtë, shpesh rrënjëzojnë në majë, që thahen pothuajse deri në bazë nga të cilët dalin kërcejtë lulorë vitin e ardhshëm.

Gjethet trishe, vezake – eliptike, të sharruara.

Lulesa vastak me 3 – 10 lule. Sepalet heshtore, të thepëta, me qime pushlore. Petalet të ngritura, të ngushta, të vogla, të bardha. Bërthokëlza 2 – 6, të trëndafilta të shndritshme.

Lul. VI VII; fryt. VIII – IX.

Në shpate me gurë, pyje të rralluara të zonave alpine. Në Kosovë e kemi ndeshur në Kobilicë.



Sorbus chamaemespilus (L.) Crantz – Vadhë mushmollëvogël Rosaceae – Trëndafilore

Shkurre e vogël 50 – 150 cm, zvarritëse – e përpjetme.
Gjethet vezake , të ngushtuara dhe të plota në bazë, dyfish të dhëmbëzuara në pjesën tjetër.
Lulet në vastakë të vegjël të ngjeshur, pushbutë. Petalet vezake të përmbysëta – heshtore, të ngritura, të trëndafilta.
Fryti ovoid ose gati rruzullor, i kuq portokall kur piqet, me pak bërthama.
Lul. VI – VII; fryt.IX – X.
Në shkëmbinj e shkorrete të vendeve të thyera. Europianojugore.

Bimë barishtore shumëvjeçare. Rizoma horizontale, pa stolone. Kërcejtë më të shkurtër, pak më të lartë se gjethet bazale.
Gjethet veshkore të gjera. Në pjesën bazale si zemër, me 5 – 7 vriguj, me buzë të dhëmbëzuara.
Lulet hermafrodite, të verdha, me 5 sepale dhe 5 petale; thekë shumë.
IV – V.
Rritet në pyje gjetherënëse të ndritshme. E përhapur në disa vende të Europës qendrore dhe perëndimore, gadishullin Ballkanik dhe Kaukaz.



Waldsteinia geoides Willd. – Valdshtania e lumtur
Rosaceae – Trëndafilore



Fragaria vesca L. – Luleshtrydhe
Rosaceae – Trëndafilore



Dryas octopetala L. – Driada tetpetlash
Rosaceae – Trëndafilore



Geum bulgaricum Pan. – Mëlaka e Bullgarisë
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare me stolone të gjata dhe të rrënjëzuara.

Gjethet me 3 gjethëza, në rozetë bazale. Gjethëzat vezake, të sharruara trashë, përsipër të gjelbra e me qime të rralla.

Shtija pak më e gjatë se gjethet, e ngritur në frytëzim. Bishti i lules me qime pushlore të rrasura. Lulet të bardha, zakonisht hermafrodite. Akenët të shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme mbi shtratin lulor, të kuq dhe të shogët.

V - VI.

Në pyje, shkorrete, gjerdhe, vende me bar, e zakonshme. Bimë aromatike e mjekësore.

Shkurrëz deri 30 cm e lartë.

Gjethet të thjeshta, gjatore deri vezake, të qëndrueshme, ura – ura, përsipër të shogëta, përposh me push të bardhë si argjend, me ndajgjethëza.

Lulet të vetmuara, me diameter 25 – 40 mm. Petla (7-) 8 (-10), të bardha. Thekë dhe karpele të shumtë.

VI – VII.

Në kullota shkëmbore të zonave të larta malore(Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptqre).

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të trashë. Kërcelli i drejtë, me pak gjethe të vogla, me qime të gjata dhe gjëndërorë.

Gjethet e bazës të mëdha, lirake. Gjethëza skajore 10 – 15 cm, si zemër – veshkore.

Lulesa me 3 – 7 lule të varura, kambanore. Kupa e gjelbër e shndritshme. Petalet trekëndëshe, majëngrëna, të bardheme deri të verdha të zbehta.

VI – VII.

Në vende shkëmbore dhe kullota të zonave të larta malore (Alpet-Shqiptare).Endemike e Ballkanit.



Geum coccineum Sibth. et Sm. – Mëlaka e kuqe
Rosaceae - Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të shkurtër e të trashë. Kërcelli 20 – 30 cm, i degëzuar.

Gjethet e bazës pendore, me 3 – 6 çifte gjethëzash të pabarabarta. Gjethëza skajore gati rrotullare, e prerë ose me vriguj. Gjethet kërcellore të ndara trish.

Lulesa me 2 – 5 lule të varura dhe kambanore. Kupa e murrme e kuqërremtë. Petalet të ngritura, me thonjëz të gjatë, ngjyrë kremë deri të trëndafilta.

VI – VII.

Në vende me lagështi, kryesisht të zonave malore.



Geum rivale L. – Mëlaka e përrenjëve
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të ngritur, të degëzuar, 15 – 50 cm të lartë.

Gjethet bazale lirake, që ndërpriten, me pjesën skajore shumë të madhe, ndërsa ato të kërcellit të pandara.

Lulet janë të kuqe, të mëdha, me bishta të gjatë, gjatë tharjes marrin ngjyrë portokalli. Fryti është aken.

VI – VIII.

Rritet në kullota dhe livadhe me lagështi të zonës subalpine dhe alpine.



Geum montanum L. - Mëlaka e maleve
Rosaceae - Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë zvarritës.

Gjethet bazale janë pendore me pak gjethëza anësore, të dhëmbëzuara. Gjethëza terminale është e madhe, e rrumbullakët. Kërcelli lulor 10 – 20 cm i lartë, me një lule e me gjethe të vogla.

Lulet të verdha – ari. Sepalet trekëndëshe. Fryti anen. Akenët të shumtë.

VII – VIII.

Rritet në kullota dhe shkurre subalpine dhe alpine.



Geum urbanum L. - Mëlaka qytetesh
Rosaceae - Trëndafilore

Bimë shumëvjeçare, leshtore. Kërcelli 20 – 70 cm, i ngritur, i degëzuar.

Gjethet e bazës pendore, me 1 - 5 çifte gjethëzash të pabarabarta. Gjethëza skajore 2 – 10 cm, gati rrotullare dhe thellësisht e vrigulluar.

Lulet të ngritura e me bishta të gjatë. Kupa e gjelbër, e spërveshur pas lulëzimit. Kurora me petale të hapura të verdha të zbehta.

V – VIII.

Rritet në vende me hije, pyje, shkorrete, gjerdhe etj. Bimë aromatike e mjekësore.



Mespilus germanica L. – Mushmolla dimërore
Rosaceae - Trëndafilore

Shkurre ose dru, 2 – 6 m e lartë.

Gjethet janë të thjeshta, të plota ose me dhëmbë të imët, në anën e poshtme me push.

Lulet me diametër 3 – 4 cm, të vetmuara. Sepalet të qëndrueshme, më të gjata se petalet. Petalet të bardha, gati rrotullare. Thekë 30 – 40; anteret të kuqe. Fryti 2 – 3 cm, me ngjyrë të gjelbër në gështenjë të çelur, i shoqëruar nga sepalet gjethore. Kur janë të papjekura kanë shije të athët, ndërsa, kur ndulken, ëmbëlsohen. Brenda ka 5 bërthama.

V – VI.

E kultivuar si shkurre apo dru frutor.



Potentilla arenaria Borkh. – Zorrëca ranore
Rosaceae – trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare deri 15 cm e lartë, tufore me kërcej steril dhe pjellor. Kërcelli lulor i shtrirë ose i ngritur me qime yllore dhe gjëndërore.

Gjethet të gishtëzuara; gjethëzat vezake të përmbysët. Lulet të vetmuara. Segmentet e kupës së dyfishtë vizake. Petalet e verdha , dy herë më të gjata se sepalet.

III – V.

Në vende shkëmbore dhe kullosa të thata.



Potentilla doerfleri Wettst. – Zorrëca e Dorflerit
Rosaceae – Trëndafilore



Potentilla micrantha Ram. – Zorrëca lulevogël
Rosaceae – Trëndafilore



Potentilla recta L. – Zorrëca e drejtë
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli 5 – 25 cm i lartë, i mbuluar me qime të dendura dhe me qime gjëndërore 0,15 – 0,2 mm të gjata.

Gjethet pëllëmbore me 5 gjethëza; gjethëzat vezake, me buzë të sharruara, me qime, të gjelbra ose të gjelbra në të hirtë.

Lulet zakonisht të shumta. Fletëzat e kupës trekëndore – heshtore. Petalet 5 – 7 mm, të bardha, më të shkurtra se sepalet.

VII – VIII.

Rritet në kullota dhe vende shkëmbore të zonës alpine. Bimë endemike e Kosovës. Në Kosovë është e përhapur në Malet e Sharrit (Bistra, Maja e Zezë, Vracë); është zbuluar nga botanisti austriak Wettstein në vitin 1892.

Barishtore shumëvjeçare, me qime pushlore e me kërcej lulorë, 5 – 15 cm e lartë.

Gjethet trishe. Gjethëzat vezake, të sharruara. Në pjesën e poshtme me qime të mëndafshta të përhimta.

Lulet të vetmuara. Sepalet në pjesën e poshtme afër bazës të kuqërremta të errëta. Petalet të bardha. Shtrati lulor shumë leshtor.

IV – V.

Ndeshet në pyje dhe shkorrete.

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcej lulor, 20 – 70 cm e lartë.

Gjethet të gishtëzuara në 5 – 7 gjethëza gjatore të gjelbra ose të përhimta. Buza e llapës e sharruar, në faqen e poshtme me nervura të ngritura. Kërcelli me bishtat e luleve me qime të gjata të rralla, midis tyre edhe qime të shkurtra e të dendura.

Lulet e shumta në cima. Sepalet trekëndëshe – vezake. Petalet të verdha, aq ose më të gjata se sepalet.

IV – VII.

Në vende barishtore të thata e shpate shkëmbore, pyje etj.



Potentilla reptans L. – Zorrëca zvarranike
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell zvarritës jo të degëzuar dhe, me përjashtim të 3 – 4 nyjeve skajore, të tjerat rrënjëzohen, 30 – 100 cm e lartë.

Gjethet në rozetë. Llapa e gishtëzuar në 5 (-7) gjethëza vezake ose gjatore vezake, dhëmbë – dhëmbë ose të sharruara si dhëmbë.

Lulet 5-pjesëshe, të gjitha të vetmuara e sqetullore. Petalet e verdha. Fryti kokë shumakenëshe.

VI – VIII.

Rritet në vende me lagështi dhe livadhe. Bimë aromatike dhe mjekësore.



Potentilla speciosa Willd. – Zorrëca e bukur
Rosaceae – Trëndafilore

Shumëvjeçare barishtore me kërcej lulorë deri 30 cm, me qime pushlore të përhimta ose të bardha.

Gjethet trishe; gjethëzat vezake të përmbysëta, ura-ura të paktën në 2/3 e sipërme, përposh me qime pushlore të bardha..

Lulet të shumta. Sepalet vezake të gjera. Petalet të bardha, pak më të gjata se sepalet. Pjalmoret gjatore. Shtrati lulor shumë leshtor.

VI – VII.

Në vende shkëmbore të zonave të larta malore. Ballkanike.



Potentilla sulphurea Lam. – Zorrëca e verdhë si squfuri
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 – 70 cm e lartë me ngjyrë të gjelbër të shndritshme, e mbulluar me qime të thjeshta të gjata dhe të shkurtra.

Gjethet të gishtëzuara; gjethëzat zakonisht 5 – 7, gjatore – vezake, 5 – 10 x 0.5 – 3.5 cm.

Lulet në cima të çlirëta. Bishti i lules me qime të thjeshta ose gjëndërore. Sepalet gjithashtu me qime. Petalet ngjyrë limoni, 2 herë më të gjata se sepalet e jashtme.

V – VII.

Në kullota të thata, shkurraja, shpate shkëmbore.



Potentilla ternata K.Koch. - Zorrëca
Rosaceae - Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 3 – 10 cm. Kërcelli i ngritur ose i shtrirë, me push; pa gjëndra.

Gjethet bazale me bishta të gjatë, gjithmonë 3 pjesëshe; kërcelloret pa bisht.

Lulesa dikaze me pak lule.Sepalet e dyta vizake - heshtore. Petalet ngjyrë të verdhë - ari.

VI – VIII.

Rritet në vende gurore, me bar, pyje të zonës subalpine.

Në Kosovë ndeshet në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare.



Prunus spinosa L. - Kullumbria
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare e lartë deri 50 cm, me rizomë të degëzuar dhe të fuqishme. Kërcelli ka ngjyrë të kuqe, i mbuluar me qime të shkurtëra e të gjata dhe gjëndërore.

Gjethet bazale me bishta të gjatë. Kanë formë pendore. Gjethëzat pykore – vezake të përmbysëta.

Lulet të shumta, në cima skajore. Petalet të verdha, shumë më të gjata se sepalet.

VI – VII.

Rritet në të çara shkëmbore dhe terrene serpentinore dhe gëlqerore. Bimë endemike e Ballkanit.



Potentilla visianii Pan. – Zorrëca e Visianit
Rosaceae - Trëndafilore

Shkurre 1 – 3 m, rrallë rritet si dru deri 5 m. Ka dru të kuqërremtë me rremba të murrme të zeza, të shumta e të hapura e me gjemba.

Gjethet vezake të përmbysëta, ose gjatore – heshtore, të dhëmbëzuara imët.

Lulet dalin para gjetheve, të vetmuara ose edhe nga 2 – 3, të bardha si borë. Fryti bërthokël, rruzullor, blu më të zi, me pluhurizë, me shije të athët, vështirë ndahet nga bërthama.

IV – V.

Ndeshet nëpër shkorrete, gjerdhe, rrëzë pyjeve të zonave të ulëta. Bimë mjekësore.



Prunus tenella Batsch – Pjeshka e egër
Rosaceae - Trëndafilore



Pyracantha coccinea Roem. - Ushinthi
Rosaceae - Trëndafilore



Pyrus amygdaliformis Vill. - Gorrica
Rosaceae - Trëndafilore

Shkurrëz e vogël. Në Kosovë rritet në lartësi deri 50 cm, kurse në vendet tjera deri 150 cm. Degët janë të përhime ose të kuqërreme.

Gjethet vizake – heshtore, 3 – 7 cm të gjata.

Lulet të vetmuara, çelin edhe para gjethimit. Sepalet deri 4 mm të gjata. Petalet kanë ngjyrë trëndafili në të kuqe. Fryti bërthokël pak e shtypur dhe pak me qime. Ka ngjyrë të bardhë – të verdheme.

III – V.

Në Kosovë ndeshet në Ostrozub, Gllarevë, Pashtrik etj. Lulet i ka të bukura, prandaj mbillet edhe si bimë dekorative.

Shkurre deri 2 m, degët me gjemba, me gjethe të qëndrueshme gjatë dimrit.

Gjethet të thjeshta, eliptike deri heshtore, buzëve me dhëmbë të imët, të shkëlqyeshme.

Lulet në vastak të përbërë. Sepalet të qëndrueshme. Petalet gati rrotullare, të bardha. Fryti rruzullor, me ngjyrë portokalli të fortë ose të kuqe të ndezur.

Lul. IV – V; fryt. IX – X.

Rritet në pyje, shkorrete, gjerdhe etj. Përdoret si shkurre zbukurimi nëpër parqe.

Shkurre ose dru 1 – 6 m, me degëza shpeshherë gjembore. Degët e reja të përhime dhe vetëm në fillim pushbuta.

Gjethet heshtore të ngushta deri vezake të përmbysëta, zakonisht të plota, ose dhëmbëza – dhëmbëza, me bazë rrotullora ose pykore, me qime leshtore.

Lulet në vastak. Nënpetlat trekëndëshe, të thepëta. Petlat eliptike, zakonisht majëngrëna. Fryti zakonisht rruzullor, i kuqërremtë – kafe, të cilat zbuten e ëmbëltohen kur piqen ose kur rrinë në kashtë. Kupa e qëndrueshme.

Lul. IV – V; fryt. X – XI.

Në vende të thata, e zakonshme.



Rosa canina L. – Trëndafili i egër
Rosaceae – Trëndafilore



Rosa gallica L. – Trëndafili i Francës
Rosaceae – Trëndafilore



Rosa pendulina L. – Trëndafili i malit
Rosaceae – Trëndafilore

Shkurre, 1 – 3 m e lartë. Kërcejtë i ka të blertë me degë të shëndosha, të mbuluara me gjemba të fortë.

Gjethet tekpendore të përbëra prej 5 – 7 gjethëzave. Gjethëzat vezake ose eliptike me dhëmbë të thjeshtë ose të dyfishtë.

Lulet janë të vetmuara ose të pakta në vastakë dhe me erë të mirë. Sepalet pendore - të çara. Petalet ngjyrë trëndafili ose të bardha. Thekët të shumtë. Fryti i kuq, i shogët, rruzullor deri eliptik, me shumë fara brenda.

Lul.V – VII; fryt. VIII – IX.

Rritet nëpër shkorrete e gjerdhe të vendeve fushore ose malore. Bimë mjekësore; frytet janë të pasura me vitaminë C.

Shkurrëz zakonisht gjugje, 40 – 80 cm.

Gjethet rënëse, me 3 – 7 gjethëza të trasha lëkurore, gatirrotullare ose vezake deri eliptike, përsipër të shogëta, përposh pushlore – bardhoshe, me nervura të dala.

Lulet zakonisht të vetmuara. Nënpetlat me gjëndra në kurriz, të jashtmet me shtojca të shumta, rënëse. Petlat të trëndafilta të errëta me aromë të fortë.

V – VI.

Nëpër shkorrete e vende të veshura të zonave kodrinore e malore të ulëta. Shpesh i mbjellë për zbukurim. Bimë mjekësore.

Shkurrëz deri 2 m. Thumbat zakonisht mungojnë, rrallëherë të shpërndarë nën lulet.

Gjethëza 7 – 11, gjatore - vezake, përsipër të shogëta ose pushlore, përposh zakonisht pak pushlore, me dhëmbë.

Lulet zakonisht të vetmuara, rrallë 2. Nënpetlat të ngushta, më të gjata se petlat, të plota, të ngritura dhe të qëndrueshme pas lulëzimit. Petlat të trëndafilta të errëta ose të purpurta.. Fryti ovoid, në formë dardhe, rrallë rruzullor, i kuq i ndezur kur piqet.

VI – VIII.

Në kullota me gurë, në vende të rrjepura e rrëzë pyjesh të vendeve të larta malore.



Rosa spinosissima L. – Trëndafili gjethenetërze
Rosaceae – Trëndafilore



Rubus caesius L. - Manaferra e kaltëreme
Rosaceae - Trëndafilore



Rubus idaeus L. - Mjedra
Rosaceae – Trëndafilore

Shkurrëz e vogël 10 – 50 cm, rrallë një m. Kërcejtë formojnë grumbuj të dendur. Thumbat të shumtë, të drejtë, të pabarabartë.

Gjethëza 5 – 11, të vogla, gati rrotullare ose eliptike të gjera, të shogëta, zakonisht me dhëmbë të thjeshtë.

Lulet të vetmuara. Sepalet heshtore të ngushta, të plota, të qëndrueshme tek fryti. Petalet verdhake të hapëta – të bardha, rrallë të trëndafilta të hapëta. Fryti rruzullor, i zi.

V – VI.

Në vende të thata me gurë e shkëmbinj.

Shkurre ose shkurrëz 1 – 2 m e lartë. Kërcejtë të degëzuar, të shogët, me si pluhur të rimtë. Thumbat të paktë ose të shumtë, të dobët, të shkurtër.

Gjethet trishe, përsipër me pak qime. Gjethëza skajore vezake, nganjëherë pak a shumë trevrigujshe, dyfishsharruar. Bishti i hullizuar.

Lulesa e shkurtër që përbëhet nga një vastak skajor me 2 - 5 lule. Sepalet vezake – heshtore. Petalet të mëdha të bardha. Thekët të gjelbër. Fryti me 8 – 10 bërthokëlza të mëdha, të zeza me pluhurizë.

V - VIII.

Rritet në pyje të zonave malore. Bimë ngjyruese, mjaltëse e mjekësore.

Shkurre deri 1 m e lartë, me kërcej të ngritur, me pluhurizë, shpesh të pajisur me shumë thumba të dobët.

Gjethet tekpendore me 5 – 7 gjethëza ose trishe. Gjethëzat nga sipër të shogëta, nga poshtë me push të bardhë.

Lulesa vile me 2 – 5 lule. Sepalet heshtore, pushbuta. Petalet të bardha, të ngushta, të ngritura. Fryti i kuq ose portokall, me shije të ëmbël e erë të mirë.

V – VI.

Rritet në çeltira pyjesh dhe pyje të rralla gjethegjera dhe halore.



Rubus ulmifolius Schott – Manaferra
Rosaceae – Trëndafilore



Sanguisorba minor Scop. – Sanguisorba më e vogël
Rosaceae Trëndafilore



Sanguisorba officinalis L. – Sanguisorba mjekësore
Rosaceae – Trëndafilore

Shkurrëz ose shkurre deri 2 m e lartë. Kërcejtë të harkuar ose të shtrirë, me pluhurizë dhe thumba të shëndoshë.

Gjethet me 3 – 5 gjethëza të dhëmbëzuara, përsipër të gjelbra – të errëta, përposh me push të bardhë.

Lulesa shpesh e gjatë, me gjethe në bazë. Sepalet me push të bardhë. Petalet të rrudhosura, rrotullare ose vezake, të bardha ose të trëndafilta. Fryti i zi, i ëmbël, i ngjitur me shtratin lulor.

V – VII.

Rritet në gjerdhe, shkorrete e kullota. Bimë mjekësore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 60 cm e lartë, e shogët ose me qime. Ka rizomë mirë të zhvilluar.

Gjethet bazale janë të vendosura në trajtë rrezesh. Gjethet kërcellorë pendore me 6 – 8 çifte gjethësash rrotullare deri eliptike, me buzë ura – ura deri të prera – të sharruara.

Lulet në koka rruzullore deri ovoide. Së pari qelin lulet e poshtme mashkullore të lulesës. Pastaj ato të mesit hermafrodite, dhe të sipërmet femërore. Kupa është e përbërë prej 4 sepaleve të hapura si yll. Kurora mungon. Thekë të shumtë. Fryti aken.

VI – VII.

Rritet në vende me bar, shkëmbinj, pranë rrugëve etj.

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, me kërcej 40 – 150 cm, të ngritur, të degëzuar.

Gjethet e bazës dhe kërcellore me 3 – 4 çifte gjethëzash. Gjethëzat vezake ose gjatore – vezake, dhëmbë – dhëmbë, shytë në majë.

Lulet në koka gati rruzullore, hermafrodite. Sepalet të ngritura – të hapura. Petalet mungojnë. Anteret ngjyrë kërmëz të errët.

V – VII.

Rritet në vende barishtore, kryesisht të zonës së ahut. Bimë ngjyruese, aromatike e mjekësore.



Sanguisorba albanica Andras. et Jav. – Sanguisorba shqiptare Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët me kërcej 20 – 100 cm, të ngritur, të degëzuar.

Gjethet lëkurore, të shndritshme, ato të bazës dhe kërcellore të poshtme me 3 – 7 çifte gjethëzash; gjethëzat vezake ose gjatore-vezake, dhëmbë-dhëmbë, pak a shumë si zemër në bazë.

Kokat (lulesat) 2 – 8 cm, cilindrike. Lulet hermafrodite; thek 4 me pjalmore të verdha.

VI – VIII.

Në shkorrete mbi shkëmbinj serpentinorë. Bimë endemike e Kosovës dhe Shqipërisë. Në Kosovë është e përhapur në terrenet kufitare me Shqipërinë (qafa e Prushit, Çerret etj).



Rosa arvensis Hudson – Trëndafil arash
Rosaceae –Trëndafilore

Shkurrëz shermendore me degë të dobëta, zakonisht zvarritëse. Thumbat të shpërndar, grremçakë, të sipërmit nganjëherë hollakë dhe gati të drejtë.

Gjethet bien shpejt; gjethëza 5 – 7, jolëkurore, jo të shkëlqyeshme, me dhëmbë të thjeshtë.

Lulet të vetmuara ose të pakta, 1- 3 rrallë 5. Sepalet vezake-heshtore. Petalet të bardha. Fryti rruzullor ose vezak, i kuq.

Lul.V – VI; fryt. VIII – IX.

Nëpër shkorrete, kullota e rrëzë pyjesh të vendeve malore.



Potentilla alba L. – Zorrëca e bardhë
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 20 cm e lartë. Kërcejtë të përpjetëm, qartësisht të ngritur mbi gjethet bazale,

Gjethet 5 pjesëshe, të gishtëzuara; gjethëzat heshtore, të prera si sharrë në majë, përsipër të gjelbra, pushbuta përposh, 2 – 10 cm të gjata, deri 2 cm të gjera..

Lule 1 – 5, të bardha.

Në vende të thata deri me lagështi dhe tokë argjilore.



Potentilla rupestris L. – Zorrëca shkëmbinjsh
Rosaceae – Trëndafilore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcej lulorë deri 40 cm, pushlore me qime të gjata e të hapura dhe gjëndërore, të paktën në pjesën e sipërme.

Gjethet pendore 10 – 17 cm, me 5 – 7 gjethëza; gjethëzat vezake deri rrotullare, me buzë ura – ura – dhëmbë – dhëmbë.

Lulet të shumta në cima skajore. Sepalet trekëndëshe, gati majëmprehta. Petalet të bardha, më të gjata se sepalet.

V – VII.

Në vende shkëmbore dhe me gurë kryesisht të zonave malore.



Sorbus aucuparia L. - Vadhë e egër
Rosaceae – Trëndafilore



Sorbus domestica L. – Vadhë
Rosaceae – Trëndafilore



Sorbus torminalis (L.) Crantz - Vadhëviçe
Rosaceae – Trëndafilore

Dru 5 – 15 m i lartë, me lëkurë të lëmuar, me sytha leshtor.

Gjethet tekpendore. Gjethëzat janë gjatore, të mprehta ose gati shytë, të dhëmbëzuara, të plota në bazë.

Lulet hermafrodite në vastak të dendur. Kupa me qime. Sepalet deltoide të përkulura nga brenda pas lulëzimit. Petalet vezake, të bardha. Fryti ovoid ose rruzullor, i lëmuar, i thartë kur brumoset, i kuq kur piqet, i qëndrueshëm në dimër.

V – VI.

Ndeshet në pyje e shkorrete malore. Bimë mjekësore.

Dru me sytha zakonisht të shogët e ngjitës, deri 20 m i lartë.

Gjethet tekpendore, me 11 – 17 gjethëza gjatore, të dhëmbëzuara, të plota në bazë.

Lulesa leshtake, të paktën në fillim, me 6 – 12 lule të bardha. Sepalet trekëndëshe. Fryti ovoid, i verdhë i kuqërremë, pastaj i murrmë – purpur, squllet dhe ka shije të ëmbël në të athët, me erë të këndshme.

Lul. IV - V fryt. IX - X.

Në pyje e shkorrete në gjendje të egër dhe e kultivuar për frytet dhe si bimë zbukurimi.

Bimë drunore prej 3 – 15 (-20) m e lartë.

Gjethet gjerësisht vezake, 5 - 9 cm, në bazë të cunguara, gati si zemër, thellësisht të vrigulluara, me 5 – 9 vriguj trekëndësh – vezakë deri heshtorë, të thepët, që zvogëlohen drejt majës.

Lulet e bardha në vastak të gjerë, leshtor. Fryti ovoid, me kokrriza, i verdhë i kuqërremë, më vonë i murrmë me pika të bardha, me shumë bërthama, i athët.

IV - V.

Rritet kryesisht në zonën e dushkut, shkorrete e pllaja shkëmbore. Gjethet dhe frytet i japin pamje të bukur, prandaj mbillet si dru zbukurimi.



Sorbus umbellata (Desf.) Fritsch. – Vadhë ombrellore
Rosaceae – Trëndafilore



Sedum acre L. – Rrushqyqe e athët
Crassulaceae – Krasulore



Sedum album L. – Rrushqyqe e bardhë
Crassulaceae – Krasulore

Shkurre ose dru i vogël.

Gjethet kanë diametër 3 - 6 cm, rombike – rrotullare. Në anën e poshtme janë dendësisht të bardhë – pushbutë.

Lulesa është vastak. Sepale 5 sa edhe petale. Petalet me ngjyrë të bardhë. Fryti ka trajtë ovoide – rruzullore. Gjatë pjekjes merr ngjyrë të verdhë – të kuqe.

Lul.V – VI; fr. IX – X.

Rritet në vende malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, e blertë, e shogët, tufore. Kërcelli nëntokësor hollak nxjerr shumë kërcej shterp të shkurtër me gjethe mbuluese si tjegulla. Kërcejtë lulorë 5 – 12 cm.

Gjethet të trasha, ovoide – trekëndore, në bazë të rrumbullakuara dhe të fryra, shpesh me shije djegëse.

Lulet të verdha. Petalet gjatësisht të mprehta, nga poshtë me nervura të dala mirë. Fryti rrëshekth me gungë në fund nga ana e brendshme.

V – VIII.

E ndeshim në vende me gurë e bar, në shkëmbinj të zonave malore, e zakonshme.

Bimë barishtore shumëvjeçare, tufore e çlirët, e blertë ose më trëndafil, e shogët, 10 – 30 cm.

Gjethet gati cilindrik, të blerta ose të kuqërreme, të këmbyera.

Lulet të bardha, më rrallë të trëndafilta, me 5 pjesë, në vastak diçka të dendur. Thekë 10; pjelloret purpur.

VI – VII.

Në vende me gurë, shkëmbinj, mure, kryesisht të zonave malore.



Rhodiola rosea L. – Rodiola trëndafilore
Crassulaceae – Krasulore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 15 – 20 cm e lartë, me stolone. Kërcelli me qime gjëndërore.

Gjethet e rozetës heshtore me majë të shkurtër, nga të dy anët me qime gjëndërore, mishtore.

Lulesa me qime të dendura gjëndërore. Lulet gati pa bisht, 13 – 14 pjesëshe, të purpurta.

VI – VII.

Rritet në substrat silikat – kvarcit ose ndonjëherë edhe në substrate gëlqerore dhe vende gurishtore të zonës alpine. Në Kosovë haset në Malet e Sharrit (Prevallë – Bistra), Alpet Shqiptare.



Sedum rubens L. – Rrushqyqe kuqalashe
Crassulaceae – Krasulore

Bimë barishtore njëvjeçare, me qime gjëndërore, zakonisht e kuqërreme, me rrënjë hollake.

Kërcelli i ngritur, 5 – 12 cm, i thjeshtë ose i degëzuar sipër.

Gjethet të këmbyera, vizake, gjysmëcilindrike, shyta, pa bishtak, të shogëta, të plota.

Lulet me 5 pjesë, të bardha ose trëndafil, në cima vastakore. Petalet heshtore të halëzuara. Thekë 5, rrallë 10. Rrëshekthe 5.

V – VII.

Në djerrina, vende të thata me bar, kryesisht të zonave malore.



Sedum stefco Stef - Rrushqyqja e Stefanit
Crassulaceae – Krasulore

Bimë barishtore shumëvjeçare. 2.5 – 8 cm e lartë, me rizome të shtrira. Kërcelli i shogët.

Gjethet të përkundrejta, të gjelbra deri të kuqërreme, eliptike – vezake, 4 – 5 mm të gjata, mishtore.

Lulesa 6 – 8 cm e gjatë, me 3 – 4 degë të dendura, me një brakte për lule. Lulet 4 – pjesëshe. Sepalet bazale të ndërfutura, të barabarta. Petalet të bardha deri në të kuqe të zbehtë. Farat të zeza, me hulli.

V – VI.

Rriten në vende shkëmbore me natyrë gëlqerore.Endemike e Ballkanit.



Sempervivum heuffelii Schott - Burgulli i Hojfelit
Crassulaceae – Krasulore

Bimë barishtore shumëvjeçare, pa stolone.

Gjethet e rozetës gjatore – vezake të përmbysëta, me thumb gjembor në majë, të shogëta, anash me qerpikë zakonisht të përkulur nga poshtë; gjethet kërcellore vezake gjatore, si zemër në fund, me qerpikë anash.

Lulesa cimë vastakore. Lulet të shumta kambanore. Petalet verdhake ose të verdha. Thekët të verdha. Fryti rrëshekth.

VII – VIII.

Në shkëmbinj gëlqeror të zonave subalpine dhe alpine.



Sempervivum macedonicum Praeger – Burgulli maqedonas
Crassulaceae – Krasulore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 7 – 10 cm e lartë, me stolone 4 – 7 cm të gjata.

Gjethet e rozetës të gjera – heshtore, nga të dy anët me qime gjëndërore; gjethet kërcellore të ngushta.

Lulesa vastak i ngjeshur, me ngjyrë të kuqe – trëndafili.

VI – VII.

Ndeshet në vende shkëmbore. Bimë endemike e Kosovës dhe Maqedonisë. Është zbuluar nga botanisti Praeger në vitin 1930. Në Kosovë është i përhapur në Gjeravicë, Bistra, Shtëpia e Malorëve, Vracë, Luboten, Përroi i Durlit etj.



Sempervivum tectorum L. – Burgulli i pullazeve
Crassulaceae – Krasulore

Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 50 cm.

Rozetat të hapura, me diametër 3 – 8 cm. Gjethet e rozetës vezake, buza e gjetheve me qime të bardha (qerpikë), pak të ngushtuara në fund, në pjesën e sipërme me ngjyrë të kuqe në të errët. Kërcejtë lulorë të shëndoshë, 20 – 50 cm. Gjethet kërcellore gjatore.

Lulesa me lule të shumta, trëndafil ose purpur.

VI – VII.

Në mure, mbi pullaze e shkëmbinj



Sedum atratum L. - Rrushqyqe e zezë
Crassulaceae – Krasulore

Bimë barishtore njëvjeçare e blertërreme me të kuqe, ose e kuqe e errët, plotësisht e shogët. Kërcelli i degëzuar shpesh që nga baza, 3 – 10 cm i lartë.

Gjethet kanë renditje të këmbyer, të mishta, cilindrike, të plota, shyta dhe pa bisht.

Lulet 5 ose 6-pjesëshe të grupuara në lulesën vastak. Sepalet kanë trajtë vezake – trekëndore. Petalet krem më të kuq. Fryti rrëshekth.

VI – VIII.

Rritet në vende shkëmbore të thata dhe gurishte.



Sedum dasyphyllum L. - Rrush i egër
Crassulaceae - Krasulore

Bimë barishtore shumëvjeçare, tufore, me kërcej shterp dhe lulor. Kërcejtë lulorë 3 – 12 cm.

Gjethet vezake, gati rrotullare, të sheshta në faqen e sipërme, konkave në faqen e poshtme, shyta.

Lulet me 5 ose 6 pjesë në cima të vogla. Sepalet pak shyta. Petalet të bardha me viza trëndafili, rreth 3 mm. Thekë 10 ose 12, me pjalmore të dala. Rrëshekthet gati të ngritura.

VI – VIII.

Rritet në vende me gurë, shkëmbinj e mure deri në zonat alpine.



Sedum ochroleucum Chaix - Rrushqyqe bardhavele
Crassulaceae - Krasulore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, e rimtë. Kërçepi i drunjëzuar nxjerr kërcej shterpë me gjethe mbulese si tjegulla. Kërcejtë lulorë të përpjetëm, 15 – 30 cm.

Gjethet vizake - cilindrike, pak të shtypura, të paqëndrueshme kur thahen.

Lulesa vastakore. Lulet verdhake ose të blertërreme të bardha. Sepalet heshtore të mprehta, gjëndërore pushpaka. Petalet të ngritura vizake - majëgjata.

V – VII.

Rritet në vende me gur deri në zonat alpine.



Sedum serpentini Janchen – Rrushqyqja serpentine Crassulacea – Krasulore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 20 cm e lartë, tufore e çlirët, hollake, e shogët, me kërcej lulor dhe shterp.

Gjethet gjatore – cilindrike, shumë shyta, 2 – 4 mm.

Lulet janë të grumbulluara në një lulesë shumë të gjerë vastakore të hapur. Petalet kanë ngjyrë trëndafili, të mprehta. Fryti rrëshekth.

VI - VII.

Në shkëmbinj serpentinorë të zonave malore. Bimë endemike e Kosovës dhe Shqipërisë. Në Kosovë është e përhapur në zonën kufitare me Shqipërinë (Planik, Morinë, Çeret) pastaj Koznik etj.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 – 30 cm.

Gjethet e rozetës vezake – heshtore majëmprehta, jo të kuqe në majë , me llapë të shogët dhe qerpikë gjëndërorë anëve; gjethet kërcellore afërsisht aq të gjera sa edhe gjethet e rozetës, me qime gjëndërore dhe me qerpikë anëve.

Lulesa cimë. Sepalet majëgjata. Petale 6, të verdha të hapëta, me qerpikë dhe me qime gjëndërore.

VII – VIII.

Në vende shkëmbore malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rrënjë zhardhokore, e shogët. Kërcelli 30 – 80 cm, i ngritur, i thjeshtë ose pak i degëzuar.

Gjethet 50 – 80 mm, vezake – gjatore, me dhëmbë të çrregullt; të kundrejta ose të grumbulluara nga 3 në qerthuj.

Lulet 5-pjesëshe, në vastakë skajorë të dendur, të verdha – të bardha, rrallë me circa trëndafili. Thekë 10, baraz ose pak më të gjata se petalet.

VI- X.

Në vende të thata me gurë, në shkëmbinj e mure. Bimë mjaltore e mjekësore.



Sedum maximum (L.) Sut. – Rushqyqja e madhe
Crassulaceae – Krasulore



Sempervivum hirtum L. - Burgulli kreshtak
Crassulaceae – Krasulore



Sempervivum kosaninii Praeger – Burgulli i Koshaninit
Crassulaceae - Krasulore



Chrysosplenium alternifolium L. – Sherq
Saxifragaceae – Iriqëzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, 5 – 40 cm e lartë. Kërcelli ka një gjethe në formë zemre, pa bisht dhe kërcell – pushtuese.

Gjethet bazale vezake si zemër me bisht të gjatë.

Lulet janë të bardha, 5 petale me 5 nervura konvergjente, dy herë më të mëdha se sepalet. Thekë 10. Gjysma pjellore, gjysma tjetër shterpe. Fryti kapsulë vezake që hapet me 4 flegra.

VII - VIII.

Rritet afër burimeve dhe vende me lagështi të zonës subalpine. Bimë dekorative.

Bimë barishtore shumëvjeçare me stolone deri 10 cm të gjata, 10 – 20 cm e lartë.

Rozetat e gjetheve të hapura, me diametër 6 – 8 cm. Gjethet e rozetës gjatore – vezake, 15 – 30 mm të gjata, 7 – 10 mm të gjera, të mishta, në majë të kuqërreme. Kërcelli lulor me qime të dendura gjëndërore.

Lulet të purpurta. Sepalet heshtore – të mprehta. Petalet sipër të purpurta, anash të bardha kurse në anën e poshtme gjelbëroshe. Pjalmoret të kuqe të çelët.

VII – VIII.

Rritet në zona alpine dhe subalpine shkëmbore silikate, më rrallë në ato gëlqerore. Në Kosovë ndeshet në Alpet Shqiptare. Endemike e Ballkanit.

Bimë shumëvjeçare, me qime në pjesën e poshtme dhe e shogët sipër. Kërcejtë 7 – 25 cm, trekëndor. Kërcejtë lulorë të bigëzuar në majë.

Gjethet rrotullare – veshkore, si zemër në fund, me ura të gjera si vriguj.

Lulet me bisht shumë të shkurtër. Sepale 4, të hapura, verdhake. Petalet mungojnë. Thekë 8. Lulja e mesit me 5 sepale dhe 10 thekë. Fryti kapsulë.

III – VI.

Rritet në vende me hije, afër burimeve të ahishteve. Bimë zbukurimi e vendeve me hije dhe bimë mjekësore.



Parnassia palustris L. - Parnasia e kënetës
Saxifragaceae – Iriqëzore



Saxifraga aizoides L. - Iriqëza thonjëz
Saxifragaceae - Iriqëzore

Bimë barishtore shumëvj-eçare, tufore e çlirët. Kërcejtë lulor të përpjetëm, 5 – 30 cm, me shumë gjethe.

Gjethet vizake - gjatore, me thumb (thonjëz), të shogëta ose me qerpik anëve, të trasha, të plota, ose me ndonjë thumb anësor.

Lulet të verdha ose portokall, shpesh me njolla të kuqe, në cimë skajore të çlirët. Sepalet në trajtë ylli. Petalet gjatore, të hapura si ylli.

VII – VIII.

Rritet në shkëmbinj e vende të lagëta të zonave alpine.



Saxifraga grisebachii Deg. et Dorf. – Iriqëza e Grisebahut
Saxifragaceae – Iriqëzore

Bimë barishtore shumëvj-eçare tufore, me kërcej gjethorë shterpë të shkurtër që mbarojnë me rozeta gjethore. Kërcejtë lulorë të ngritur ose të përpjetëm, 10 – 20 cm, me gjethe të shumta, të mbuluara mbi gjithë gjatësinë me qime gjëndërore.

Gjethet e rozetës pallake ose heshtore; kërcelloret të kuqërreme me majë të blertë, me thumb në majë.

Lulet purpur, në vile me 15 – 25 lule.

VI – VIII.

Në shkëmbinj gëlqerorë subalpine dhe alpine; e zakonshme.

Endemike e Ballkanit.



Saxifraga rotundifolia L. – Iriqëza gjetherrotullare
Saxifragaceae – Iriqëzore

Bimëbarishtore shumëvjeçare, 10 – 60 cm e lartë. Në pjesën e sipërme e degëzuar.

Gjethet e bazës kanë trajtë veshkore - rrotullare. Buza e llapës ura - ura.

Lulesa melth i çlirët. Sepalet të ngritura dhe më vonë të hapura dhe të ndara deri në fund. Petalet të bardha. Nga ana e sipërme me pika të kuqe, nga ana e poshtme me pika të vedha. Fryti kapsulë.

V - VIII.

Rritet në vende me hije e të lagëta të zonave malore.



Saxifraga scardica Griseb. – Iriqëza e Sharrit
Saxifragaceae - Iriqëzore

Bimë shumëvjeçare, tufore e dendur, me kërcej gjethor 4 – 7 cm, gati të drunjëzuar në bazë, shumë të degëzuar, me gjethe të ngjeshura. Kërcejtë lulorë të ngritur ose të përpjetëm.

Gjethet e kërcejve gjethorë të hapura të spërveshura, gjatore-pallake ose heshtore-gjatore, në gjysmën e poshtme me dhëmbë të imët, shpesh me hidatoda. Gjethet e kërcejve lulorë gjatore-pallake, të mprehta, me thumb.

Lulesa vastakore, me 3 – 11 lule. Sepalet vezake ose vezake-gjatore, shpesh majëmprehta. Petalet gjerësisht vezake të përmbysëta, të bardha ose trëndafil.

VI – VIII.

Në shkëmbinj të zonave alpine. Ballkanike

Bimë shumëvjeçare, tufore e dendur, me kërcej gjethorë shterpë që mbarojnë me rozeta gjethore. Kërcejtë lulorë pak dredhakë, 5 – 14 cm, me qime të hapura gjëndërore.

Gjethet e bazës në rozeta, të rimta, të shogëta, vizake-heshtore, të mprehta, me shumë hidatoda anëve.

Lulet purpur të hapur, në vile të ngjashme me kalli. Kupa me qime të dendura gjëndërore.

VI – VII.

Në shkëmbinj gëlqerorë të zonave alpine. Endemike e Ballkanit.



Saxifraga sempervivum C. Koch. – Iriqëza gjithmon e blertë
Saxifragaceae - Iriqëzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, tufore e dendur, zakonisht me qime gjëndërore vetëm në pjesën e sipërme. Kërcelli lulor 12 – 50 cm, me gjethe, i degëzuar vetëm sipër.

Gjethet në rozeta të sheshta gjysmësferike, në pjesën e sipërme të zgjeruara gradualisht, në formë lopate, shyta ose të mprehta, me dhëmbëza si të sharrës.

Lulet të bardha ose krem të hapur, nganjëherë me njollë të kuqe. Sepalet vezake ose vezake – trekëndëshe.

VI – VIII.

Në shkëmbinj malorë deri në zonat



Saxifraga paniculata Mill. – Iriqëza në formë melthi
Saxifragaceae – Iriqëzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, tufore, me filiza shterp shumë të shkurtër. Kërcejtë lulorë 2 – 12 cm, me qime, të zhveshura ose me 1 – 3 gjethe.

Gjethet e bazës në rozeta të çlirëta, 10 – 20 x 2 – 5 mm, heshtore – pallake, shyta, të plota ose me 1 – 3 dhëmbë në majë, me pak qime të gjata anëve.

Lulet të bardha, në vile me 1 – 3 lule; këmbëzat (bishtat e luleve) afërsisht sa lulet. Sepalet shyta, gypi i kupës i ngjitur me vezoren. Petalet vezake të përmbysëta.

VI – VIII.

Në shkëmbinj e lëndina të lagëta të zonave alpine.



Saxifraga androsacea L. – Iriqëza si androsace
Saxifragaceae – Iriqëzore

Bimë barishtore shumëvjeçare . Kërçepi zvarritës me filiza shterpë. Kërcejtë lulorë të degëzuar sipër, pa gjethe, 3 – 30 cm.

Gjethet vezake të përmbysëta, gati me bisht të dalluar, të dhëmbëzuar në majë.

Lulet në melth të çlirët me 3 – 5 degë. Sepalet të ndara deri në fund. Petalet të bardha me dy njolla të verdha në fund, të hapura në trajtë ylli. Thekët me pjalmore trëndafili.

VII – VIII.

Rritet në vende të lagëta të zonave alpine (Gjeravicë etj.)



Saxifraga stellaris L. – Iriqëza yllore
Saxifragaceae – Iriqëzore



Saxifraga taygetea Boiss et Heldr. - Iriqëza e Tajgetesë
Saxifragaceae - Iriqëzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërçep të shkurtër pa filiza shterpë. Kërcelli rreth 20 cm, i ngritur, i degëzuar sipër.

Gjethet e bazës veshkore - rrotullare, me bishta; kërcelloret të pakta.

Lulesa vastakore. Sepalet të ngritura të hapura, të ndara deri në fund. Petalet të bardha me pika të kuqe.

VI – VII.

Rritet në shkëmbinj të zonave alpine. Endemike e Ballkanit.



Ribes alpinum L. – Rrush serezi alpin
Grossulariaceae – Grosulariore

Shkurre 1 -2 m, pa gjemba, me degë të shogëta.

Gjethet me 3 – 5 vriguj me dhëmbë, të shogëta ose me pak qime, 2 – 6 cm.

Lulet njëseksore, me mbeturina të seksit tjetër, në vile të ngritura. Nënpetlat të shogëta, pa qerpikë, të hapura ose të kthyera nga poshtë. Petlat të blertërreme, pallake, 4 – 5 herë më të shkurtra se nënpetlat. Fryti rrushk i kuq, i shogët, pa shije.

Lul. IV – V; fryt. VIII – IX.

Në pyje e vende me gurë subalpine e alpine.



Ribes petraeum Wulfen – Rrush serezi i shkëmbinjëve
Grossulariaceae – Grosulariore

Shkurre 1 – 3 m, me degë pa gjemba. Gjethet me 3 – 5 vriguj të mprehtë, dhëmbë – dhëmbë, të shogëta ose pushpaka.

Lulet në vile, horizontale, më vonë të varura, të kuqërreme. Sepalet të kuqërreme, rrotullare – pallake. Petalet të kuqërreme. Fryti rrushk i kuq – purpur i errët, i thartë.

Lul. IV - VI; fryt. VIII - IX.

Në vende me gurë e shkëmbinj subalpnë.



Anthyllis aurea Welden – Antilida e praruar
Fabaceae - Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, lehtësisht e drunjëzuar, 10 – 30 cm.

Gjethet kryesisht bazale ose në 1/3 e poshtme të kërcellit, tekpendore, me 13 - 19 gjethëza gati të barabarta, vezake deri eliptike dhe me çime të mëndafshta sipër e përposh.

Kokat të dendura. Kupa gypore, me brinjë, e mëndafshtë – e kreshpët, me dhëmbë trekëndësh – si fëndyell dhe shumë më të shkurtër se gypi. Kurora e verdhë.

VI – VII.

Në shpate shkëmbore e kullota sub-alpine dhe alpine.

Endemike e Ballkanit.



Astragalus glycyphyllos L. Arithja gjetheëmbël
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcej 30 – 100 (-150) cm, të shtrirë, zakonisht të skuqur në lulëzim.

Gjethet tekpendore, 10 – 20 cm, me 7 – 14 palë gjethëza vezake ose gjerësisht eliptike, shytë, shpesh me majucë, me qime të rrasura e të rralla përposh, gati të shogëta përsipër.

Vilet gjatore, të dendura, me lule të shumta gati të ngritura përpjetë, gati të pabisht. Kupa e shogët. Kurora krem e zbehtë. Bishtaja paksa e përkulur.

V – VII.

Në pyje e shkurreta; kryesisht në ahishte. Europiane – Siberiane – Jugore.



Coronilla elegans Pancic – Milëza e hijshme
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare 20 – 120 cm.

Gjethet me 3 – 5 (-6) palë gjethëza eliptike, me pluhërizë përposh; ndajgjethëzat të lira, membranore.

Kokat me 6 – 18 lule, me bishta lulorë 6 – 9 cm. Kurora e bardhë, e trëndafiltë ose e purpurt. Bishtaja katërkëndëshe.

IV – V.

Në pyje dhe shkorrete. Europiane.



Anthyllis vulneraria L. – Antilida plagëshëruese
Fabaceae - Bishtajore



Arachis hypogaea L. – Kikiriki
Fabaceae – Bishtajore



Astragalus onobrychis L. - Arithja esparsetë
Fabaceae Bishtajore

Shkurrëz dyvjeçare deri shumëvjeçare, deri 50 cm e lartë.

Gjethet bishtshkurta pjesërisht të thjeshta, pjesërisht të përbëra nga 3 gjethëza, me qime të buta si mëndafsh nga ana e poshtme.

Lulet zakonisht në koka të dendura, të bartura nga dy brakte pëllëmbore të vendosura në bazë të lulesës. Kupa e fryrë në lulëzim, e ngushtuar në majë, me 5 dhëmbë jo të barabartë dhe me grykë të pjerrët. Kurora e verdhë, e kuqërremtë, e purpurtë ose e bardheme. Fryti bishtajë më 1 (- 2) fara.

V - VIII.

Në vende të thata e të zhveshura, kullota alpine etj. Bimë aromatike, mjaltëse dhe foragjere.

Bimë njëvjeçare, 20 – 50 cm e lartë.

Gjethet çiftpendore, me 4 gjethëza eliptike deri vezake të përmbysëta; ndajgjethëzat vizake, të ngjitura me bishtakun.

Lulet pa bisht, në vile sqetullore të gjetheve bazale. Kupa dybuzore; buza e sipërme me 4 dhëmbë kurse e poshtmja e plotë. Kurora e verdhë, e ngjitur në bazën e gypit të thekëve. Bishtaja cilindrike, e ngushtuar ndërmjet farave, joçahëse, që formohet nën tokë. Farat të ngrënshme kur piqen.

V – VII.

E kultivuar. Bimë industriale.

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcej të shtrirë ose të përpjetëm, në bazë e hdrunjëzuar, 10 - 60 cm.

Gjethet tekpendore, me 8 - 15 palë gjethëza. Gjethëzat gjatore ose eliptike, të mprehtë ose gati shyte, me qime të mëndafshta në të dyja faqet.

Lulet në vile. Vilet ovoide ose gjatore, me 4 - 20 lule. Kupa 6 - 8 mm, me dhëmbë. Kurora manushaqe e çelët ose e errët, rrallë e bardhë ose e verdhë. Fryti bishtajë ovoide - heshtore deri gjatore.

VI - VII.

Ndeshet në vende të thata gurishtore, kullota të zonave malore.



Chamaecytisus austriacus (L.) Link – Vjexhësa e Austrisë
Fabaceae – Bishtajore



Colutea arborescens L. - Fshikarta
Fabaceae – Bishtajore



Coronilla emerus L. – Milëza emerus
Fabaceae – Bishtajore

Shkurrëz, 15 - 70 cm e lartë. Degët të ngritura ose të shtrira, pak a shumë leshtore.

Gjethet me bisht. Një gjethe është e përbërë prej tre gjethëzave. Ato kanë trajtë gjatore ose heshtore.

Lulet në koka të shumta. Kupa leshtore. Kurora e verdhë. Fryti bishtajë.

VII - VIII.

Rritet në pyje e shkorrete.

Shkurre 2 - 3 m e lartë. Ka dru të ngurtë me blana të bardha në të verdhë dhe me njolla ngjyrë gështenje. Degët e reja pushlore.

Gjethet tekpendore, me 9 - 13 gjethëza të plota, eliptike ose vezake – të përmbysta, të rimta.

Lulesa vile. Vilet me nga 4 - 8 lule. Sepalet e kupës të ngjitura duke dhënë një kupë kambanore. Petalet e kurorës me ngjyrë të verdhë. Fryti bishtajë 5 - 7 x 2 cm, shumë e fryrë, me parete si letër, joçahëse ose çahëse afër majës.

V - VI.

E ndeshim në pyje e shkorrete, shpate me diell. Bimë mjaltëse. Gjethet dhe rrënjët përdoren në mjekësinë popullore.

Shkurrëz, 50 - 120 ose 200 cm e lartë, me kërcell shumë të degëzuar.

Gjethet me 5 - 9 gjethëzave vezake, me thimth, të rimta; ndajgjethëzat trekëndorë, membranore e të lira.

Lulet zhvillohen në koka sqetullore. Kupa kambanore. Kurora e verdhë; flamuri me thonjëz. Bishtaja me 8 – 15 artikuj (segmentë).

Lul. III – IX; fryt. VIII – X.

Rritet në vende shkëmbore, gurishtore e shkorrete. Bimë e helmët dhe mjekësore.



Coronilla scorpioides (L.) Koch. – Milëza bishtakrepe
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore njëvjeçare 5 – 20 cm, e shogët e rimtë.

Gjethet të thjeshta ose me 3 gjethëza; gjethëza skajore eliptike, kurse gjethëzat anësore gati të rrumbullakta.

Kokat me 2 – 3 lule, me bishta lulorë 2 – 4 cm e më të gjatë se gjethja mbajtëse. Kurora e verdhë.

Bishtaja vizake, e përkulur (si skorpion) deri 5 cm e gjatë.

IV – V.

Në vende të thata dhe si bar i keq i kulturave bujqësore.



Coronilla varia L. – Milëza e ndryshme
Fabaceae – Bishtajore

Shkurrëz 10 – 25 cm, e rimtë, e shogët.

Gjethet tekpendore, me 7 – 11 gjethëza vezake eliptike me buzë cipëthatë; ndajgjethëzat të bashkuara, rënëse.

Koka me 4 – 6 (-10) lule dhe bisht lulor 2 – 3 herë më të gjatë se gjethja mbajtëse. Kupa me gyp dhe dhëmbë të shkurtër, shytë. Kurora e verdhë.

IV – VII.

Në kullota të thata dhe vende shkëmbore. Rritet në Alpet Shqiptare dhe Malet e Sharrit.



Coronilla vaginalis Lam. – Milëza me mill
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 120 cm e lartë.

Gjethet tekpendore me 13 - 25 gjethëza. Gjethëzat të gjitha njësoj, eliptike, të rimta nga ana e poshtme. Ndajgjethëzat membranore.

Lulet në koka sqetullore. Kupa kambanore. Kurora e bardhë, e trëndafiltë ose e purpurt. Fryti bishtajë. Bishtaja katërkëndëshe.

V - VIII.

Rritet në vende me bar, fusha, pyje etj. Bimë aromatike, e helmët dhe mjekësore.



Cytisus hirsutus L. – Vjexhësa qimeashpër
Fabaceae – Bishtajore

Shkurrëz, 30 - 100 cm ose 200 cm e lartë, e kreshpët e me qime pushlore. Degët të ngritura ose të përpjetëm, rrallë të shtrira.

Gjethet trishe dhe me bishta. Përsipër të shogëta, përposh pushlore. Gjethëzat kanë trajtë vezake deri eliptike.

Lulet në tufa me nga 1 - 4 bashkë. Kupa pushlore dhe ka trajtë gypi. Kurora e verdhë ose e trëndafiltë e verdhë.

IV - VI.

Rritet në pyje, shkorrete e kullota.



Cytisus nigricans L. – Vjexhësa e zezërremë
Fabaceae – Bishtajore

Shkurre e ngritur, pa gjemba, deri 1 (1.5) m, që nxihet kur thahet. Bisqet deri 45 cm ose më shumë, cilindrikë, leshtorë, që lulëzojnë në vitin e parë.

Gjethet me 3 gjethëza; gjethëzat gjatore ose vezake të përmbysëta deri heshtore, të gjelbra të errëta përsipër, dhe të gjelbra të shndritshme përposh, me qime leshtore të rrasura në të dyja faqet kur janë të reja.

Lulet të shumta, në vile skajore të stërgjatura, të drejta dhe pa gjethe. Kupa kambanore, dybuzore. Kurora e verdhë, që nxihet kur thahet.

VI – VII.

Në pyje, kullota, shkorrete e gjerdhe.



Cytisus supinus L. – Vjexhëza shpinështrirë
Fabaceae – Bishtajore

Shkurrëz, 20 - 60 ose 120 cm e lartë. Degët janë të ngritur ose të përpjetme, pushlore deri leshtore, pa gjemba.

Gjethet trishe, me bisht. Gjethëzat eliptike, gjatore ose vezake të përmbysëta dhe pushlore.

Lulesa skajore, e kokët. Kupa gypore dhe pushlore. Kurora e verdhë. Flamuri zakonisht me njollë të murrme. Fryti bishtajë. Bishtaja 2 - 3 cm e gjatë dhe leshtore.

VI - VII.


Rritet në pyje e shkorrete.



Dorycnium pentaphyllum Scop. – Dorikna pesëgjethesh
Fabaceae – Bishtajore



Galega officinalis L. – Qerbashi mjekësor
Fabaceae – Bishtajore



Genista hassertiana Bald. – Mokërrza
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare ose gati shkurrëz, 10 – 80 cm.

Gjethet me 5 gjethëza gati të barabarta ndërmjet tyre, pa bisht, d. m. th. vendosen pothuajse drejtpërsëdrejti mbi kërcell; gjethëzat vizake deri vezake të përpërmbysëta.

Lulet në koka sqetullore. Lulesa me 5 - 15 lule me bishta të shkurtër. Kupa me dhëmbë të barabartë. Kurora e bardhë. Fryti bishtajë.

IV - V.

Rritet në vende me bar, buzë rrugëve etj.

Shumëvjeçare barishtore me kërcej 50 – l20 cm, të shogët, rrëvaga – rrëvaga e të degëzuar.

Gjethet takpendore, me ll – l5 gjethëza; gjethëzat l5 – 50 x 4 – l5 mm, gjatore – heshtore, me thimth.

Lulesa e madhe, më e gjatë se gjethja. Kupa kambanore, me 5 dhëmbë. Kurora e bardhë e kaltër. Bishtaja cilindrike, çahëse.

V – VII.

Rritet në vende me lagështi, buzë hendeqeve. Bimë e helmet, aromatike e mjekësore.

Shkurre e ngritur 80 - 100 cm e lartë, me degë të përkundërta pothuaj në çdo nyje.

Gjethet me 3 gjethëza të përkundërta, shumë të palosura dhe gati vizake. Në faqen e poshtme të mëndafshta, përsipër të shogëta.

Lulet në sqetullat e gjetheve të sipërme, nga 2 - 4 në një lëmshuk skajorë. Lulet më të poshtme me brakte gjethore tripjesëshe. Kupa dybuzore. Buzët gati aq sa gypi. Kurora e verdhë.

V - VI.

Rritet në shpate të degraduara e të thata deri në zonat malore.

Bimë endemike e Kosovës dhe Shqipërisë. Në Kosovë e ndeshim në Devë, Qafa e Prushit, Koznik, Guranë.



Genista januensis Viv. – Gjineshtra e Janusit
Fabaceae – Bishtajore

Shkurre 20 – 50 cm, pa gjemba, e shogët. Kërcejtë dhe degët trekëndësh në prerje tërthore.

Gjethet të thjeshta, të plota, ato të degëve lulore eliptike deri vezake, kurse ato të degëve jolulore eliptike deri heshtore.

Lulet në vile të shkurtra mbi degët anësore të përpjetme. Kurora e verdhë. Bishtaja e shogët me 5 – 8 fara.

Lul. IV – VI; fryt. VII – IX.

Në vende shkëmbore të zonave malore dhe kullota. Europianejuglindore.



Genista sylvestris Scop. – Gjineshtra pyjesh
Fabaceae – Bishtajore

Shkurre deri 1 m e lartë, me gjemba sqetullorë; degët e reja me qime të mëndafshta.

Gjethet të thjeshta, gjatore të ngushta ose eliptike.

Lulet në vile skajore të gjata dhe të çlirëta. Kupa me gyp 2 mm dhe dhëmbë si fill 4 mm të gjatë. Bishtaja e shkurtër, me 1 farë

V – VI.

Në livadhe të thata dhe shkëmbinj në zonat malore. Ilirike.



Lathyrus grandiflorus S. S. – Vingjëra lulemadhe
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, pushlore, me kërcej 30 – 80 (-150) cm, pa flatër, rrëvaga – rrëvaga – cepatare.

Gjethet me loze, me 1 (-2) palë gjethëza vezake në majë. Ndajgjethëzat të fëndyellta.

Vilet me 1 – 2 (-4) lule, më të mëdha se gjethet. Flamuri manushaqe, flatrat purpur, karena e trëndafiltë. Bishtaja e murrme, e shogët.

IV – VII.

Në vende me bar, përgjithësisht të thata.



Lupinus polyphyllus Lindl. – Lupina shumëgjethëshe
Fabaceae - Bishtajore

Bimë barishtore, 60 – 150 cm e lartë; jo e degëzuar.

Gjethet në qerthuj me 9 – 17 gjethëza; gjethëzat 3 – 15 cm të gjata, vizake – heshtore.

Lulesa vile deri 50 cm e gjatë, me 50 – 80 lule shumëngjyrëshe. Lulet dyseksore, zigomorfe. Flamuri më i shkurtër se karena. Fryti bishtajë, 2,5 – 6 cm i gjatë me 4 – 12 fara.

V – VIII.

E kultivuar si bimë zbukurimi.



Ononis pusilla L. – Kalmuthi i vockël
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 5 – 15 cm, e ngritur, e degëzuar, pjesërisht e drunjëzuar në bazë.

Gjethet me 3 gjethëza e bishtak të gjatë; gjethëzat eliptike deri gati rrotullare, dhëmbë-dhëmbë të halëzuar.

Lulet pa bisht në kallinj të çlirët, me brakte gjethore drejt majës. Kurora e verdhë, në përgjithësi më e vogël se kupa. Bishtaja 6-8 mm, ovoide.

VI – VII.

Në vende me gurë të vegjël të përzier me rërë të trashë (zhurishte) e vende të thata. Eurimesdhetare.



Podocytisus caramanicus Boiss et Heldr. – Këmbavjexhësi
Fabaceae - Bishtajore

Shkurre e ngritur, pa gjemba, deri 2 m. Degët si shufra, të rimta, cilindrike kur janë të reja.

Gjethet me 3 gjethëza; gjethëzat vezake të përmbysëta, 5-15 mm, me thimth; bishtaku 3-10 mm.

Vilet 5-15 cm, skajore të ngritura, shpesh piramidale. Kupa kambanore e shkurtër, dybuzore, me dhëmbë të barabartë. Kurora e verdhë. Bishtaja vezake deri gjatore, 5-7 cm, me bisht; flegrat të holla, si letër.

Lul. VI – VII; fryt. IX – X.

Në pyje e shkorrete. Ballkanike. Në Kosovë e kemi ndeshur në Hanë të Elezit



Sophora japonica L. – Sofora e Japonisë
Fabaceae – Bishtajore

Dru deri 25 m, me gjethe rënëse.

Gjethet 15 – 25 cm, tekpendore me 3 – 5 palë gjethëza vezake ose vezake – heshtore, të gjelbra të errëta e të shnditshme përsipër, të rimta e pushlore përposh.

Lulet në melthe të mëdha skajore. Kupa kambanore, me 5 dhëmbë. Kurora e bardhë – krem ose e trëndafiltë e çelët. Bishtaja cilindrike, 50 – 80 mm, e ngushtuar ndërmjet farave, joçahëse.

Lul. VII – VIII; fry. IX – X.

E kultivuar për zbukurim. Aziatike-lindore



Trifolium hybridum L. – Tërfili hibrid
Fabaceae – Bishtajore

Bimë shumëvjeçare, e shogët ose qimerënë, me kërcej zakonisht 10 – 20 (-40) cm, të ngritur përpjetë ose të përpjetëm e të çlirët, rrallë tuforedendur, jorrënjëlëshuese në nyjë.

Gjethëzat vezake të përmbysëta. Bishtakët deri 10 cm. Ndajgjethëzat pjesërisht barishtore, vezake deri vezake – heshtore, të tkurrura gradualisht në një majë të fëndyellt.

Kokat rruzullore, me bishta më të gjatë se gjethet. Gypi i kupës me 5 nervura të dalluara. Kurora purpur ose në fillim e bardhë , më vonë e trëndafiltë, që bëhet e murrme.

V – VIII.

Në kullota dhe vende me bar deri në zonat malore.



Trifolium pignantii Fauche, Chaub. – Tërfili i Pinjantit
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë. Kërcelli i përpjetëm, 15 – 45 cm i lartë.

Gjethëzat vezake ose eliptike, 10 – 30 mm të gjatë dhe 10 - 5 mm të gjerë; ndajgjethëzat vezake, shyte ose majëngrëna.

Kaptinëza 2 -3 cm e gjatë, rruzullore, e vetmuar. Lulet me bishta të shkurtër. Gypi i sepaleve i shogët. Petalet të bardha.

V – VI.

Në pyje, faqe mali, vende të pjerrëta dhe livadhe. Ballkanike.



Trifolium velenovskyi Vandas – Tërfili i Velenovskit
Fabaceae - Bishtajore

Bimë zakonisht njëvjeçare, me kërcej deri 30 cm, të shumtë, të degëzuar.

Gjethëzat deri 15 mm, gjatore-vezake ose rombike; skajorja gati pabisht. Ndajgjethëzat të zgjeruara dhe të rrumbullakuara nga baza.

Kokat me 30 – 40 lule, pak të çlirëta, bishtat më të gjatë se 50 mm. Kurora 6 - 7 mm, e verdhë si ari, që mbetet me këtë ngjyrë pas lulëzimit.

VI – VIII.

Në kullota të zonave malore. Ballkanike.



Trigonella caerulea (L.) Ser – Trëndelina e kaltër
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore njëvjeçare, aromatike. Kërcelli 20 – 60 (-100) cm i lartë, fyl, i padegëzuar ose i degëzuar në pjesën e sipërme.
Gjethet me tre gjethëza; gjethëzat vezake – të zgjatura ose eliptike, dhëmbë – dhëmbë.
Lulet në vile të shkurtëra dhe të rrumbullakta. Kupa e dhëmbëzuar. Kurora e kaltër, rrallë e bardhë. Bishtaja e fryrë, 6 mm e gjatë dhe 2 mm e gjerë.
VI – VII.
Në toka të punuara, pranë rrugës; në Europën Veriore dhe të Mesme vetëm e kultivuar.



Vicia hirsuta (L.) Gray – Grashina e kreshpët
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore njëvjeçare, aromatike. Kërcelli 20 – 60 (-100) cm i lartë, fyl, i padegëzuar ose i degëzuar në pjesën e sipërme.
Gjethet me tre gjethëza; gjethëzat vezake – të zgjatura ose eliptike, dhëmbë – dhëmbë.
Lulet në vile të shkurtëra dhe të rrumbullakta. Kupa e dhëmbëzuar. Kurora e kaltër, rrallë e bardhë. Bishtaja e fryrë, 6 mm e gjatë dhe 2 mm e gjerë.
VI – VII.
Në toka të punuara, pranë rrugës; në Europën Veriore dhe të Mesme vetëm e kultivuar.



Vicia lathyroides L. – Grashina si vingjër
Fabaceae – Bishtajore



Vicia pannonica Crantz – Grashina e Panonisë
Fabaceae- Bishtajore



Vicia sparsiflora Ten. – Grashina me lule të rralluara
Fabaceae – Bishtajore

Bimë njëvjeçare, pushlore, 10 – 40 cm.

Gjethet me loze zakonisht të thjeshta, me 2 – 4 palë gjethëza, vezake të përmbysëta – eliptike deri vizake, me thumb shumë të shkurtër. Ndajgjethëzat të plota, pa njollë.

Lulet të vetmuara. Dhëmbët e kupës të barabartë, gati sa gypi. Kurora e purpurt deri si blu. Bishtaja e zezë, e shogët, me një sqep të shkurtër.

III – V.

Në vende të thata me bar, kryesisht në zona mesdhetare. Euri – Mesdhetare.

Bimë njëvjeçare, pushlore, 10 – 50 (-60) cm.

Gjethet 2 – 5 cm, me 4 – 10 palë gjethëza, vizake deri pykore të përmbysëta, shytë ose të cungëta, me thumb, me loze. Ndajgjethëzat të plota, me njollë.

Lulet nga 2 – 4, në vile të shkurtëra. Dhëmbët e kupës gati të barabartë. Kurora e verdhë e çelët ose e purpurt e zbeht; flamuri pushlor mbi kurriz. Bishtaja e verdhë.

IV – V.

Kryesisht si bar i keq i kulturave bujqësore, në vende barishtore e gjerdhe.

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli gjysmë i ngritur, në prerje tërthore në pjesën bazale i rrumbullakët, në pjesën e sipërme këndor, 40 – 60 cm i lartë.

Gjethet me 8 – 10 palë gjethëza, bishti i gjethes mbaron me një gjembth. Gjethëzat gjatore; në gjethet e sipërme heshtore; ndajgjethëzat vezake

Lulesa me bishtak më të gjatë ose më e shurtë se gjethja, sqetullore, me 10 – 20 lule. Lulja deri 2 cm e gjatë.

Bishti i lules më i shkurtër se kupa. Kupa e gjelbëreme; dhëmbët e kupës të pabarabartë, trekëndor. Kurora e verdhë e çelët.

IV – VI.



Genista sagitalis L. – Gjineshtra shigjetake
Fabaceae - Bishtajore



Genista tinctoria L. – Gjineshtra ngjyruese
Fabaceae – Bishtajore

Shkurre pa gjemba deri 3 m. Kërcejtë cilindrikë, rrëvaga-rrëvaga, të epshëm, të rimtë të gjelbër, të shogët e shumë të degëzuar.

Gjethet të thjeshta, që bien herët, heshtore, të shogëta përsipër, me qime të mëndafshta të rrasura përposh, gati pa bisht.

Lulet në vile skajore të çlirëta, me erë të mirë. Kupa si lëpushkë, njëbuzore, jo e rregullt me 5 dhëmbë të shkurtër. Kurora e verdhë e ndezur. Bishtaja çahëse, e sheshtë, pushlore.

V – VII.

Në shkorrete dhe vende me diell. Xana ose gjineshtra është bimë aromatike e industriale.

Gati shkurrëz pa gjemba, shumëvjeçare, e degëzuar ose jo e degëzuar, 10 - 25 cm e lartë. Kërcelli i drunjëzuar, i shtrirë, me degë barishtore të ngritura dhe të flatruara e të ngushtuara në nyje.

Në çdo nyje (3 - 6) nga një gjethe të thjeshtë, eliptike, përsipër të shogëta, përposh pushlore.

Lulesa vile, e mbledhur, me rreth 10 lule të verdha. Kupa gypore, dybuzore dhe me qime të mëndafshta. Bishtaja gjatore, e mbuluar me qime të vogla e të shtrira.

V - VII.

Rritet në vende të thata barishtore e kullota.

Gjysmëshkurre shumëvjeçare, deri 60 cm e lartë. Kërcelli në pjesën bazale i drunjëzuar, kurse degët të thjeshta, barishtore dhe me kënde.

Gjethet e thjeshta, të plota, pa bisht, majëmprehta, gjatore - heshtore.

Lulesa vile skajore. Lulet të vendosura në sqetullat e brakteve vizake. Kupa dybuzore. Buza e sipërme e çarë dysh, e poshtmja me tre dhëmbë. Kurora e verdhë.

V - VII.

Rritet në vende barishtore e kullota. Qysh në kohët e lashta është përdorur për ngjyrosje në të verdhë të leshit, linit dhe mëndafshit.



Spartium junceum L. – Xana
Fabaceae – Bishtajore



Gleditsia triacanthos L. – Gledіçe me tre gjemba
Fabaceae - Bishtajore

Shkurre ose dru i vogël deri 7 m i lartë.

Gjethet me tri gjethëza. Gjethëzat kanë trajtë eliptike deri eliptike – vezake.

Lulet janë të grupuara në vile pa gjethe. Kupa kambanore. Kurora rreth 2 cm e madhe dhe e verdhë ari. Fryti bishtajë, 4 – 6 cm e gjatë dhe çahëse. Farat të zeza.

Lul. IV – V; fryt. VII – VIII.

Kultivohet si dru zbukurimi në parqe e lulishte. Bimë e helmet.



Laburnum anagyroides Med. – Ajdësa anagjiri
Fabaceae - Bishtajore

Dru me gjethe rënëse, 1 - 7 (- 40) m, zakonisht me gjemba të thjeshtë ose të degëzuar në degë dhe trung.

Gjethet pendore dhe dyfish - pendore, ndajgjethëzat të vogla rënëse.

Lulet poligame, zakonisht në vile sqetullore, gjelbëroshe - të bardha. Kupa me 3 - 5 vriguj. Kurora pak zigomorfe, me tri deri pesë petale. Thekë 6 - 10.

Bishtaja e shtypur, kosërake dhe shpesh e përdredhur, joçahëse. Farat të shumta.

V - VII.

E kultivuar si dru zbukurimi. Amerikaneveriore.



Hippocrepis comosa L. – Hipokrepëza balluke
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcej të drunjëzuar në bazë, 5 - 20 cm e lartë.

Gjethet tekpendore me gjethëza vizake - eliptike, të rimta. Ndajgjethëzat të vogla dhe të lira.

Lulet në koka sqetullore. Kupa gypore - kambanore me 5 dhëmbë. Kurora e verdhë. Fryti bishtajë. Segmentet e bishtajës në trajtë patkoi.

V - VII.

Rritet në vende barishtore.



Lathyrus aphaca L. - Sygjarpri
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore njëvjeçare, e shogët dhe e rimtë, me kërcej të degëzuar në bazë, 50 - 80 cm e lartë.

Gjethet të thjeshta, vezake - heshtore, që janë në fakt ndajgjethe të ndryshuara, 1 - 3 cm të gjata. Llapa e tyre është e shëndrruar në loze të gjatë dhe të përdredhur që shërben për kapjen e bimës rreth trupave tjerë.

Lulet të vogla, zakonisht të vetmuara, të vendosura në sqetullën e gjethes mbi bishta 2 - 5 cm të gjatë. Kupa gypore e me dhëmbë. Kurora e verdhë. Fryti bishtajë.

V - VI.

Rritet në vende barishtore, livadhe, kullota, shkorrete të degraduara.



Lathyrus cicera L. – Vingjëra qiqër
Fabaceae – Bishtajore

Bimë njëvjeçare, me kërcej 10 – 60 (-100) cm, me flatra.

Gjethet me loze, me 1 (-2) pale gjethëza vizake deri heshtore. Ndajgjethëzat heshtore, gjysmëshigjetake.

Lulet të vetmuara, me bishta 10 – 30 mm. Kupa me dhëmbë të barabartë. Kurora e kuqërremtë – purpur. Bishtaja e murrme, e shogët. Fara 2 – 6, të lëmuara.

IV – VI.

Në vende të thata me bar si edhe në toka të kultivuara.



Lathyrus latifolius L. – Vingjëra gjethegjerë
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët ose pushlore, me kërcej 60 - 150 cm, me flatra.

Gjethet me loze, vezake ose eliptike - rrotullare, me një palë gjethëza. Ndajgjethëzat heshtore, gjysmëshigjetake.

5 - 15 lule të grupuara në vile sqetullore të cilat vile janë më të mëdha se gjethet. Kupa gypore me dhëmbë të pabarabartë. Kurora purpur në trëndafil. Fryti bishtajë, e murrme, e shogët.

V - VII.

Rritet në vende me bar, gjerdhe etj.



Lathyrus laxiflorus ¬(Desf.) O. Kuntze. – Vingjëra luleçlirtë Fabaceae – Bishtajore

Bimë shumëvjeçare pushlore ose gati e shogët me kërcej cepatar, 20 – 50 cm.

Gjethet pa loze, me 1 palë gjethëza heshtore, eliptike deri gati rrotullare. Ndajgjethëzat heshtore deri vezake – rrotullare, shigjetake ose gjysmëshigjetake, gati të barabarta sa gjethëzat.

Lulesa vile. Vilet me 2 – 6 lule. Kupa me dhëmbë gati të barabartë. Kurora blu – manushaqe. Bishtaja pushlore.

V – VIII.

Në livadhe e kullota të zonave malore.



Lathyrus niger L. – Vingjëra e zezë
Fabaceae – Bishtajore

Bimë shumëvjeçare, e shogët ose pushlore, me kërcej të ngritur cepatarë, 20 - 40 cm.

Gjethet me loze, zakonisht me një palë gjethëza vizake - heshtore. Ndajgjethëzat vizake, të mprehta në majë.

Lulesa vile me 5 - 12 lule. Kupa me gyp dhe dhëmbë. Kurora e verdhë. Bishtaja e zezë, e shogët ose pushlore.

V - VII.

Në pyje, shkorrete dhe kullota.



Lathyrus pratensis L. – Vingjëra livadhesh
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, rrallë herë me qime të pakëta, si e rimtë dhe kur thahet nxihet, 15 - 90 cm.

Gjethet pa loze; 3 – 6 (- 8) palë gjethëza heshtore deri eliptike, shytë, me thumb. Ndajgjethëzat vizake.

Lulet në vile. Këto të fundit me 2 - 6 lule e më shumë. Kupa e trëndafiltë me dhëmbë të pabarabartë. Kurora purpur që bëhet blu. Bishtaja e shogët, e zezë.

V - VI.

Në pyje të rralla dhe shkorrete deri në zona malore. Bimë ngjyruese dhe mjaltëse.



Lathyrus setifolius L. – Vingjëra gjethekreshtake
Fabaceae - Bishtajore



Lathyrus tuberosus L. –Vingjëra me zhardhokë
Fabaceae -Bishtajore



Lathyrus venetus (Mill.) Wolf. – Vingjëra e Venedikut
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore njëvjeçare gjethekreshtake. Kërcejtë me flatra të ngushta, 10 – 60 cm.

Gjethet të zhvilluara dy nga dy përgjatë kërcellit dhe me loze për kapje. Me anë të lozëve kacavirret dhe bëhet më stabile.

Lulet të vetmuara. Bishti i lules 10 - 40 mm i gjatë. Kupa me dhëmbë paksa të pabarabartë. Kurora ngjyrë portokalli - të kuqe. Fryti bishtajë, eliptike.

IV - VI.

Rritet në vende të thata të papunuara.

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët ose gati kështu, me rizomë horizontale të hollë dhe me zhardhokë. Kërcejtë të përpjetëm ose përdredhës deri 1 m, qartësisht katërfaqëshe, pa flatra.

Gjethet me nga një palë gjethëza eliptike, gjatore ose heshtore. Ndajgjethëzat vizake - heshtore.

Lulet në vile sqetullore me 2 - 7 lule më të mëdha se gjethet. Kupa me dhëmbë paksa të barabartë. Kurora e kuqe në purpur. Bishtaja e murrme, e shogët.

V - VI.

Rritet në kultura bujqësore si bar i keq, si dhe në zona malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, 20 - 50 cm e lartë. Kërcejtë të përpjetëm.

Gjethet pa loze, me 2 – 3 (-4) palë gjethëza vezake, të holla e të mprehta në majë. Ndajgjethëzat vezake - të thepëta sepse ngushtohen në majë.

Lulesa vile e dendur me 7 - 20 lule. Kupa gypore. Kurora e trëndafiltë, me nervura manushaqe. Fryti bishtajë.

IV - V.

Ndeshet në pyje e shkorrete.



Lotus corniculatus L. - Thuepula
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 50 cm e lartë. Kërcejtë të shtrirë ose të përpjetëm, të shogët deri leshtorë, me degëzim të pakët.

Gjethet tekpendore me 5 gjethëza. Gjethëzat heshtore deri vezake. Ndajgjethëzat të reduktuara në gjemba.

Lulesa kaptinë në formë të mburojës mbi bishta të gjatë, të përbërë nga një numër i pakët lulesh (3 - 6). Kupa kambanore. Kurora e verdhë. Bishtaja cilindrike, çahëse, 2 - 3 cm e gjatë, pasi piqet merr ngjyrë kafe.

IV - VIII.

Rritet në vende barishtore, në livadhe e kullota.



Medicago arabica (L.) Huds. – Jonxha me njolla
Fabaceae – Bishtajore

Bimë njëvjeçare, pushlore me qime të rralla deri e shogët, 20 – 50 cm. Kërcejtë zvarritës cepatarë.

Gjethet trishe. Gjethëzat në formë vezake të përmbysur, dhëmbë – dhëmbë pranë majës, me njollë ngjyrë kafe në mes. Ndajgjethëzat dhëmbë – dhëmbë.

Lulesa me l – 4 (-6) lule të verdha, mbi bishta të gjatë, por më të shkurtër se bishti i gjethes. Bishtaja e spërdredhur me 4 – 7 rrotullime.

IV – VI.

Në vende barishtore e kullota.



Medicago sativa L. – Jonxha e kultivuar
Fabaceae– Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, pak a shumë me push, 30 - 50(- 80) cm e lartë.

Gjethet me 3 gjethëza. Gjethëzat vezake të përmbysëta ose heshtore të përmbysëta, dhëmbë - dhëmbë në majë. Ndajgjethëzat heshtore.

Lulesa vile. Vilet të dendura me 5 - 40 lule, me bisht 30 - 40 cm. Kupa me 5 dhëmbë. Kurora blu - manushaqe ose e verdhë. Bishtaja mund të jetë e drejtë, kosërake ose e përdredhur si spiral.

IV - VI.

E kultivuar si bimë foragjere.



Melilotus alba Medicus – Makthi i bardhë
Fabaceae – Bishtajore



Melilotus officinalis (L.) Pallas – Makthi mjekësor
Fabaceae - Bishtajore



Onobrychis alba Waldst. et Kit – Esparseta e bardhë
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore njëvjeçare ose dyvjeçare e ngritur dhe e degëzuar. Ka erë kumarine dhe arrinë lartësi 50 - 120 cm.

Gjethet me tri gjethëza. Gjethëzat heshtore - vizake, të dhëmbëzuara. Ndajgjethëzat vizake dhe të plota.

Lulet në vile sqetullore. Kurora e bardhë - e verdheme. Fryti bishtajë ovoide, i cili kur piqet merr ngjyrë të përhime të murrme.

VII - IX.

Në vende të papunuara dhe me lagështi. Bimë e helmët.

Bimë barishtore dyvjeçare, e shtrirë ose e ngritur, deri 150 cm e lartë.

Gjethet me 3 gjethëza vezake,zakonisht të dhëmbëzuar; të vitit të parë më të mëdha se të vitit të dytë. Gjethëza e mesme me bisht më të gjatë se anësorët. Ndajgjethëzat heshtore si fëndyell.

Lulet të vogla, të varura në vile 4 - 10 cm të gjata. Vilet shumëlulëshe (30 - 70). Kupa me pesë dhëmbë. Kurora e verdhë. Bishtaja ovale, me rrudha tërthore, e shogët, me thimth, zakonisht me një farë.

V - VIII.

Rritet në livadhe e vende me lagështi, toka të punuara. Nëse thërmohet lëshon erë kumarine. Bimë e helmët, mjekësore dhe aromatike.

Bimë barishtore shumëvjeçare pushlore. Kërcelli 40 – 70 cm i lartë.

Gjethet me 13 – 21 gjethëza vizake deri eliptike.

Lulet në vile sqetullore. Kupa pushlore me qime të hapura dhe me dhëmbë të paktën dy herë më të gjatë se gypi. Kurora e bardhë ose e trëndafiltë, shpesh me nervura të trëndafilta.

V – VII.

Në kullota të thata malore e subalpine



Onobrychis scardica (Griseb.) Hal. – Esparseta e Sharrit
Fabaceae - Bishtajore



Onobrychis viciifolia Scop. - Esparseta gjethegrashine
Fabaceae - Bishtajore



Ononis spinosa L. – Kalmuthi gjembor
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 30 cm e lartë, e mbuluar me qime të palosura, me bisqe sterile dhe fertile.

Gjethet tekpendore me 5 – 9 gjethëza vezake – vizake, përposh me qime.

Lulesa vile. Kupa kambanore, me 5 dhëmbë të barabartë, të paktën dy here më të gjatë se gypi. Kurora e trëndafiltë – purpurtë me nervure të purpurta. Bishtaja me qime të palosura.

VI – VIII.

Bimë endemike e Ballkanit. Në Kosovë e ndeshim në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare. Rritet në vende shkëmbore – gëlqerore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 40 - 70 cm e lartë. Në pjesën e poshtme gati e shogët, kurse në pjesën e sipërme pushlore.

Gjethet e përbëra tekpendore me 5 - 12 çifte gjethëzash vezake – gjatore.

Lulet në vile sqetullore piramidale, e gjatë 5 - 7 cm. Kupa kambanore, pushlore, me dhëmbë më të gjatë se gypi. Kurora e trëndafiltë me nervura të purpurta. Fryti bishtajë.

V - VII.

Rritet në livadhe,shpatije të rrahura nga dielli, buzë rrugëve si dhe e kultivuar si foragjere.

Gati shkurrëz, 20 - 70 cm e lartë. Kërcejtë me qime të kthyera nga poshtë dhe me gjemba, shpesh e drunjëzuar në bazë.

Gjethet me 3 gjethëza. Ato janë eliptike dhe me dhëmbëza anash. Ndajgjethëzat vizake. Lulet të vetmuara. Në raste të rralla nga dy në çdo nyje. Kupa me push dhe dhëmbë, dy herë më e gjatë se gypi. Kurora e trëndafiltë ose purpur. Fryti bishtajë. Farat të murrme.

V - IX.

Në vende të thata jopjellore dhe me lagështirë. Bimë mjekësore.



Pisum elatius Bieb. – Bizelja më e lartë
Fabaceae– Bishtajore

Bimë barishtore njëvjeçare. Kërcelli i shogët, i rimtë, 50 - 100 ose 160 cm i lartë.

Gjethet të përbëra, pendore. Në përbërjen e një gjetheje marrin pjesë 1 - 3 palë gjethëza që mbarojnë me loze. Ndajgjethëzat të mëdha, gjysmëkërcellpushtuese e dhëmbë - dhëmbë.

Lulesa vile me 1 - 2 lule, 2 - 3 cm të gjata. Flamuri ka ngjyrë lila, flatrat të kuqe të mbyllët, karenet trëndafili ose të bardheme të blertë. Fryti bishtajë.

VI - VII.

Rritet në shkurraja, rrallë si bimë ruderale ose edhe e kultivuar.



Lupinus micranthus Guss. – Lupini lulevogël
Fabaceae – Bishtajore

Njëvjeçare 40 – 50 cm e lartë, e kreshpët me qime të argjendta.

Gjethet me bishtak deri 6 cm të gjatë e me 7 gjethëza vizakepallake, me thimth. Ndajgjethëzat vizake si fëndyell.

Vilet në trajtë koke, që në frytëzim zgjatet. Buza e sipërme e ndarë dysh, kurse buza e poshtme me 3 dhëmbë. Kurora blu – manushaqe. Bishtaja leshtore, e kuqe e murrme.

IV – V.

Në vende të thata dhe shkorrete. Ne Kosovë është konstatuar në rajonin e Dushkajes.



Robinia pseudoacacia L . - Driza e butë
Fabaceae – Bishtajore

Dru deri 25 m i lartë. Degët e reja dhe gjethet të shogëta.

Gjethet tekpendore me 13 - 15 gjethëza eliptike. Ndajgjethëzat të shndërruara në gjemba të shëndoshë.

Lulesa vile sqetullore e varur, 10 - 20 cm e gjatë, me 15 e më shumë lule aromatike. Kupa kambanore. Kurora e bardhë, baza e flamurit e verdhë.

IV - VI.

E kultivuar dhe e natyralizuar. Bimë mjaltëse. Ka prejardhje nga Amerika Veriore. Në Evropë e sjellur në fillim të shekullit XVII nga një kopshtar francez.



Trifolium alpestre L. – Tërfili i alpeve
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë, me kërcej 15 - 25 cm, të drunjëzuar nga poshtë.

Gjethet trishe. Gjethëzat me dhëmbëza në majë.

Kaptinat rruzullore, skajore të vetmuara, gati të pabisht. Dhëmbët e kupës të fëndyellt, leshtakë, më i poshtmi shumë më i gjatë se të tjerët. Kurora purpur, rrallë e trëndafiltë ose e bardhë. Bishtaja ovoide.

V - VIII.

Në kullota, pyje, çeltira etj.



Trifolium badium Schreber – Tërfili i murrmë
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 5 - 15 cm, me kërcej të përpjetëm, pushimët, shpesh të degëzuara e me shumë koka.

Gjethëzat eliptike deri vezake, zakonisht të pabisht. Ndajgjethëzat vezake - heshtore.

Lulet në koka të dendura e bisht-gjata. Kurora e verdhë në lulëzim, e murrme pas lulëzimit; flamuri në trajtë luge, i hullizuar. Fryti bishtajë.

VI - VIII.

Në kullota të zoave të larta malore.



Trifolium dubium Sibth. – Tërfili i dyshimtë
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore njëvjeçare, zakonisht leshtake, me kërcej 5 – 40 cm, me ndërnyja të zgjatura.

Gjethëzat zemërpërmbysët ose vezake të përmbysëta. Ndajgjethëzat gjerësisht vezake.

Koka me 3 – 15 (-20) lule, me bishta hollakë. Dhëmbët e kupës të pabarabartë. Kurora e verdhë, që bëhet e verdheme – e murrme pas lulëzimit.

V – VIII.

Në kullota e vende me bar dhe lagështi.



Trifolium incarnatum L. – Tërfili ngjyrë mishi
Fabaceae – Bishtajore

Bimë njëvjeçare ose dyvjeçare,15 - 20(- 50) cm, pushlore. Kërcejtë të thjeshtë ose të degëzuar vetëm nga baza.

Gjethet kërcellore me bisht 20 - 40 cm, me gjethëza gati rrotullare. Ndajgjethëzat vezake, që pështjellin kërcellin në një farë gjatësie, me dy veshëza.

Kaptina e vetme skajore, në fillim vezake, pastaj zakonisht vezake – gjatore. Kupa me dhëmbë sa ose më të gjatë se gypi. Kurora e kuqe si gjaku, trëndafiltë, krem ose e bardhë.

V - VII.

Në toka të punuara e të papunuara.



Trifolium montanum L. - Tërfili i maleve
Fabaceae - Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, pushlore me qime të imëta në kërcej dhe në faqen e poshtme të gjetheve. Kërcejtë 10 – 60 cm, të ngritur përpjetë, të thjeshtë ose me 1 - 2 degë sipër.

Gjethëzat e poshtme heshtore, kërcelloret eliptike ose gjatore.

Kokat (lulesat) shpesh të parëzuara, të dendura e me lule të shumta, rruzullore ose ovoide. Kupa me dhëmbë të fëndyellt. Kurora e bardhë - si qumsht. Bishtaja zakonisht me një farë.

V - VII.

Rritet në kullota e livadhe të thata të zonave malore.



Trifolium noricum Wulfen – Tërfili i Norikumit
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, tufore, me rizomë të drunjëzuar. Kërcejtë zakonisht jo të degëzuar, të përpjetëm, me qime të hapura e të dendura, 10 – 25 cm të lartë.

Gjethet gati të gjitha bazale, me bisht 6 – 10 cm. Gjethëzat pushlore përposh. Ndajgjethëzat lëkurore, të bardhëreme.

Kaptinat të vetmuara, rrallë herë nga dy. Lulet të verdha ose krem.

VI – VIII.

Rritet në lëndina gëlqerore, në të çara të shkëmbinjëve gëlqeror të zonës alpine dhe subalpine.



Trifolium pretense L. – Tërfili i livadheve
Fabaceae - Bishtajore



Trifolium repens L. - Tërfili zvarritës
Fabaceae – Bishtajore



Trifolium resupinatum L. - Tërfili i përmbysët
Fabaceae - Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, tufore, pak a shumë leshtake, me rizoma të drunjëzuara. Degët pak të shtrira dhe të lakuara përpjetë.

Gjethet trishe. Gjethëzat vezake - eliptike, të gjera, me majë shytë, në anën e sipërme me një njollë të bardhë, me bishta të barabartë.

Lulesa kaptinë sferike ose vezake, me bisht të shkurtër ose pa bisht. Lulet ngjyrë rozë në kafe. Kupa gypore me dhëmbë. Bishtaja vezake.

III - X.

Rritet në vende me lagështi mesatare, shkurrnaja e pyje të rralla. Bimë foragjere, mjaltëse dhe mjekësore. Gati kosmopolite.

Bimë barishtore shumëvjeçare, me stollone mbitokësore zvarritëse rrënjëlëshuese në nyje, 10 - 15 cm e lartë.

Gjethet trishe me bisht 15 - 20 cm të gjatë e më tepër. Gjethëzat vezake të përmbysëta. Në mes me njolla të bardha (rrip i thyer). Ndajgjethja rreth 15 mm e gjatë, heshtore, në majë e mprehtë, vemesore, këllëfëse.

Lulesa kaptinë me diametër deri 2 cm e përbër nga shumë lule (40 deri 80). Pas lulëzimit merr formën e një çadre. Lulet të bardha deri rozë e që pas lulëzimit marrin ngjyrë kafe të çelur. Fryti bishtajë.

V - IX.

Rritet në vende barishtore, në kullota me lagështi mesatare.

Bimë njëvjeçare, rrallë dyvjeçare, e shogët, 10 – 40 cm, me kërcej të shtrirë.

Gjethet me tre gjethëza. Bishti i gjethes 5 – 7 cm i gjatë. Gjethëzat vezake të përmbysëta.

Kokat rruzullore, me bishta 20 – 40 mm, më të gjatë se gjethet. Kupa në frytëzim dardhëngjashme, e rrethuar me dy dhëmbët e sipërm divergjentë. Kurora e trëndafiltë - ngjyrë mishi.

IV – VII.

Rritet në vende me bar me lagështi. Bimë mjaltëse.



Trigonella corniculata L. – Trëndelina
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore njëvjeçare. Kërcejtë 10 - 15 cm, të shtrirë ose të ngritur, të shogët ose gati të shogët.

Gjethet me tre gjethëza, zakonisht dhëmbë - dhëmbë. Gjethëzat vizake heshtore, shyte.

Lulet në vile. Vilet vezake gjatore me 8 - 20 (- 30) lule. Kupa me dhëmbë të pabarabartë. Kurora e verdhë. Flatrat më të shkurtra se karena. Bishtaja kosërake, e varur, majëmprehtë, e shtypur, e shogët.

IV – V.

Në kullota e vende të thata. Bima kur thahet ka aromë.



Vicia cracca L. – Grashina kraka
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 200 cm. Kërcejtë e shogët ose pushlorë.

Gjethe me loze, me 6 – 15 palë gjethëza, vizake deri vizake – gjatore.

Lulet në vile të dendura. Vilet me 10 – 30 lule. Kupa me gyp, me dhëmbin e poshtëm gati sa gypi. Kurora si gyp, blu – manushaqe. Fryti bishtajë.

VI – VII.

Në pyje e kullota të zonave malore.



Vicia lutea L. – Grashina e verdhë
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore njëvjeçare gati e shogët deri leshtore, 10 – 50 (-80) cm.

Gjethet 3 – 6 cm, zakonisht dyrrjetëse, me 3 – 10 palë gjethëza. Gjethëzat vizake ose gjatore, me thumb. Ndajgjethëzat të plota ose dhëmbë-dhëmbë.

Lulet 1 – 2 bashkë, gati të pabisht. Kupa gungore, me dhëmbë të pabarabartë, të poshtmit më të gjatë se gypi. Kurora zakonisht e verdhë e çelët, por shpesh e ngjyer në të purpurt.

IV – V.

Në toka të papunuara, kullota të thata, por më shpesh si bar i keq i kulturave bujqësore.



Vicia onobrychioides L. – Grashina si esparsetë
Fabaceae – Bishtajore



Vicia sativa L. – Grashina e kultivuar
Fabaceae – Bishtajore



Vicia serratifolia Jacq. – Grashina e Narbonës
Fabaceae – Bishtajore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët ose pushlore, 30 – 80 cm.

Gjethet me loze, me 4 – 11 palë gjethëza, 10 – 35 x 1 – 4 mm, vizake ose gjatore – heshtore. Ndajgjethëzat të plota ose me dhëmbë të paktë.

Vilet me 4 – 12 lule. Kupa me dhëmbë të pabarabartë. Kurora manushaqe me karenë të çelët. Bishtaja e kuqërremtë – e murrme, e shogët.

V – VII.

Në çeltira pyjesh dhe kullota të zonave malore.

Bimë njëvjeçare, pushlore, deri 80 cm.

Gjethet me 3 – 8 gjethëza vizake, të mprehta deri majëngrëna, me thumb. Ndajgjethëzat dhëmbë-dhëmbë, zakonisht me një njollë të errët.

Lulet të vetmuara ose çifte. Dhëmbët e kupës gati të barabartë. Kurora zakonisht e purpurt, rrallë rozë ose e bardhë.

IV – VI.

Në mjedise të ndryshme, nga kullota e vende me bar deri në në zona pyjore, por më shpesh si bar i keq i kulturave bujqësore

Bimë njëvjeçare, me kërcell të trashur, fyl, të pajisur me push.

Gjethet me 1 – 3 palë gjethëza. Gjethëzat kanë formë vezake ose eliptike, të plota ose të sharruara. Gjethet përfundojnë me lozë. Ndajgjethëzat të plota ose dhëmbë-dhëmbë.

Lulet në vile me nga 1 – 4 ose 6 lule. Dhëmbët e kupës jo të barabartë. Kurora e purpurt e errët. Fryti bishtajë me ngjyrë të zezë ose të murrme.

IV – VI.

Rritet në vende të punuara e të papunuara.



Vicia villosa Roth. – Grashina leshtore
Fabaceae – Bishtajore

Bimë njëvjeçare, rrallë dyvjeçare, 30 – 200 cm, leshtore deri pushlore me qime të rrasura ose e shogët.

Gjethet me loze, me 4 – 12 palë gjethëza vizake deri eliptike. Ndajgjethëzat të plota,

Vilet me 10 – 30 lule. Kupa gungore në bazë, me dhëmbë të pabarabartë. Kurora zakonisht manushaqe, purpur ose blu.. Bishtaja e shogët.

V – VII.

Kryesisht në gjerdhe. Bimë foragjere.



Daphne blagayana Freyer – Xerxelja e Bllagajt
Thymelaeaceae – Therrokore

Shkurrëz e përherëblertë deri më 30 cm, me kërcej të gjatë, të shtrirë, të degëzuar e të hapur, me gjethe vetëm në krye.

Gjethet 3 – 6 cm, vezake të përmbysëta deri eliptike të zgjatura, shyte, të pabisht, të shogëta, lëkurore.

Lulet të bardha – krem, të pabisht, në kaptina, 10 – 15 së bashku. Frytet bërthokla të bardheme.

Lul. IV – VI; fryt. VIII.

Në pyje, kullota e shpate me gëmusha e gurë. Ballkanike.



Daphne laureola L. - Xerxelja dafinëz
Thymelaeaceae - Therrokore

Shkurrëz përherë e blertë deri 120 cm e lartë, me bisqe të reja të gjelbra, të shogëta.

Gjethet heshtore, majëmprehta, lëkurore, të shogëta, të shkëlqyeshme, të poshtmet të kthyera poshtë, të mesmet të shtrira, ndërsa të sipërmet të ngritura.

Lulet të verdheme - të gjelbra. Sepalet vezake, të mprehta. Petalet munguese. Frytet bërdhokla ovoide, 6 x 8 mm, të zeza kur piqen.

III - IV.

Bimë mjaftë e shpesht nëpër pyje gjethegjera, me tokë lehtësisht të thatë.



Daphne mezereum L. - Jargavan mali
Thymelaeaceae - Therrokore

Shkurëz gjetherënëse deri 1.5 m e lartë, me degë të ngritura,të hirta ose të trëndafilta. Bisqet e reja qimeashpra.

Gjethet në tufëza në krye të degëve. Të poshtmet eliptike, të sipërmet heshtore.

Lulet si në ngjyrë trëndafili që shfaqen mbi degëza të vjetra, 2 - 4 së bashku, që dalin para gjetheve, duke formuar kështu një lulesë në trajtë kalliri. Frytet bërthokla të kuqe.

III - V.

Nëpër pyje e shkurrnaja të zonave të larta. Bimë e helmët dhe mjekësore.



Daphne oleoides Schreber – Xerxelja si yll
Thymelaeaceae – Therrokore

Shkurrëz e përhereblertë deri më 60 cm, me shumë degë. Bisqet e reja me qime.

Gjethet heshtore – eliptike, lëkurore, zakonisht pak a shumë leshtake kur janë të reja, më vonë gati të shogëta e të shkëlqyshme përsipër.

Lulet të bardha ose krem, gati të pabisht, në kaptinëza skajore 3 – 6 së bashku. Frytet bërthokla të kuqe, pushlore.

V – VI.

Nëpër kullota malore e vende të rrjepura gëlqerore.



Daphne cneorum L. – Hollokuqi i shkurtër
Thymelaeaceae – Therrokore

Shkurrëz e përhereblertë me degë zakonisht të shtrira ose të përpjetme, të gjata, të holla, të drejta e të lëmuar; 5 – 30 cm e lartë.
Gjethet zakonisht 3 – 4 herë më të gjata se të gjera, gjatore të përmbysëta, nganjëherë me thumb, të pabisht, të shogëta.
Lulet të merme, ngjyrë trëndafili, gati të pabisht, në kaptinëza, 6 – 10 (-20) së bashku. Sepalet shyte.
Lul. V – VI; fryt. VIII – IX.
Në vende të thata me gur, zakonisht gëlqerore.



Thymelaea passerina (L) Cosson et Germ. – Therroke
trumcakësh Thymelaeaceae – Therrokore

Bimë brishtore njëvjeçare me kërcell të ngritur, 20 – 50 cm, të thjeshtë ose pak të degëzuar, të shogët ose me push të rrallë lart.

Gjethet vizake – heshtore, të mprehta e me thumb, të sipërmet dalngadalë të reduktuara në trajtë braktesh.

Lulet hermafrodite, të gjelbëreme, të vetmuara ose me tufëza 2 – 3 së bashku.

VI – VIII.

Në ranishte,djerrina, fusha.

Shkurre ose dru i vogël deri 8 m i lartë. Degët e reja të gjelbëreme – të verdha, me 4 qoshe. Lëvorja e përhime me plasaritje të kuqërreme.

Gjethet të përkundërta, eliptike – të thepëta, me 3 - 5 palë nervura.

Lulesa ombrellë sqetullore. Lulet të verdha, që lulëzojnë para se të dalin gjethet. Fryti bërthokël mishtore, e kuqe, e ngrënshme.

II - IV.

Rritet nëpër pyje e shkurrnaja. Bimë mjekësore, ngjyruese e mjaltëse



Cornus mas L. – Thana
Cornaceae – Thanore



Cornus sanguinea L. - Thanukla
Cornaceae – Thanore

Shkurre që rritet 2 - 4 m. Degët të reja pak pushlore, shpesh të kuqe të errëta.

Gjethet të përkundërta, eliptike, buzëplota, të thepëta, të blerta të çelëta, me 3 - 4 palë deje anësore, bisht-shkurtëra, rënëse.

Lulet të bardha, në kima si vastakë, me bishta. Fryti bërthokël me formë sferike. Në fillim i gjelbër – i kuq, kur piqet i zi – i kaltër, jo i ngrënshëm.

V – VI.

E shpeshtë nëpër gjerdhe, shkorrete e pyje.



Ilex aquifolium L. – Ashja
Aquifoliaceae – Ashore

Shkurre ose dru i vogël 2 – 10 m. Lëvorja ngjyrë hiri e çelët.

Gjethet 5 – 12 cm, të përherëblerta, të thjeshtë, lëkurore, të këmbyera, të lëmuara, me dhëmbë gjembakë therrës.

Lulet njëseksore; lulet femër të bardha, me buzë të kuqe në lule mashull. Fryti gati rruzullor, i kuq dhe me shumë fara.

Lul. IV – V; fryt. IX – II.

Nëpër pyje të freskëta e vende me hije të zonës së ahut e të dushqeve. Bimë ngjyruese dhe e helmët.



Euonymus europaeus L. – Herdhaqeni i Evropës
Celastraceae – Celastrore

Shkurre ose dru i vogël, 1 – 5 m i lartë, i shogët, me shumë degë të përkundërta katër cepatare.

Gjethet të përkundërta, me llapë eliptike ose heshtore, të blerta – të errëta, të dhëmbëzuara.

Lulesa cimë sqetullore e përbërë nga 2 – 5 lule. Petale 4, të verdheme. Fryti kapsulë. Kapsula 4-qoshëshe, e kuqërreme. Farat të mbështjella me një aril mishtor në ngjyrë portokalli të shkëlqyeshme.

IV – VI.

Rrite nëpër pyje, shkurrnaja, gjerdhe, sidomos në pyjet e dushkajave dhe gështenjave.



Euonymus latifolius (L.) Miller – Herdhaqeni gjethegjerë
Celastraceae - Celastrore

Shkurre ose dru i vogël 1 – 5 m.

Gjethet në pëgjithësi të përkundërta, gjatore të përmbysëta – eliptike, të thepëta, me dhëmbë si të sharrës.

Lulesa cimë e përbërë nga 4 – 12 lule 5-pjesëshe. Fryti kapsulë me ngjyrë të kuqe. Farat të mbështjella me aril.

Lul. V – VI; fryt. IX – X.

Në pyje të freskëta gjethegjera (ahishte dhe gështenjishta).

Shkurre gati e shogët me shumë degë, 1 – 3 m. Bisqet e holla, me lëvore të gjelbër të mbuluar me lytha të zinj.

Gjethet të përkundërta me llapë heshtore, shumë të thepët, me buzë të dhëmbëzuar.

Lulet 4-pjesëshe, në përgjithësi të bashkuara nga dy mbi një bisht të përbashkët 2 – 3 cm, sipër të bigëzuar, duke formuar kështu një lulesë në trajtë cime me 1 – 3 lule. Fryti kapsulë, ngjyrë trëndafili. Farat të zeza, pjesërisht të mbuluara prej arilit.

Lul. IV – VI; fryt. VII – X.

Në shkorrete dhe korije të degraduara.



Euonymus verrucosus Scop. – Herdhaqeni i malit
Celastraceae – Celastrore



Staphylea pinnata L. – Shtogëri
Staphyleaceae – Shtogrore

Shkurre deri 5 m. Degët e reja të shogëta me shumë thjerrëza të bardheme.

Gjethet të përkundërta, bishtgjata, pendore, rënëse, të përbëra nga 5 – 7 gjethëza të pabisht, heshtore – të thepëta ose eliptike, buzëdhëmbëzuara.

Lulet hermafrodite, të rregullta, 5 – pjesëshe, të lira, në melthe skajore të varura. Sepalet të bardheme. Petalet të bardheme. Fryti kapsulë e fryrë, çahëse, 3 – 4 cm, me 2 – 3 vriguj, vemesore, me 3 ose pak fara.

Lul. IV – V; fryt. VII – VIII.

Nëpër pyje dhe e kultivuar si shkurre zbukurimi.

Bimë barishtore shumëvjeçare deri 50 cm e lartë. Ka të zhvilluar rizomën. Kërcelli i shogët i pajisur me degë jo lulebartëse.

Gjethet vizake, të plota, me renditje spirale. Gjethet e rrezeve të vogla kanë trajtë gati rrotullare.

Lulesa është e thjeshtë. Lulet të grumbulluara në të ashtuquajtura ciate. Një ciat përmban një lule femër dhe disa lule mashkull. Mbi vezore qëndrojnë tre shtyllëza të lira.

IV - VII.

Rritet në vende të thata me bar, në shkëmbinj e vende me gur. Bimë e helmët dhe ngjyruese.



Euphorbia cyparissias L. – Rryelli selvi
Euphorbiaceae – Qumështore

Bimë shumëvjeçare tufore, deri 90 cm, pushlore, me kërcej zakonisht të zhveshur në bazë që lulëzojnë vitin e dytë, pa degë sqetullore jolulebartëse.

Gjethet heshtore përmbysëse ose pallake, të plota, ato të vitit të parë më të mëdha se të vitit të dytë. Gjethet e rrezeve gjerësisht vezake. Gjëndrat me brirë zakonisht konvergjentë.

VI – VII.

Rritet nëpër ahishte si bimë hijedashëse. Bimë e helmet, ngjyruese dhe mjekësore.



Euphorbia amygdaloides L. - Rryelli si bajame
Euphorbiaceae – Qumështore

Bimë shumëvjeçare disi tufore deri 60 cm, e shogët, e rimtë, e padegëzuar qysh nga baza, deri me 30 rreze sqetullore.

Gjethet të këmbyera, vizake – heshtore deri eliptike – gjatore, zakonisht të mprehta, të plota, të forta ose gati lëkurore, me nervura me vendosje pëllëmbore. Gjethet e rrezeve vezake – heshtore; ato të rrezeve të vogla rombike – deltoide deri veshkëlore.

Rreze 5 – 30, zakonisht 2 herë të dyzuara. Kapsula me hulliza të cekëta.

IV – VIII.

Në vende të thata ose shkëmbore, toka djerrë, lëndina etj.



Euphorbia seguieriana Necker – Rryelli seguieranë
Euphorbiaceae – Qumështore



Euphorbia glabriflora Vis. - Rryelli me lule të shogëta
Euphorbiaceae – Qumështore

Bimë njëvjeçare zakonisht me kërcell të vetëm të ngritur përpjetë 10 - 50 (- 80) cm të lartë.

Gjethet vezake të përmbysta - pallake, shyte, të sharruara në gjysmën e sipërme. Rreze 5, në fillim të trizuara, më pas të dyzuara. Braktetë të pranishme ndërmjet luleve mashkull. Farat me rrudha në trajtë rrjete.

IV - XI.

Rritet në toka të trazuara, në vende me bar ose të punuara si bar i keq i kulturave bujqësore, buzë rrugësh, në gërmadha e vende me gur.



Euphorbia helioscopia L. – Rryelli diellpamës
Euphorbiaceae – Qumështore

Shkurre e vogël, e shogët, me kërçep të trashë drunor. Kërcejtë në pjesën e poshtme të drunjëzuar, me degë të holla njëvjeçare lulembajtëse, 10 - 20 cm të lartë.

Gjethet vizake - heshtore, të mprehta ose shyte, të rimta, pikaloshe. Gjethet lulore të rrezeve më të gjera se gjethet kërcellore. Ato të rrezeve të vogla vezake, të verdha. Rreze (1-) 3 - 5.

V - VII.

Në shpate gurishtore të zonave malore serpentine. Ballkanike.



Euphorbia esula L. – Rryelli i athët
Euphorbiaceae – Qumështore

Bimë shumëvjeçare deri 120 cm, e shogët ose pushlore, me kërcej zakonisht të padegëzuar në bazë, por me degë sqetullore jolulebartëse.

Gjethet 2 – 7 cm të gjata, vizake, të plota, zakonisht shyte. Gjethet e rrezeve më të shkurtra; ato të rrezeve të vogla rombike, deltoide ose veshkëlore.

Lulet të vendosura në grupe të vogla. Gjëndrat majëngrënë ose me dy brirë.

IV – VII.

Rritet në vende me lagështi, në toka të punuara, buzë rrugësh.



Euphorbia myrsinites L. – Rryelli mërsinë
Euphorbiaceae – Qumështore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të mbuluar me qime të buta, zakonisht të padegëzuar.

Gjethet gjatore ose gjatore – ovale, gati pa bisht, të ngushta në bazë. Baza e gjetheve të sipërme ka formë zemre. Gjethet pranë luleve eliptike ose vezake – gjatore, me ngjyrë të verdhë të çelët.

Ciatet kanë formë kupe, me 5 gjethe të mprehta. Nektarmbajtëset kanë ngjyrë dylli ose të verdhë. Fryti kapsulë.

V – VI.

Rritet në vende me bar, shkurrishta e pyje.



Euphorbia polychroma Kern. – Rryelli shumëngjyrësh
Euphorbiaceae – Qumështore

Bimë shumëvjeçare, e shogët dhe e rimtë, me kërcej të shumtë, dekumbentë ose të përpjetëm, të trashë e të thjeshtë, me gjethe të dendura, deri 40 cm e lartë.

Gjethet vezake të përmbysëta deri gati rrotullare, majëhollë ose me thumb, zakonisht të trasha e mishtore.

Lulet të vendosura në grupe të vogla me gjëndra si gjysmëhënë. Braktetë mungojnë ndërmjet luleve mashkull. Fryti kapsulë, i shogët. Farat me rrudha, të përhime të murrme.

V - VIII.

Në vende shkëmbore ose me gurë. Bimë e helmët.



Euphorbia salicifolia Host. – Rryelli gjethe shelgu Euphorbiaceae – Qumështore

Bimë shumëvjeçare deri 80 cm, pak a shumë pushlore gjëndërore, e pa degëzuar në bazë, me 0 – 3 degë sqetullore jolulebartëse.

Gjethet 2.5 – l0 cm të gjata, heshtore deri vezake – heshtore, të plota. Kërcelloret të këmbyera, me nervure me vendosje pendore. Gjethet e rrezeve vezake; ato të rrezeve të vogla rrotullare deltoide deri veshkëlore.

Lulet të vendosura në grupe të vogla. Gjëndrat me dy brirë.

IV - VI.

Rritet në shkurrishta, buzë arash etj.



Mercurialis perennis L. – Merkuriali shumëvjeçar
Euphorbiaceae – Qumështore



Aesculus hippocastanum L .- Gështenja e egër
Hippocastanaceae - Hipokastanore



Acer campestre L. - Kreka
Aceraceae - Panjore

Bimë shumëvjeçare, deri 40 cm e lartë, që nxihet kur thahet, me rizomë, me kërcej të thjeshtë, zakonisht të fryrë në nyjë.

Gjethet të përkundërta, eliptike - heshtore,ura-ura të sharruara, të grumbulluara në pjesën e sipërme të kërcellit.

Lulet mashkull më shpesh të tufëzuara, të vendosura në kallinj të gjatë. Lulet femër më shpesh të vetmuara ose disa bashk në lulesë sqetullore.

IV - VI.

Në vende me hije, më shpesh në pyje me ah. Bimë e helmët.

Dru deri 25 m. Lëvorja ngjyrë kafe e errët, që shqitet në formë pllakash të çrregullta.

Gjethet të përkundërta, pëllëmbore të çara, me 5 - 7 gjethëza, me buzë dyfish të sharruara, përposh me ngjyrë ndryshku sa janë të reja.

Lulesa në melthe skajore .Lulet të bardha me një njollë të verdhë ose të kuqe në qendër. Thekë 7. Fryti kapsulë ovoide, me gjemba të shtrirë, që përmban 1 - 3 fara, me pamje si të gështenjës.

Lul. IV – V; fr. VIII – IX.

Aty - këtu në gjendje të egër dhe e kultivuar si dru zbukurimi.

Shkurre ose dru që të rritet deri 15 m, me lëvore të kuqërreme. Degët njëvjeçare me thjerrëza gjatore ngjyrë portokalli.

Gjethet e përkundërta, pëllëmbore, të trasha gati të lëkurta, me 3 – 5 vriguj, rënëse. Baza e llapës me buzë të rrumbullakosur, në trajtë zemre.

Lulet njëseksore, të blerta në të verdhë dhe me push. Janë të grupuara në vastak të përpjetëm dhe dalin bashk me gjethet. Frytet shojza me flatra horizontale dhe me nga dy fara.

IV – V.

Rritet nëpër shkurraja të zonës mesdhetare.



Acer macrophyllum Pursh – Panja gjethemadhe
Aceraceae – Panjore

Dru deri 30 m i lartë me kurorë të gjerë dhe të lëshuar.
Gjethet më të mëdha se te llojet e tjera, 25 – 35 cm të mëdha; bishtaku 20 – 30 cm i gjatë. Llapa zakonisht me tre vriguj të dhëmbëzuar.
Lulet njëseksore, deri 3 mm të mëdha, të verdha të gjelbra dhe të grupuara në lulesën vastak, 10 – 20 cm të gjatë. Fryti shojzë.
IV – V.
E kultivuar nëpër parqe ose pranë shtëpive. Me prejardhje nga pjesa perëndimore të Amerikës Veriore.



Acer negundo L. – Panjë amerikane
Aceraceae – Panjore

Dru deri më 20 m i lartë.
Gjethet 15 – 25 cm, tekpendore, me 3 – 5 (-7) gjethëza heshtore ose pak a shumë eliptike, majëmprehta, me dhëmbë të mëdhenj, shpesh të vrigulluara sidomos ajo e kreut, më rrallë buzëplota, me nervura pendore.
Lulet njëseksore, të papetale, të gjelbëreme, që dalin përpara gjetheve; lulet mashkull në vastakë, ato femër në vile të varur. Frytet shojza të shogëta, 3 cm të gjata, me flatra këndngushta.
Lul. IV – V; fryt. VIII – IX.
I kultivuar si dru zbukurues nëpër rrugë e parqe. Amerikane Veriore.



Acer monspessulanum L. – Krekëza
Aceraceae – Panjore



Acer obtusatum W. et K. - Panja
Aceraceae - Panjore



Acer pseudoplatanus L. – Panja e malit
Aceraceae – Panjore

Shkurre ose dru i vogël deri 12 m i lartë. Lëvorja e murrme.

Gjethet me bishta të gjatë sa llapa. Faqja e sipërme e shkëlqyeshme, e poshtmja e rimtë. Llapa e ndarë në 3 vriguj me nervura qendrore.

Lulet formojnë lulesën vastak. Kanë ngjyrë të blertë – të verdheme. Në fillim janë të përpjetëm, pastaj të varur. Fryti shojzë me flatra gati paralele, të kuqe.

IV – V.

Rritet në shkurrishta e çeltira pyjesh termofile.

Dru deri 10 – 15 m i lartë, me lëvore të përhime - vjollcë.

Gjethet me bisht më të shkurtër se llapa, deri 12 cm të gjatë dhe 6 – 11 cm të gjerë, të skuqur në vjeshtë, me bazë në trajtë zemre, 5 - vrigullore. Dy vrigujt e bazës mezi dallohen.

Lulet njëseksore të verdha në të blertë, në fillim të përpjetëm, pastaj të varur. Fryti shojzë me flatra. Akenët me qime.

Lul. IV – V; fryt. VIII – IX.

Rritet në pyje gjethegjera (dushkaja, gështenjishta etj.). Mjaltëse shumë e mirë.

Dru deri më 30 m, me degë të hapura. Lëvorja e përhime.

Gjethet nga poshtë jo të lëmuara, të blerta të rimta, vriguj 5, të mprehtë, të shkurtër dhe jo të barabartë të dhëmbëzuar dendur dhe trashë.

Lulet të shumta njëseksore, në melthe të ngushta të varura 10 – 20 cm të gjata, që dalin zakonisht bashkë me gjethet. Frytet shojza, gati të shogëta.

Lul. IV – V; fryt. VIII – IX.

Në pyje gjethegjera sidomos ahishte. Mjaltëse e mire.



Acer tataricum L. - Ulza
Aceraceae - Panjore

Shkurre deri më 6 – 8 m me degë të murrme në të kuqe.

Gjethet 6 – 10 cm, gjatore, majëmprehta, me buzë jo rregullisht 2 herë të sharruara, shpesh me dy vriguj anësor të vegjël në bazë.

Lulet njëseksore, në melthe bishtgjata, me ngjyrë të bardhë në të blertë. Fryti shojzë me flatra gati paralele, verës të kuqërreme, kurse më vonë marrin ngjyrë hiri.

V – VI.

Rritet në shkurrishta, ledhe arash etj. Mjaltëse e mirë.



Juglans regia L. – Arra
Juglandaceae – Arrore

Bimë drunore deri 25 m e lartë, me lëvore të hirtë – të gjelbër, më vonë të hirtë – të kuqërremtë dhe të çara për së gjati.

Gjethet janë pendore tek, me 5 – 9 gjethëza gati të shogëta, të gjera eliptike, të plota, me aromë karakteristike.

Bimë monoike. Lulet mashkull zhvillohen së bashku me gjethet, kanë 6 – 30 thekë. Kokrrat e polenit bien shumë lehtë nga lëvarëzat. Lulet femër zhvillohen në majë të degëve. Fryti është bërthokël. Pjesa mishnore e blertë ndahet lehtë nga bërthokla. Farat të pasura me vaj.

IV – V.

Në Kosovë kryesisht e kultivuar, aty – këtu edhe natyrore.



Chamaenerion angustifolium L. – Epiloba gjethengushtë
Onagraceae – Onagrore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 - 150 - 200 cm e lartë. Rizoma është e gjatë, zvarritëse me stolone mishnore të bardha nga të cilat zhvillohen kërcejt lulor të padegëzuar ose të degëzuar.

Gjethet gjatore ose heshtore - lineare, të gjata 4 - 20 cm, pa bisht ose me bisht të shkurtër.

Lulesa vile me shumë lule me brakte. Sepalet lineare - heshtore, të gjata gati sa petalet. Kurora e kuqe në të purpurt. Fryti kapsulë, 4 - 8 cm e gjatë, e kuqërremtë, me qime të dendura.

VI - VIII.

Rritet në ahishte, vende të prera të pyjeve, vende me lagështi etj.



Epilobium hirsutum L. – Epiloba qimeashpër
Onagraceae – Onagrore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rrënjë shumë hollake, me stolone nëntokësore. Kërcejtë deri 200 cm të lartë, të shëndoshë, zakonisht leshtorë.

Gjethet gjatore deri heshtore, gjysmë kërcell-pushtuese.

Lulet të mëdha me ngjyrë trëndafili të purpurt. Sepalet me thimth. Petalet majëngrëna. Kreza katërvrigujshe.

VI - VIII.

Rritet buzë lumenjëve e liqeneve, në kanale etj.



Epilobium montanum L. – Epiloba e maleve
Onagraceae – Onagrore


Bimë barishtore shumëvjeçare me rrënjë të trasha, të drunjëzuara, me kërcej të ngritur e të lartë 20 - 110 cm.

Gjethet të këmbyera, vizake, me qime të forta.

Lulet në lulesa të çlirëta. Petalet të plota ose pak majëngrëna, manushaqe ose të purpurta. Gonxhet e luleve lehtësisht të varura përpara lulëzimit.

VI - VIII.

Ndeshet në gjerdhe, vende me gurë, zallishte lumenjsh dhe shpate të thata.



Epilobium dodonaei Vill. – Epiloba e Dodonës
Onagraceae - Onagrore

Bimë me rrënjë shumë hollake, që nxjerr bitme (filiza të hollë) në vjeshtë. Kërcejtë 10 – 80 cm, me qime të forta e të rrasura.

Gjethet të përkundërta ose qerthullore, vezake deri vezake të ngushta, me dhëmbë të rrallë ose rrallë të plotë.

Lulet aktinomorfe. Petalet majëngrëna, të purpurta – të trëndafilta.

V – VIII.

Në pyje, vende me lagështi etj.



Dictamnus albus L. – Lule mastike
Rutaceae - Rutore



Haplophyllum boissieranum Vis. et Pan. –
Haplofili i Buasierit Rutaceae – Rutore



Haplophyllum coronatum Griseb. – Haplofili kurorëzuar
Rutaceae – Rutore

Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 100 cm e lartë, e merme. Kërcejtë të drunjëzuar në bazë, me qime gjëndërore të zeza.

Gjethet të këmbyera, tekpendore; gjethet e poshtme vezake të përmbysëta, të tjerat plotësisht të ndara në 7 – 9 gjethëza.

Lulet të mëdha, në vile skajore me brakte. Lulesa nxjerr esencë me erën e uzos. Petale 5, të shtrira, të bardha – trëndafili me pika të purpurta. Thekë 10, me fije 18 – 20 mm. Fryti kapsulë.

V – VI.

Rritet në vende barishtore, sidomos nëpër shkurrishta e kullota të zonave të ulëta. Ka përhapje të rrallë. Bimë e helmët dhe mjekësore.

Bimë shumëvjeçare me kërcej 6 – 25 cm, me push të përdredhur, pak a shumë leshtore në pjesën e lulesës.

Gjethet të thjeshta, heshtore deri heshtore të përmbysëta, të holluara poshtë.

Lulesa cimë pak a shumë e dendur. Nënpetlat vizake heshtore. Petlat të lugëta, të plota, të verdha me një vijë të gjelbër për së gjati. Fryti kapsulë.

V – VI.

Në vende të thata dhe gurishtore. Ilirike. Në Kosovë ndeshet në fshatin Goriq, Koznik etj. Bimë e helmët.

Endemike e Ballkanit.

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë 12 – 35 cm, me push të imët – të përdredhur, të bardhë – leshtorë në pjesën e lulesës.

Gjethet të ndryshme; gjethet e mesit të kërcejve ose gjethëzat qendrore 8 – 25 x 1-4 mm.

Lulesa e dendur. Sepalet vizake – heshtore. Kurora e verdhë. Kapsula pushlore në faqen e brendshme pranë majës, me 8 brirë majëthimthuar.

V – VI.

Nëpër kullota të thata. Ballkanike. Bimë e helmët.



Haplophyllum suaveolens (D. C.) G. Don –
Haplofili erëmirë Rutaceae – Rutore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 40 cm e lartë.

Gjethet në pjesën e poshtme të kërcellit me bisht, heshtore, të tjerat të pabisht.

Lulesa cimë e dendur. Kupa pesëpjesëshe. Sepalet vezake ose trekëndore – heshtore. Petalet qëndrojnë gjatë, të verdha. Thekë 10.

Vi – VII.

Në vende të thata shkëmbore.



Citrus limón (L.) Burm – Limoni
Rutaceae – Rutore

Dru i vogël, 2 – 5 m. Bisqet e reja me qoshe, pastaj të rrumbullakosura, të shogëta, me gjemba sqetullore të forta.

Gjethet eliptike të gjera, të mprehta, të sharrëzuara ose ura-ura, 5-10 cm.

Lulet të vetmuara ose në vile të shkurtra lulepakë, hermafrodite, ose mashkullore nga ana funksionale. Thekë 25-40, të lidhur në grupe. Petalet të bardha. Fryti vezakë, me lëkurë nganjëherë të ashpër ose gati të lëmuar, me ngjyrë të verdhë në frytin e pjekur.

Lul. III-IX, fryt. Gjatë gjithë vitit.

I kultivuar. Ka prejardhje nga Kina dhe India. Bimë mjekësore. Përmban vitaminë C.



Cotinus coggygria Scop. - Cërmëdelli
Anacardiaceae – Shqemore

Shkurre 3 – 5 m e lartë, e shogët, me erë rrëshire.

Gjethet të thjeshta, të plota, 3 – 8 cm të gjata, vezake ose vezake të përmbysëta, me majë të rrumbullakët, me bisht, me erë të këndshme.

Lulet të vogla në melthe skajore, të verdha, me shumë bishta shterpë, të pajisura me fije të gjata pupëlore. Frytet bërthokla të vogla, në trajtë veshke, të murrme në të kuqe kur piqen.

V – VI.

Rritet nëpër toka të veshura me shkurre apo rrëzë pyjesh kodrinore. Bimë regjëse dhe ngjyruese.



Pistacia terebinthus L. - Bafra
Anacardiaceae – Shqemore



Rhus coriaria L. – Shqeme
Anacardiaceae – Shqemore



Oxalis corniculata L. – Thartusha brinoke
Oxalidaceae – Oksalidore

Dru i vogël ose shkurre gjetherënëse deri 5 m e lartë. Lëvorja e murrme – e kuqërreme.

Gjethet tekpendore, me 3 – 9 gjethëza. Gjethëzat kanë trajtë vezake deri vezake të përmbysëta, me thumb, lëkurore.

Lulesa melth me degë të gjata. Lulet të gjelbra në gështenjë. Fryti bërthokël. Në filim të kuqe të errëta, kur piqen bëhen të zeza.

IV – VII.

Rritet nëpër shpate dhe shkëmbinj gëlqeror. Bimë regjëse.

Shkurre deri më 4 m, me lëng qumështor.

Gjethet rënëse tekpendore, me 7 – 21 gethëza. Gjethëzat vezake deri gjatore, buzëdhëmbëzuara, me qime sidomos në faqen e poshtme, që është më e zbehtë se ajo e sipërmja..

Lulesa rreth 10 cm, në melth vizake skajore. Lulet njëseksore ose poligame, të vogla. Frytet bërthokla të vogla, gati rruzullore, të murrme në të kuqe kur piqen.

Lul. IV – VIII; fryt. X – XI.

E kultivuar nëpër parqe e kopshte. Mesdhetare-jugore. Bimë regjëse dhe ngjyruese.

Barishtore shumëvjeçare, zvarritëse, pushlore, 5 – 15 cm e lartë. Kërcejtë të shtrirë, deri 30 cm, që rrënjëzojnë në nyjat, pa stole nëntokësore.

Gjethet me tri gjethëza, pak a shumë ngjyrë vjollcë; gjethëzat zemërpërmbysët, thellësisht majëngrëna.

Lulesa në trajtë ombrelle, me 1 – 7 lule. Sepalet heshtore. Petalet të verdha. Kapsula cilindrike, e kreshpët. Farat me 6 – 8 brinjë tërthore të murrme.

IV – IX.

Në toka të punuara, buzë rrugëve,



Oxalis acetosella L. – Tharbtusha
Oxalidaceae – Oksalidore



Linum flavum L. – Liri i verdhë
Linaceae - Linore



Linum hologynum Rchb. – Liri shtyllëzngjitur
Linaceae – Linore

Bimë barishtore shumëvjeçare me push të rrallë, 5 – 12 cm e lartë. Në pjesën mbitokësore ka një rizomë hollake të pajisur me luspa të tulta.

Gjethet me tri gjethëza si zemër në bishta të gjatë e të hollë. Janë të ndijshme prandaj mund të mblidhen. Në faqen e poshtme purpur – të kuqe.

Lulet të vetmuara, kambanore, mbi bishta të gjatë që dalin drejtpërdrejt nga rizomet. Sepalet gjatore – heshtore. Petalet të bardha, me dej lila deri vjollcë. Farat të murrme, të cilat kur piqen, lirohen nga kapsula në prekje.

IV – VI.

Në pyje dhe vende me hije.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 – 60 cm e lartë dhe me kërcej të ngritur e pak të degëzuar.

Gjethet me 3 (-5) nervura. Të poshtmet heshtore të përmbysët, të sipërmet heshtore të pabisht.

Lulesa në trajtë cime, e degëzuar dhe mund të jetë me 10 – 15 lule. Sepalet heshtore të thepëta. Petalet të verdha, me llapë vezake. Fryti kapsulë. Kapsula me sqep.

VI – VII.

Rritet kryesisht në toka të mbuluara me bar.

Bimë barishtore shumëvjeçare e shogët.

Gjethet 0.5 – 1.5 mm të gjera, vizake ose në trajtë filli, me një nervurë dhe me buzë të lëmuar ose nganjëherë të ashpër.

Lulesa në trajtë cime. Sepalet heshtore; pjesa e fundit e nervurës së mesit shumë e dalë dhe pak a shumë si karenë. Petalet 2.5 herë më të gjata se sepalet, të kaltra, vjollcë ose trëndafil – të purpurta. Shtyllëzat pothuaj të ngjitura deri në majë me 5 kreza.

VI – VII.

Në livadhe të zonave malore. Ballkanike.



Linum capitatum Kit. – Liri me krejca
Linaceae – Linore

Bimë barishtore shumëvjeçare e shogët. Kërcejtë lulor 10 – 40 cm, të fortë, të gjelbër, me flatra.

Gjethet e rozetës me nga 3 nervura, shytë, më të gjata e më mëdha se ato të kërcellit.

Lulesa shumë e dendur, me 5 – 10 (-15) lule. Petalet të verdha, me llapë vezake të përmbysët, shytë.

VI – VII.

Në shpate shkëmbore, livadhe të thata, shpate pyjore, deri në zonën alpine.

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, me kërcell 10 – 60 cm të lartë.

Gjethet të pabisht, të mesit të gjera, të sipërmet vizake – heshtore, me 1 – 3 nervura paralele.

Lulesa luleshumë, në trajtë cime. Petalet 3 – 4 herë më të gjata se sepalet, me ngjyrë qielli të kaltër. Një kohë jo të gjatë pas lulëzimit petalet delikate bijnë. Krezat të kokëta. Fryti kapsulë çahëse.

VI – VII.

Rritet në shpatije dhe vende tjera të thata e të gjelbëruara, pyje të ndritshme halore.



Linum hirsutum L. - Liri i kreshpët
Linaceae - Linore

Bimë barishtore shumëvjeçare deri 50 cm e lartë. Kërcejtë pushlor sipër, të fortë, të ngritur, luleshumë.

Gjethet e mesit gjatore, të përmbysëta të mprehta ose shyte, me 3 - 5 nervura.

Lulesa në trajtë cime. Sepalet vezake - heshtore. Petalet rreth 2 - 2,5 herë më të gjata se sepalet; ngjyrë vjollce kur janë të reja, të kaltra kur thahen.

V – VII.

Rritet në vende të mbuluara me bar dhe në vende të thata.



Linum perenne L. – Liri shumëvjeçar
Linaceae - Linore



Linum tauricum Willd. – Liri i Krimesë
Linaceae - Linore



Linum tenuifolium L. – Liri gjethengushtë
Linaceae – Linore



Erodium ciconium (L.) L'Her. – Gjilpërqyqja me sqep lejleku
Geraniaceae – Geraniore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërçep shumë të degëzuar, shpesh i drunjëzuar e me shumë kërcej rozeta, disa pa lule, disa lulembajtëse, deri 40 cm të lartë.

Gjethet e poshtme pallake të ngushta, zakonisht me tre nervura. Gjethet e sipërme kërcellore shpesh heshtore, me 1 (-3) nervura.

Lulesa në trajtë cime, e dendur, me 10 deri 20 lule. Sepalet ngushtësisht të thepëta. Petalet të verdha. Thekë 5 me fije të ngjitura në bazë. Fryti kapsulë çahëse.

V – VII.

Në vende gëlqerore e serpentinore të zonave malore. Gati ballkanike.

Bimë barishtore shumëvjeqare gati në formë shkurre me rrënjë të trasha boshtore. Kërcejtë 15 – 50 (- 100) cm të lartë, në pjesën e poshtme gati të drunjëzuar.

Gjethet të ngushta lineare, të ashpra, me një nervurë.

Lulet në lulesa me 12 ose më tepër lule në bishta të hollë e të shkurtër. Sepalet heshtore, kurse petalet të lira, 3 herë më të gjata se sepalet. Kanë ngjyrë trëndafili të çelët.

VI – VII.

Rritet në vende të thata me bar me natyrë serpentinore ose gëlqerore. Në Kosovë ka përhapje sporadike (Mushtisht etj.).

Bimë një ose dyvjeçare, me kërcell 10 – 70 cm, me qime të shkurtra.

Gjethet, të paktën afër bazës, me vriguj të ndërmjetëm; gjethëzat pendore të prera, me segmentet më të fundit dhëmbë – dhëmbë ose pendore të çara.

Ombrellat me (1-) 3 – 10 lule; braktetë vezake heshtore, dendësisht leshtake. Nënpetlat gjëndërore – leshtake, me halë si sqep. Petlat blu ose jargavan,me nervure më të errëta.

III – IX.

Në toka të thata, ranore, në vende me bar, me gur etj,



Erodium cicutarium (L.) L'Her – Gjilpërqyqja si kukutë
Geraniaceae - Geraniore



Geranium bohemicum L. – Kamarosha e Bohemisë
Geraniaceae – Geraniore



Geranium dissectum L. – Kamarosha gjetheprerë
Geraniaceae – Geraniore

Bimë njëvjeçare, me kërcell deri 100 cm, me qime të rralla ose të dendura.

Gjethet të përbëra pendore. Gjethëzat pendore të çara ose pendore të prera me mbulesë qimesh.

Lulesa ombrellë. Ombrella deri me 12 lule, me bisht deri 10 cm. Petalet zakonisht të purpurta – trëndafil, të kuqe deri të bardheme, dy të sipërmet më të mëdha. Fryti me ndërtim të posaçëm. Pas pjekjes së frytit sqepi nuk ndahet por shpërdridhet si spirale.

III – X.

Në toka të punuara ose të trazuara, toka ranore, zallishte, vende të thata me bar. Bimë mjekësore.

Bimë një ose dyvjeçare, me kërcell (10-) 20 – 60 cm, të ngritur përpjetë, të kreshpët ose me qime gjëndërore.

Gjethet 2 – 6 cm të gjera, me llapë të ndarë në 5 – 7 vriguj, pendore të carë pa rregull. Segmentet e vrigujve vezake – gjatore.

Lulet manushaqe – blu të ndritshme, me nervura më të errëta. Sepalet 9 – 12 mm, me hale.

V – VII.

Në pyje, sidomos me halorë , zakonisht të shfrytëzuar.

Bimë njëvjeçare, me kërcell 10 – 40 (-60) cm, të përpjetëm ose të ngritur, me qime të rralla.

Gjethet me llapë të ndarë deri në bazë në 5 – 7 vriguj të fqinjëzuar, thellësisht pendorë të çarë; gjethet më të sipërme të përkundërta, me bishta të qartë.

Bishtat e luleve (këmbëzat) dendësisht pushlore. Nënpetlat dendësisht pushlore. Petlat me ngjyrë të purpurt – trëndafil, më rrallë të bardha.

III – VI.

Në vende me bar, në toka djerrë ose të punuara, në gjerdhe etj.



Geranium lucidum L. – Kamarosha e ndritshme
Geraniaceae – Geraniore



Geranium macrorrhizum L. – Kamarosha rrënjëgjatë
Geraniaceae – Geraniore



Geranium phaeum L. – Kamarosha e zeshkët
Geraniaceae – Geraniore

Bimë njëvjeçare, e shkëlqyeshme. Kërcelli me ngjyrë si në të kuqe, i ngritur ose i përpjetëm (që vjen duke u lartësuar), l0 – 40 cm.

Gjethet 2 – 6 cm të gjera, të rrumbullakëta, me 5 vriguj të lëmuar, ura – ura ose me majë të çarë shkurtimisht trish.

Bishtat me nga dy lule. Sepalet vezake – heshtore, me nervura të dala mirë. Petalet të plota, trëndafili ose në të kuqe.

IV – VI.

Në vende me hije, shkëmbinj, mure e gjerdhe.

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë horizontal. Kërcelli i ngritur me push të imët, 20 – 50 cm i lartë.

Gjethet të merme me llapë të ndarë në 5 – 7 vriguj me nga 3 – 4 segmente në çdo anë, shyte, por me thumb të dallueshëm.

Lulesa në trajtë vastaku ose ombrelle me nga 4 – 9 lule të kërrusura. Baza e lulesës me dy brakte gati të pabisht. Sepalet të kuqërremta. Petalet me llapë vezake dhe të plotë, si purpur e errët në të kuqe.

VI – VIII.

Rritet në vende me hije, në pyje e shkëmbinj të zonave malore. Bimë ngjyruese, mjaltëse dhe mjekësore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë të shkurtër. Kërcelli 40 – 70 (-ll0) cm, i ngritur përpjetë me qime gjëndërore të hapura, të shkurtra e të gjata.

Gjethet 6 – l5 cm të gjera, me llapë pëllëmbore të ndarë në (5-) 7 vriguj të gjerë; të bazës me bisht të gjatë; kërcelloret me bisht të shkurtër.

Lulet të shumta. Sepalet me hale rreth l mm, dendësisht gjëndërore – pushpak, si dhe me qime të gjata jogjëndërore. Petalet vezake përmbysëse - rrotullare, të plota, zakonisht të hapura, më rrallë të spërveshura, të zeshkëta ose të murrme –purpur.

VI – VIII.

Rritet në vende me lagështi ose me hije, në pyje të çlirëta, vende me bar etj.



Geranium purpureum Vill. - Kamarosha e purpurt
Geraniaceae – Geraniore

Bimë një ose dyvjeçare, leshtake, shpesh bëhet e kuqe. Kërcelli l0 – 50 cm, zakonisht i përpjetëm.

Gjethet 3 – 8 cm të gjera, me llapë të ndarë shumë thellë, aq sa duket si e përbërë, në 3 (-5) ndarje kryesore dyfishpendore të prera, me segmente gjatore, me thimth ose me majucë.

Bishtat me nga dy lule. Nënpetlat të kreshpëta, vezake, me thimth ose me halë të shkurtër. Petlat me ngjyrë të purpurt – trëndafil ose të kuqe, rrallë të bardhë.

III – IX.

Në vende me hije, në pyje, vende shkëmbore etj.



Geranium pyrenaicum Burm. – Kamarosha e Pireneve
Geraniaceae – Geraniore

Bimë barishtore shumëvjeçare, kërcelli 25 – 70 cm, i ngritur, me push ose me qime kaqurrele.

Gjethet me llapë rotullare të ndarë në 5 – 7 vriguj të fqinjëzuar; secili vrigull me anë të plota e të drejta, si edhe me majë të gjerë ura – ura.

Bishtat zakonisht me nga dy lule, më të gjatë se gjethet. Sepalet me thimth të shkurtër. Petalet thellësisht majëngrëna, pra dyvrigujshe, në ngjyrë purpur deri jargavan ose si në blu.

V – VIII.

Rritet në lëndina, pyje të rralla, në vende me bar etj.



Geranium robertianum L. - Kamarosha e Robertit
Geraniaceae - Geraniore

Bimë barishtore një ose dyvjeçare, leshtake ose gjëndërore, shpesh bëhet e kuqe. Kërcelli 10 – 50 cm, zvarritës deri i përpjetëm.

Gjethet 3 – 8 cm të gjera, me llapë të ndarë shumë thellë në 3 (-5) ndarje kryesore dyfishpendore të prera, me segmente gjatore ose vizake, me thimth ose me majucë.

Bishtat me nga dy lule. Këmbëzat me qime të gjata të hapura gjëndërore dhe me qime të spërveshura jogjëndërore. Sepalet heshtore me halë. Petalet të plota, trëndafil të ndritshme, rrallë të bardha. Pjalmoret me ngjyrë portokalli.

V – IX.

Rritet në vende me hije, pyje, vende shkëmbore. Bimë mjekësore.



Geranium rotundifolium L. – Kamarosha gjetherrumbullakët
Geraniaceae – Geraniore



Geranium sanguineum L. – Kamarosha ngjyrë gjaku
Geraniaceae – Geraniore



Geranium subcaulescens L'her. – Kamarosha e hirtë
Geraniaceae – Geraniore

Bimë njëvjeçare, rrallë dyvjeçare, me kërcell 10 – 40 (-50) cm, të ngritur ose të përpjetëm, me qime të gjata e të shkurtra.

Gjethet e bazës të rrumbullakta, me llapë të ndarë në 5 – 7 (-9) vriguj të fqinjëzuar, pykorë, thellësisht ura – ura ose të ndarë në majë në segmente të shkurtra shytë; gjethet e sipërme të ndara më thellë dhe në më shumë segmente të mprehta.

Nënpetlat me thimth. Petlat të plota, trëndafil – jargavan , rrallë të bardha.

IV – VI.

Në gërmadha, buzë rrugësh, në toka të thata, në gjerdhe etj.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 40 (- 90) cm e lartë dhe e kreshpët. Kërcelli i degëzuar, i ngritur, me qime të gjata e të bardha.

Gjethet kryesisht kërcellore, me llapë pëllëmbore të ndarë në 5 – 7 vriguj. Secili vrigull me 1 – 3 segmente vizake gjatore.

Lulet zakonisht me bishta 7 – 15 cm të gjatë. Sepalet me hale të shkurtër. Petalet vezake, majëngrëna, të kuqërremta – purpur të ndritshme, rrallë trëndafili.

V – VIII.

Rritet në toka shkëmbore, pyje e livadhe ose vende me bar.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 8 – 20 cm e lartë.

Gjethet 2 – 3 cm të gjera, pushlore në të dyja faqet. Llapa e ndarë në vriguj. Çdo vrigull me tre segmente.

Bishtat kanë nga dy lule. Sepalet me hala. Petalet të kuqërremta në purpur, majëngrëna.

VI – VII.

Rritet në vende shkëmbore ose me bar të zonave malore.

Endemike e Ballkanit.



Geranium sylvaticum L. – Kamarosha e pyllit
Geraniaceae – Geraniore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të trashë. Kërcelli i ngritur dhe i mbuluar me qime, 20 – 60 (- 80) cm të lartë.

Gjethet kanë vendosje qerthullore dhe duke filluar prej bazës janë pëllëmbore të ndara në 5 – 7 pjesë romboike të mëdha dhe të dhëmbëzuara.

Lulet zakonisht janë të mëdha 13 – 18 mm, vjollce – të kuqe ose vjollce – blu të ndritshme. Fletëzat e kupës janë vezake me hala të shkurtëra.

VI – VIII.

Rritet në pyje, kullota, shkurre të zonës malore dhe subalpine.

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë të shkurtër dhe të trashë; kërcelli me qime gjëndërore të gjata, 40 – 70 cm i lartë.

Gjethet me llapë pëllëmbore të ndarë në 5 – 17 vriguj.

Lulet në lulesa pak a shumë të çlirët. Sepalet me thimth dhe plotë me qime. Petalet të bardha të trëndafilta, në kohën e lulëzimit të spërveshura.

VI – VIII.

Në livadhe, çeltira pyjesh dhe shkurrnaja të zonës subalpine dhe alpine. Ballkanike (Shqipëri, Greqi, Bullgari, Maqedoni). E ndeshim në Alpet Shqiptare dhe në Koritnik.



Geranium aristatum Freyn Sint.– Kamarosha me halë
Geraniaceae – Geraniore

Bimë barishtore njëvjeçare, pa qime, 30 – 70 cm e lartë. Kërcejtë të thjeshtë ose të degëzuar.

Gjethet vezake – eliptike ose gjatore me buzë të sharruara deri ura-ura.

Lulet në vile sqetullore, të verdha dhe shumë zigomorfe. Sepale 3, të lira, të gjelbra. Sepalja e poshtme e madhe e cila ngushtohet gradualisht në një shpor. Petale 5, e sipërmja më e madhe se të tjerat. Thekë 5 me antere të bashkura. Fryti kapsulë.

VI – VIII.

Rritet në ahishte me lagështirë. Në Kosovë ka përhapje sporadike



Impatiens noli - tangere L. – Lule mos më prek
Balsaminaceae – Balsaminore

Bimë barishtore njëvjeçare, mbi 2 m e lartë. Kërcelli në pjesën e sipërme i degëzuar.

Gjethet vezake – eliptike me buzë të sharruara, 6 – 25 cm të gjata dhe 18 – 65 mm të gjera. Bishti i gjethes me gjëndra, 3 – 4 cm i gjatë.

Lulet në vile sqetullore; lulëzojnë pothuajse përnjëherë. Janë të purpurta – të kuqe ose rozë ose të bardha.

VI – X.

Bimë zbukurimi me origjinë nga India. Në Europë i sjellur në shekullin e XIX.



Impatiens glandulifera Royle – Impatiensi gjëndërmbajtës
Balsaminaceae – Balsaminore

Bimë njëvjeçare, me këcell shtrirës mbi sipërfaqen e tokës, pushlore, 10 – 60 cm. Kërcejtë të thjeshtë ose të degëzuar.

Gjethet çiftpendore,shpesh të pabarabarta, me 5 – 8 çifte gjethëzash eliptike ose gja – tore – heshtore.

Lulet hermafrodite, aktinomorfe, 5-pjesëshe. Nënpetla 5, rënëse; petla 5, që bien shpejt, të verdha. Fryti me 2 ose më shumë gjemba të shëndoshë anash.

V – VIII.

Në vende ranishtore e gurishtore dhe si bimë e keqe në kulturat prashitëse. Kozmopolite.



Tribulus terrestris L. – Tribula tokësore
Zygophyllaceae – Zigofilore



Polygala doerfleri Hayek – Poligala e Dorflerit
Polygalaceae - Poligalore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e ngritur, me kërçep të drunjëzuar, me kërcej të shumtë, të padegëzuar, deri 40 cm të lartë.

Gjethet vizake – heshtore, të këmbyera, të shogëta.

Lulet në vile skajore, hermafrodite, me ngjyrë trëndafili. Sepale 5, të pabarabarta, të lira; dy të brendshmet shumë më të mëdha se 3 të jashtmet. Petale 3, të bashkuara në një gyp në pjesën e poshtme dhe të lira në pjesën e sipërme. Thek 8, me fille të bashkuara. Fryti kapsulë.

VI – VII.

Rritet në vende shkëmbore dhe me bar me natyrë serpentinore. Bimë endemike e Kosovës dhe Shqipërisë. Në Kosovë është e përhapur në Labjan, Koznik, Mushtisht, Devë, Mrasor, etj.



Polygala comosa Schkuhr. – Poligala me xhufkë
Polygalaceae - Poligalore

Bimë barishtore shumëvjeçare e ngritur ose e përpjetme. Kërcejtë 7 – 20 (-40) cm.

Gjethet e poshtme si mistri, që bien zakonisht përpara lulëzimit; të sipërmet vizake deri vizake-heshtore të mprehta.

Vilet skajore me 15 – 50 lule konike deri cilindrike të dendura. Lulet zakonisht lila-të trëndafilta.

V – VIII.

Në livadhe dhe kullota të thata dhe pyje.

Shumëvjeçare gati e ngritur ose e përpjetme, me kërçep të drunjëzuar. Kërcejtë 5 – 50 cm të lartë.

Gjethet të shogëta ose pushpakë. Bazalet vezake përmbysët – të ngushta. Kërcelloret heshtore deri vizake me thimth.

Vilet skajore me (10 -) 15 – 20 lule. Lulet të kuqërreme – purpur, rrallë të bardha. Fryti kapsulë.

V – VII.

Rritet në livadhe të thata të zonave malore.



Polygala major Jasq. – Poligala e madhe
Polygalaceae – Poligalore



Polygala monspeliaca L. – Poligala e Monpeliesë
Polygalaceae – Poligalore

Njëvjeçare e ngritur. Kërcejtë 10 – 40 cm, të shumtë, pushpakë.

Gjethet e bazës pallake, ato kërcellore heshtore deri vizake – heshtore.

Lulet në vile. Flatrat (nënpetlat) eliptike, të ngushta, gjelbëroshe të bardha, me 3 nervura kryesore dhe shumë anësore. Kurora e bardheme, shumë më e shkurtër se flatrat. Fryti kapsulë. Kapsula pa bisht, vezakepërmbysët, e gjatë sa flatrat.

IV – VI.

Në vende shkëmbore dhe çeltira pyjesh.



Frangula alnus Miller – Tulkuqi
Rhamnaceae - Pjerzore



Paliurus spina – christi Miller – Driza
Ramnaceae - Pjerzore



Rhamnus alpinus L. subsp. fallax Boiss. – Arrçi, Shurrë pele
Rhamnaceae – Pjerzore

Shkurre ose dru i vogël deri 6 m i lartë. Degët njëvjeçare të kuqërreme, pushlore.

Gjethet me bisht të kuqërremtë, llapa e plotë, eliptike, me 8 – 10 çifte dellëzimesh anësore.

Lulet 5 – pjesëshe dhe hermafrodite, të vetmuara ose në tufëza të përbëra nga 2 – 10 lule që formojnë cima ombrellore. Petalet të bardha të gjelbëreme. Frytet gati rruzullore, në fillim të gjelbëreme, pastaj të kuqe dhe në fund të zeza.

IV – VI.

Rritet në pyje gjethegjera që mbajnë lagështirë.

Shkurre 1 – 4 m e lartë, gati e shogët. Degët kur janë të reja pushlore, me gjemba të dendur. Lëvorja e murrme – e kuqërreme.

Gjethet të këmbyera, rënëse, të lëkurtë, të shogët dhe majëshytë. Ndajgjethëzat të shndërruara në gjemba.

Lulet 5-pjesëshe në vastak të përbërë. Petalet të verdha. Fryti i thatë i rrethuar nga një flatër e gjerë përqark në formë rrethi.

V – VII.

Në shpate e vende të thata, shkorrete.

Shkurre e ngritur deri më 4 m. Degët me lëvore të përhime, pa gjemba në majë. Degët e reja të shogëta.

Gjethet shpesh heshtore të përmbysëta; ato të bisqeve deri më 13 cm, të thepëta, të gjelbra në të dyja faqet, me 7 – 20 palë dellëzime anësore.

Lulet shpesh pak a shumë hermafrodite, të gjelbra në të verdheme, 2 – 3 së bashku. Frytet bërthokla të zeza, gati rruzullore.

Lul. V – VI; fryt. VII – IX.

Në vende me lagështi e buzë ujërash. Ballkanike dhe Ilirike.



Rhamnus pumila Turra – Arrçi kënec
Rhamnaceae – Pjerzore

Shkurrëz zakonisht dioike, 5 – 20 cm. Degët drunore me lëvore të hirtë, të përkulura, zvarritëse mbi shkëmbinjtë.

Gjethet vezake të përmbysëta ose gati të rrumbullakët, shumë të ndryshme nga forma dhe madhësia, buzëdhëmbëzuara, rënëse.

Lulet të verdha-të gjelbëreme, me dhëmbë të mprehtë. Frytet bërthokla të zeza.

Lul. V – VI; fryt. VIII – IX.

Nëpër shkëmbinj të zonave alpine. Europiane Jugore.



Hedera helix. L. – Urthi
Araliaceae – Araliore

Shkurre 20 -30 m, me kërcej që varën në degët e bimëve bujtare ose që zvarritet në tokë me shumë rrënjë ajrore.

Gjethet të këmbyera, të qëndrueshme, të trasha si lëkurë. Ato të degëve pa lule zakonisht me 3 - 5 vriguj, kurse të degëve me lule eliptike ose vizake dhe të plota.

Lulet janë dygjinish. Sepalet shumë të vogla, të shtrira pastaj të kthyera poshtë. Fryti rrushk. Kur piqet merr ngjyrë të zezë.

Lul. IX – X; fryt. II – IV.

I shpeshtë mbi drurë pyjor, mbi mure etj. Bimë mjekësore dhe mjaltëse.



Angelica archangelica L. – Angjelika
Apiaceae – Ombrellore

Bimë dy ose shumëvjeçare e fuqishme, aromatike. Rizoma është e fuqishme, e shkurtër me shumë rrënjë adventive. Kërcelli cilindrik, i degëzuar, i shogët, me ngjyrë të kuqërremtë, 50 - 300 cm i lartë.

Gjethet shumë të mëdha me bishta të gjatë, tre herë pendore, në pjesën e sipërme të kërcellit me këllëf të fryrë.

Ombrellat lulore 8 - 15 cm në diametër, në bishta të gjatë me shumë lule. Petalet të bardha.

VI - VII.

Rritet pranë lumenjve dhe burimeve, në toka me lagështi. Në Kosovë është konstatuar rrëzë maleve të Mushtishtit.



Astrantia major L. - Astranta e madhe
Apiaceae - Ombrellore

Bimë shumëvjeçare deri 100 cm, me rizomë të trashë. Kërcejtë zakonisht të padegëzuar, përveçse në pjesën e sipërme.

Gjethet e bazës me bisht 10 – 20 cm, pëllëmbore e ndarë zakonisht në 3 - 5 segmente heshtore deri gjatore, të sharruara ose dhëmbë-dhëmbë, segmenti i mesit i lirë.

Lulesa ombrellë e thjeshtë, me diametër 2 – 3 cm. Braktezat vizake - gati pallake, të bardha – të trëndafilta, të gjata sa ombrella. Kupa me dhëmbë. Petalet të bardha – të trëndafilta.

VI – VIII.

Rritet në zona pyjore me hije. Bimë mjekësore.



Bupleurum rotundifolium L .- Brikau me gjethe të rrumbullakëta Apiaceae - Ombrellore

Bimë njëvjeçare, 15 – 75 cm, e rimtë, shpesh me nuancë të purpurt. Kërcelli i ngritur përpjetë, i degëzuar nga lartë.

Gjethet eliptike - vezake deri gati rrotullare, shytë, shpesh me thumb, kërcell-pështjellëse.

Ombrellat me (3 -) 5 – 10 rreze, shpesh disi të trashura në bazë dhe në majë. Braktetë mungojnë. Brakteza 5 – 6, heshtore të përmbysëta, të verdheme – të gjelbra, të hapura në lulëzim; nervurat të dallueshme.

V – VI.

Rritet në toka të punuara. Shpesh si bar i keq i kulturave bujqësore. Bimë e helmët.



Bupleurum veronense Turra – Brikau i fortë
Apiaceae – Ombrellore



Conium maculatum L. - Kukuta e njollosur
Apiaceae - Ombrellore



Daucus carota L. – Karota e egër
Apiaceae – Ombrellore

Bimë njëvjeçare, 30 - 75 cm, e gjelbër e çelët, zakonisht shumë e degëzuar. Kërcelli i ngritur përpjetë, rrëvaga – rrëvaga.

Gjethet e poshtme disi me bishtak të dallueshëm, të tjerat të pabisht, të gjitha vizake - heshtore deri heshtore, me 3 – 5 nervura.

Ombrellat me 5 – 8 (-10) rreze të dendura. Braktetë të verdheme, vizake – heshtore deri heshtore. Braktezat heshtore deri vezake, paksa të lugëta, zakonisht me halë të gjatë.

VI – VIII.

Në vende të thata me bar, kullota, shkorrete etj., të zonave mesdhetare. Gati ballkanike.

Bimë dy - shumëvjeçare, 50 – 250 cm, gati e shogët, me erë të rëndë. Kërcelli i ngritur përpjetë, cilindrik, fyl, shumë i degëzuar, zakonisht me njolla të kuqërremta - të murrme në pjesën e poshtme.

Gjethet e poshtme me konture trikëndore, dy deri katërherëpendore; segmentet gjatore- heshtore deri në formë dalte.

Ombrellat me (6-) 10 - 20 rreze të pabarabarta. Brakte 5 - 6, trekëndore të ngushta deri vezake - heshtore. Sepalet mungojnë. Petalet të bardha . Fryti gati rruzullor.

VI – VIII.

Rritet në gjerdhe, buzë kanalesh, në kopshte etj. Bimë e helmët.

Bimë barishtore një ose dyvjeçare. Rrënjët kanë trajtë boshtore.

Kërcelli arrinë gjatësinë 50 - 80 cm ose më shumë, me brinjë, me qime gjembore, rrallë i shogët.

Gjethet dy - trefishpendore, me segmente nga vizake deri vezake - heshtore.

Lulesa ombrellë. Lulet të bardha. Në mes të lulesës është një lule e purpurt në të zezë. Fryti ka formë elipse ose vezake.

VI - IX.

Rritet në vende të thata. Bimë e keqe e kulturave agrare.



Aegopodium podagraria L. – Bar shtergjia
Apiaceae – Ombrellore



Anthriscus sylvestris (L.) Hoffm. – Stërpujë pyjesh
Apiaceae – Ombrellore



Bupleurum karglii Vis. – Brikau i Karglit
Apiaceae – Ombrellore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, me rizomë të gjatë, hollake. Kërcejtë deri 100 cm, të shëndoshë, fyl, pak të degëzuar.

Gjethet e bazës me kontur deltoid, një – dyfishtrishe, me segmente heshtore deri vezake, të sharruara, nganjëherë me 3 vriguj; bishtaku më i gjatë se llapa; gjethet kërcellore më të vogla, me një bishtak të shkurtër të fryrë; të sipërmet zakonisht të plota.

Ombrellat me 10 – 20 rreze. Petalet të bardha, nganjëherë të trëndafilta.

V – VIII.

Më shpesh buzë kanalesh e gjerdhe, në pyje dhe kullota me lagështi. Euroaziatike.

Bimë barishtore dy ose shumëvjeçare, 60 – 150 cm. Rrënja me unaza tërthore. Kërcelli i ngritur përpjetë, i degëzuar, fyl.

Gjethet 15 – 30 cm, me llapë me konturë trekëndor – të thepët, dyfishpendore të prera me segmentet e rendit të tretë heshtore të ndara thellë.

Ombrellat zakonisht me 8 rreze, më rrallë deri 15. Petalet të bardha, majëngrëna. Fryti i lëmuar, i shogët ose me qime rreth bazës.

IV – VIII.

Në kopshte, vende të braktisura, pyje, livadhe malore. Bimë e helmët.

Bimë barishtore njëvjeçare ose rrallë dyvjeçare deri 50 cm.

Gjethet e poshtme heshtore; të sipërmet vizake – heshtore deri vizake, të mprehta, me 5 – 7 nervura.

Ombrellat me 2 – 5 rreze. Braktezat vezake gati shytë, me thumb, gjelbroshe – të verdha, zakonisht më të mëdha se braktetë, që përmbyllin disi ombrellëzën.

VI – VIII.

Në vende shkëmbore, në kullota etj., të zonave malore. Ballkanike.



Bupleurum praealtum L. – Brikau shumë i lartë
Apiaceae – Ombrellore

Bimë njëvjeçare, deri 150 cm, me kërcell të ngritur përpjetë, të shogët, rrëvaga-rrëvaga, me degëzim dikotomik.

Gjethet vizake, të thepëta; kërcelloret me bazë të zgjeruar kërcellpështjellëse; nervura e mesit shumë më e trashë se të tjerat.

Ombrellat me 2 – 3 (-5) rreze. Braktetë zakonisht shumë më të shkurtra se rrezet, vizake – heshtore, me majë të mprehtë.

V – IX.

Në pyje të degraduara ose të prera, bokërima etj. Europiane – Jugore.



Foeniculum vulgare Mill. – Maraja e rëndomtë
Apiaceae – Ombrellore

Bimë shumëvjeçare, e shogët, e rimtë, e merme. Rizoma horizontale, nejçe dhe me unaza, e bardheme. Kërcelli rrëvaga-rrëvaga, i shkëlqyeshëm, i degëzuar, 40 – 200 cm i lartë

Gjethet e bazës tre-katërfishpendore, të prera, të ndara plotësisht në segmente në trajtë filli; kërcelloret tre-katërfishpendore të prera, me këllëf më të gjatë se llapa.

Ombrellat me 4 – 30 rreze. Sepalet mungojnë. Petalet të verdha. Fryti ovoid – gjator.

VI – VIII.

Në toka të thata të papunuara, buzë kanalesh, rrugësh si dhe e kultivuar. Bimë mjaltëse, aromatike dhe mjekësore.



Huetia cynapioides (Cuss.) P.W.Ball. – Qinapi si kulturë
Apiaceae – Ombrellore

Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 40 (-70) cm, zvarritëse ose e ngritur përpjetë, me kërçep (kërcell nëntokësor) zhardhokor-gati rruzullor.

Gjethet trefishpendore të prera, me vriguj vizakë ose vizakë-heshtorë, të mprehtë, jo më të gjatë se 1.5 mm.

Ombrella me 3 – 15 rreze. Këmbëzat me ose pa dhëmbë të shkurtër në majë. Brakteza 3 – 6, vizake ose heshtore, të shogëta. Sepalet mungojnë. Petalet të bardha, vezake të përmbysëta, me majë të spërveshur nga branda. Fryti 3-6 mm, vizak-gjator.

VI – VII.

Në pyje të zonave malore.



Heracleum sphondylium subsp. pollinianum Bertol. – Heraklea rrotullë
Apiaceae – Ombrellore



Oenanthe fistulosa L. – Luledhri fyle
Apiaceae – Ombrellore



Seseli varium Trev. – Seseli ndryshues
Apiaceae – Ombrellore

Bimë barishtore shumëvjeçar. Kërcelli i drejtë, pushlor ose kreshtak poshtë.

Gjethet me 5 – 7 vriguj parësor zakonisht të mprehtë ose të thepët, me push të butë, të grathët ose dendësisht me push të bardhë përposh. Vrigujt trekëndor.

Ombrellat me 12 – 45 rreze. Petalet të bardha; të jashtmet rrezake.

V – VIII.

Në kullota malore subalpine,pyje halor etj.

Bimë shumëvjeçare deri 80 cm, me rrënjë pjesërisht zhardhokore dhe pjesërisht jo të fryra. Kërcelli i ngritur përpjetë, rrvaga-rrvaga, fyl, i degëzuar në pjesën e sipërme.

Gjethet e bazës dy-trefishpendore të prera, me segmente të vogla vizake; kërcelloret pendore të prera, me vriguj vezakë. Bishtakët fyl; të sipërmit më të gjatë se llapa.

Ombrellat skajore, me bisht më të gjatë se rrezet. Rreze 2 – 4. Petalet të bardha-të trëndafilta; të jashtmet më të mëdha.

V – VII.

Në vende dhe livadhe me lagështi, në ujëra të cekëta, gropa me ujë, këneta etj.

Bimë barishtore dyvjeçare. Rizoma boshtore, e degëzuar, në pjesën e sipërme me disa penjëza. Kërcelli i drejtë, 30 – 120 cm, cilindrik, i hullizuar. Prej baze i degëzuar, në pjesën e sipërme pa gjethe.

Gjethet të shogëta; të poshtme me bisht të lugët, 2 – 3 fishpendore të prera; të mesme dhe të sipërme pa bisht, kërcellpushtuese.

Lulesa ombrellë me 15 – 25 rreze. Petalet të vogla, të rrumbullakët, të bardha. Fryti i zgjatur – elipsoid, me brinjë të dalluar mirë.

VII – VIII.

Në livadhe dhe kullota të thata. E përhapur në Europën Jugore, Kaukazë dhe Afrikë Veriore.



Laserpitium siler L. – Lazërpica siler
Apiaceae – Ombrelore

Bimë shumëvjeçare, 30 – 100 (-180) cm, gati e shogët, me kërçep të mbuluar me pejza të shumta, të murrme. Kërcelli i thjeshtë ose i degëzuar nga lart.

Gjethet e poshtme deri 100 cm, dy – katërfishpendore, me kontur trekëndor; segmentet vizake – heshtore, disi të rimta dhe lëkurore, nganjëherë paksa gjirake; nervura kryesore e dalë, e bardheme.

Ombrellat me 20 – 50 rreze. Petlat të bardha. Fryti gjator, 6 – 12 mm.

V – VIII.

Në kullota të thata në shpate shkëmbore të zonave malore.



Orlaya grandiflora (L.) Hoffm. – Orlaja lulemadhe
Apiaceae – Ombrellore

Bimë njëvjeçare, zakonisht 20 – 70 cm. Kërcelli i ngritur përpjetë, i lëmuar, cepatar.

Gjethet e bazës 5 – 15 cm, tre – katërfishpendore të prera; kërcelloret të reduktuara në këllëfë, disi të plota dhe pendore të prera.

Ombrella me 5 – 12 rreze. Petlat të bardha, të jashtmet deri 8 herë më të gjata se të tjerat. Frytet vezake – gjatore.

V – VIII.

Në vende barishtore



Eryngium campestre L. – Gjembardhi i fushës
Apiaceae – Ombrellore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e ngritur përpjetë, me gjemba, 15 - 70 cm. Kërcelli drunor në bazë, i degëzuar në trajtë vastaku në pjesën e sipërme.

Gjethet e bazës zakonisht të qëndrueshme, lëkurore, me 5 - 6 palë segmente; gjethet kërcellore kërcellpështjellëse, më të vogla.

Lulesa në trajtë vastaku, gjelbëroshe e çelët, e përbërë nga shumë kaptinëza ovoide. Sepalet vezake - heshtore, me halë.

VII - IX.

Rritet në vende ose kullota të thata, në kodra e buzë rrugësh. Bimë mjaltëse dhe mjekësore.



Chaerophyllum coloratum L. – Stërpuja e ngjyrosur
Apiaceae – Ombrellore

Bimë zakonisht njëvjeçare, e fuqishme, 30 -130 cm, e grathët me qime të shkurtra. Kërcelli fyl, i degëzuar, tepër i ashpër nga qimet kreshtake të spërveshura.

Gjethet pendore; ato të bazës me segmente vezake ose gati të rrumbullakëta; kërcelloret vezake – heshtore deri vizake – heshtore, dhëmbë – dhëmbë, pykore në bazë, nganjëherë të reduktuara në një segment skajor heshtor ose vizak.

Ombrellat me 5 – 10 rreze, mbi bishta të gjatë. Braktetë me brakteza të shumta, në trajtë filli. Lulet e jashtme me 2 -3 petla më të mëdha se të tjerat dhe me 2 vriguj të pabarabartë. Petlat të bardheme ose si të purpurta.

V – VII.

Në kullota, toka të punuara e të thata, në gjerdhe etj.



Tordylium maximum L. – Tordila e madhe
Apiaceae - Ombrellore

Bimë njëvjeçare, me kërcej deri 100 cm, me qime të gjata të hapura, por të grathët në pjesën e poshtme.

Gjethet trefishpendore, me segmente 0.5 – 1.5 mm të gjera, vizake.

Ombrella me 6 – 20 rreze. Braktetë mungojnë ose rrallë vetëm një. Braktezat heshtore ose vezake – heshtore, vemesore, shumë të dallueshme në frytëzim. Petlat të verdha. Fryti 4 – 25 mm, gjator.

V – VI.

Në vende me gurë, shkëmbore, në toka të punuara të zonave mesdhetare. Bimë endemike e Ballkanit.



Heracleum sphondylium L. - Heraklea rrotulle Apiaceae - Ombrellore

Bimë barishtore shumëvjeçare ose dyvjeçare, me rizomë të trashë. Kërcelli i ngritur përpjetë,

150 – 180 cm, zakonisht me qime, sidomos poshtë.

Gjethet të thjeshta, pendore ose trishe, leshtore, të grathëta, deri me push të bardhë përposh. Bishti i fryrë dhe këllëfës në bazë.

Ombrellat me 12 - 45 rreze. Petalet të bardha, gjelbëroshe rrallë të trëndafilta.

VI – IX.

Rritet në kullota, buzë gjerdheve e nëpër gërmadha të zonës së ulët. Bimë e helmët dhe mjekësore.



Ligusticum mutellina (L.) Grantz. - Vratiku mutelinë
Apiaceae - Ombrellore

Bimë barishtore shumëvjeçare, zakonisht 10 – 50 cm, gati e shogët. Kërçepi me pejza të shumta e të trasha. Kërcelli i ngritur përpjetë, fyl, zakonisht me 1 – 2 degë.

Gjethet me kontur trekëndor, 5 – 10 cm, dy-trefishpendore të prera, me segmente vizake – heshtore, me thumb.

Ombrellat skajore me 7 – 10 (-15) rreze, përgjithësisht të shoqëruara nga 1 - 2 ombrella anësore më të vogla. Petalet të kuqe, të purpurta ose të trëndafilta.

VI – VIII.

Në kullota të zonave të larta malore.



Pimpinella serbica (Vis.) – Pimpinela e Serbisë
Apiaceae – Ombrellore

Bimë barishtore shumëvjeçare, rreth 50 cm, e shogët,me kërcell të degëzuar në pjesën e sipërme.

Gjethet e poshtme si zemër, të sharruara, me bishtak të gjatë; të tjerët vijuese thellësisht të vrigullta; të sipërmet pëllëmbore të ndara deri në bazë në segmente të shumta kreshtake.

Ombrellat me 10 – 15 rreze. Brakte 5 – 8, vizake, të ashpra. Petlat të trëndafilta.

V – VII.

Në livadhe malore. Ballkanike.



Sanicula europaea L. – Sanikëla e Europës
Apiaceae - Ombrellore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 – 60 cm, e shogët me kërcell nëntokësor drunor, që prodhon një rozetë gjethesh dhe një shtije të thjeshtë të ngritur përpjetë.

Gjethet e bazës me llapë pëllëmbore të ndarë zakonisht në 3 – 5 segmente vezake, me 3 vriguj të trashë dhe dhëmbë që mbarojnë me halë të shkurtër.

Lulesa e përbërë nga një numër ombrellash, të vendosura në trajtë cime duke formuar shpesh një ombrellë të vetme të përbërë të rremë, me 3 rreze. Nënpetlat të dallueshme. Petlat të bardha ose të trëndafilta.

VI - VIII.

Në zona pyjore me hije. Bimë mjekësore.



Seseli rigidum Waldst et Kit – Seseli i paepshëm
Apiaceae – Ombrellore

Bimë barishtore dyvjeçare, 50 - 150 cm e lartë. Kërcelli cepatar me degët e sipërme të këmbyera.

Gjethet e bazës një – dyfishtrishe; segmentet vezake, dhëmbë – dhëmbë ose disi të vri-

gullta; gjethet e sipërme vezake – si zemër, kërcell-pushtuese, ura – hra të sharruara, rrallë gati të plota.

Lulesa ombrellë e përbërë. Lulet të vogla, të verdha, të zhvilluara në majë të rrezeve të pabarabarta. Fryti i thatë, si i murrmë - i zi.

IV - VI.

Rritet kryesisht në zona pyjore.



Smyrnium perfoliatum L. – Smirna gjethepushtuese
Apiaceae – Ombrellore

Bimë shumëvjeçare, deri 100 cm e lartë, pushpak, të paktën në pjesën skajore.

Gjethet dy - tre (- katër) fishpendore, me segmente vizake, shumë të thepëta dhe të paepshme.

Lulesa ombrellë. Ombrellat me 10 - 30 rreze. Petalet të bardha ose të purpurta – të trëndafilta.

VIII - IX.

Rritet në shkëmbinj të thepisur gëlqeror.



Trinia glauca (L.) Dumort – Netërza e rimtë
Apiaceae – Ombrellore


Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 50 cm, e shogët, e rimtë, me kërçep plotë me pejza gjethesh të thata. Kërcelli cepatar, i epshëm, shumë i degëzuar. Degët e poshtme shpesh gati sa kërcelli kryesor.

Gjethet e bazës dy - trefishpendore të prera, me segmente vizake pak të trashura; kërcelloret të prera trish.

Lulesa ombrellë. Petalet të bardha ose të bardha në trëndafil. Fryti ovoid.

V - VII.

Në kullota, vende shkëmbore të zonave malore.



Tamarix tetrandra Pallas ex Bieb. – Marina me katër thekë Tamariaceae - Marinore

Shkurre ose dru i vogël deri 4 m, me lëvore të zezë.

Gjethet të mprehta, me buzë cipëthatë, të pabisht.

Lulet në vile kallingjashme, të bardha. Braktetë gjatore, shytë, barishtore, vetëm në krye cipëthata. Sepalet të plota. Petalet vezake deri vezake - eliptike, rënëse pas lulëzimit.

IV - VI.

Në vende me lagështi, kryesisht në male. Ballkanike.



Reseda lutea L.- Shukulli i verdhë
Resedaceae- Shukullore

Bimë dyvjeçare. Kërcelli me kënde, 50 - 100 cm i lartë.

Gjethet gjatore - heshtore dhe janë të plota. Gjethet bazale të valëzuara dhe në rozetë.

Lulet formojnë vile të gjata dhe të dendura. Sepalet dhe petalet me nga 4 dhe janë të verdhëme.

IV - VI.

Rritet në vende me gurë, shkëmbinj deri në zonat malore. Bimë ngjyruese dhe mjekësore.



Reseda luteola L. - Shukulli i verdhemë
Resedaceae - Shukullore

Bimë barishtore një deri shumëvjeçare, pushpakë. Kërcejtë të vetmuar ose tuforë, të përpjetëm, me puprriza të ashpra në këndet, 20 – 60 cm e lartë.

Gjethet të ashpra dhe kërcore anëve, të plota, në shumicën e rasteve të çara tresh me segmente të zgjatura.

Lulet të verdha të blertërreme, në vile që zgjaten më vonë. Nënpetla 6, vizake. Petla 6; të sipërmet të çara tresh me rripëza anësore më të mëdha në formë gjysmëhëne.

V – VII.

Në djerrina e toka të punuara.



Lythrum salicaria L. - Bargjaku
Lythraceae - Litrore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 40 - 120 cm e lartë, me rizomë të trashë. Kërcelli i ngritur, katër cepatar, pak i degëzuar.

Gjethet kryesisht të përkundërta os në qerthuj nga 3. Kanë formë vezake deri heshtore gjatore, gjysmëkërcellpështjellëse në bazë.

Lulet gati të pabisht në cima qerthullngjashme duke formuar një kalli skajor. Kupa e purpurt. Kurora 6 pjesëshe ngjyrë trëndafili. Thekë 12. Fryti kapsulë.

VI - IX.

Rritet buzë hendeqeve, vijave të ujit si dhe në mjedise të njelmëta e të lagëta.



Punica granatum L. – Shega
Punicaceae – Shegore

Shkurre ose dru 2 – 4 m. Degët me 4 qoshëza dhe shpeshherë me gjemba në majë.

Gjethet të rënshme, gjatore ose heshtore, të shogëta, buzëplota, të përkundërta, lëkurore, majërrumbullakuara.

Lulet hermafrodite, njëshe ose 2 – 5 së bashku, sqetullore, pothuaj të pabisht. Kupa lëkurore, e qëndrueshme, e kuqërremtë Petalet të kuqe. Fryti rrushk, me ekzokarp lëkuror, me shumë fara të mbështjella prej një tuli të lëngshëm xhelatinor të athët ose të ëmbël.

Lul. V – VII; fr. IX – X.

Në Kosovë e kultivuar edhe si dru zbukurues.



Oenothera biennis L. – Enotera dyvjeçare
Onagraceae - Onagrore

Bimë barishtore dyvjeçare me kërcej 30 – 150 cm, leshtake.

Gjethet të këmbyera, kërcelloret deri 20 x 5 cm, heshtore.

Lulet aktinomorfe, në një kalli sqetullor. Nënpetla 4, të spërveshura në lule. Petlat të verdha. Thekë 8, në dy qerthuj. Fryti kapsulë cilindrike; farat të shumta.

VI – VIII.

Buzë rrugëve, në terene me rërë. Amerikanoveriore; e natyralizuar.



Amaranthus retroflexus L. - Nena e përveshur
Amaranthaceae – Nenore

Bimë barishtore njëvjeçare me kërcell 50 - 100 cm të lartë, të ngritur, me hulliza, i blertë i hapët, leshtor në pjesën e sipërme.

Gjethet me ngjyrë të blertë të çelët, zakonisht të ngushtuara dalëngadalë te bishti.

Lulesa skajore, në kallinj zakonisht të ngjeshur dhe të shkurtër. Braktezat të forta e gjembore, deri 2 herë më të gjata se rrethlulja. Fryti i thatë që çahet tërthorazi.

VI – IX.

Në toka të punuara, si bar i keq i kulturave prashitëse, në gërmadha e djerrina.

Bimë barishtore dyvjeçare me një rozetë gjethesh të qarta në bazë, 10 - 50 cm e lartë. Kërcelli i thjeshtë ose pak i degëzuar në pjesën e sipërme.

Gjethet bazale heshtore të përmbysëta, zakonisht shyte dhe me 3 - 7 nervura. Gjethet kërcellore më të ngushta, të përkundërta dhe me 3 nervura.

Lulet në vastakë skajorë gjethorë. Kupa me vriguj të fëndyelltë. Kurora e trëndafiltë ose pak a shumë e purpurt, rrallë e bardhë.

VI - VIII.

Rritet në vende me bar, shkurrishta dhe shpate malore. Bimë mjekësore.



Centaurium erythraea Rafn. - Bar ethesh
Gentianaceae - Gencianore



Gentiana asclepiadea L. - Genciana asklepiade
Gentianaceae - Gencianore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 - 80 cm e lartë. Kërcejtë të ngritur, cilindrikë, të lëmuar, të shogët.

Gjethet të pa bisht, vezake - heshtore, të sipërmet pak kosërake, gjysmëkërcellpushtuese me 3 (- 5) nervura gjatore të dallueshme.

Lulet 1 - 3, në sqetullën e gjetheve të sipërme, njëanësore, të pa bisht ose gati të pa bisht. Kupa gypore. Kurora blu - manushaqe, me gyp 4 cm të gjatë dhe me dhëmbë majëmprehtë. Anteret të bashkuara.

VII - IX.

Rritet në lëndina, shkorrete e pyje me lagështi.



Gentiana cruciata L. - Genciana gjethekryqëzuar
Gentianaceae - Gencianore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 50 cm e lartë, e shogët. Kërcejtë të përpjetëm, shpesh të kuqërremtë.

Gjethet heshtore, me 3 nervura, gjysmëkërcellpushtuese.

Lulet në tufëza të grumbulluara në sqetullën e 2 - 3 çifte gjethesh, si dhe në tufëza skajore. Kupa gypore dhe me dhëmbë. Kurora kaltroshe nga jashtë dhe blu nga brenda. Anteret të lira. Farat të flatruara.

VI - IX.

Rritet në livadhe me lagështirë, kullota etj.



Gentiana kochiana Perr. et Song. – Genciana e Kohut
Gentianaceae – Gencianore

Bimë e shkurtër barishtore, 3 – 20 cm; rizoma me shije që djeg, cilindrike.

Gjethet bazale të buta, vezake ose vezake – gjatore, 2 - 6 cm të gjata; gjethet kërcellore më të vogla.

Lulja 5 pjesëshe. Kupa kambanore, e ndarë thellë në 5 vriguj. Kurora e madhe, kambanore – si hinkë, e kaltër e mbyllur, rrallë manushaqe.

VI – VIII.

Në livadhe e kullota malore. Në Kosovë e përhapur në Malet e Sharrit.



Gentiana lutea L. – Sanëza
Gentianaceae – Gencianore

Shumëvjeçare, 40 – 150 cm, e shogët dhe pak a shumë e rimtë. Kërcelli i thjeshtë, i shëndoshë, i ngritur.

Gjethet bazale me bisht 10 cm dhe llapë heshtore 25 x 10 cm e me 5 nervura kryesore paralele; gjethet kërcellore 4 – 8 palë, të pa bisht, që vijnë duke u zvogëluar dhe më të sipërmet braktengjashme, si zemër, mejëmprehtë.

Lulet në tufëza skajore dhe sqetullore. Kurora e verdhë, përsipër me 2 – 3 vija pikash të murrme.

VI – VII.

Në livadhe e kullota malore. Bimë mjekësore.

Genti, mbreti Ilir, ka qen njohës në zë për përgatitjen dhe përdorimin e kësaj bime.



Gentiana punctata L. - Genciana pikaloshe
Gentianaceae - Gencianore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 60 cm e lartë. Kërcelli i ngritur, i thjeshtë, cilindrik, i shtypur.

Gjethet lëkurore, vezake - heshtore, majëmprehta.

Lulet në tufëza skajore, kërcelli pra jo me lule sqetullore. Kupa gypore me dhëmbë gati heshtorë. Kurora blu - manushaqe e errët me gyp konik dhe me vriguj të mprehtë. Anteret të bashkuar.

VI - IX.

Rritet në vende serpentinore. Endemike shqiptare. E përhapur në Kosovë (mes tjerash Mushtisht) si dhe Shqipëri.



Gentiana pneumonanthe L. - Genciana e Nopçes Gentianaceae - Gencianore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 60 cm e lartë. Ka kërcell të shëndosh, të përpjetëm ose të ngritur.

Gjethet 7 - 12 cm të gjata, 4 - 6 cm të gjera, vezake - eliptike me nervura gjatore të dalluara.

Lulet pa bisht, të grupuara në tufëza skajore ose sqetullore. Kupa dhe kurora kambanore. Kurora ka ngjyrë të verdhë, zakonisht me njolla purpur të errët.

VI - VIII.

Rritet në kullota alpine dhe subalpine.



Gentiana utriculosa L. - Genciana si kacekth
Gentianaceae - Gencianore

Bimë barishtore njëvjeçare, 6 - 15 (- 25) cm e lartë. Kërcejtë të përpjetëm, të degëzuar dhe përgjithësisht shumëlulesh.

Gjethet lëkurore, eliptike; kërcelloret më të ngushta se bazalet.

Dhëmbët e kupës heshtorë, majëmprehtë. Gypi i kupës 10 - 14 mm i gjatë, me kënde dhe flatra. Kurora ngjyrë blu - manushaqe.

V - VIII.

Rritet në livadhe të thata e kullota, kryesisht të zonave malore subalpine.



Gentiana verna L. – Genciana pranverore
Gentianaceae – Gencianore

Barishtore shumëvjeçare, 4 – 2O cm. Kërcelli i ngritur, që zgjatet pas lulëzimit.

Gjethet heshtore ose eliptike; ato të kërcellit 1 – 3 palë.

Lulet zakonisht të vendosura nga 1 në majë të kërcellit. Dhëmbët e kupës heshtore, majëmprehtë; gypi i kupës i flatruar në këndet. Kurora me vriguj ngjyrë blu të errët; gypi i kurorës gjelbërosh – blu nga jashtë,me një vijë të bardhë në çdo gji.

VI – VII.

Ndeshet në kullota alpine e subalpine.



Gentianella bulgarica (Velen.) J. Holub - Gencianëza bullgare
Gentianaceae - Gencanore

Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcej të degëzuar, 5 - 20 cm e lartë.

Gjethet kërcellore kanë trajtë gjatore - heshtore, vendosje të përkundërt dhe pa bisht.

Lulet janë aktinomorfe. Kupa e ndarë në vriguj gati të barabartë, vizakë të sheshtë ose pak të spërveshur. Kurora manushaqe e zbehtë ose e bardhërreme. Fryti kapsulë.

VI - VIII.

Rritet në livadhe e kullota të zonave malore. Bimë endemike e Ballkanit.



Gentianella ciliata (L.) Borkh. – Gencianëza e qerpiktë
Gentianaceae- Gencianore

Bimë barishtore dyvjeçare 15 – 30 cm, me kërcell të ngritur, të thjeshtë ose pak të degëzuar, cilindrik, i shogët.

Gjethet të pa bisht, heshtore – vizake, me një nervurë, majëmprehta, me bazë gjysmëkërcellpushtuese.

Lulet 4 pjesëshe. Kupa me dhëmbë heshtorë – vizakë të barabartë. Kurora me gyp 20 – 25 mm dhe vriguj, ngjyrë blu – manushaqe, me kinde (qerpikë) vizakë në bazë.

VII – IX.

Në kullota të thata e çeltira pyjesh. Europianojugore – Kaukazike.



Gentianella crispata Vis. – Gencianëza kaçurrele
Gentianaceae – Gencianore

Bimë baishtore dyvjeçare e shogët, 2 – 20 cm.

Gjethet e poshtme vezakepërmbysëta – pallake, shytë; të sipërmet heshtore.

Lulet 5 pjesëshe. Kupa me vriguj gati të barabartë ndërmjet tyre, të shogët, me buzë kaçurrele e të zeshkëta. Kurora blu – manushaqe ose e bardhërreme.Fryti kapsulë.

VI – VIII.

Në kullota të thata. Subballkanike.



Gentianella lutescens (Velen.) – Gencianëza e verdhërreme
Gentianaceae – Gencianore

Dyvjeçare, 3 – 40 cm e lartë, me kërcej të degëzuar.

Gjethet kërcellore vezake të ngushta, shyte, përveç të sipërmet që janë majëmprehta, të shogëta.

Kupa e ndarë në vriguj. Vrigujt janë më të shkurtër deri aq sa gypi, vizakë, të shogët; buzët të sheshta ose të spërveshura. Kurora 18 – 25 mm, e purpurt ose e verdhërreme. Kapsula pa bisht.

VI – VIII.

Në kullota malore.



Vinca herbacea Waldst.Kit. – Mënekshe barishtore
Apocynaceae – Apocinore

Bimë njëvjeçare, 20 – 50 cm, me kërcej cilindrikë, pjesërisht të fryer në bazë, me push gjëndëror, të verdhë ose të kuqërremë.

Gjethet heshtore.

Lulet në kallinj të dendur, hermafrodite, me erë. Kurora me push gjëndëror, e verdhë nga jashtë dhe e kuqe e errët përbrenda, buza e poshtme me vriguj gati të barabartë. Kreza e verdhë

V – VII.

Parazite në bishtajore të ndryshme.



Orobanche gracilis Sm. – Sparqa e hajthme
Orobanchaceae – Sparqore

Bimë barishtore shumëvjeçare; 5-10 cm e lartë; kërcejtë janë të shtrirë dhe shumë më të gjatë (20- 80 cm).

Gjethet të përkundërta që kapen direkt për kërcellin ose me një bisht deri 2 mm të gjatë. Në pjesën e sipërme gjethet jan më të ngushta, majëmprehta.

Lulet të vetmuara, sqetullore. Kurora zakonisht kaltëroshe e çelët.

III - V.

Në pyje dhe gjerdhe.



Vinca minor L. - Mënekshe më e vogël
Apocynaceae - Apocinore

Bimë 10 - 20 cm e lartë, por kërcejtë e shtrirë shumë më të gjatë (1 m ose më shumë), e shogët.

Gjethet e qëndrushme, me bisht dhe llapë heshtore, buzëplota, shyte në majë, përposh me nervura rrjetore të dalura.

Lulet të vetmuara sqetullore. Vrigujt e kupës trekëndore, të shogët. Kurora blu – manushaqe.

II - VI.

E kultivuar si bimë zbukurimi.



Orobanche reticulata Wallr. – Sparqe e rrjetëzuar
Orobanchaceae – Sparqore

Njëvjeçare 20 – 40 cm, e ngjashme me O. alba por më e shëndoshë.

Lulet rrallë me erë; braktetë trekëndore. Kurora 18 – 22 (-30) mm, e trëndafiltë -purpur në shpinë dhe në majë; buza e sipërme me dy vriguj, e poshtmja me vriguj të barabartë, jo me qerpikë. Fijet e thekëve të shogët. Kreza e purpurt.

V – VII.

Parazite mbi Carduus, Cirsium, Carlina, Scabiosa, Knautia etj.



Orobanche ramosa L. – Sparqe e degëzuar
Orobanchaceae - Sparqore

Njëvjeçare me kërcej 5 – 25 (-40) cm, të fryrë në bazë, cilindrikë, të thjeshtë apo të degëzuar, me push gjëndëror.

Gjethet luspore të rralla, heshtore, majëmprehta.

Lulesa kalli, e çlirtë apo e ngjeshur. Kurora me push gjëndëror, me gyp të zbehtë dhe grykë blu-violet; buza e poshtme me qerpikë e me vriguj pak a shumë të barabartë midis tyre. Pjalmoret të shogëta ose me qime të rralla në bazë.

V – VIII.

Parazite zakonisht në bimë të kultivuara (duhan, patate, domate etj.).



Tozzia alpina subsp. carpatica (W.) D. – Tozia
Orabanchaceae - Sparqore

Bimë barishtore shumëvjeçare, gjysmëparazite, e degëzuar. Kërcelli 10 – 50 cm e lartë, i drejtë, lehtë këputet.

Gjethet të përkundrejta, të lëmuara, të trasha, në pjesën e sipërme të kërcellit më dhëmbëz të imët.

Lulet të vetmuara të cilat grumbullohen në lulesë në majë të degëve; kurora e verdhë – e bardhërreme.

VI – VII.

Në lugina me rrjedhje uji të zonës subalpine deri alpine. Në Kosovë është vënë re në Malet e Sharrit (Gjimibeg, Vracë, Shutman, Piribreg, Përroi i Durlit etj).

Bimë e vogël barishtore shumëvjeçare dimëruese, insektngrënëse. Kërcelli 5 - 14 cm i lartë.

Gjethet 6 - 9, në rozetë bazale. Kanë formë eliptike gjatore, të buta dhe të tulta. Përsipër pak veshtullore.

Lulet janë të vetmuara. Kupa dybuzore dhe e qëndrueshme. Kurora me vriguj jo të barabartë. Ka ngjyrë të trëndafilt deri blu të zbehtë. Në grykë e verdhë. Vrigujt e buzës së poshtme kunjore. Shpori i verdhemë, 6 - 10 mm i gjatë.

V - VI.

Rritet në afërsi të burimeve me ujë, në shkëmbinj me shumë lagështirë, kryesisht në toka serpentinore.



Pinguicula hirtiflora Ten. - Pinguikula lulekreshtë
Lentibulariaceae - Lentibulariore

Shumëvjeçare dimëruese me sythe.

Gjethet pranverore vezake të gjera , kurse verore eliptike – gjatore. Llapa e plotë, e tultë, përsipër me gjëndra veshtullore.

Lulet të vetmuara. Vrigujt e kupës vezake të gjera. Kurora blu – lila, me njolla të bardha në bazë. Shpori cilindrik, i drejtë.

VI – VII.

Në vende me lagështi të zonave malore. Endemike e Ballkanit.



Pinguicula balcanica Gasper – Pinguikula e Ballkanit
Lentibulariaceae – Lentibulariore



Asperula aristata L. – Njëgjira e halëzuar
Rubiaceae – Rrezore

Bimë barishtore tufore, e çlirët ose e dendur, e blertë rrallëherë e rimtë me pluhurizë, me filiza pak a shumë të shumtë, por pa stolone nëntokësore. Kërcejtë të përpjetëm deri të ngritur, barishtor në bazë, zakonisht të ashpër dhe me qime në bazë, në pjesën e sipërme të shogët, 10 - 50 cm të lartë.

Gjethet në qerthuj nga 4, gati heshtore deri vezake, majëmprehta.

Lulesa zakonisht shumë e degëzuar. Kurora gjerësisht hinkëngjashme, e purpurt e zbehtë deri e bardhërreme.

VI - IX.

E përhapur në livadhe e vende shkëmbore të thata.

Bimë me rizomë zvarritëse. Kërcejtë 15 – 25 (-35) cm, të ngritur, 4-këndor, të shogët me përjashtim të nyjeve të kërcellit të cilat janë të pajisura me një unazë qimesh.

Gjethet eliptike – heshtore ose heshtore, zakonisht nga 8 në qerthuj, të dhëmbëzuara anash, me thimth në majë.

Lulet të bardha të vendosura në një lulesë në formë mburoje në majë të kërcellit. Lulesat anësore zakonisht 3, skajoret me bisht lulor të gjatë. Kurora hinkëngjashme.

VI – VII.

Në pyje ahu e gjetherënës mezofilë. Bimë mjekësore dhe mjaltëse.

Filizat e rinj të blertë ose të përhimtë – të blertë, të drunjëzuar në bazë ose barishtor. Kërcejtë 10 – 60 cm, shpesh me pupërri deri me qime të shkurtëra poshtë, zakonisht gati të shogët lart.

Gjethet në qerthuj prej 4, heshtore deri vizake.


Lulesa e degëzuar lirshëm; braktet të lira. Kurora hipokrateriforme deri gati hinkëngjashme, e purpurt e zbehtë ose e verdhërreme; gypi 2 – 3 herë më i gjatë se vrigujt.

V – VII.

Në vende të thata gurishtore.Endemike e Ballkanit.



Asperula cynanchica L. - Njëgjira qenmbytëse Rubiaceae - Rrezore



Asperula odorata (L.) – Njëgjira erëmirë
Rubiaceae – Rrezore



Asperula taurina L. – Njëgjira e Taurit
Rubiaceae - Rrezore



Galium aparine L. - Ngjitësja rodhe
Rubiaceae - Rrezore

Bimë barishtore njëvjeçare kacavjerrëse ose shtrirëse. Kërcejtë e degëzuar, 4 - këndor, 30 - 150 cm. Janë të pajisur, sikur edhe gjethet, me qime të kthyera si gremça me anë të cilave ngjitet për objekte të tjera.

Gjethet në qerthuj. Në çdo nyje të kërcellit ka 5 - 9 gjethe vizake - heshtore, me majë si halëza.

Lulet në cima sqetullore, me ngjyrë të bardhë si të blertë, me bishta të gjatë që dalin nga nyjet. Fryti 3 - 5 mm me kreshta të dendura gremçake.

V - IX.

Rritet në shkorrete, gjerdhe, buzë rrugëve e në të mbjella. Bimë e helmët.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 – 50 cm, me stolone nëntokësore ngjyrë portokalli. Kërcejtë të ngritur, të shëndoshë, qartësisht 4-këndor, pak a shumë me qime të hapura.

Gjethet 4 – pjesëshe. Kurora gypore deri ngushtësisht hinkëngjashme, e bardhë ose e verdheme e zbehtë.

V – VI.

Në pyje gjethegjerë deri në zonat e larta malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, rrënja primare pak e zhvilluar, me stolone nëntokësore dhe rizoma hollake e me rrënjë mitake të shumta. Kërcelli 20 - 60 cm i lartë, 4 faqesh me qime të hapura.

Gjethet 12 - 20 x 4 - 60 mm, gjerësisht heshtore deri vezake, majëmprehta, me 3 nervura, pak a shumë leshtore.

Lulet në qerthuj cimash me nga 5 - 9 lule. Kupa mungon. Kurora e verdhë, kreza e kokët. Fryti i thatë, rruzullor.

IV - VI.

E hasim në pyje jo të dendura, gjatë rrugëve dhe kullota.



Galium cruciata L. - Bar shëngjergji
Rubiaceae - Rrezore



Galium lucidum All. – Ngjitësja e shkëlqyeshme
Rubiaceae – Rrezore

Bimë barishtore. Stolonet zakonisht të pranishme. Këcejtë 25 – 30 cm të lartë, të ngritur ose të përpjetëm.

Gjethet vizake – heshtore, me majë të hollë hialine, buza paksa e kthyer, e ashpër.

Lulesa gjatore ose vezëngjashme, e dendur me degëza të përpjetme deri të hapura. Kurora e bardhë. Fryti ngjyrë kafe e errët.

V – VIII.

Në vende të thata me bar e shkëmbinj.



Galium odoratum (L.) Scop. - Ngjitësja erëmirë
Rubiaceae - Rrezore

Bimë me rizomë zvarritëse. Kërcejtë të ngritur, 4 - këndorë, 15 - 25 (- 35) cm të lartë.

Gjethet në qerthuj, 3 - 5 herë më të gjata se të gjera.

Lulesat anësore zakonisht 3, skajoret me bisht lulor të gjatë. Kurora hinkëngjashme, 4 – 7 mm në diameter. Fryti me qime gremqake.

V - VII.

Ritet në pyje ahu e gjetherënëse mezofile. Bimë mjekësore dhe mjaltëse.



Galium sylvaticum L. – Ngjitësja e pyjeve
Rubiaceae – Rrezore

Bimë barishtore shumë vjeçare, 30 – 140 cm. Kërcelli i drejtë, rrallë i përkulur, i degëzuar, cilindrik me 4 vija paralele, i shogët.

Gjethe 6 – 8 në një nyje, gjatore – heshtore.

Lulesat terminale me shumë lule. Bishtat e shkurtër, pas lulëzimit përkulen poshtë. Kurora e bardhë. Fryti i shogët.

VII – VIII.

Ritet në biotope të pyjeve.



Crucianella angustifolia L. – Krucinela gjethengushtë
Rubiaceae – Rrezore

Bimë barishtore njëvjeçare me kërcej deri 50 cm të lartë, të shogët.
Gjethet kryesisht në qerthuj prej 6 – 8; më të poshtmet vezake – heshtore, të sipërmet vizake, me buzë të kthyera, disi të ashpra, kaltëroshe – të blerta.
Kalliri 2 – 8 cm; lulet të pabisht të vetmuara. Kurora 4 – vrigullore, e verdhë e zbehtë.
V – VII.
Në vende të thata me bar. Euri-Mesdhetare.

Bimë njëvjeçare me kërcej deri 40 cm, të shtrirë, disi të ashpër, me gjemba të vegjël të spërveshur.
Gjethet në qerthuj prej 4 – 6; të poshtmet vezake të përmbysëta majëhollë, që vyshken shpejt; të sipërmet heshtorë të përmbysëta, majëngrëna.
Lulet në kaptina të vogla skajore, deri me 10 gjethe të bashkuara që formojnë një pështjellë. Kaptinat 4 deri 10 lulëshe. Kurora hinkëngjashme, trëndafili në lila.
IV – VI.
Bimë e keqe për kullotat dhe për kulturat bujqësore, sidomos për grurin.



Sherardia arvensis L. – Sherardia e arës
Rubiaceae - Rrezore



Galium verum L. - Ngjitësja e vërtetë
Rubiaceae - Rrezore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë 30 - 120 cm të lartë, të ngritur deri të përpjetëm, me 4 brinjë të dukshme.

Gjethet vizake deri vizake - heshtore, majëmprehta dhe të ndritshme.

Lulet janë shumë të vogla, aromatike. Kurora gjithmonë gati e shogët nga jashtë, e artë – e verdhë. Fryti zakonisht i shogët dhe i thatë.

V - VIII.

Rritet në livadhe të thata, kullota, shkorrete dhe çeltira pyjesh. Bimë e helmët dhe mjekësore.



Lonicera alpigena L. – Bardhaqeni
Caprifoliaceae – Dorëzonjore

Shkurre deri 3 m, zakonisht e shogët, me palcë të plotë.

Gjethet gjatore – vezake të përmbysëta deri eliptike, majëmprehta deri të thepëta.

Bishti lulor 25 – 35 (-50) mm. Braktetë vizake, zakonisht më të gjata se vezorja. Kurora dybuzore, e verdhërreme ose gjelbroshe – e verdhë, me nuancë në të kuq të murrme. Rrushqet rruzullorë deri ovoid, të kuq.

Lul. V – VI; fryt. VIII.

Në shkorrete e pyje të zonave malore.



Lonicera caprifolium L. - Dorëzonja
Caprifoliaceae - Dorëzonjore

Shkurre kacavjerrëse, gati e shogët dhe mund të rritet deri 8 m.

Gjethet eliptike deri eliptike të gjera, shyte, rrallë majëmprehta, përsipër të gjelbra të errëta, përposh të rimta, në pjesën e sipërme të biskut të bashkuara.

Lulet me kurorë të bardhë ose të verdheme, nganjëherë me nuanca të kuqe. Ato i ngjajnë një dorë të vogël me gishtërinjë të përkulur dhe kanë erë shumë të mirë. Fryti rrushk. Rrushqet të kuq ose portokalli të kuq.

Lul.V – VII; VIII – IX.

Rritet në pyje e gjerdhe deri në zonat malore dhe e kultivuar.



Lonicera xylosteum L. - Lulemaji drufortë
Caprifoliaceae - Dorëzonjore

Shkurre deri 3 m. Bisqet dhe gjethet janë me push.

Gjethet eliptike - vezake të gjera gati rrotullare.

Bishti lulor 12 - 20 mm. Braktetë heshtore. Kurora dybuzore, e verdheme - e bardhë, gypi i barabartë ose më i shkurtër se llapa. Fryti rrushk. Rrushqet kanë formë të rrumbullakët dhe janë të kuqe.

Lul. V – VI; fryt. VII – VIII.

Rritet në pyje të rralla.



Sambucus ebulus L. - Qingla
Caprifoliaceae - Dorëzonjore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 0.6 - 2 m e lartë. Kërcelli i drejtë, zakonisht i thjeshtë.

Gjethet pendore të përkundërta. Gjethëzat gjatore deri gjatorë - heshtorë, të thepëta, të sharruara, përsipër të shogëta, përposh pushlore.

Lulet në tufa vastakore. Kurora e bardhë, kurse pjalmoret vjollcë. Fryti rruzullor i zi.

VI - VII.

Rritet buzë rrugëve, djerrina dhe nëpër ledhe e gërmadha. Bimë mjekësore dhe ngjyruese.



Sambucus nigra L. - Shtogu
Caprifoliaceae - Dorëzonjore

Shkurre ose dru, 3 - 7 (- 10) m e lartë. Degët janë me palcë të bardhë.

Gjethet tekpendore. Gjethëzat vezake ose vezake - heshtore, të thepëta dhe të sharruara.

Lulet janë të vogla të mbledhura në lulesa si tufë, me erë të mirë e me veti mjekuese. Lulesa në diametër 10 - 24 cm. Kurora e bardhë, kurse anteret të verdha. Fryti bërthokël. Ka trajtë rruzullore dhe ngjyrë të zezë.

VI - VII.

Rritet nëpër gjerdhe e pyje me pak lagështi.Mjekësore



Symphoricarpus albus L. - Inxhi i bardhë
Caprifoliaceae – Dorëzonjore

Shkurre 0.3 – 2 m e lartë; kërcelli i drejtë, degët të shogëta.

Gjethet të thjeshta e rënëse, vezake rrotullare ose vezake, shyte, të plota ose rrallë me vriguj gjirak.

Lulet në vile fundore si kalli. Braktetë dhe braktezat vezake, të thepëta, të shogëta. Kupa me 5 vriguj. Kurora kambanore, e trëdafiltë, me qime brenda grykës. Fryti bërthokël, rruzullor, i bardhë, i qëndrueshëm edhe gjatë dimrit.

Lul.VI – IX; fryt. VII – X.

E kultivuar si bimë zbukurimi. Lulet vizitohen nga bletët. Amerikaneveriore



Weigela florida DC. – Veigela e këndshme
Caprifoliaceae – Dorëzonjore


Shkurre gjetherënëse deri 3 m e lartë

Gjethet të këmbyera me bishtak të shkurtër, eliptike, 5 – 10 cm të gjata majëmprehta, të dhëmbëzuara.

Lule 3 – 4, pa bishtak të përbashkët. Kupa e ngjitur duke dhënë një gyp me dhëmbë. Kurora e trëndafiltë, brenda trëndafili – e zbehtë.

V – VI.

E kultivuar si bimë zbukurimi. Zona e përhapjes natyrale shtrihet në Kinë, Kore dhe Japoni.



Viburnum opulus L. – Top bore
Caprifoliaceae – Dorëzonjore

Shkurre deri 4 m e lartë me gjethe rënëse, degët të shogëta.

Gjethet me 3 – 5 vriguj me dhëmbë, në faqen e poshtme me qime.

Lulet e brendshme të lulesës të vogla, hermafrodite (pjellore); ato periferike të mëdha, të bardhë, shterp. Fryti gati rrotullar, i kuq.

V – VI.

Në pyje e shkorrete malore dhe e kultivuar për zbukurim. Bimë mjekësore dhe mjaltëse.



Sambucus racemosa L. – Shtogu i kuq
Caprifoliaceae – Dorëzonjore

Shkurre deri 4 m, me lëvore të përhimtë e palcë të kuqe – kafe.

Gjethëzat vezake, vezake – heshtore ose eliptike, të thepëta, të sharruara, të shogëta ose pushlore, të rralla kur janë të reja.

Lulesa melth ovoid. Kurora e verdheme deri gjelbroshe e bardhë. Pjalmoret të verdha. Fryti rruzullor, i kuq.

Lul. III – V; fryt. VII – VIII.

Në zona të larta malore dhe subalpine.



Viburnum lantana L. - Butina e butë
Caprifoliaceae - Dorëzonjore

Shkurre deri 6 m e lartë me degë pushlore.

Gjethet vezake - heshtore, zakonisht majëmprehta, të sharruara, përsipër të rrudhosura e me qime yllore, përposh pushbutë e me qime yllore të dendura.

Lulet në vastakë cimozë. Lulesa me diametër 6 - 10 cm. Lulet të bardha krem. Fryti ovoid i shtypur, i kuq në fillim e i zi më vonë.

IV - V.

Në pyje e kullota malore.



Valerianella locusta L. – Haraqinëza karkalece
Valerianaceae – Valerianore

Njëvjeçare deri 40 cm e lartë.

Gjethet e poshtme kërcellore përgjithësisht pallake të gjera deri vezake, shyte të plota deri gjirake, të mesit dhe të sipërmet vezake – pallake deri heshtore, të plota deri me gjire si dhëmbë.

Lulet hermafrodite, në lëmshuk skajor. Kurora 1.5 mm, ngjyrë qielli e qartë.

IV – VI.

Në toka të punuara e të papunuara të zonës së shkorreteve mesdhetare e të dushkajave.



Valeriana montana L. - Haraqina malore
Valerianaceae - Valerianore

Shumëvjeçare, rrënjët si zhardhok. Këcelli 10 – 40 (-60) cm, i vetmuar, i shogët.

Gjethet e bazës të thjeshta, eliptike ose vezake, të plota; kërcelloret e poshtme zakonisht pendore të çara (nganjëherë të çara trish ose të plota); të sipërmet pendore të prera me gjethëza pak a shumë vizake.

Lulesat të thjeshta, ose nganjëherë të degëzuara. Lulet hermafrodite, trëndafil. Gypi i kurorës 3.5 – 5 mm. Fryti gati dy herë më i gjatë se i gjerë, më qime në të dy faqet.

V – VIII.

Në vende të thata me bar, shkëmbinj etj. të zonave malore.



Valeriana tuberosa L. – Haraqina zhardhokore
Valerianaceae - Valerianore

Bimë shumëvjeçare me rizomë, 12 - 50 cm e lartë. Kërcelli me qime ose gati i shogët.

Gjethet e bazës të plota, vezake ose eliptike (rrallë si zemër), me bisht. Gjethet kërcellore të thjeshta, vezake, të plota ose me dhëmbë.

Lulesa e përbërë. Lulet me ngjyrë vjollcë, të trëndafilta ose të bardha. Kurora me gyp si hinkë, me një gungë afër bazës. Thekë 3. Fryti i shogët.

V - VIII.

Rritet në shkorrete dhe shkëmbinj të zonave malore.



Valeriana officinalis L. - Haraqina mjekësore Valerianaceae - Valerianore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të thjeshtë të shkurtër. Kërcelli 30 - 150 cm, zakonisht i vetmuar, me hulliza, i shogët.

Në përgjithësi të gjitha gjethet pendore; ato të kërcellit me 5 - 15 palë segmente. Gjethëzat ose segmentet vizake, heshtore ose eliptike, të plota ose me dhëmbë.

Lulesa cimë mjaftë e degëzuar. Lulet ngjyrë trëndafili ose të bardha. Gypi i kurorës 2.5 – 5 mm.

V - VII.

Në vende me lagështirë e pyje. Bimë mjekësore dhe mjaltëse.



Centranthus longiflorus subsp. junceus (Boiss. et Heldr.) – Centranta lulegjatë
Valerianaceae – Valerianore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë të drejtë ose të përpjetëm, të degëzuar në pjesën e sipërme, 40 – 200 cm e lartë.

Gjethet vizake deri vezake; të plota..

Lulesa cimë, zakonisht e përbërë. Kurora trëndafili ose vjollcë; gypi i kurorës 12 – 18 mm; shpori (8-) 10 – 14 mm.

V – VII.

Në vende shkëmbore të zonës subalpine. Në Kosovë është e përhapur në Malet e Sharrit – Oshlak. Endemike e Ballkanit.



Cephalaria flava (Sibth. Et Sm) – Cefalaria e verdhërreme
Dipsacaceae – Berunzore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli i drejtë, i grathët ose i shogët.

Gjethet pendore të ndara; vrigujt të shumtë, vezakë ose të zgjatur, të dhëmbëzuar.

Lulet të verdha të zbehta. Braktetë e pështjellës të lulesës të kuqe – të gështenjtë, me qime.

V – VIII.

Në vende me bar dhe gurishtore.



Cephalaria pastricensis D. et H. – Cefalaria e Pashtrikut
Dipsacaceae – Berunzore

Bimë barishtore shumëvjeçare deri 2 m e lartë.

Gjethet pendore të prera, të shogëta ose të qerpikta, me 4 – 7 palë vriguj heshtorë ose gjatorë, të sharruar ose dhëmbë – dhëmbë.

Lulesa kaptinë. Braktetë e pështjellës vezake – heshtore, të purpurta të zeza në majë. Luspat e shtratit lulor pallake të thepëta, të qerpikta, të purpurta të zeza në majë. Kurora e verdhë.

VI – IX.

Në kullota të zonave malore. Bimë endemike e Kosovës dhe Shqipërisë; është zbuluar nga Dorfleri dhe Hayek në vitin l921. Në Kosovë është i përhapur në Pashtrik.



Cephalaria transsylvanica (L.) R. et S. –
Cefalaria e Transilvanisë Dipsacaceae – Berunzore



Knautia drymeia Heuffel – Knauta e dushkajave
Dipsacaceae - Beruzore



Dipsacus sylvestris Hudson - Berunza e pyllit
Dipsacaceae - Berunzore

Njëvjeçare 30 – 80 cm, me kërcej të ngritur, të degëzuar pothuaj deri në bazë e të grathët.

Gjethet lirake ose pendore të prera, me vriguj eliptike deri vizake – heshtore ose vizake, buzëplota ose të sharruara – dhëmbë – dhëmbë ose të vrigullta.

Kaptinat gjysmërruzullore. Luspat e shtratit lulor vezake – heshtore, majëmprehta ose të thepëta. Kurora e bardhë e verdhërreme.

VI – VII.

Në vende barishtore të thata, buzë kanalesh e rrugësh.

Shumëvjeçare, 30 – 90 cm. Rizoma e drunjëzuar, me rozetë gjethesh dhe kërcej lulorë anësorë.

Gjethet bazale me bishtak 3 – 6 cm e llapë eliptiko-heshtore, majëmprehta, me buzë ura-ura si sharrë. Gjethet kërcellore pa bisht.

Lulesa kaptinë. Kurora e trëdafiltë-manushaqe. Lulet e periferisë pak më të mëdha se ato të qendrës. Kreza e kokët, e purpurt.

V – VII.

Në pyje fletore të degraduar veçanërisht në ato me dushqe ose gështenjë, buzë pyjeve, gjerdhe etj.

Bimë barishtore një ose dyvjeçare, 50 - 200 cm e lartë. Kërcelli i ngritur, gypor, me gjemba të butë e të hapur.

Gjethet të përkundërta, pak a shumë heshtore. Të poshtmet bazëngjitura, me buzë dhëmbë - dhëmbë e me gjemba të rrallë. Gjethet e sipërme të plota, të shogëta, të pajisura me gjemba mbi nervurën kurrizore dhe anash.

Lulet e vogla ngjyrë lilaku të grupuara në lulesën kaptinë. Braktetë e pështjellës vizake, të pabarabarta, shpesh dalin përtej kaptinës.

VI - VIII.

Rritet në toka të punuara, hedhurina, buzë rrugëve etj. Bimë ngjyruese dhe mjaltëse e mirë.



Scabiosa graminifolia L. – Skabioza gjethebari
Dipsacaceae – Berunzore

Bimëbarishtoreshumëvjeçare tufore, me qime të mëndafshta – të argjendta, e drunjëzuar në bazë, me kërcell 20 – 30 cm, i përpjetëm dhe me gjethe në 1/3ose 2/3 e poshtme, të ngritura e të karenuara
Gjethet vizake, majëmprehta.

Kaptinat të vetmuara. Braktetë e pështjellës trekëndore – vezake. Kurora në lulet anësore gati dy herë më të gjatë se ajo e luleve qendrore, ngjyrë kaltëroshe – manushaqe.
VI – VIII.
Në shkëmbinj e vende me gurë deri në zonën alpine. Europianojugore.

Bimë barishtore shumëvjeçare ose dyvjeçare, 20 – 80 cm, me kërcell të ngritur, pushlor, me gjethe dhe i degëzuar përsipër.

Gjethet e rozetës jolulore vezake të përmbysëta – heshtore, me buzë ura - ura, kërcelloret e sipërme lirake ose njëfishpendore të prera, pushlore.

Kaptinëzat me diametër 15 – 20 mm. Braktetë e pështjellës më të shkurtra se lulet. Kurora e luleve anësore qartësisht më e gjatë se e luleve qendrore, e verdhërreme.

V – VIII.

Në toka të papunuara, hedhurina, skarpate të hekurudhave etj. Bimë ngjyruese dhe mjaltëse.



Scabiosa ochroleuca L. – Skabioza e verdhërreme
Dipsacaceae – Berunzore



Knautia dinarica (Murb.) Borban – Knauta dinarike
Dipsacaceae – Berunzore

Shumëvjeçare barishtore 30 – 80 cm, me rrënjë vertikale boshtore. Kërcelli i ngritur, me ndërnyjet e poshtme të shkurtra, të grathëta e pushlore, ndërsa të sipërmet dhe bishtat lulorë leshtorë dhe zakonisht me qime gjëndërore.

Gjethet bazale eliptike ose gjatore – heshtore, kërcelloret heshtore, majëmprehta, me push të përhimtë, kërcellpështjellëse.

Kaptina me diameter 2.5 – 4 cm. Kurora e purpurt.

VII – VIII.

Në shkorrete e livadhe me lagështi të zonave malore.

Endemike e Ballkanit.

Njëvjeçare 20 – 30 cm me kërcell të ngritur, të kreshpët dhe përgjithësisht i degëzuar.

Gjethet e bazës heshtore, të përmbysëta – pallake, dhëmbë – dhëmbë, të vrigullta ose lirake, të sipërmet shpesh pendore të prera me segmente vizak ose vizakë – gjatorë.

Kaptinëzat me diameter 2 – 3 cm. Braktetë e pështjellës heshtore. Kupa me 10 kreshta puplore të hapura në frytëzim. Kurora e trëndafilt e purpurt, me buzën e poshtme shumë të zgjatur në lulet e periferisë.

V – VII.

Në vende të thata e me bar të zonave të ulëta. Mesdhetare – lindore.



Tremastelma palaestinum (L.) Janchen – Tremastelma e Palestinës Dipsacaceae – Berunzore



Scabiosa columbaria L. - Skabioza pëllumb
Dipsacaceae - Berunzore

Bimë barishtore dyvjeçare me rrënjë të trashë gjysmëdrunorë. Kër-cejtë të shumtë, të degëzuar, të shogët.

Gjethet 2 ose 3 herë të ndara pendore – rezhdore; segmentet vizake, me qime në majë. Gjethet e poshtme me bishta.

Lulet kaptinore të rrethuara në gjethëza luspore, të mbuluara dendur me qime të palosura. Kaptina rruzullore. Kupa me dhëmbë. Kurora me ngjyrë të verdhë të zbehtë. Fryti aken.

VII – VIII.

Rritet në vende shkëmbore – serpentinore dhe shkëmbinj gëlqeror të zonës malore. Endemike e Ballkanit.



Scabiosa fumaroides Vis. et Panç. – Bari i zgjebës
Dipsacaceae - Berunzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 - 70 cm e lartë. Kërcelli është i ngritur dhe i degëzuar përsipër.

Gjethet fillestare të pandara. Gjethet kërcellore pendore të prera, zakonisht të grathëta. Segmentet janë heshtore deri vizake.

Kaptinëzat mbi bishta lulor të shkurtër. Braktetë e pështjellës më të shkurtra se lulet. Kurora manushaqe.

VI - VIII.

Rritet në vende me bar, kullota të thata, buzë pyjeve, deri në zonat malore.



Scabiosa silenifolia Waldst. et Kit. -
Skabioza gjethesilene
Dipsacaceae - Berunzore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të degëzuar e me gjethe në bazë, 10 - 20 cm e lartë.

Gjethet të qerpikta në bazë, të poshtmet heshtore të përmbysëta - pallake, buzëplota, majëmprehta; të sipërmet lirake ose pendore të prera, me segmentin skajor më të madh se anësoret.

Kaptinëzat 1 - 3. Braktetë e pështjellës vezake - heshtore. Kurora e luleve anësore qartësisht më e gjatë se ajo e luleve qendrore, blu, manushaqe ose lila.

VII - IX.

Rritet në shkëmbinj e shpate me gurë të zonave malore.



Forsythia europaea Deg. et Bald. - Boshtra Evropiane Oleaceae - Ullinjore



Forsythia suspensa (Thunb.) Vahl. – Boshtra e varur Oleaceae – Ullinjore



Jasminum officinale L. – Jasemini Oleaceae – Ullinjore

Bimë shkurrore e lartë deri 3 m. Degëzat dhe nyjet me palcë dhe me kthina.

Gjethet të thjeshta eliptike ose vezake, të shogëta. Gjethet e degëve pa lule të dhëmbëzuar deri në mes, ato të degëve me lule buzëplota, 5 - 8 cm të gjata.

Lulet të verdha. Kurora me vriguj gjatorë. Kapsula ovoide, e lëmuar, me sqep.

Lul. IV – V; fryt. VIII – IX.

Bimë endemike dhe relikte terciare e Kosovës dhe Shqipërisë. Në Kosovë është e përhapur në rrethin e Pejës, Gjakovës (Qafa e Prushit e deri në Ponoshec) rrethin e Rahovecit (Koznik, Zatriq) rrethin e Prishtinës (Golesh). Rritet në vende shkëmbore serpentinore duke formuar shkurrnaja të pastra ose të përziera.

Shkurre prej një deri dy metra e lartë. Degëzat gjithmonë fyle; nyjet me palcë të plotë.

Gjethet e degëzave shterpe të thjeshta, 6 – 10 cm, ato të degëzave me lule shpesh të përbëra (trishe), vezake të zgjatura, të shogëta, me buzë të dhëmbëzuar.

Lulet të verdha, me kurorë 18 – 25 mm të gjatë. Fryti kapsulë.

(III) IV – V; fryt. VIII – IX.

E kultivuar në parqe e kopshte si shkurre zbukurimi. Aziatikolindore

Shkurre gjetherënëse ose gjysmë-përherëblertë, 1 – 5 m e lartë, me degë të përkulura kacavjerrëse.

Gjethet të përkundërta, tekpendore, zakonisht me 5 – 7 gjethëza heshtore të thepëta, 1 – 6 cm; skajorja më e madhe se anësoret.

Lulet në cima skajore lulepakë, të merme. Kupa me dhëmbë të fëndyelltë, më të gjatë se gypi. Kurora e bardhë.

V – IX.

E kultivuar në parqe e kopshte se shkurre zbukurimi. Bimë aromatike.

Dru deri 40 m i lartë, me lëvore të përhime, në fillim të lëmuar, ndërsa në degët e vjetra ajo bëhet e ashpër dhe më në fund e plasaritur. Sythët të zinjë, nga dhe e ka marrë emrin.

Gjethet tekpendore me gjethëza gjatore të përmbysta, pa bisht, zakonisht me buzë ura – ura ose me dhëmbë si të sharrës.

Lulet në melthe të shkurtër, shpesh njëseksore, pa kupë e kurorë. Thekët të purpurt. Fryti shojzë.

IV - V.

Buzë ujërash dhe në pyje me lagështi. Bimë mjekësore.



Fraxinus excelsior L. - Frashëri i zi
Oleaceae - Ullinjore

Dru deri 8 (10) m i lartë, me lëvore të përhime, të lëmuar. Degët njëvjeçare zakonisht të shogëta.

Gjethet të përkundërta, tekpendore, me 5 - 9 gjethëza vezake deri heshtore, majëholla, me bisht të shkurtër.

Lulesa melth. Kupa me vriguj të thellë. Kurora me ngjyrë të bardhë. Fryti shojzë eliptike - pallake, me një farë.

IV - VI.

Më se i rëndomtë nëpër shkorrete e pyje vendesh të thata. Bimë mjekësore.



Fraxinus ornus L. - Frashëri i bardhë
Oleaceae - Ullinjore



Ligustrum vulgare L. - Voshtra
Oleaceae - Ullinjore

Shkurre 1 - 3 m e lartë, me degë të holla të hapura dhe me lëvore të lëmuar e të përhime.

Gjethet të përkundërta, me llapë eliptike.

Lulesa melth skajor. Lulet të merme, katërpjesëshe. Kurora e bardhë me gyp të gjatë sa llapa. Thekët me fije paksa të dala e me antere gjatore. Fryti rrushk i zi dhe i shkëlqyeshëm.

V - VI.

Rritet nëpër ledhe, gjerdhe dhe shkorrete.



Vincetoxicum huteri Vis. et Asch. – Qenmbytsja e Huterit
Asclepiadaceae – Asklepiadore

Barishtore shumvjeqare. Kërcejtë 50 – 150 cm, lehtësisht përdredhës, pushpak.

Gjethet me bishta të shkurtër, vezake – heshtore, , të mprehta në majë, nervurat e faqes së poshtme me pak push.

Cimat me 6 – 10 lule; bishtat lulorë 5 – 10 mm.Vrigujt e kupës gjatorë. Kurora gjelbëroshe – e verdhë, me vriguj vezakë – gjatorë dhe me qime leshtore të drejta në faqen e sipërme. Korona me segmente të larguara. Rrëshekthet boshtorë.

V – VII.

Në shkorrete. Subendemike.



Calystegia sepium (L.) R. Br. - Gështalla e gardheve
Convolvulaceae - Dredhore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, 30 - 120 cm. Kërcejtë janë dredhës që përdridhen nga e djathta.

Gjethet kanë llapë shigjetake, gjirake të thellë. Bishti i gjethit 1 - 3 cm i gjatë.

Lulet të vetmuara, me bisht sqetullor. Kupa pjesërisht e mbështjellë me dy brakteza shpesh me pikla të kuqe. Kurora si hinkë, e bardhë. Kreza me dy vriguj të fryrë.

V - IX.

Rritet në pyje me lagështi, gjerdhe, buzë lumenjsh e liqenesh. Bimë mjekësore.



Calystegia sylvatica (Kit.) Griseb. – Gështalla e pyllit
Convolvulaceae – Dredhore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 – 200 cm, e shogët.

Gjethet me bisht 7 – 9 mm, me llapë shigjetore, thellësisht gjirake.

Lulet të vetmuara, me bisht 8 – l4 cm. Braktezat shumë të fryra në bazë, gjerësisht vezake deri anëngrëna në majë,që e mbulojnë plotësisht kupën. Kupa si kambanë, me dhëmbë të mprehtë. Kurora e bardhë si hinkë.

V – X.

Nëpër gjerdhe e shkorrete.



Convolvulus althaeoides L. - Dredhja mëllagëngjashme
Convolvulaceae - Dredhore

Barishtore shumëvjeçare pushlore. Kërcejtë të drunjëzuar në bazë me degë barishtore të holla, zvarritëse ose dredhëse, deri 100 cm.

Gjethet me forma llapash të ndryshme, të sipërmet thellësisht të vrigulluara dhe si zemër deri shigjetake.

Kupa leshtore me dhëmbë heshtorë. Kurora e trëndafiltë, më e errët në qendër.

IV – VI.

Rritet në vende të thata të pambjella, livadhe të thata, buzë rrugësh.



Convolvulus arvensis L. - Dredhja e arës
Convolvulaceae - Dredhore

Barishtore shumëvjeçare me rizoma të bardheme, e tëra e shogët ose me push të shkurtër, 10 - 15 (100) cm. Kërcejtë e hollë, dredhës, që përdridhen zakonisht nga e majta.

Gjethet pak a shumë të plota, të thelluara në fund me veshëza, me bisht 2 - 3 cm.

Lulet dalin në sqetullën e gjetheve, të vetmuara ose nga dy, me bishta më të gjatë se gjethet. Kupa si kambanë. Petalet plotësisht të ngjitura në formë hinke, të bardhë deri të trëndafiltë.

IV - X.

Rritet në kopshte, vreshta, gjerdhe. Kosmopolite.



Convolvulus cantabrica L. - Dredhja e Kantabrisë
Convolvulaceae - Dredhore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 50 cm, me qime të hapura mbi gjethe e degët e poshtme, rizoma e drunjëzuar.

Gjethet e bazës pallake, me gjysmën e poshtme të ngushtuar në një bisht të gjerë, të sipërmet vizake.

Lulet me diametër 3 - 4 cm, pak a shumë të njëanshme që dalin në majë të degëve ose të bishtave të zgjatur. Kupa gypore dhe me dhëmbë. Kurora e trëndafiltë.

V - VII.

Rritet në vende të thata, shkorrete, sidomos gëlqerore.



Convolvulus compactus Griseb. - Dredhja e Kosovës
Convolvulaceae - Dredhore

Gjysmëshkurre me bucë të dendur. Tërë bima është e mbuluar me qime argjendi – mëndafshi,prandaj edhe ka ngjyrë të tillë.

Gjethet janë ovale, bishti i gjatë aq sa edhe llapa.

Lulet janë të vetmuara, gati të ulura, pa bisht. Kurora ka ngjyrë të bardhë.

VI - VII.

Rritet në vende me bar dhe gurishtore të zonës kodrinore me natyrë serpentine.

I përhapur në Ballkan, Turqi. Në florën e Kosovës është e përhapur vetëm në Guranë (Hani i Elezit). Është

zbuluar nga botanisti gjerman Grisebach në vitin 1844.



Ipomoea purpurea Roth. – Gështalla e purpurt
Convolvulaceae – Dredhore

Bimë barishtore njëvjeçare, 1 – 4 m. Kërcejtë zvarritës me qime të përkulura.

Gjethet në formë zemre, me qime të buta, 5 – 15 cm, zakonisht të plota.

Lulet në formë hinke 4 – 6 cm, zakonisht e kaltër, pas lulëzimit e spërdredhur si spirale e me ngjyrë të purpurt-manushaqe. Kupa me dhëmbë heshtorë.

VII – IX.

Në gërmadha, rrënoja, gjerdhe, buzë rrugëve dhe e kultivuar si bimë zbukuruese.



Phacelia tanacetifolia Bentham – Facelia gjethe karajpeli
Hydrophyllaceae – Hidrofilore

Bimë barishtore njëvjeçare, 20 – 80 cm, me push gjëndëror dhe e grathët.

Gjethet 2 – 10 cm, të këmbyera, me bisht të shkurtër, njëfish deri dyfish-pendore të prera.

Lulesa bishtakrepë. Kupa pa shtojca ndërmjet vrigujve, me 6 – 8 vriguj vizakë. Kurora rrotëse deri kambanore, blu, e qëndrueshme. Thekët shumë të dalur, me shtojca në bazë. Kapsula ovoide.

V – X.

E kultivuar si bimë mjaltëse për bletët. Amerikanoveriore.



Anchusa azurea Miller – Gjuhëlopa blu
Boraginaceae – Boraginore

Bimë shumëvjeçare, 30-80 cm, me kreshta të forta, të hapura.

Gjethet bazale vizake-pallake, të mprehta; kërcelloret vizake-heshtore.

Lulet në cima të dendura, në frytëzim të zgjatura 10 cm e me kupa të larguara nga njëra-tjetra. Braktetë trekëndore, të mprehta. Kurora blu-manushaqe. Akenët të ngritura.

IV-VII.

Në toka të papunuara, buzë arash dhe rrugësh, kullota të thata etj., deri në zonën e dushkajave.



Anchusa cretica Miller – Gjuhëlopa e Kretës
Boraginaceae – Boraginore

Bimë barishtore njëvjeçare, 5 – 50 cm, e grathët me qime. Kërcejtë të ngritur, të thjeshtë ose të degëzuar në bazë, me kreshta të ngritura – të hapura.

Gjethet heshtore të përmbysura – vizake, me 5 – 9 dhëmbë nga çdo anë dhe që mbarojnë me kreshta të hapura.

Cimat të dendura, me brakte vizake. Kurora ngjyrë manushaqe – blu.

III – VI.

Rritet në toka të papunuara, kullota të thata etj., deri në zonat malore. Subballkanike.



Anchusa officinalis L. - Gjuhëlopa mjekësore
Boraginaceae - Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare, rrallë dyvjeçare, e grathët, me kreshta ose qime njëtrajtëshe. Kërcejt 15 - 35 (70) cm, të degëzuar në pjesën e sipërme.

Gjethet bazale vizake - pallake, që zhduken në lulëzim; kërcelloret të pabisht, heshtore, gjysmëkërcellpështjellëse.

Lulet në cima. Cimat bishtakrepe, të dendura në frytëzim, me kupa të larguara nga njëra tjetra rreth 4 – 8 mm. Braktetë vezake. Kurora purpur - manushaqe. Akenët ovoidë - të tërthortë.

V - VII.

Në vende të punuara, rrugë, vreshta etj., deri në zonën e dushkajave.



Alkanna scardica Griseb. – Alkana e Sharrit
Boraginaceae – Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare jogjëndërore, kreshtake – e grathët me qime të shkurtra. Kërcejtë 10 – 30 cm, të përpjetëm ose të ngritur.

Gjethet bazale heshtore të përmbysëta; kërcelloret gjatore – heshtore.

Lulet në cima skajore me brakte. Kurora blu, e shogët ose leshtake nga ana e jashtme.

VI – VII.

Në vende shkëmbore dhe vende me bar të zonës subalpine. Ballkanike. Në Kosovë e përhapur në Kurvallë (Alpet Shqiptare).



Lithospermum apulum L. Vahl. – Kokërruja me shumicë
Boraginaceae - Boraginore

Bimë njëvjeçare, 5 – 25 cm, me kërcej të ngritur, të vetmuar deri të shumtë, shpesh të degëzuar në bazë, të grathët me qime të rrasura.

Gjethet kërcellore vizake ose gjatore-vizake, të ngitura, të pabisht, të mprehta; të sipërmet në trajtë braktesh e të zgjatura.

Cimat lulore të dendura, pak a shumë njëanësore. Kurora e verdhë, paksa më e gjatë se kupa.

III – V.

Në zonën e makies, në toka të punuara e të thata.



Nonea micrantha Boiss. Reut. – Nonea me lule të vogla
Boraginaceae - Boraginore

Bimë barishtore njëvjeçare, 10 – 40 cm e lartë. Kërcelli i drejtë, në pjesën e sipërme i degëzuar, me qime gjëndërore.

Gjethet vizake – heshtore, 4 – 7 cm të gjata,deri 1 cm të gjera.

Lulet në cima skajore. Kupa kambanore. Kurora e verdhë e zbehtë.

IV – V.

Në zona shkëmbore, shpate gurishtore



Solenanthus krasniqii Wraber – Solenanta e Krasiqit
Boraginaceae – Boraginore

Bimë njëvjeçare, me shumë kërcej. Kërcejtë përplot qime gjëndërore, deri 50 cm të lartë., të ngitur, me degëzim të dobët.

Gjethet heshtore, 35 x 10 mm, lehtësisht të valëzuar.

Lulet në cima me brakte, ngjyrë manushaqe.

IV – V.

E përhapur në toka të papunuara të zonave malore



Nonea pallens Petrovic – Nonea e zbehtë
Boraginaceae – Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli deri 80 cm i lartë, me bisqe sterile dhe fertile, në fillim i mbuluar me qime leshtake, më vonë pa qime.

Gjethet bazale heshtore të mprehta, me 3 nervura; gjethet kërcellore vizake – heshtore, me 1 nervurë. Gjethet e sipërme janë mbrojtëse të lulesës.

Lulet në cima pa brakte që formojnë një melth. Kurora me gyp cilindrik, e purpurt.

V – VI.

Rritet në vende shkëmbore – gëlqerore. Bimë endemike e Kosovës (mbi fshatin Gorozhup – Pashtrik) dhe fshatin Strazh (Guri i Zi). Është zbuluar nga botanisti slloven T. Wraber në vitin 1986.



Solenanthus scardicus Bornm. – Solenanta e Sharrit
Boraginaceae – Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare ose dyvjeçare, 50 – 100 cm, me kërcej të degëzuar.

Gjethet bazale vezake deri heshtore të gjera, me 3 – 5 nervura anësore; kërcelloret më të vogla, eliptike të ngushta deri heshtore; të sipërmet të pabisht.

Kupa me vriguj heshtor. Kurora me vriguj eliptikë të gjerë, shytë, purpur.

VI – VIII.

Kryesisht në pyje me ah. Subendemike.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 60 cm, e grathët, me qime të hapura ose të spërveshura. Rizoma horizontale e trashë. Kërcejt të ngritur.

Gjethet bazale heshtore, ura – ura, me nervura të dala përposh; gjethet e poshtme me bishtak.

Cimat të dendura me mjaft lule të varura. Kupa me gyp dhe dhëmbë të fëndyelltë e të thepët. Kurora zakonisht e purpurt – manushaqe, rrallë e bardhë.

V – VII.

Në kullota dhe livadhe me lagështirë, pyje të freskëta, buzë gropash me ujë etj. Bimë mjekësore dhe e helmët.



Symphytum officinale L. – Kufilma mjekësore
Boraginaceae – Boraginore



Asperugo procumbens L. – Asperuga e shtrirë
Boraginaceae – Boraginore

Bimë barishtore njëvjeçare, l0 – 70 cm, e grathët. Kërcejtë rrëvaga – rrëvaga, me qime të spërveshura.

Gjethet zakonisht heshtore, gati të mprehta deri shyte, me një nervurë shumë të qartë. Të sipërmet pa bisht.

Lulet të vetmuara dhe sqetullore ose në çifte sqetullore. Kupa e vrigulluar gati deri në bazë, dhëmbë – dhëmbë, rritës në frytëzim. Kurora si e purpurt, që bëhet manushaqe e errët. Luspat të bardha.

III – VI.

Në toka të papunuara, buzë rrugësh, në gërmadha, shpesh edhe në toka të punuara.



Cerinthe minor L. - Qerintha e vogël
Boraginaceae - Boraginore

Bimë një deri shumëvjeçare, 15 – 45 cm, me kërcell të ngritur, cilindrik, të shogët, zakonisht në pjesën e sipërme të degëzuar.

Gjethet të pabisht, kërcellpushtuese, me fund në formë zemre. Gjethet lulore shumë të reduktuara; maja e rrumbullakuar.

Lulet në cima skajore, me brakte. Kupa me vriguj të qerpiktë. Kurora e verdhë, nganjëherë me njolla të murrme në grykë, e ndarë deri në mes në 5 pjesë të thepëta.

V – VII.

Rritet në toka të punuara e të papunuara, vreshta, kopshte e buzë rrugësh.



Cynoglossum officinale L. - Gjuhëqeni mjekësor
Boraginaceae - Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e përhimtë - e gjelbër, 20 - 50 cm.

Gjethet bazale me llapë heshtore. Kërcelloret zvogëlohen duke u ngjitur lart, heshtore - vizake.

Lulet në cima. Cimat në lulëzim gatirruzullore. Kurora purpur e thellë. Bishtat në frytëzim të pëkulur - të hapur. Akenët me buzë me gjemba pak a shumë të dendur.

V - VIII.

Në toka të papunuara, buzë arash dhe rrugësh, vende me pleh. Bimë e helmët.



Echium italicum L. - Ushqerëza e Italisë
Boraginaceae - Boraginore



Echium rubrum Jacq. - Ushqerëza e kuqe
Boraginaceae - Boraginore

Bimë barishtore një - dyvjeçare, e grathët, 20 - 80 cm e lartë.

Gjethet kërcellore me vendosje të këmbyer, heshtore, pa bisht.

Lulesa në trajtë kalliri, kupa me rripëza, në lulëzim shumë të zgjatura. Kurora mjaft zigomorfe, ngjyrëndryshe. Në fillim ngjyrë trëndafili pastaj ngjyrë qielli në vjollcë. Thekët shumë të dalur mbi gypin e kurorës.

IV - IX.

Rritet në toka të punuara e kullota të thata, buzë rrugësh. Bimë e helmët, sidomos frytet. Mjaltore shumë e mirë.

Bimë barishtore dyvjeçare, 40 - 100 cm e lartë. Kërcejtë të ngritur, të grathët.

Gjethet bazale 20 - 35 cm të gjata, të shtrira në tokë, kërcelloret eliptike.

Lulet të vendosura në degëza në formë spiraleje duke formuar një lulesë në formë melthi mjaft të zgjeruar. Kurora ngushtësisht në trajtë hinke, me ngjyrë të bardhë ose trëndafili të zbehtë. Thekët tepër të dalur.

IV - VIII.

Në toka të papunuara, kullota të thata, buzë rrugësh etj. Bimë e helmët.

Bimë barishtore dyvjeçare, 20 - 50 cm e lartë me një deri disa kërcej lulembajtës.

Gjethet bazale dhe kërcellore heshtore deri eliptike, të holluara në bazë.

Lulesa pak a shumë në trajtë kalliri. Kurora në trajtë hinke, e kuqe e errët, me 4 – 5 thekë shumë të dalur.

V – VII.

Rritet në toka të papunuara, shkorrete dhe kullota.



Echium vulgare L. - Ushqerëza e rëndomtë Boraginaceae - Boraginore



Halacsya sendtneri (Boiss.) Dorfl. - Halaçi i Sentnerit Boraginaceae - Boraginore

Bimë barishtore njëvjeçare, 5 - 40 cm e lartë, pushbutë. Kërcejtë të ngritur ose zvarritës - të përpjetëm, të degëzuar.

Gjethet eliptike ose eliptike - heshtore, me nervura të dala nga ana e poshtme, të plota.

Lulet në cima skajore. Cimat bishtakrepe, të dendura. Kupa me dhëmbë. Kurora e bardhë. Fryti i thatë, i shogët ose pushlor.

VI - XI.

Rritet në toka të punuara dhe të papunuara, gërmadha, buzë rrugësh etj.

Bimë barishtore njëvjeçare, 10 - 50 cm e lartë, me kërcej të ngritur, të degëzuar në pjesën e sipërme, e ashpër për shkak të qimeve të dendura.

Gjethet përgjithësisht të ngritura dhe shumë të afruara ndaj kërcejve, vizake - heshtore.

Lulet në cima skajore, të vetmuara ose të çiftëzuara. Vrigujt e kupës vizake, të pabarabartë. Kurora e bardheme, rrallë në ngjyrë qielli.

IV - VI.

Rritet në toka të papunuara dhe të punuara.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 25 cm, me sistem të gjatë dhe të fuqishëm rrënjor. Kërcelli është i ngritur, i padegëzuar, i mbuluar me qime të ashpra dhe mbaron me një lulesë cimozike.

Gjethet janë të thjeshta, me buzë të plota, në bazë të kërcellit lineare - heshtore, ato të kërcellit më të vogla, të mbuluara me qime të ashpra.

Lulet hermafrodite. Kupa me 5 fletëza të ngjitura. Kurora e verdhë - ari, në formë hinke. Fryti tetraaken.

V - VI.

Rritet në vende me bar dhe shkëmbinj serpentinor. Bimë endemike e Ballkanit. Në Kosovë është e përhapur në terene serpentinore.



Heliotropium europaeum L. - Dielldridhësi i Europës Boraginaceae - Boraginore



Lithospermum arvense L. - Kokërruja e arave Boraginaceae - Boraginore



Lithospermum purpureo - coeruleum L. - Kokërruja e purpurtë në të kaltër Boraginaceae - Boraginore



Paramoltkia doerfleri Wettst. - Moltkia e Dorflerit Boraginaceae - Boraginore



Myosotis arvensis Hill. – Lulemiza e arës Boraginaceae – Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcej të ngritur, të degëzuar në pjesën e sipërme dhe me qime, e lartë 30 - 50 cm.

Gjethet heshtore, 5 - 7 x 0.8 - 1 cm, të plota, të qerpikëta.

Lulet të grupuara në cima me gjethe. Kupa gypore me 5 dhëmbë vizake. Kurora përbëhet prej 5 petaleve, me gyp 1.5 - 2 cm. Në fillim kurora e kuqërremtë si purpur, më vonë blu manushaqe. Thekë 5 me fije të gjata që dalin 5 - 8 mm mbi bazën e gypit të kurorës. Fryti aken. Akenët ovoidë – rruzullorë, të bardhë.

IV - V.

Rritet në pyje gjetherënëse e shkorrete, gjerdhe dhe vende me hije

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë të ngritur, 30 - 50 cm të lartë. Ato dalin nga një rizomë horizontale.

Gjethet të mprehta, heshtore, të mbuluara me kreshtëza të shpërndara dhe të rrasura.

Lulet në cima skajore me brakte. Kupa e ndarë gati deri në bazë. Kurora në pjesën e sipërme gradualisht zgjerohet, e purpurt - e errët. Thekët të përmbyllur brenda gypit. Shtyllëza e pistilit zakonisht e dalur.

V - VII.

Rritet në vende të thata e me bar, në pyje termofile të dushkut etj. Bimë endemike e Kosovës dhe Shqipërisë. Në Kosovë është e përhapur në Blinajë, Kaqanik, Dule, Novobërd.

Bimë barishtore njëvjeçare, rrallë dyvjeçare, 10 – 30 (-60) cm, me qime të rrasura. Kërcejtë të shëndoshë, shpesh shumë të degëzuar në bazë.

Gjethet bazale heshtore të përmbysëta, gati të pabisht, të mprehta; kërcelloret pak më të vogla.

Lulesa e zgjatur, luleshumë. Kupa e kreshpët me qime grremqake të hapura. Kurora me grykë të verdhë dhe llapë blu të çelët.

IV – VII.

Në toka të papunuara, kullota të thata, në gjerdhe e buzë rrugësh, toka të punuara etj.



Myosotis scorpioides L. – Lulemiza bishtakrepe
Boraginaceae – Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë zvarritës dhe me stolone. Kërcejtë deri 100 cm, të përpjetëm deri të ngritur.

Gjethet gjatore deri gjatore – heshtore.

Lulesa cimë. Këmbëzat deri 10 mm në frytëzim. LLapa e kurorës me diameter deri 8 mm; shtyllëza shpesh e dalur.

IV – VII.

Në vende me ujë ose me shumë lagështirë



Myosotis sylvatica Hoffm. – Lulemiza e pyllit
Boraginaceae - Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare ose rrallë edhe dyvjeçare, 20 – 50 cm. Kërcejtë shpesh shumë të degëzuar, të mbushur plotë me gjethe.

Gjethet eliptike ose vezake, të pabisht, me qime të shpërndara të rrasura.

Lulesa e zgjatur, pa brakte, me bisht të ngritur - të hapur. Kupa rënëse; rripëzat e kupës vizake, me qime gremçake. Kurora blu - manushaqe, me llapë të sheshtë.

IV – IX.

Rritet kryesisht në pyje me bung dhe ahishte, shkorrete etj.



Nonea pulla (L.) DC. – Nonea e errët
Boraginaceae – Boraginore

Bimë barishtore dy ose shumëvjeçare. Kërcelli i drejtë, 30 – 40 cm, në pjesën e sipërme i degëzuar, fyl, me shumë gjethe.

Gjethet me renditje të këmbyer; të poshtmet gjatore, të sipërmet 5 – 10 cm të gjata dhe 1 – 2 cm të gjera, me qime.

Lulet me bisht të shkurtër, me brakte. Kupa kambanore. Kurora dyfish më e gjatë se kupa, vjollce – e mbyllur deri e purpurt – e zezë.

V – VIII.

Në livadhe të thata, kullota, buzë rrugëve etj.



Lappula squarrosa (Retz.) Dum. – Rrodhëza e ashpër
Boraginaceae – Boraginore



Onosma echioides L. - Çiklla si ushqerëz
Boraginaceae - Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 30 cm e lartë, me rizomë të drunjëzuar. Kërcejtë janë të shumtë, me qime të gjata dhe yllore, në bazë të drunjëzuar.

Gjethet e poshtme janë vizake ose vizake - gjatore, 20 - 60 x 1 - 7 mm.

Lulet në cima skajore. Bishtat e luleve janë shumë të shkurtër ose mungojnë. Braktetë më të shkurtër se sepalet ose kanë të njëjtën gjatësi. Kupa e gjatë 7 - 15 mm, e verdhë si limoni ose e verdheme, me qime në grykë. Anteret të mbyllura.

VII.

Rritet në vende të thata me natyrë serpentinore. Endemike e Ballkanit.

Bimë barishtore një deri dyvjeçare, 10 – 40 cm, me qime të shpërndarë deri të dendura, të hapura deri të rrasura. Kërcejtë të ngritur, shpesh të degëzuar.

Gjethet gjatore deri vizake – heshtore.

Lulet në cima skajore. Kupa e vrigulluar deri në bazë, rritëse. Kurora gati rrotëse, blu e zbehtë. Akenët trekëndore-ovoide.

VI – IX.

Në toka të papunuara të thata, kullota me gurë etj.

Gati shkurrëz, 10 – 60 cm, me kërcej të drunjëzuar, e thjeshtë ose me pushpakë dhe kreshtake - yjore.

Gjethet e poshtme vizake, vizake – heshtore ose pallake, me buzë zakonisht të spërveshur; faqja e sipërme e llapës me zhardhokë që bartin një kreshtë qendrore dhe kreshta yjore.

Lulet të pabisht ose gati kështu. Kupa me kreshta të thjeshta dhe me disa kreshta yjore me rreze të shkurtra. Kurora e verdhë – e zbehtë, nga jasht pak a shumë dendësisht leshtake.

VI – VII.

Në shpate të thata kserotermike dhe në mjedise shkëmbore.



Onosma javorkae Hayek - Çiklla si shellige
Boraginaceae - Boraginore



Onosma visianii G. C. C. – Çiklla e Visianit

Boraginaceae – Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 – 50 cm, me rrënjë të zgjatur e të shëndoshë, me një rozetë gjethesh dhe një shtije qendrore të ngritur shumë e degëzuar në bazë. Kërcejtë dhe gjethet me kreshta (qime të gjata dhe të forta)

Gjethet e poshtme vezake ose vizake – heshtore.

Lulesa shumë e degëzuar. Kupa me 2 – 3 sepale të ngjitura deri në mes ose gati deri në majë. Kurora e bardheme ose e verdhë e zbehtë, me qime.

V – VI.

Në shpate të thata të rrahura nga dielli, kryesisht në zonat e ulëta e mesdhetare. Europianejuglindore.



Pulmonaria mollis Wulf. - Pulmonaria e butë

Boraginaceae - Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 50 cm.

Gjethet e mëdha të cilat gradualisht ngushtohen në bisht më të shkurtër ose aq sa llapa. Faqja e sipërme e llapës pa njolla, e butë, e mbuluar me qime të dendura gjëndërore.

Lulet në cima skajore. Lulesa gjëndërore - veshtullore. Kurora ngjyrë qielli në vjollcë, në trajtë hinke. Fryti aken.

IV - V.

Në pyje gjethegjerë e shkorrete.



Pulmonaria officinalis L. - Pulmonaria mjekësore
Boraginaceae - Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë dhe nyje të fryra. Kërcelli i mbuluar me qime, 20 - 40 cm i lartë.

Gjethet me llapë vezake, me qime të ashpra, nga sipër shpesh me njolla.

Lulet në cima skajore. Kurora në trajtë hinke, ngjyrëndryshme. Në fillim e kuqe, më vonë vjollcë e errët.

III - V.

Në pyje gjethegjerë, në vende me hije dhe pak lagështi, deri pranë zonës së ahishteve. Bimë mjekësore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, zakonisht deri 40 cm.

Llapa e gjetheve verore deri 15 – 7 cm, të ngushtuara menjëherë në bishtak, pa njolla ose rrallë disi me njolla; faqet e sipërme të ashpra, me kreshta të gjata. Gjethet kërcellore të srërgjatura, më të posht-met qartësisht më të vogla se gjethet verore.

Lulesa me qime të gjata. Kurora e kuqe deri sa thahet.

V – VIII.

Kryesisht në formacione pyjore të zonave malore.



Pulmonaria rubra Schott – Pulmonaria e kuqe
Boraginaceae – Boraginore



Symphytum tuberosum L. - Kufilma zhardhokore
Boraginaceae - Boraginore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë zvarritës që formon zhardhok të trashë. Kërcejtë 15 - 25 (-50) cm, me qime të rrasura, pjesërisht me flatër.

Gjethet vezake të përmbysëta, në bazë të ngushtuara.

Lulet në cima të shkurta skajore. Kupa me dhëmbë vizakë. Kurora e verdhë dhe me dhëmbë shytë. Shtyllëza e dalur nga kurora.

III – VI.

Rritet në pyje gjethegjerë sidomos me dushqe, mëllëzë dhe shkozë.



Atropa bella - donna L. - Helmarina
Solanaceae - Hikerore

Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 2 m e lartë, me qime, me erë të rëndë. Rizoma e trashë. Kërcelli me shumë degë të hapura.

Gjethet të këmbyera, vezake - heshtore.

Lulet të vetmuara ose të parëzuara në sqetull të gjetheve të sipërme. Kupa pushlore, në fillim kambanore, më pas të shtrirë në trajtë ylli nën frytin. Kurora gypore - kambanore, e murrme në të purpurt. Fryti rrushk, i zi, i shkëlqyeshëm, me tul shumë të helmët.

VI - VIII.

Rritet në ahishte të prera, rrahe të lagët etj.



Datura stramonium L. - Tatulla
Solanaceae - Hikerore

Bimë barishtore njëvjeçare, me erë të keqe, rrënjë boshtor dhe të degëzuar. Kërcelli i drejtë, i shogët, i dyzuar, 50 – 200 cm i lartë.

Gjethet të këmbyera me llapë vezake - eliptike, me dhëmbë të mëdhenj të mprehtë.

Lulet të vetmuara sqetullore mbi bishta 3 - 10 mm që drunjëzohen në frytëzim. Kupa gypore, pak e fryrë me dhëmbë të mprehtë e të pabarabart. Kurora 5 - 10 cm, e bardhë në trajtë hinke. Kapsula vezake, plotë gjemba. Farat të zeza.

VI - X.

Rritet në vende të punuara, buzë rrugëve e plehrishte. Bimë mjekësore dhe e helmët.



Hyoscyamus niger L. - Matergona e zezë
Solanaceae - Hikerore

Bimë barishtore dyvjeçare, veshtullore për shkak të qimeve gjëndërore ngjitëse, me erë të keqe. Kërcelli i ngritur, i thjeshtë ose i degëzuar, 30 - 80 cm i lartë.

Gjethet 15 - 20 cm të gjata, vezake deri vezake - gjatore. Gjethet e poshtme të plota dhe me bisht, të sipërmet gjysmëkërcellpështjellëse dhe pa bisht.

Lulet në sqetullat e gjetheve të sipërme. Kurora në trajtë hinke, e verdhë kafe me nervura kafe në të purpurt. Gryka e kurorës e purpurt në të zezë. Fryti kapsulë.

V - VIII.

Rritet në gërmadha, vende të papunuara, pranë mureve. Bimë helmuese dhe mjekësore.



Physalis alkekengi L. - Fshikakuqi
Solanaceae - Hikerore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 - 70 cm e lartë, gatipushlore, me rizomë horizontale. Kërcelli i ngritur, i thjeshtë ose i degëzuar sipër, cepatar.

Gjethet vezake - heshtore, të mprehtë dhe shpesh pak të thepët në majë, të plota deri gjirake ose me pak dhëmbë të trashë.

Lulet të vetmuara në sqetull të degëve të mesit. Bishti i lules përkulet pas lulëzimit. Kupa kambanore, me 5 dhëmbë heshtorë, e fryrë si fshikëz e madhe në kohën e frytëzimit. Më në fund me ngjyrë të kuqe - portokalli dhe që mbështjell plotësisht frytin pa e prekur këtë. Kurora e bardhë e ndotur. Fryti rrushk ngjyrë portokalli.

V - VII.

Rritet në pyje me lagështi, gjerdhe, vreshta, fusha e çeltira.



Physalis pubescens L. – Fshikakuqi pushlor
Solanaceae – Hikerore



Lycium europaeum L. – Harvalina
Solanaceae –Hikerore



Solanum dulcamara L. - Idhnakthi i ëmbël i hidhur
Solanaceae - Hikerore

Bimë barishtore njëvjeçare 10 – 150 cm e lartë, dendësisht pushbut dhe shpesh pak a shumë veshtullore. Kërcelli i thjeshtë ose i degëzuar sipër.

Gjethet vezake të gjera, të mprehta, të cunguara ose si zemër në bazë, zakonisht të dhëmbëzuara, me dhëmbë të mprehtë të pabarabartë

Lulet të vetmuara, sqetullore. Kupa me dhëmbë të gjatë, heshtore të ngushtë. Kurora gati e plotë, e verdhë me 5 njolla të errëta në grykë. Pjalmoret të purpurta. Fryti rrushk, i verdhë ose i gjelbër, i mermë e me shije të ëmbël.

V – VII.

E kultivuar për frytet e saj të ngrënshme. Amerikanejugore.

Shkurre 1 – 4 m e lartë, me degë të forta, me shumë gjemba sqetullorë të shkurtër e të fortë dhe me lëvore të çelët.

Gjethet rënëse pak mishtake, të tjeshta, të plota, të mprehta, me një nervurë.

Lulet të vetmuara ose në tufa, nga 2 – 3 bashkë, sqetullore, me bisht 5 – 8 mm. Kupa me 5 dhëmbë ose me dy buzë. Kurora e bardhë – trëndafile. Thekët zakonisht të dalë, me fije të shogëta, gati të barabarta. Fryti rrushk, ovoid, i kuq ose në ngjyrë portokalli me diametër 8 mm.

Lul. V – XI; fryt. VIII – IV.

Në shkorrete bregdetare. Euri – Mesdhetare. Bimë mjekësore

Gjysmë shkurre, me kërcell kacavjerrës, 30 - 200 cm. Poshtë kërcelli i drunjëzuar, sipër barishtor.

Gjethet vezake - heshtore, të plota, të sipërmet të prera trishë. Vrigujt anësor më të vegjël dhe janë afër bazës.

Lulesa cimë me lule ngjyrë vjollce ose purpur. Kupa me dhëmbë. Anteret të verdha. Fryti rrushk. Në fillim i gjelbër, në pjekuri i kuq, i shkëlqyshëm, ovoid.

IV - VII.

Rritet në pyje me lagështi, vende të papunuara, gjerdhe, brigje lumenjsh, kryesisht në mjedise me hije.



Solanum nigrum L. - Idhnakthi i zi
Solanaceae - Hikerore

Barishtore njëvjeçare, 15 - 50 cm e lartë, me kërcell të degëzuar, të shtrirë deri të përpjetëm.

Gjethet heshtore deri vezake, me bisht pjesërisht të flatruar dhe me llapë asimetrike, buzëplotë deri gjirake me dhëmbë.

Lulesat cima me 5 - 10 lule, të çlirta. Kupa konike, e spërveshur ose e ngjitur në bazë të frytit. Kurora e bardhë. Fryti rrushk, më i gjerë se i gjatë, i zi, më pas i shkëlqyeshëm.

IV - X.

Rritet në gërmadha, vende të punuara dhe oborre të lëna. Bimë e helmët dhe mjekësore.



Antirrhinum majus L. – Gojëujku
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 – 100 cm, përposh e shogët ndërsa te lulesa me push gjëndëror.

Gjethet të kundrejta ose të këmbyera, heshtore ose heshtore - vizake, 2 - 12 herë më të gjata se të gjera, qartësishtë pykore në bazë, të plota.

Lulet me ngjyra të ndryshme, por zakonisht buza e sipërme nga ana e mbrendshme e verdhë. Vrigujt e kupës vezake – gjatore, shytë. Kapsula gjatore.

VI - IX.

E kultivuar si bimë zbukurimi.



Chaenorhinum minus (L.) Lange – Kenorhina më e vogël
Scrophulariaceae – Sarushtore

Njëvjeçare 5 – 30 cm, me push të dendur gjëndëror. Kërcejtë të ngritur, të degëzuar që në bazë.

Gjethet të përkundërta, heshtore – vizake.

Lulet të vetmuara në sqetullat e gjetheve të sipërme. Kupa e ndarë pothuajse deri në bazë në vriguj. Kurora e verdhë – manushaqe; shpori 1.5 – 2.5 mm, pak a shumë cilindrik.

IV – IX.

Në toka të thata e të papunuara, toka ranore, buzë rrugëve etj.



Digitalis ferruginea L. - Luletogëza ngjyrë ndryshku Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 60 - 100 cm e lartë. Kërcelli i ngritur, i thjeshtë.

Gjethet kërcellore pa bisht dhe kërcell-pushtuese, që zvogëlohen drejt majës.

Lulet në vile skajore, të kthyera në një anë. Bishti i lules dhe kupa janë me qime gjëndërore. Kupa e ndarë në vriguj si fëndyell. Kurora kambanore, 40 - 50 mm e gjatë, me push nga ana e jashtme, e verdhë.

VI - VIII.

Rritet në pyje, shkorrete, kullota etj.



Digitalis grandiflora Mill. - Luletogëza lulemadhe Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me lartësi 40 - 120 cm. Kërcelli i ngritur dhe i shogët, në përgjithësi i kuqërremtë.

Gjethet e bazës vizake - pallake, buzëplota, majëmprehta, të shogëta deri pak pushlore përposh. Gjethet kërcellore vijnë duke u zvogëluar drejtë majës.

Lulet në vile skajore. Vilet janë të gjata dhe me shumë lule të dendura. Kupa me 5 vriguj të barabartë, me buzë cipëthatë të gjerë. Kurora në ngjyrë ndryshku ose e verdhë në kafe me nervura të murrme - purpurt, me gyp konik.

V - VII.

Rritet në pyje e shkorrete. Bimë e helmët.



Digitalis laevigata W. et K. – Luletogëza e lëmuar Scrophulariaceae – Sarushtore

Shumëvjeçare barishtore 60 – 100 cm e lartë, e shogët.

Gjethet gjatore – heshtore deri heshtore, buzëplota ose dhëmbë – dhëmbë.

Lulesa vile e gjatë, shumë e çlirët. Vrigujt e kupës vezakë, majëmprehtë ose të thepëta. Kurora e verdhërreme, me nervure të purpurta të murrme; vrigujt e buzës së poshtme shyte.

V – VII.

Në pyje e shkurrishta. Bimë endemike e Ballkanit.



Digitalis lanata Her. - Luletogëza leshtake
Scrophulariaceae - Sarushtore

Njëvjeçare 5 – 15 cm, me kërcell të ngritur, rrallë të degëzuar.

Gjethet kërcellore gati të rrumbullakta deri eliptike të gjera ose rombike, me 1 – 4 (-6) palë dhëmbë në çdo anë.

Kurora e bardhë ose e verdhë, me buzën e sipërme zakonisht lila. Kapsula eliptike gjatore, që del nga kupa.

VI – IX.

Në livadhe dhe kullota të zonës subalpine dhe alpine.

Bimë barishtore njëvjeçare, 10 – 30 cm, me kërcell të drejtë, të thjeshtë ose të degëzuar.

Gjethet vezake deltoide, me 4 - 6 dhëmbëza në çdo anë.

Lulet zigomorfe, me brakte. Braktetë (gjethet lulore) të ngjashme me gjethet, por pak më të gjera. Kurora dybuzore, e bardhë ose me buzën e sipërme lila - manushaqe.

V – IX.

Rritet në livadhe ose kullota të zonave malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 - 100 cm e lartë. Kërcelli i ngritur, i shogët ose gati i shogët.

Gjethet kanë formë gjatore - heshtore, me renditje të këmbyer.

Lulet në vile skajore. Lulesa e dendur. Braktetë heshtore. Kupa me 5 vriguj të barabartë. Kurora gypore e bardhë ose e verdhëreme e bardhë, me nervura të murrme ose manushaqe.

V - VII.

Rritet në shkurraja, vende shkëmbore e kullota. Bimë mjekësore.



Euphrasia liburnica Wettst. – Eufrasia e Liburnias
Scrophulariaceae – Sarushtore



Euphrasia rostkoviana Hayne - Eufrazia e Rostkovit
Scrophulariaceae - Sarushtore



Gratiola officinalis L. – Dërnoku mjekësor
Scrophulariaceae – Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, me rizoma, 30 – 50 cm e lartë. Kërcejtë fyl, me kënde, të ngritur, hipës.

Gjethet të përkundërta me llapë heshtore, me dhëmbë të rrallë deri buzëplota.

Lulet të vetmuara në sqetullat e gjetheve mbajtëse. Kupa me 5 dhëmbë të pabarabartë. Kurora dybuzore, e bardhë - trëndafili, zakonisht me nervura të purpurta të kuqe. Kreza dyvrigujshe.

V – VII.

Në livadhe me lagështirë, buzë ligatinave. Bimë mjekësore.



Lathraea squamaria L. – Latrea
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë tipike parazite, pa klorofil dhe pa gjethe normale të gjelbra. Rizoma është e degëzuar, e bardhëreme dhe e mbuluar me luspa të trasha mishnore. Me anë të haustorieve thith nga rrënjët e bujtarit materiet ushqyese. Kërcelli mbitokësor i drejtë, i trashë dhe sukulent, i mbuluar me luspa gjethore.

Lulet zigomorfe, të vendosura në bishta të trashë. Kupa kambanore, me ngjyrë të verdhë të përlyer deri purpur të kuqe, me 4 – 5 dhëmbë. Kurora dybuzëshe.

IV – V.

Rritet në vende rënore të pasura me humus, vreshte, parqe, në dushkaja, ahishte etj. Paraziton në rrënjë të bimëve të ndyshme drunore (Alnus, Corylus, Fagus, Carpinus, Populus, Betula).



Linaria genistifolia (L.) Mill. – Linaria gjethegjineshtre
Scrophulariaceae – Sarushtore

Shumëvjeçare 30 – 100 cm, e shogët dhe e rimtë. Kërcejtë të ngritur, të shëndoshë, të degëzuar.

Gjethet heshtore, vizake deri vezake, me bazë kërcellpështjellëse, të gjitha me 3 (-5) nervure, majëmprehta, të këmbyera.

Vilet të zgjatura. Kupa (2-) 4 – 6 mm. Kurora e verdhë, ndërsa shpori 8 – 10 mm.

VI – IX.

Në livadhe të thata.



Linaria pelisseriana (L.) Mill. – Linaria e Pelisierit
Scrophulariaceae – Sarushtore

Barishtore shumëvjeçare, 30 - 80 cm e lartë, me kërcell në të shumtën e rasteve të padegëzuar, të shogët, me gjethe të dendura.

Gjethet 2 - 6 cm të gjata, vizake, me një nervurë, buzëplota, pa bisht, majëmprehta, qerthullore në pjesën e poshtme, të këmbyera përsipër.

Lulet në vile skajore. Kupa me 5 dhëmbë shpesh të pabarabartë. Kurora dybuzore, e verdhë me njollë ngjyrë oranzhe dhe një shpor cilindrik.

VI - X.

Rritet në vende shkëmbore, toka të punuara, buzë rrugëve, kryesisht në zonën e ulët. Bimë mjekësore.



Linaria vulgaris Miller - Linaria e rëndomtë
Scrophulariaceae - Sarushtore

Njëvjeçare 10 – 50 cm. Kërcelli i ngritur, i thjeshtë ose i degëzuar në bazë, i shogët, i rimtë.

Gjethet dytrajtëshe, të poshtmet pendore të prera me 9 – 15 segmente eliptike të ngushta, majëmprehta e qerthullore nga 3 bashkë; të sipërmet vizake, të thjeshta.

Vileja e dendur dhe e shkurtër. Kupa gati pa gyp e me vriguj. Kurora ngjyrë manushaqe të errët, shpori 10 mm.

III – IV.

Në toka të punuara, kullota të thata.



Linaria peloponnesiaca Boiss. et Heldr. -
Linaria e Peloponezit
Scrophulariaceae – Sarushtore

Shumëvjeçare barishtore, 25 – 70 cm, e shogët përveç lulesës që është zakonisht me push gjëndëror. Kërcejtë të ngritur, të degëzuar, zakonisht pa gjethe nën lulesën.

Gjethet vizake, majëmprehta, të këmbyera.

Vilet shumë të dendura. Kurora e verdhë e zbehtë; shpori 7 – 8 mm.

VI – VIII.

Në vende shkëmbore, vende me bar, buzë pyjesh sidomos me ah. Endemike – Ballkanike.



Linaria dalmatica (L.) – Linaria e Dalmacisë
Scrophulariaceae – Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare 30 – 100 cm, e shogët dhe e rimtë. Kërcejtë të ngritur, të shëndoshë, të degëzuar.

Gjethet të këmbyera, 2 – 4 (-5) herë më të gjata se të gjera, vezake deri hesh-

tore, majëmprehta.

Vilet të zgjatura; kurora e verdhë; fryti kapsulë

VI – IX.

Në livadhe të thata.



Melampyrum doerfleri Ronniger – Grurëziu i Dërflerit
Scrophulariaceae – Sarushtore

Bimë barishtore njëvjeçare 20 – 40 cm e lartë, me kërcell të ngritur.

Gjethet 25 – 60 x 6 – 30 mm, heshtore deri vezake heshtore, me bishtak të shkurtër. Braktetë vezake si zemër, dhëmbë – dhëmbë, zakonisht ngjyrë manushaqe – blu, rrallë të gjelbërta.

Lulesa e çlirtë, pak a shumë kalli ose vile njëanësore. Kupa e shogët ose pushpakë, dhëmbët heshtorë të ngushtë. Kurora 12 – 18 mm, e verdhë; gryka gjysmë e mbyllur.

VI – VIII.

Në kullota e livadhe të zonave subalpine (Bogë – Rugovë). Subendemike.



Melampyrum heracleoticum Boiss. Et Orph.– Grurëziu i Heraklesë Scrophulariaceae – Sarushtore

Bimë barishtore njëvjeçare, 20 – 50 cm, me kërcej të degëzuar.

Gjethet vizake deri vizakeheshtore. Braktetë të gjelbra, krëhërake në pjesën e poshtme, dhëmbët përfundojnë në halëza të epëshme si fill.

Lulesa e çlirtë, pak a shumë kalli ose vile njëanësore. Kupa e shogët; dhëmbët si fill. Kurora e verdhë, gryka e mbyllur.

V – VII.

Në kullota të thata e shkorrete të zonave malore. Subendemike.



Odontites glutinosa Benth. – Odontiti ngjitës
Scrophulariaceae – Sarushtore

Bimë barishtore njëvjeçare, 12 – 30 cm, me push gjëndëror, me kërcell të ngritur ose me pak degë gati të ngritura.

Gjethet 10 – 20 mm, vizake, buzëplota.

Lulesa deri 8 cm në frytifikim, në fillim e dendur dhe më vonë e çlirtë. Kupa me dhëmbë vizake – heshtore. Kurora e verdhë, nganjëherë me nuancë të murrme – purpur, me gyp 9 – 12 mm.. Kapsula pak më e gjatë se kupa, me qime leshtore.

VIII- X.

Në shpate malore me gurë. Ballkanike.



Odontites lutea (L.) Clairv. – Odontiti i verdhë
Scrophulariaceae – Sarushtore

Bimë barishtore njëvjeçare, 20 – 50 cm, me push të rrasur ose kaçurrel, me kërcell të ngritur e me shumë degë të përpjetme.

Gjethet vizake, buzëplota, të hapura ose të spërveshura.

Lulesa 3 – 10 cm, si kalli, njëanësore. Kupa me dhëmbë trikëndore, gatimajëmprehtë. Kurora e verdhë e shndritshme, pushlore, buza e poshtme e spërveshur.

VII – IX.

Në vende të thata me bar, shpate me gur. Euri-Mesdhetare.



Odontites verna (Bellardi) Dumort. – Odontiti pranveror
Scrophularieceae – Sarushtore

Njëvjeçare 20 – 50 cm me push të rrasur. Kërcelli i ngritur ose i përpjetëm, pjesërisht katërkëndor, i thjesht ose i degëzuar, me ndërnyjet e poshtme zakonisht më të shkurtra se gjethet.

Gjethet heshtore, me buzë lehtësisht ura – ura gati të plota, më të gjera mbi bazën.

Lulesa 3 – 10 cm, e çlirtë, me lule gati pabisht, njëanësore. Kupa 5 – 8 mm. Kurora pushlore, e kuqërremtë – trëndafil, rrallë e bardhë, me buzën e poshtme të spërveshur.

VIII – IX.

Në shkorrete, buzë rrugëve, toka të punuara. Euroaziatike.



Melampyrum arvense L. - Grurëziu i arave
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë njëvjeçare, 20 – 40 cm, me kërcell të ngritur ose të përpjetëm, katërkëndësh përsipër.

Gjethet heshtore, majëmprehta, më të mëdhatë në bazë me 1 - 2 rrypëza të hapur në çdo anë.

Lulesa cilindrike. Braktetë pak a shumë të kuqërremtë, me 4 - 6 rrypëza si fëndyell në çdo anë. Kupa me dhëmbë si fill. Kurora me gyp të trëndafiltë, e verdhë përsipër dhe me grykë të mbyllur shpesh manushaqe.

V – VII.

Rritet në ara me grurë, toka të punuara, gjerdhe etj.



Melampyrum bihariense Kerner - Grurëziu
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore njëvjeçare, 20 - 50 cm e lartë. Kërcelli i thjeshtë ose i degëzuar, me internodie të shkurtra e të mbuluara me qime.

Gjethet vezake - heshtore, buzëplota.

Lulet janë në lulesa të shpërndara, shpesh të kthyera në një anë. Braktetë në pjesën e lulesës janë si gjethe me bazë të zgjeruar dhe me dhëmbë të gjatë. Kupa është gypore. Kurora dy herë më e gjatë se kupa, e verdhë - ari. Buza e sipërme helmetngjashme, e poshtmja trevrigujshe.

VII - VIII.

Rritet në pyje të zonave malore sidomos në përbërje gjeologjike gëlqerore. Në Kosovë ka përhapje sporadike.



Melampyrum cristatum L. - Grurëziu me kreshtë
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore njëvjeçare, 15 - 40 cm e lartë. Kërcelli i ngritur e me qime të rralla.

Gjethet të përkundërta, zakonisht buzëplota, vizake, majëmprehta.

Lulesa e ngjeshur, në një kalli 4 - qoshesh. Brakteja formohet nga një llapë bazale dhe një shtojcë skajore. Llapa në formë zemre, me rreth 15 dhëmbëza të halëzuar, shtojca skajore vizake, e plotë. Gjatësia maksimale e braketeve të poshtme 2 - 3 cm që vijnë duke u zvogëluar përsipër dhe gjithmonë të kthyera nga poshtë. Kurora e verdhë në të zbehtë. Fryti kapsulë që qahet vetëm gjatë njërës anë.

V - VII.

Rritet në pyje të rralluara, shkorrete.



Melampyrum pratense L. – Grurëziu i livadheve
Scrophulariaceae – Sarushtore

Bimë njëvjeçare. Kërcelli i drejtë, 10 – 50 cm, i thjeshtë ose i degëzuar, zakonisht i shogët.

Gjethet me bishta të shkurtër, buzëplota, vezake – heshtore ose heshtore.

Lulesa skajore, shpesh njëanësore. Braktetë në pjesën e sipërme të lulesës vijnë duke u zgjeruar dhe më të halëzuara, të gjelbra. Kurora dybuzore, e vedhë - e çelët ose e bardheme, rrallë e verdhë.

VII – IX.

Në çeltira pyjesh, ahishte, kullota etj.



Parentucellia latifolia (L.) Karnel – Parentucela gjethegjerë
Scrophulariaceae – Sarushtore

Njëvjeçare, 3 – 25 cm. Kërcelli i ngritur, përgjithësisht i thjeshtë, me qime gjëndërore të hapura.

Gjethet të përkundërta, pa bisht, e hapur anash me 2 – 4 dhëmbë.

Lulesa 1 – 4 cm, e ngjeshur. Kupa me gyp 6 – 8 mm dhe dhëmbë l – 2 mm. Kurora e kuqërremtë e purpurt. Fryti kapsulë.

IV – VI.

Në kullota të thata, toka të punuara të zonave të ulëta.



Pedicularis brachyodonta Schloss. – Pedikularia dhëmbëshkurtër
Scrophulariaceae - Sarushtore

Shumëvjeçare barishtore me kërcell të ngitur ose të përpjetëm, fyl, të mbuluar me qime, 20 – 40 cm.

Gjethet pushlore, heshtore, dyfishpendore të prera me segmente vizakë – gjatorë, me majucë e të sharruara.

Lulet janë të mëdha, të verdha të zbehta. Kupa afër bazës leshtore dhe e fryrë. Dhëmbët e kupës (4) si deltë, buzëplotë, të qerpiktë.

V – VII.

Në kullota e shpate malore. Endemike – Ballkanike. Në Kosovë e përhapur në Malet e Sharrit.



Pedicularis petiolaris Ten. - Pedikularia me bisht
Scrophulariaceae - Sarushtore



Rhinanthus alectorolophus Scopoli - Takllina e tufëzuar
Scrophulariaceae - Sarushtore



Rhinanthus minor L – Takllina më e vogël
Scrophulariaceae – Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të ngritur pushlor deri leshtor, 7 - 25 cm e lartë.

Gjethet me bisht leshtor e llapë me kontur heshtor, të shogët, dyfish pendore të prerë e me segmente të sharruarë e me thimth.

Lulesa kallinj. Kallinjtë të shkurtër, me bosht leshtor të bardhë. Kupa leshtore, e dhëmbëzuar dhe e fryrë. Kurora e trëndafiltë.

VI - VII.

Rritet në kullota të thata të zonave malore.

Bimë barishtore njëvjeçare gjysmëparazite. Kërcelli është i drejtë, katërkëndësh, deri 80 cm i lartë.

Gjethet të kundrejta, kërcellpushtuese, heshtore deri vezake, me buzë të sharrëzuar.

Lulet në vile skajore, me brakte. Braktetë e gjera, vezake, me buzë të sharrëzuar. Kupa e fryer, gatirrotullare, me 4 dhëmbë. Kurora dybuzore, e verdhë, në majë manushaqe. Buza e sipërme si kaskë.

V – VII.

Rritet në livadhe të ngrohta e me lagështi të zonave malore.

Njëvjeçare, 5 – 50 cm, e shogët ose me qime të pakta..

Gjethet vezake – gjatore deri vizake – heshtore, me buzë ura – ura si sharrë; më të sipërmet dhëmbë – dhëmbë, jeshile shumë – të errëta.

Lulet në vile skajore. Braktetë të shogëta ose të grathëta me qime të rralla, më të gjata ose (të poshtmet) pak më të shkurtra se kupa, me dhëmbët e poshtme më të mëdhenj se të sipërmit, jo të halëzuar. Kupa e shogët ose me qime të thjeshta të rralla. Kurora me gyp të drejtë e grykë pak a shumë të hapur.

V – VII.

Në livadhe përgjithësisht me lagështi të zonave malore.



Rhinanthus rumelicus Velen. – Takllina e Rumelisë
Scrophulariaceae – Sarushtore



Scrophularia bosniaca G. Beck - Sarushta boshnjake
Scrophulariaceae - Sarushtore



Scrophularia canina L. - Sarusha e qenit
Scrophulariaceae - Sarushtore

Njëvjeçare deri 60 cm, me kërcell të thjeshtë ose të degëzuar, shpesh me rrvaga të zeza, përsipër me qime gjëndërore pak a shumë të dendura.

Gjethet heshtore deri vezake.

Lulet në vile skajore. Braktetë trekëndore – vezake, me qime gjëndërore, me dhëmbë që vijnë duke u zvogëluar drejt majës. Kupa me qime gjëndërore; qimet të qëndrueshme në frytëzim. Kurora me gyp lehtësisht të përkulur, e verdhë, në majë manushaqe.

V – VII.

Në vende të thata me bar të zonave malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 - 80 cm e lartë.

Gjethet kanë formë rrotullare, gati si zemër në bazë. Buza e llapës dyfish e dhëmbëzuar.

Lulet sajojnë lulesën e quajtur cimë. Cimat kanë zakonisht 6 - 9 lule. Braktetë kryesisht gjethore. Kupa e vrigulluar. Vrigujt e kupës vezake. Kurora e murrme e gjelbër. Fryti kapsulë.

VI - VIII.

Rritet në të çara të shkëmbinjëve të zonës malore .

Shumëvjeçare, 40 – 80 cm, me erë çimke. Kërcejtë të ngritur, të rimtë, me kënde.

Gjethet e poshtme me llapë me konturë trekëndësh, të ndarë në 7 - 9 segmente që nga ana e tyre ndahen në segmente të rendit të dytë të prerë ose dhëmbë - dhëmbë.

Lulet në cima shumëulëshe çë formojnë një melth të degëzuar. Kupa me 5 vriguj rrotullarë me buzë cipëthatë të gjerë e të bardhë. Kurora 5 – 6 mm, zakonisht dybuzore.

V – VIII.

Rritet në vende shkëmbore, në toka të papunuara etj.



Scrophularia nodosa L. – Sarushta me nyje
Scrophulariaceae - Sarushtore

Shumëvjeçare, 60 – 120 cm, e shogët ose me qime të rralla. Kërcelli i ngritur, i degëzuar, me katër kënde të mprehtë.

Gjethet të përkundërta; kërcelloret vezake-majëmprehta, dyfish të sharruara trash, me bazë si zemër ose të cunguar.

Cimat zakonisht me 5 – 7 lule. Kupa me segmentë vezakë të gjera dhe me buzë cipëthatë të ngushtë. Kurora e murrme e verdhërreme.

V – VII.

Në pyje, vende me hije e me lagështi. Bimë e helmët.


Dyvjeçare 50 – 200 cm me push të qëndrueshëm.

Gjethet e bazës 12 – 40 x 3 – 14 cm, gjatore – heshtore të përmbysëta deri vezake të përmbysëta, buzëplota, me bishtak të shkurtër.


Lulesa e degëzuar. Braktet e poshtme vezake – heshtore, të sipërmet heshtore. Kurora me diametër 18 – 30 mm. Thekët njëtrajtësh, të gjithë me pjalmore veshkëngjashme, qimet e fijeve të bardha.

VI –VII.

Në vende shkëmbore. Europianolindore e Qendrore.



Verbascum speciosum Schrader – Bar peshku i bukur
Scrophulariaceae – Sarushtore



Verbascum lychnitis L. – Bar peshku gunevgjitkë Scrophulariaceae – Sarushtore

Bimë barishtore dyvjeçare, 80 – 150 cm e lartë. Kërcejtë të degëzuar përsipër dhe shpesh edhe poshtë.

Gjethet e poshtme vezake deri heshtore, të dhëmbëzuara jo rregullisht, pykore në bazë, të gjelbra përsipër e me push të bardhërreme përposh.

Lulesa e degëzuar. Kurora e verdhë ose e bardhërreme. Thekët të gjithë me pjalmore veshkëngjashme e fije me push të verdhë ose të bardhë.

VI – VIII.

Në livadhe të thata, djerrishte. Europiano-Kaukazike.



Verbascum blattaria L. – Barpeshku moleje
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë dyvjeçare, 40 - 70 (- 120) cm. Kërcelli me kënde, me qime gjëndërore të bardhëreme në gjysmën e sipërme, i shogët në bazë.

Gjethet të shogëta. Ato të bazës pallake, gati pa bisht e llapë heshtore, gjethet kërcellore pa bisht, vizake - heshtore, gjysmëkërcellpështjellëse.

Lulesa e degëzuar. Kurora e verdhë, manushaqe në bazë. Thekë 5, të poshtëmit me antere të stërgjatura e fije të veshura me qime ngjyrë manushaqe të bardhë. Kapsula gati rruzullore.

V - VIII.

Në toka të punuara, gjerdhe, shkorrete.



Verbascum longifolium Ten. - Bar peshku gjethegjatë
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare ose dyvjeçare, 50 - 200 cm e lartë, me push të dendur të bardhërremë ose të verdhemë që sipër më në fund bie flokë - flokë.

Gjethet e bazës eliptike - gjatore deri vezake - heshtore, majëmprehta, buzëplota. Gjjethet kërcellore pa bisht.

Lulet në vile skajore; lulesa e dendur, cilindrike. Braktetë vizake. Kurora me diametër 20 - 35 mm, e verdhë. Thekët dytrajtësh. Kreza si çomangë.

VI - VIII.

Rritet në kullota malore e vende të thata të rrahura nga dielli.



Verbascum nigrum L. – Bar peshku i zi
Scrophulariaceae – Sarushtore

Shumëvjeçare barishtore 60 – 90 (-150) cm. Kërcelli i ngritur, jo i degëzuar, rrëvaga – rrëvaga, pushlor, përsipër i kuqërremtë.

Gjethet e bazës trekëndore-heshtore, si zemër në bazë; gjethet e sipërme kërcellore heshtore, gati pa bisht.

Lulesa e thjeshtë ose e degëzuar. Braktetë vizake. Kupa me qime të bardha. Kurora e verdhë. Thekët të gjithë me pjalmore veshkëngjashme ngjyrë portokalli dhe qimet e fijeve ngjyrë manushaqe.

VI – VIII.

Në toka të papunuara, djerrishte, pyje, shkorrete.



Verbascum phoeniceum L. - Bar peshku manushaqe
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 - 60 (- 100) cm e lartë. Kërcelli me qime leshtore.

Gjethet bazale pa bisht ose me bisht 1 - 3 cm. Kanë formë vezake heshtore. Gjethet kërcellore mungojnë ose disa të vogla.

Lulesa është e thjeshtë. Braktetë heshtore ose vizake. Bishti i lules zgjatet në frytëzim deri 22 mm. Sepalet vezake. Kurora ngjyrë manushaqe. Fryti kapsulë ovoide.

VI - VII.

Rritet në kullota të thata.



Verbascum pulverulentum Vill. – Bar peshku pluhurosur
Scrophulariaceae – Sarushtore

Dyvjeçare barishtore, 50 – 120 cm, me qime leshtore të bardha. Kërcelli me degë të harkuara.

Gjethet e bazës vezake të përmbysëta – gjatore, me buzë ura – ura deri gati të plota, gati pa bisht ose me bishtak të shkurtër; kërcelloret gjerësisht si zemër, jo të stërgjatura.

Lulesa e degëzuar. Braktetë vizake. Kurora me diameter 18 – 25 mm. Thekë të gjithë me pjalmore veshkëngjashme e fije me push ngjyrë manushaqe.

VI – VIII.

Në toka të punuara, kullota të thata.



Verbascum thapsus L. - Bar peshku tapsus
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore dyvjeçare, 30 - 200 cm e lartë e më shumë. Ka kërcell të mbuluar me qime të hirta ose të bardha të hirta, pa gjëndra, të drejtë dhe pak të trashur.

Gjethet gjatore ose vezake, anëve me dhëmbë shytë ose pa dhëmbë, pa bisht ose të ngushtuara në formë bishti.

Lulesa është vile e gjatë. Lulet të verdha. Braktetë vezake - heshtore. Fillet e thekëve me qime të bardha.

V - VII.

Rritet në vende barishtore e shkëmbore.



Veronica andrasovskyi Jav. - Veronika e Andrasovskit
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët.

Gjethet janë të trasha. Të poshtmet me bishta, të sipërmet pa to. Kanë trajtë gjatore - ovale, buzëve me dhëmbë shytë.

Lulet janë të grupuara nga 3 - 5 në lulesa vastak. Kupa është e shogët ose me pak qime. Kurora në fillim është e bardhëreme.

VI - VII.

Rritet në vende gurore - shkëmbore dhe me bar. Është bimë endemike e Kosovës dhe Shqipërisë.



Veronica beccabunga L. - Veronika bekabungë
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 60 cm, e shogët. Kërcejtë të shtrirë cilindrik, bosh përbrenda, në përgjithësi të trëndafiltë - purpur.

Gjethet vezake ose gjatore, dhëmbëza - dhëmbëza, jeshile të errëta, të trasha, majëshyte.

Lulet në vile, me 10 - 20 lule. Kupa me 4 segmente. Kurora blu e errët ose e kaltër. Kapsula gati rruzullore.

IV - IX.

Në kanale me ujë të rrjedhshëm, pranë burimeve e në vende me shumë lagështi.



Veronica chamaedrys L. - Veronika dushkvogël
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 15 cm e lartë. Kërcejtë e ngritur ose të përpjetëm, me dy vija të qarta me qime ndërsa pjesa tjetër e shogët.

Gjethet vezake ose heshtore, me buzë ura - ura, pak a shumë pushlore, pa bisht ose me bisht të shkurtër.

Lulet në vile. Vile 2 - 5, 4 - 15 cm të gjata, mbi bishta të gjatë, rreth e rotull me qime. Kupa me 4 vriguj heshtorë, pushlore. Kurora blu e shndritshme.

IV - VI.

Në shkorrete, pyje, kullota.



Veronica jacquinii Baumg. - Veronika e Zhakinit
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë janë të drejtë ose të lakuar, 30 - 70 cm të lartë.

Gjethet të rrumbullkëta ose vizake të gjera, të prera pendore ose dy herë pendore të ndara; vrigujt të ngushtë.

2 - 6 lule formojnë lulesën vile. Braktetë vizake. Kupa është e ndarë në vriguj jo të barabartë. Kurora ka ngjyrë intensive të kaltër.Thekë dy.

VI - VII.

Rritet në vende të thata me diell, shkëmbinj, kullota, shkurrishta etj.



Veronica serpyllifolia L. Veronoka gjethelisre
Scrophulariaceae – Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 5 – 20 (-30) cm, me kërcell pushlor.

Gjethet gjatore ose gati rrotullare, me bishtak të shkurtër, buzëplota ose lehtësisht ura-ura.

Lulet në vile skajore. Vilet me shumë ose pak gjëndra. Kupa me 4 segmentë eliptikë deri vezakë. Kurora e bardheme në lila me vena blu.

IV – VII.

Në vende barishtore me lagështirë, livadhe e ranishte, buzë rrugëve.



Veronica persica Poiret - Veronika persiane
Scrophulariaceae - Sarushtore

Barishtore njëvjeçare, 5 - 50 cm, pushlore.

Gjethet me bisht të shkurtër, vezake të gjera, me bazë pak a shumë të cunguar, me buzë ura - ura si sharrë, kryesisht të këmbyera, por të poshtmet të përkundërta.

Lulet të vetmuara në sqetullat e gjetheve. Vrigujt e kupës vezakë - heshtorë. Kurora blu. Fryti kapsulë, me nervura të dalura.

I - VIII.

Në toka të punuara, kopshte dhe kudo në mjedise të banuara.

Shumëvjeçare barishtore, 5 – 20 cm. Kërcejtë shumë të degëzuar në bazë, të shtrira ose të përpjetme, që formojnë jastëqe.

Gjethet vezake deri gjatore – heshtore, shyte, të gjelbërta – përhime dhe pushlore në faqen e sipërme, me buzë ura – ura ose të sharruara, nganjëherë gati të plota.

Vilet në fillim të dendura e vezake me 25 – 30 lule, më pas të zgjatura. Kurora blu e zbehtë ose e kaltër, rrallë e trëndafiltë ose e bardhë.

III – VI.

Rritet në livadhe të thata e kullota.



Veronica prostrata L. – Veronika e shtrirë
Scrophulariaceae – Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare 10 – 20 cm. Kërcejtë të shtrirë, të drunjëzuar, të shogët.

Gjethet eliptike, buzëplota ose të sharrëzuara, të shogëta përveç bishtakut të qerpiktë, të grumbulluara në majë të kërcellit.

Vilet zakonisht dy, të përkundërta, si kokë, që dalin afër majës së kërcellit dhe që janë të afruara aq sa mund të ngatërrohen për një vile skajore. Boshti i lulesës me qime leshtore. Kurora e kaltër.

V – VIII.

Në shkëmbinj e shpate shkëmbore të zonave malore. Subendemike



Veronica thessalica Bentham – Veronika e Tesalisë
Scrophulariaceae – Sarushtore



Veronica urticifolia Jacq. - Veronika gjethehithre
Scrophulariaceae - Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të fortë horizontalë, 15 – 40 cm.

Gjethet mjaft variabile: të rrumbullakëta, të përmbysëta – vezake, eliptike ose heshtore.

Sipër të shogëta ose me qime të rralla, përposh me qime, sidomos afër dejve. Buza e llapës dy here e dhëmbëzuar deri cekët e çarë.

Lulet në vile skajore kallingjashme e me brakte. Kurora ngjyrë vjollce të errët ose të çelët. Thekë 2.

VI – VIII.

Në vende me bar, pyje e shkurrishta të zonës subalpine. Bimë endemike e Kosovës. Ndeshet në Alpet Shqiptare. U zbulua nga botanisti malazias Lakushiq në vitin 1971.



Ramonda serbica Pan. - Ramonda
Gesneriaceae - Gesneriore

Shumëvjeçare barishtore, 30 – 60 cm. Kërcejtë lulorë të ngritur, pak pushlorë, bima bëhet e murrme kur thahet.

Gjethet pa bisht ose gati pa bisht, vezake të gjera, majëprehta, pushlore, gati si zemër në bazë, me buzë të sharruara.

Lulet në vile 15 - 20 lulëshe. Kupa me 4 segmentë gati të barabartë. Kurora lila ose e trëndafiltë me nervura më të errëta.

V – VII.

Rritet në pyje, veçanërisht në ahishte, në vende me lagështi e gurishtore.



Wulfenia blecicii Lak. – Vulfenia e Bleçiqit
Scrophulariaceae – Sarushtore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rozetë bazale, 15 - 20 cm e lartë.

Gjethet të thjeshta, përsipër të kreshpëta, përposh leshtore të murrme, vezake të përmbysëta, me buzë ura - ura ose dhëmbë - dhëmbë.

Shtija 6 - 8 cm, me 1 - 3 lule 5 - pjesëshe. Kurora e thellë dhe e rrumbullakët si tas, me vriguj të drejtë - të hapur, lila deri manushaqe. Fryti kapsulë.

VI - VII.

Rritet në të çara shkëmbinjsh me hije të zonave malore. Bimë endemike e

Ballkanit.



Campsis radicans (L.) Seem. – Kampsida
Bignoniaceae – Bignoniore

Shkurre me kërcell shpërdredhës, deri 10 m; me rrënjë adventive të dukshme.

Gjethet pendore me 9 – 11 gjethëza eliptike, 3 – 6 cm të gjata me buzë të dhëmbëzuara.

Lulesa me 4 – 11 lule. Lulet gypore me grykë të gjerë, 5 – pjesëshe, 6 – 9 cm, me ngjyrë tjegulle deri të kuqe. Kapsula e varur në trajtë bishtaje, 5 – 15 cm e gjatë.

V – X.

E kultivuar si bimë zbukurimi. Dallohet me rritje të shpejtë. Duron temperaturën e ulët deri – 20 grad Celsius. Ka prejardhje nga Amerika Veriore

Bimë drunore deri 10 m e lartë.

Gjethet 12 – 15 cm, qerthullore, përfundi në trajtë zemre, të plota, rënëse.

Lulesa melth piramidale, 15 – 20 cm. Kupa dybuzore. Kurora 4 – 5 cm, e bardhë, me njolla të kuqe dhe me vijëza të verdha përmbrenda. Kapsula 20 – 35 cm, e varur, në trajtë bishtaje.

Lulëzon VI – VII; frytëzon XI – XII.

E kultivuar për zbukurim. Amerikaneveriore



Catalpa bignonioides Walt. – Katalpa
Bignoniaceae – Bignoniore



Globularia cordifolia L. – Turëza gjethezemër
Globulariaceae – Turezore



Globularia elongata Heget - Turëza e zgjatur
Globulariaceae - Turezore



Acanthus balcanicus H. et J.B.K.R. - Dashtra e Ballkanit
Acanthaceae - Akantore

Shkurrëz shumë e vogël, 5 – 12 cm e lartë, me kërcej të drunjëzuar dhe të degëzuar që lëshojnë aty këtu tufa me rrënjë mitake.

Gjethet lëkurore, me bisht të ngushtuar, në formën e mistrisë, të vendosura në rozeta, me një nervurë. Kërcelli lulembajtë pa gjethe ose me disa gjethe në formë luspash.

Kaptinëza hemisferike. Braktetë e pështjellës heshtore, të errëta, pushlore. Kupa dybuzore, me dhëmbë të gjatë gati sa gypi. Kurora blu – vjollcë.

V – VII.

Nëpër vende të thata plot gurë dhe shkëmbinj të zonave malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, me shumë rizoma pa stolone. Kërcelli është i drejtë, i padegëzuar, në majë me një lulesë kaptinore.

Gjethet të shogëta, ato të rozetës me bishta lopatore ose vezake të gjera. Gjethet kërcellore vezake ose lineare, në bazë të ngushtuara, pa bisht, buzëplota.

Lulesa kaptinë e rrumbullakët. Kupa me qime, vrigujt të mprehtë dy herë më të gjatë se gypi i kupës. Kurora vjollce e kaltër, rrallë trëndafili ose e bardhë.

V - VI.

Rritet në livadhe dhe kullota të thata, sidomos në shkëmbinj gëlqeror. Në Kosovë ka përhapje sporadike.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 25 – 120 cm e lartë, me kërcej të drejtë e të thjeshtë.

Gjethet e bazës jogjembore,llapa 20 – 60 x 5 – 15 cm, zakonisht pendore të prera. Gjethet e sipërme kërcellore pak a shumë me bisht, vezake.

Lulet në kallinj të dendur skajorë e cilindrik. Braktetë rreth 40 cm, vezake. Kupa 4 - 5 cm. Kurora 3.5 – 5 cm, e bardhërreme me vena purpur.

VI – VIII.

Rritet në zona pyjore dhe shkurrnaja malore. Bimë endemike e Ballkanit.



Plantago argentea Chaix – Gjethedelli i argjendtë
Plantaginaceae – Plantaginore

Barishtore shumëvjeçare me një rozetë gjethesh. Gjethet me llapë vezake deri eliptike, gati të plota, me 3 -5 nervura, të shogëta ose me qime të rralla.

Shtijet shumë më të gjata se gjethet. Kallinjtë mbi 4 cm të gjata në kohën me fryt. Sepalet gati të barabarta. Gypi i kurorës i shogët. Pjalmoret të verdheme, fijet të bardhërreme.

VI – VII.

Në kullota alpine atje ku shkrin bora. Ballkanike.



Plantago gentianoides Sibth. et Sm. –
Gjethedelli si sanzëPlantaginaceae – Plantaginore

Barishtore shumëvjeçare me një ose disa rozeta, 20 – 50 cm e lartë.

Gjethet vizake – heshtore, të plota, me qime leshtore të shkurtra e të shtrira ose nganjëherë të mëndafshta, veçanërisht përposh.

Shtijet me 6 – 12 rrëvaga, kallinjtë 0.5 – 2 cm. Kurora me vriguj hialinë. Pjalmoret të bardha.

VI – VIII.

Në vende të thata me bar ose gurë të zonave malore kryesisht gëlqerore.



Plantago dardanae Rexhepi et Dim. –
Gjethedelli i Dardanisë
Plantaginaceae – Plantaginore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Gjethet janë të vendosura në bazën e kërcellit në rozetë, të ngushta, vizake, deri 24 mm të gjata dhe të gjera deri 0.8 mm.

Shtija lulore e gjatë 70 – 75 mm. Braktetë ngjyrë kafe të çelët, 2.3 mm, më të shkurtëra se lulet dhe nuk i mbulojnë ato. Tubi i kurorës i shogët.

VII.

Rritet në kullota silikate alpine në lartësi mbidetare deri 2.500 m. Bimë endemike e Kosovës. Ndeshet vetëm në Gjeravicë. Eshtë zbuluar nga botanisti Rexhepi dhe Millaku në vitin l997.



Plantago lanceolata L. - Gjethedelli heshtor
Plantaginaceae - Plantaginore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 50 cm e lartë.

Gjethet në rozeta bazale, zakonisht vizake - heshtore me 3 - 5 nervura mirë të dalluara, gati të shogëta.

Shtija në pjesën e sipërme ka të zhvilluar lulesën kalli shumë të dendur. Petale 4, në bazë të ngjitura duke formuar një gyp 2 - 3 mm. Pjesët e sipërme të petaleve qëndrojnë të lira dhe janë me ngjyrë kafe.Thekë 4. Ato dalin jasht kurorës, dhe anteret e tyre janë me ngjyrë të verdhë.

IV - X.

Rritet në vende me bar, në djerrishte, buzë rrugëve.



Plantago major L. - Gjethedelli i madh
Plantaginaceae - Plantaginore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 5 - 30 cm e lartë.

Gjethet në një ose disa rozeta. Ato janë vezake ose eliptike deri 10 cm të gjera dhe po aq të gjata, të shogëta, me 3 - 9 nervura.

Shtija lulore e barabartë me gjethet ose i kalon ato. Kalliri është i hollë dhe cilindrik, 5 - 12 cm. Sepalet gati të barabartë, të gjelbër. Kurora në formë gypi, e shogët, me vriguj heshtorë deri vezake gjithashtu të shogët. Fryti kapsulë.

IV - VIII.

Rritet në vende me lagështi, buzë rrugëve, toka të punuara. Bimë mjekësore.



Plantago media L. - Gjethedelli i ndërmjemë
Plantaginaceae - Plantaginore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 60 cm e lartë.

Të gjitha gjethet në një ose disa rozeta, me qime, gradualisht të ngushtuara në një bisht të shkurtër. Llapa eliptike deri vezake eliptike. Shtijat dukshëm më të ngritura se gjethet.

Lulesa kalli gjator – cilindrik, i ngjeshur. Petalet të bardha si të argjendtë. Gypi i kurorës i shogët. Thekët dalin 8 - 13 mm nga kurora me fije lila dhe atraktive. Fryti kapsulë me 2 - 4 fara.

V - VII.

Rritet në kullota të zonës subalpine e alpine. Bimë e helmët dhe mjekësore.



Plantago reniformis G. Beck. – Gjethedelli si veshkë
Plantaginaceae – Plantaginore

Barishtore shumëvjeçare, me disa rozeta gjethesh, 5 – 10 cm e lartë.

Gjethet vizake-heshtore, të sheshta ose të hullizuara, të thepëta, të gjelbra, me 3 – 5 nervura, të shogëta ose pak pushlore.

Shtijet lulore sa ose më të gjata se gjethet. Kalliri gjator-ovoid. Braktetë të plota, gati rrotullare ose si veshkë. Sepalet të lira, pothuajse krejtësisht cipëthata. Gypi i kurorës i shogët. Kapsula konike, me dy kthina.

VI – VIII.

Në kullota e shkëmbinj të zonës subalpine dhe alpine



Plantago atrata Hoppe – Gjethedelli i nxirë
Plantaginaceae - Plantaginore

Barishtore shumëvjeçare zakonisht me një rozetë.

Gjethet në rozetë bazale, me llapë vezake si zemër ose gati rrotullare dhe e cunguar në bazë, ura – ura deri me dhëmbë, pak a shumë me qime të përdredhura, bishti më i gjatë . se llapa.

Shtijet i kalojnë gjethet. Kallinjtë 2 – 6 cm, të dredhura. Fillet e thekëve kanë ngjyrë vjollce – të çelët, anteret janë të bardha.

V – VII.

Në kullota të zonës subalpine dhe alpine. Bimë endemike e Ballkanit. Në Kosovë është e përhapur në Alpet Shqiptare.



Plantago subulata L.- Gjethedelli i fëndyellt
Plantaginaceae - Plantaginore

Bimë barishtore shumëvjeçare me bazë të drunjëzuar.

Gjethet në rozeta bazale. Ato janë trekëndore në gjithë gjatësinë, të ashpra, nganjëherë me qime të dallueshme.

Lulet të grupuara në lulesën kalli. Kallinjtë 2 – 5 x 0.2 - 0.3 cm. Braktetë të thepëta. Lulet katërpjesëshe, aktinomorfe. Fryti kapsulë.

V - VIII.

Rritet në kullota dhe shkëmbinj të zonave malorë, në terrene me natyrë serpentinore.



Verbena officinalis L. - Barshpretka
Verbenaceae - Verbenore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 60 (100) cm. Kërcelli është katërkëndësh, i ngritur dhe i degëzuar. Degëzat pushlore.

Gjethet janë vezake të zgjatura, të vrigulluara ose pendore të çara. Të sipërmet më të vogla dhe pa bisht.

Lulesa vile si kallinj. Ka lule të vogla. Kupa ka 5 dhëmbë të shkurtër, kurora në trajtë hinke, e trëndafiltë e zbehtë. Fryti kapsulë e vogël.

V - IX.

Rritet buzë rrugëve, afër arave, vende me bar deri në zonën subalpine. Bimë mjekësore.



Cymbalaria muralis P. Gaetner – Cimbalare muresh
Lamiaceae – Buzore

Barishtore shumëvjeçare, 10 – 40 cm. Kërcelli i shtrirë i përpjetëm, fillngjashëm, që rrënjëzon në nyjet.

Gjethet të këmbyera, veshkëngjashme deri gjysmërrethore rrallë gati të rrumbullakta, si zemër ose si veshkë në bazë, me 5 – 9 vriguj rrotullarë, faqja e poshtme shpesh e kuqërremtë.

Lulet të vetmuarta në sqetullat e gjetheve. Kurora lila me qiellzë të verdhë e me lythë. Shpori konik. Kapsula e shogët dhe që del nga kupa.

IV – X.

Në shkëmbinj, mure e vende ruderale. Europianojugore.



Hyssopus officinalis L. – Hisapi mjekësor
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore ose shkurre xhuxhe shumëvjeçare, me kërcej 20 – 60 cm, të shumtë, zakonisht të ngritur përpjetë.

Gjethet zakonisht me buzë të spërveshur (në dukje vizake).

Lulesa njëanësore, e përbërë nga qerthuj të rremë me nga 4 – 10 lule. Braktetë vizake. Kupa e shogët ose pushpakë, me gyp 4 mm dhe dhëmbë. Kurora blu – manushaqe.

VI – IX.

Në shkëmbinj dhe kullota me gurë, kryesisht në zona malore. Bimë mjekësore. Euroaziatike.



Acinos alpinus(L.) Moench – Mendërmira e alpeve
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare (gati si shkurrëz) 5 – 3O cm, me kërcej drunorë në bazë, pushlore me qime të rralla deri të dendura.

Gjethet me bisht 1 – 3 mm, me llapë eliptike deri gati rrotullare, të plota ose dhëmbëza – dhëmbëza drejtë majës.

Lulet në qerthuj me nga 3 - 8 lule. Kupa me gyp 4 – 6 mm, e dhëmbëzuar.

Kurora manushaqe me shenja të bardha në buzën e poshtme.

VI – VIII.

Rritet kryesisht në kullota alpine e subalpine.



Acinos arvensis (Lam.) Dandy – Mendërmira arash
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore zakonisht njëvjeçare, pushlore, deri 40 cm e lartë.

Gjethet heshtore deri vezake, shyte ose të mprehta, të plota ose me dhëmbëza.

Lulet në qerthuj të rremë me nga 3 – 8 lule, të cilat zakonisht nuk i kalojnë braktetë. Kurora zakonisht manushaqe me shenja të bardha mbi buzën e poshtme.

V – VII.

Në kullota e vende gurishtore të thata, zakonisht në zonat malore.



Ajuga chamaepitys (L.) Schreber - Ajuga si pishë e vogël
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare jetëshkurtër, 5 - 30 cm, shumë e degëzuar, e shogët deri me qime të dendura, të buta të drejta dhe e epshme.

Gjethet të ndara trish, me segmente vizake. Braktetë të ngjashme me gjethet.

Lulet nga 2 - 4 në çdo nyje. Kupa 4 - 6 mm, me dhëmbë sa ose më të shkurtër se gypi. Kurora zakonisht e verdhë me shenja të kuqe ose purpur. Fryti akenë me rrudha tërthore.

IV - VIII.

Rritet në kullota të thata, livadhe, toka të papunuara e gurishtore.



Lamium bifidum Cyrillo subsp. balcanicum Vel.–
Hithëbuta përgjysmë e çarë. Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore njëvjeçare. Kërcelli i drejtë, i padegëzuar ose i degëzuar që nga baza.

Gjethet me bishtak, vezake – trekëndore, me buzë të dhëmbëzuar.

Lulet të grupuara në qerthuj në majë të kërcellit dhe të degëve. Kupa e e dhëmbëzuar. Gypi i kurorës dukshëm më i gjatë se kupa; buza e sipërme e çarë në dy vriguj. Petalet purpur në manushaqe.

V – VI.

Në vende shkëmbore dhe barishtore. Endemike e Ballkanit.



Lavandula angustifolia Miller – Lavanda gjethengushtë
Lamiaceae – Buzore

Shkurre deri 120 (180) cm, e hirtë – pushbutë.

Gjethet vizake, zakonisht të spërveshura në buzë, pushbutë, të bardha kur janë të reja, që bëhen më vonë të gjelbra.

Lulet në kallinj 3 – 8 cm, me bisht të gjatë; qerthujt e rremë me nga 6 – 12 lule. Braktetë zakonisht më të shkurtra se kupa. Kurora purpur – manushaqe.

VI – IX.

E kultivuar. Bimë mjekësore e aromatike. Mesdhetare



Lycopus europaeus L. – Likopsi i Europës
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me qime të rralla deri të dendura, 20 – 90 cm, me rizome zvarritëse, rrënjëlëshuese, stolonmbajtëse.

Gjethet e poshtme me llapë thellësisht të vrigullt ose të ndarë në bazë; të sipërmet me dhëmbëza..

Qerthujt e rremë luleshumë. Kupa me dhëmbë si të gjembët. Kurora e trëndafiltë ose e bardhë me njolla purpur.

IV – IX.

Në kullota me lagështi, buzë kanalesh, pranë pellgjesh me ujë. Bimë mjekësore.



Ocimum basilicum L. – Borziloku
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore njëvjeçare, 20 – 60 cm e lartë, me qime të gjata kaçurrele me erë të këndshme.
Gjethet të thjeshta, vezake, 1.5 – 5 x 0.8 – 3.2 cm.
Lulet të grumbulluara në qerthuj me nga 3 – 5 lule. Lulet 5 – pjesëshe, zigomorfe, të bardha.
VI – IX.
Mbillet në saksi ose oborret e shtëpisë. Përdoret në kuzhinë si mëlmesë; ka prejardhje nga India.



Thymus vulgaris L. – Lisra e zakonshme
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 40 cm e lartë; kërcelli i drejtë.
Gjethet janë të vogla, me qime të imëta, të hirta – të gjelbra, gjatore, anash të kthyera përposh.
Lulet në qerthuj. Braktetë manushaqe – trëndafili. Kupa gypore, dybuzore; buza e poshtme me dy dhëmbë, kurse e sipërme me tre. Kurora e bardhërreme ose trëndafili e zbehtë.
V – IX.
Në vende gurishtore e kullota të zonave malore, shpatije.



Ziziphora capitata L. – Zizifora e kokët
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcej deri 20 cm, të thjeshtë ose të degëzuar, të ashpër.
Gjethet vizake – heshtore, të plota, zakonisht manushaqe përposh dhe me pika gjëndërore.
Lulesa e shkurtër, lulepakë, e pajisur në bazë me brakte vezake ose rombike të thepëta. Kupa dybuzore, me gyp të gjatë e të përkulur. Kurora paksa dybuzore, 10 – 15 mm, e trëndafiltë.
VI – VIII.
Në mjedise të thata të zonave të ulëta dhe mesdhetare. Europianejuglindore – Aziatikeperëndimore.



Ajuga genevensis L. - Ajuga e Gjenevës
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 50 cm e lartë. Kërcelli është i padegëzuar.

Gjethet gjatore ose eliptike - vezake, 35 - 55 mm të gjata, 10 - 30 mm të gjera, pa bisht dhe pak e përqafojnë kërcellin.

Nga 2 (-3) lule në qerthuj ose në lulesa kalliri. Lulet janë të mëdha, me bisht, të verdha me rrjetë të degëzuar vijash të purpurta.

V - VII.

Rritet në vende shkëmbore - gëlqerore, shkorrete, kullosa etj.



Ajuga laxmannii (L.) Benth. - Ajuga e Laksmanit
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Ka të zhvilluar rizomën që nga pamja e jashtme i ngjanë rrënjës. Kërcejtë të shogët deri leshtor, 10 - 30 cm.

Gjethet e poshtme vezake. Buza e llapës ura - ura ose me vriguj të cekët.

Lulet janë të vendosura në cima të ngjeshura duke formuar qerthuj të rremë me nga 6 deri më shumë lule. Braktetë vezake, zakonisht të vrigullta dhe të ngjyera në blu. Kurora ka ngjyrë blu të çelët, rrallë të trëndafiltë.

IV - VII.

Rritet në kullota, livadhe e shkorrete deri në zonat malore



Ajuga pyramidalis L. – Ajuga piramidale
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë, pa stolone, me kërcej 5 – 30 cm, gati të shogët ose leshtorë.

Gjethet e poshtme vezake të përmbysëta, të plota ose me dhëmbë të rrumbullakët. Braktetë vezake, nganjëherë të vrigullta, zakonisht të ngjyera në blu ose manushaqe; të gjitha i kalojnë lulet.

Lulesa piramidale e ngjeshur, që fillon gati nga baza e kërcellit; me nga 4 – 8 lule. Kurora manushaqe – blu e çelët; gypi e kalon kupën; buza e sipërme e plotë.

V – VIII.

Zakonisht në livadhe të thata, kryesisht në zonat malore.



Ajuga reptans L. - Ajuga zvarritëse
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me erë të rëndë, 20 - 60 cm e lartë.

Gjethet kërcellore të poshtme vezake ose vezake - gjatore, si zemër deri pykore në bazë. Braktezat të fëndyellta ose në trajtë filli, vëmesore.

Lulet në qerthuj të rremë të zhvilluara në sqetull të gjetheve lulore. Qerthujt luleshumë. Kurora zakonisht ngjyrë jargavani.

V - VII.

Ndeshet në toka të papunuara, gjerdhe, gërmadha etj.



Ballota nigra L. - Ballota e zezë
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me stolone të gjata rrënjëlëshuese në nyje, 10 - 40 cm e lartë. Kërcelli i thjeshtë më qime të palosura.

Gjethet e bazës me bishta të gjatë, vezake, të plota ose ura - ura. Gjethet përgjatë kërcellit pa bisht.

Lulet 6 - 8 të grupuara në qerthuj të rremë. Braktetë vezake, të plota, pa bisht, me ngjyrë blu në vjollcë. Kupa me dhëmbë, me qime gjëndërore. Kurora blu, rrallë e trëndafiltë ose e bardhë. Thekët të dalur, me fije leshtake.

IV - VI.

Rritet në livadhe me lagështi, pyje dhe shkorrete deri në zonat malore.



Calamintha grandiflora (L.) Moench –
Mendërmira lulemadhe Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 – 50 cm, leshtake me qime të rralla.

Gjethet vezake ose vezake – gjatore, të mprehta me dhëmbë të thellë

ose të sharruara; dhëmbë 6 ose më shumë në çdo anë.

Lulet në cima me nga l – 5 lule. Kupa gati e shogët, me gyp cilindrik 7 – 8 mm dhe me dhëmbë të pabarabartë. Kurora 3 herë më e gjatë se kupa, manushaqe – e trëndafiltë.

VI – VII.

Rritet kryesisht në pyje gjethegjerë, sidomos në ahishte



Clinopodium vulgare L. - Trumza e rëndomtë
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, l0 – 30 cm, gati e shogët ose pushlore, me kërcej jolulembajtës zvarritës ose rrënjëlëshues.

Gjethet me bisht l – 5 cm. Llapa si zemër, ura – ura e sharruar.

Qerthujt e rremë me nga 2 – 3 lule dhe pak a shumë njëanësore. Braktetë kreshtake. Kupa gypore, e grathët dhe me dhëmbë. Kurora 2 – 2.5 herë më e gjatë se kupa, ngjyrë qielli në lila. Fryti aken.

IV – V.

Në shkurrnaja dhe vende me bar, sidomos në toka me lagështi.



Galeopsis speciosa Miller - Galeopsa e bukur
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 - 70 cm e lartë, pushlore deri leshtore.

Gjethet vezake - heshtore ose vezake, të rrumbullakuara ose pykore në bazë, cektësisht ura - ura të sharruara.

Lulet në cima pa bisht, të ngjeshura si lëmshuk, të rrethuara me një pështjellë braktesh të zhvilluara dhe me qerpikë të gjatë. Kurora e trëndafiltë në purpur.

VI - VIII.

E ndeshim në shkorrete dhe pyje gjethegjerë.



Glechoma hederacea L. – Glekoma si urth
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore njëvjeçare, 20 - 40 (- 80) cm e lartë. Kërcejtë në kënde me qime kreshtake.

Gjethet me bisht, me llapë vezake - eliptike, me buzë të dhëmbëzuara.

Lulet në qerthuj të dendur me nga 4 - 8 lule. Kupa gypore me dhëmbë gati të gjembët. Kurora e verdhë ose e bardhë në të verdhë, me një njollë të madhe purpur në buzën e poshtme.

VI - VIII.

Rritet në çeltira pyjesh, gjerdhe e vende me bar deri në zonën e ahishteve.



Glechoma hirsuta W. et K. - Glekoma qimeashpër
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 15 - 70 cm e lartë, e mbuluar me qime të shpërndara deri të dendura.

Gjethet kanë trajtë vezake deri vezake - rrotullare. Buza e llapës me dhëmbë të trashë.

Lulet janë të grupuara në qerthuj të rremë me 8 - 15 lule. Kupa është gypore dhe e dhëmbëzuar. Kurora e verdhë, shpesh me gyp manushaqe. Buza e poshtme me tre vriguj pak a shumë të barabartë.

V - VIII.

Rritet në pyje dhe vende me hije të zonave malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të zhvilluar mirë dhe me stolone. Kërcelli me qime, 20 – 50 cm i lartë.

Gjethet 4 – 7 cm të gjata, 2 – 4 cm të gjera, si zemër – vezake ose vezake – gjatore, ashpër të sharruara. Qerthujt e rremë të ngjeshur me 6 – 16 lule. Kupa kambanore e mbuluar me qime të rralla. Kurora zakonisht e bardhë, nganjëherë e bardhë në të verdhë, afërsisht 3 herë më e gjatë se kupa..

V – VIII.

Çeltira pyjesh të zonës kodrinore dhe malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 50 cm, si glekoma si urthi, por zakonisht më e madhe dhe me qimëri më të dendur.

Gjethet me bisht 3 – 4 cm, të sipërmet gjerësisht vezake - trekëndore, ura - ura të sharruara.

Lulet nga 4 - 7 në sqetullat e gjetheve. Dhëmbët e kupës 2 herë më të shkurtër se tubi i saj. Kurora ngjyrë manushaqe, 20 – 30 mm.

IV – VI.

Rritet në pyje, shkorrete dhe gjerdhe.



Lamiastrum galeobdolon (L.) Crantz. -
Hithëbuta galeobdolon Lamiaceae - Buzore



Lamium album L. – Hithëbuta e bardhë
Lamiaceae – Buzore



Lamium amplexicaule L. - Hithëbuta kërcellpushtuese
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore njëvjeçare, 8 - 20 cm e lartë, me qime deri të dendura.

Gjethet e sipërme në formë zemre, pa bisht, kërcellpushtuese, ura - ura. Gjethet e poshtme me bisht dhe po ashtu të dhëmbëzuara thellë.

Lulet në qerthuj të rremë me kupë dhe kurorë. Kurora si e trëndafiltë - purpur me një gyp të drejtë. Anteret leshtake.

III - X.

Në toka të punuara, kopshte, vreshta.



Lamium garganicum L. - Hithëbuta e malit Gargan
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët ose gati e tillë, 20 - 60 cm e lartë.

Gjethet si zemër - vezake. Buza e llapës ura - ura.

Lulet janë të grupuara në çerthuj. Kupa ka formë gypi dhe e dhëmbëzuar në pjesën e sipërme. Kurora dybuzore, e trëndafiltë deri e purpurt. Buza e sipërme e çarë dysh ose me dhëmbë të cekët. Thekët leshtake.

IV - VIII.

Rritet në vende të freskëta shkëmbore të zonave malore deri ato alpine



Lamium maculatum L. - Hithëbuta me njolla
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 80 cm e lartë. Kërcelli i drejtë pushator.

Gjethet me bisht 2 - 4 cm të gjatë. Llapa trekëndore - vezake ose si zemër, shpeshherë me njolla të bardha, ura - ura të sharruara trashë dhe në mënyrë të çrregullt.

Lulet të purpurta të kuqe. Kupa me dhëmbë heshtor. Kurora me gyp të përkulur në trajtë të germës S. Buza e poshtme me njolla të errëta.

III - IX.

Në toka të papunuara, gjerdhe, pyje e shkorrete.



Lamium purpureum L. - Hithëbuta e purpurt
Lamiaceae - Buzore

Bimë njëvjeçare pushlore, 10 - 20 (- 30) cm e lartë. Kërcejtë lulorë shumë a pak të shtrirë në fund dhe që ngrihen gradualisht.

Gjethet e poshtme të rrumbullakëta; të sipërmet vezake. Llapa ura - ura ose dhëmbë - dhëmbë. Gjethet lulore të afruara.

Lulet në qerthuj të dendur. Kupa gypore me 5 dhëmbë. Kurora purpur në manushaqe, me gyp të drejtë. Buza e sipërme e plotë. Anteret leshtake.

III - IX.

Në toka të punuara e të papunuara, kopshte, vreshta etj.



Leonurus cardiaca L. - Bishtluani i zemrës
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 - 80 (- 150) cm e lartë.

Gjethet të hirta. Në anën e poshtme me qime të cilat bien. Të poshtmet me 5 - 7 vriguj, të sipërmet deri thellësisht të çara trish.

Çerthujt e rremë me plotë lule. Kupa gypore me dhëmbë. Kurora e bardhë ose e trëndafiltë. Buza e saj e sipërme me plotë qime nga ana kurrizore. Fryti aken, me maje të fortë si gjemb.

VI - VIII.

Rritet në toka të papunuara, buzë kanalesh, vende me pleh. Bimë mjekësore.



Melissa officinalis L. - Milca mjekësore
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 100 - 150 cm e lartë. Kërcejtë janë të ngritur dhe të degëzuar.

Gjethet gjerësisht vezake ose gjatore, me erë të këndshme si të limonit. Buza e llapës pak a shumë me ura të thelluara përveç bazës.

Lulet në qerthuj sqetullor. Qerthujt kanë 4 - 12 lule. Kupa dybuzore. Buza e sipërme ka tre dhëmbë, e poshtmja dy. Kurora po ashtu dybuzore, e verdheme. Pas fekondimit merr ngjyrë të bardhë ose të trëndafiltë.

V - VII.

Rritet në gjerdhe e shkurrnaja me hije. Bimë mjekësore dhe mjaltëse.



Satureja montana L. – Shtërmeni
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 - 120 cm e lartë, e merme. Kërcelli i hirtë - leshtor, nganjëherë me qime të rralla.

Gjethet e kundrejta, të buta, pak a shumë të hirta ose të bardheme, të sharruara, heshtore. Gjethet e kërcellit pa bisht.

Lulet në qerthuj të rremë duke formuar kallinjë cilindrik në maje të kërcellit dhe degët. Kupa leshtake. Kurora jargavan ose e bardhë.

VI - VIII.

Rritet në livadhe me lagështi, buzë vendeve me ujë.



Mentha longifolia (L.) Hudson - Mendra gjethegjatë
Lamiaceae - Buzore

Bimë shumëvjeçare gati si shkurrëz, e merme, me kërcej lulembajtës, 10 – 40 cm, pushpak ose e shogët.

Gjethet heshtore të ngushta, të shogëta ose me qime dhe me pika gjëndërore të tejdukshme.

Qerthujt e rremë më shpesh të dendur. Braktetë e poshtme i kalojnë qerthujt e rremë. Kupa gypore, me dhëmbë të mprehtë. Kurora zakonisht e trëndafiltë e çelët.

VII – IX.

Në shpate gurishtore, kullota të thata etj, deri në zonat malore.



Melittis melissophyllum L. - Melitis gjethemilce Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare me erë të fortë. Kërcejtë janë 30 deri 50 cm të lartë.

Gjethet gati të pabisht, si zemër deri të cungëta në bazë. Buza e llapës me dhëmbë të mëdha.

Lulet janë të grupuara në qerthuj. Qerthujt kanë nga deri 6 lule të vendosura në mënyrë njëanësore. Kupa dybuzore. Kurora po ashtu dybuzore dhe e bardhë. Buza e poshtme shpesh me shenja të trëndafilta ose purpur.

V - VIII.

Rritet në pyje gjethegjerë deri pranë zonës së ahishteve.



Mentha pulegium L. - Mendra e egër
Lamiaceae - Buzore



Micromeria albanica Griseb. K. Maly - Bishtmiu shqiptar
Lamiaceae - Buzore



Micromeria cristata (Hampe) Griseb. –
Bishtmiu kreshtak. Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 40 cm, gati e shogët deri pushlore, me erë të fortë.

Gjethet vezake paksa të dhëmbëzuar ose të plota.

Lulet në qerthuj të rremë luleshumë. Braktetë si gjethe,por më të vogla. Kupa me dhëmbë jo të pabarabartë e të qerpiktë. Kurora e trëndafiltë.

V - IX.

Në mjedise me lagështi, gropa e pellgje, buzë ujrave. Bimë eterovajore.

Bimë barishtore shumëvjeçare me pjesën e poshtme të kërcellit të drunjëzuar. Kërcej ka shumë dhe të degëzuar, rreth 20 - 40 cm të lartë. Tërë bima është e mbuluar me qime të bardha të hirta .

Gjethet janë ovale, shytë, zakonisht të ngushtuara në bisht, aromatike.

Lulesa është terminale, në fillim e ngjeshur. Braktetë janë lineare, me maje. Kupa e hirtë, rreth 3 mm e gjatë. Kurora me tub pak të lakuar, e bardhë. Buza e poshtme me njolla ngjyrë manushaqe të zbehtë.

VII - VIII.

Në vende shkëmbore – gëlqerore të zones kodrinore – malore. Bimë endemike e Kosovës, e përhapur në grykën e lumit të Prizrenit,dhe te Ura e Shenjtë. Eshtë zbuluar nga botanisti gjerman A. Grisebach në vitin l841.

Bimë shumëvjeçare, 5 – 20 cm , me kërcej të shumtë, të ngritur, hollakë, të thjeshtë dendësisht pushlore me qime të shkurtra dhe të hapura.

Gjethet e poshtme gjatore ose eliptike, të tjera vizake, pushpakë ose pushlore me qime të rrasura, të vendosura njëra mbi tjetrën gati në gjithë kërcellin.

Qerthujt e rremë me (2-) 6 (-10) lule. Kupa pushlore, leshtore në grykë; dhëmbët heshtore deri vizake – heshtore. Kurora e purpurt.

V – VII.

Në vende të thata gurishtore dhe shkëmbinj. Endemike e Ballkanit.



Nepeta nuda L. – Nepeta lakuriqe
Lamiaceae – Buzore

Shumëvjeçare barishtore me kërcej 50 – 120 cm, të shogët, katërkëndorë përsipër, me degëzim vastakor.

Gjethet vezake deri vezake – gjatore, pak a shumë si zemër në bazë, me buzë ura – ura, të poshtmet me bisht të shkurtër, të sipërmet pa bisht.

Lulesa e degëzuar, me gjethe të reduktuara. Kupa me dhëmbë. Kurora manushaqe ose e bardhërreme.

VI – VII.

Në vende me bar dhe shkëmbore të zonave malore dhe alpine.



Origanum vulgare L. - Rigoni i zakoshëm
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e merme, me kërcej deri 90 cm, në pjesën e sipërme e degëzuar, zakonisht pushlore.

Gjethet me bishtak, vezake, të plota.

Lulesa vastakore, e dendur, e përbërë nga lëmshukë ose kalithi vezak deri prizmatik. Braktezat të shogëta, të purpurta ose të blerta. Kupa gypore me dhëmbë. Kurora e trëndafiltë, rrallë e bardhë.

VII - IX.

Rritet në vende barishtore, shkurraja e pyje të rralla. Bimë mjekësore e aromatike.

Ndër ne përdoret si çaj mali. Bimë mjekësore dhe mjaltëse.



Prunella laciniata L. – Prunela e rripëzuar
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 15 – 30 cm, dendësisht pushlore.

Gjethet e bazës të plota; kërcelloret dora – dorës të çara deri pendore të ndara.

Lulesa në bazë me gjethe. Braktetë veshkëlore. Kurora e verdhë – zbehtë ose e bardheme, me gyp 10 mm.

V – IX.

Përgjithësisht në kullota të rrahura nga dielli, shkurrnaja.



Prunella vulgaris L. - Prunela e rëndomtë
Lamiaceae - Buzore



Salvia aethiopis L. - Sherbela etiopiane
Lamiaceae - Buzore



Salvia argentea L. – Sherbela e argjendtë
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë të shkurtër, deri 30 cm e lartë. Kërcejtë të degëzuar, të ngritur ose të përpjetëm.

Gjethet e kundrejta, vezake - heshtore, pak a shumë pushlore.

Lulesa kalli i dendur cilindrik me qerthuj të rremë. Lulesa ka dy gjethe në bazë. Braktetë veshkëlore. Kurora ngjyrë manushaqe, petalengjitur duke formuar një gyp më të gjatë se kupa.

IV - X.

Rritet kryesisht në kullota e livadhe me lagështi, gjerdhe e shkurrnaja.

Bimë barishtore dyvjeçare, rrallë shumëvjeçare, me rrënjë të fortë boshtor. Kërcelli i mbuluar me qime të bardha - të merimangëta, i drejtë, i fortë dhe me aromë.

Shumica e gjetheve janë të vendosura në rozetë. Bishti i gjethes 2 – 5 cm, me qime të dendura leshtorë. Llapa vezake - eliptike, 2 - 25 x 2 – 5 cm.

Qerthujt me nga 6 - 12 lule. Kupa gypore - kambanore, leshtore. Kurora e bardhëreme, dy herë më e gjatë se kupa.

VI – VIII.

Rritet në vende të thata, djerrina etj. Në Kosovë pak e përhapur.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 80 cm, gjëndërore me erë të keqe.

Gjethet e bazës dendësisht leshtore, me llapë ura – ura ose të vrigullt; të sipërmet pak a shumë qimerënë dhe të reduktuara.

Qerthujt e rremë me nga 4 – 8 lule. Braktetë veshkëlore. Kupa me gyp 7 mm dhe dhëmbë 2 – 5 mm. Kurora zakonisht e bardhë, e ngjyer në trëndafili ose të verdhë; buza e sipërme tepër kosërake dhe leshtake.

VI – VII.

Në toka të thata të papunuara, shpesh në vende shkëmbore e të thata.



Salvia amplexicaulis Lam. - Sherbela kërcellpushtuese
Lamiaceae - Buzore



Salvia glutinosa L. - Sherbela veshtullore
Lamiaceae - Buzore



Salvia horminium L. - Sherbela e gjelbër
Lamiaceae - Buzore

Bimë shumëvjeçare, deri 80 cm e lartë, me kërcell dendësisht leshtore.

Gjethet gati të shogëta përsipër, përposh pushlore. Të poshtmet pa bisht ose me bisht të shkurtër, të sipërmet pa bisht dhe kërcellpushtuese.

Lulet zakonisht në qerthuj të rremë sqetullorë. Qerthujt me nga 6 - 8 lule. Kupa dybuzore, pushlore me qime të hapura. Kurora ngjyrë manushaqe.

VI - VII.

Rritet në çeltira pyjesh, kullota e livadhe, buzë rrugësh të zonave malore. Bar i keq i kulturave bujqësore.

Bimë barishtore shumëvjeçare ngjitëse, e merme në lulesë. Kërcejtë të thjeshtë ose të degëzuar, 40 - 60 (-80) cm. Rizoma e drunjëzuar.

Gjethet e poshtme me bisht 6 – 8 cm; llapa heshtore ose si zemër, pushlore dhe me dhëmbë shytë.

Qerthujt e rremë me nga 2 - 6 lule. Kupa gypore - kambanore. Kurora me gyp të bardhemë me buzë të mëdha, të verdha dhe rrëvaga ose pikëza manushaqe.

VII – IX.

Rritet në pyje me hije të freskëta, më rrallë në zona të ulëta.

Bimë barishtore njëvjeçare, 20 - 50 cm, me kërcej të ngritur, të thjeshtë ose të degëzuar.

Gjethet heshtore në vezake - heshtore, urëza - urëza, pushlore, shyta.

Lulesa e dendur. Lulet në qerthuj të rremë sqetullorë me nga 4 - 8 lule. Braktetë në pjesën e sipërme me ngjyrë manushaqe dhe formojnë një xhufkë skajore. Kupa pushlore, kurora e trëndafiltë ose manushaqe.

IV - V.

Në toka të papunuara, kullota etj.



Salvia officinalis L. – Sherbela mjekësore
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 100 cm e lartë, e drunjëzuar në bazë. Kërcejtë e ngritur përpjetë, pak të degëzuar dhe zakonisht pa gjethe në pjesën e sipërme.

Gjethet pendore të prera ose pendore me 3 - 6 çifte segmentesh anësore të vogla, të rrudhosura dhe të mbuluara me qime të rrasura.

Lulet në qerthuj të rremë me nga 2 - 4 lule. Kupa dendësisht gjëndërore - pushlore. Kurora deri 40 mm, manushaqe - blu ose blu.

V - VII.

Në vende të thata, buzë rrugësh, kryesisht në toka serpentinore. Bimë endemike e Ballkanit.



Salvia ringens Sibth. et Sm. - Sherbela kurorëhapur
Lamiaceae - Buzore

Shkurrëz 3O – lOO cm, e hirtë – pushbutë, e merme. Kërcelli drunor në bazë.

Gjethet zakonisht pa veshëza në fund, vezake.

Qerthujt e rremë me 5 – l O lule. Kupa me dhëmbë. Kurora ngjyrë manushaqe.

V – VII.

Rritet më shpesh në substrat të thatë e shkëmbor, kryesisht në zona të ulëta e mesdhetare. Ndër ne e kultivuar. Bimë mjekësore.



Salvia pratensis L. - Sherbela e livadheve
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 40 - 80 cm e lartë, me kërcell të ngritur, të degëzuar, pushlor.

Gjethet bazale të thjeshta, me bisht 3 - 4 cm dhe llapë vezake dhe me buzë ura – ura. Faqja e sipërme e rrudhët, e poshtmja e kreshpët. Gjethet kërcellore më të vogla, të pabisht.

Lulet në qerthuj të rremë sqetullorë, të drejta, me degëza të shkurtëra. Qerthujt me nga 4 - 6 lule. Kurora e kaltër - violet, dy - buzore. Thekë dy. Fryti aken.

V - VIII.

Rritet në vende të thata barishtore, shpatije gurore.



Salvia sclarea L. - Shëngjini
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, më rrallë dyvjeçare, shumë e degëzuar, zakonisht gjëndërore nga lartë, 50 - 110 cm, me kërcell të trashur.

Gjethet të thjeshta. Të poshmet në vitin e parë në trajtë rozete, të mëdha. Kërcelloret me llapë 5 - 12 cm.

Lulesa e hapur, qerthujt e rremë me nga 4 - 6 lule. Braktetë vemesore, manushaqe. Kupa me gyp të grathët. Kurora e trëndafiltë ose si jargavan.

VI - VII.

E ndeshim në shkurrnaja e pyje të prerë, në shpate të thata. Bimë e helmët.



Salvia verbenaca L. – Sherbela shporizë
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 – 80 cm, me kërcej të degëzuar, me qime gjëndërore sipër.

Gjethet bazale me bishtak 2 – 5 cm dhe llapë eliptike, me 3 – 4 vriguj; kërcelloret më të vogla dhe pa bisht.

Lulesa zakonisht e thjeshtë, e zgjatur; qerthujt e rremë me nga 6 – 10 lule; braktetë të gjelbra. Kupa zmadhohet paksa në kohën e frytit. Kurorëza blu, jargavan ose manushaqe; buza e sipërme e kurorëzës jo e përkulur në formë drapri.

IV – IX.

Në toka të thata të papunuara, kullota, buzë rrugësh etj., kryesisht në zona të ulëta.



Salvia verticillata L. – Sherbela qerthullake
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 80 cm, me kërcej të thjeshtë ose me degë të shkurtra, pak a shumë të ngritura

Gjethet e poshtme me bisht. Bishti shpesh me dy pjesëza heshtore. Llapa në trajtë zemre, me dhëmbë të trashë; të sipërmet më të vogla, gati të pabisht.

Lulet të grumbulluara në qerthuj nga 15 – 30 lule të vogla ngjyrë qielli ose të hapët lila.

VI – IX.

Kryesisht në kullota, buzë livadhesh e rrugësh të zonave malore.



Scutellaria alpina L. – Skutelara e alpeve
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcej 20 – 50 cm, të ngritur, të thjeshtë ose të degëzuar.

Gjethet vezake, ura – ura të sharruara, të mprehta, si zemër në bazë, gati të shogëta deri pushlore me qime të shpërndara.

Lulet të vendosura në lulesë njëanësore. Braktetë të plota. Kurora purpur ose manushaqe në purpur, me gyp të përkulur. Buza e poshtme zakonisht e bardheme.

V – VII.

Element i pyjeve kryesisht me ah dhe bungë.

Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcej 30 – 60 cm, e gjelbër si e hirtë, me qime të shtrira; degët të hapura.

Gjethet heshtore, më rrallë gjatore ose vezake të përmbysëta, të ngushtuara në bazë, ura – ura të sharruara, pushbutë të bardheme.

Qerthujt e rremë me 6 – 10 lule, zakonisht të larguar. Braktetë vizake, të shkurtra, të fëndyellta. Kupa me 5 dhëmbë të barabartë e të drejtë. Kurora e bardhë.

VII – VIII.

Në toka të papunuara, gërmadha e vende të thata, kryesisht në zonat mesdhetare.

Gatishkurrëz, me kërcej deri 30 cm, të përpjetëm, të thjeshtë ose të degëzuar, pak a shumë pushlore.

Gjethet vezake, rrallë heshtore, ura – ura të sharruara, zakonisht shytë, të poshtmet me bishtak; të sipërmet pak a shumë të pabisht.

Lulesa e dendur, gjatore. Braktetë heshtore të thepëta, të plota, të vendosura si tjegulla, të pabisht, purpur. Kurora purpur ose manushaqe.

VI – VIII.

Në vende gurishtore e shkëmbore të pjerrëta të zonave të larta malore.



Scutellaria columnae All. – Skutelara e Kolonës
Lamiaceae – Buzore



Marrubium peregrinum L. - Bari i qenit
Lamiaceae – Buzore



Sideritis montana L. – Sideriti i malit
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 40 (-60) cm, e kreshpët, me kërçep që mbart rozeta skajore gjethesh të qëndrueshme; kërcejtë lulorë anësorë, zakonisht gatishtijorë.

Gjethet e bazës me bisht 5 – 10 cm me llapë trekëndore, si zemër. Kërcelloret më të vogla, gati të pabisht.

Lulet në qerthuj të rremë, zakonisht në kalli të dendur. Kupa gypore dhe me dhëmbë. Kurora e verdhë e çelët; buza e sipërme e çarë dysh.

VI – VIII.

Rritet në kullota, livadhe të thata, shkorrete, vende shkëmbore etj. të zonave të larta malore.



Stachys alopecurus (L.) Ben. - Sarusha
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore njëvjeçare, deri 30 cm, leshtore.

Gjethet gjatore – heshtore, dhëmbë – dhëmbë.

Qerthujt e rremë me nga rreth 6 lule, të larguar ose pak a shumë të ngjeshur. Dhëmbët e kupës gati të barabartë dhe të halëzuar. Kurora e verdhëme që nxihet kur thahet, zakonisht me buzën e poshtme të verdhë.

V – VII.

Në vende të thata barishtore e kullota.



Stachys alpina L. - Sarusha alpine
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë horizontale. Kërcejtë të ngritur, 30 - 100 cm.

Gjethet me bisht. Llapa thellësisht si zemër në bazë.

Qerthujt e rremë luleshumë, zakonisht të larguar. Lulet të pabisht ose gati kështu. Braktetë të fëndyellta. Kupa gypore me dhëmbë. Kurora zakonisht e murrme-manushaqe, dendësisht leshtake.

VI - VII.

Kryesisht në pyje dhe kullota të zonave malore.



Stachys officinalis (L.) Trevison - Sarusha mjekësore
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 120 cm, e ngritur, leshtake me qime të rralla deri të dendura.

Gjethet heshtore, të mprehta, si zemër në bazë , me buzë ura – ura, të poshtmet me bishtak të shkurtër; të sipërmet të pabisht.

Qerthujt e rremë zakonisht me nga 4 – 10 lule; të sipërmit të ngjeshur, të poshtmit të larguar. Kurora e trëndafiltë – purpur, pushpak.

VI – VIII.

Në vende me lagështirë, buzë ujërave të rrjedhshme.



Stachys palustris L. – Sarusha e kënetës
Lamiaceae – Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 40 (- 80) cm e lartë, e shogët deri dendësisht e kreshpët, me kërçep. Kërçepi përfaqëson një kërcell të shkurtër nëntokësor nga i cili dalin gjethet në rozetë skajore.

Gjethet bazale me bisht, me dhëmbë të thellë. Ato kërcellore gati pa bisht, me qime të bardha dhe të buta.

Lulesa kalli me qerthuj lulor të ndërprerë. Kurora e kuqe në purpur. Buza e sipërme e plotë.

VI - VIII.

Rritet në kullota të thata, pyje e shkurrnaja të zonave malore.



Stachys germanica L. - Sarusha e Gjermanisë
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, pushbutë - e hirtë. Kërcejtë të ngritur, 30 - 100 cm.

Gjethet gjatore deri gjatore - vezake, llapa si zemër në bazë, pushbutë - e hirtë në pjesën e poshtme.

Lulesa luleshumë. Lulet në qerthuj të rremë. Kupa e ngjitur duke dhënë një gyp me dhëmbë. Kurora dendësisht leshtake me ngjyrë trëndafili.

VI - VIII.

Në vende barishtore, toka të papunuara dhe kullota deri në zonat malore.



Stachys recta L. - Sarusha e drejtë
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, e ngritur, 30 - 100 cm e lartë, me qime ose gjëndërore - pushlore.

Gjethet të përkundërta, të mbuluara dendësisht me qime të hapëta. Të poshtmet me bisht 4 - 6 cm e llapë vezake si zemër 7 - 10 x 5 - 8 cm. Buzët e llapës ura - ura të sharruara dhe të mprehta.

Qerthujt e rremë zakonisht me nga 6 lule, pak a shumë të ngjeshur. Kupa gjëndërore - pushlore, me gyp 3 - 4 mm, me dhëmbë të barabartë. Kurora zakonisht e trëndafiltë me vena purpur. Vrigulli i mesëm i buzës së poshtme të kurorës më i madh se ata anësor. Fryti aken.

VI - VIII.

Rritet në pyje me lagështirë dhe hije.



Stachys sylvatica L. - Sarusha e pyllit
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizoma zvarritëse, 20 - 40 cm e lartë, e ngritur ose e përpjetme, gati e shogët deri e kreshpët, me kërcell me brinjë.

Gjethet e kundrejta. Të poshtmet gjatore deri vezake, të rrumbullakuara ose pykore në bazë, të plota deri ura - ura të sharruara.

Lulet në qerthuj me nga 6 - 10 lule. Kupa me dhëmbë trekëndorë dhe më të shkurtër se gypi i kupës. Kurora dybuzore, e verdhë e zbehtë ose e verdhe në të bardhë, . Fryti aken trekëndor.

V - VIII.

Rritet në vende me gur, shkëmbinj, kullota të thata. Bimë e helmët.



Stachys scardica (Griseb.) Hayek - Sarusha e Sharrit Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 - 60 cm e lartë. Kërcelli i drejtë dhe i padegëzuar, me qime të dendura të gjata.

Gjethet e poshtme me bishta, të sipërmet pa to. Ato kanë formë gjatore - heshtore deri heshtore të sharrëzuara, përposh pushbutë me qime të hirta yjore.

Lulesa në trajtë kalliri të çlirtë. Kupa gypore me dhëmbë shumë më të shkurtër se gypi. Kurora e bardhë me nuanca të kuqe, dybuzore. Buza e sipërme e drejtë, pak e fryrë, e plotë. Buza e poshtme trevrigujshe.

VII - VIII.

Rritet në kullota, shkurre dhe pyje. Bimë endemike e Ballkanit.



Teucrium chamaedrys L. – Arrsi dushk i vogël
Lamiaceae - Buzore

Gati shkurrëz, zakonisht 20 - 35 cm, me kërcej lulembajtës njëvjeçarë, leshtakë.

Gjethet me bishta të shkurtër; llapa e gjethes gjatore ose gjatore - vezake, të plotë deri të çarë – të sharruar, me dhëmbë shytë, zakonisht pushlore përposh.

Lulet trëndafili të vendosura nga 2 në sqetullën e gjethes. Kupa gypore me dhëmbë gati të barabartë.

V - VII.

Në shkurrishta e vende gurishtore të thata. Bimë mjekësore.



Teucrium montanum L. – Arrsi malesh
Lamiaceae – Buzore

Shkurre e ulët, me kërcej zakonisht deri 15 cm, drunore e të degëzuar në bazë, me qime të bardha të thjeshta e të rrasura.

Gjethet lëkurore, ngushtësisht eliptike, të plota, të pabisht, me push të bardhë përposh.

Lulet të vendosura në kokë gjysmë sferike skajore, me brakte në trajtë gjethesh. Kupa me dhëmbë heshtorë. Kurora e verdhë e çelët.

VI – VII.

Në vende gurishtore e shkëmbore të thata të zonave malore.



Teucrium polium L. – Bar i majasëllit
Lamiaceae - Buzore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 45 cm e lartë, me kërcej leshtakë - të hirtë.

Gjethet të tufëzuara, zakonisht heshtore. Në pjesën e sipërme të kërcellit gjethet të dhëmbëzuara, në të dyja faqet me qime.

Lulesa kokë e përbërë, me brakte në trajtë gjethesh. Kupa dendësisht leshtake. Kurora e bardhë ose pak a shumë e skuqur.

VI - VIII.

Rritet kryesisht në vende të thata e kullota. Bimë mjekësore.



Campanula albanica Witasek – Lulekambana shqiptare
Campanulaceae – Kambanore



Campanula alpina Jacq. - Lulekambana e Alpeve
Campanulaceae - Kambanore



Campanula cervicaria L. – Lulekambana si qafë
Campanulaceae – Kambanore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcej 8 – 15 (-27) cm, të përpjetëm deri të ngritur, të shogët.

Gjethet e bazës si zemër, të sharruara, që mungojnë gjatë kohës së lulëzimit. Kërcelloret eliptike të ngushta deri vizake, majëmprehta.

Lulet të vetmuara ose 2 – 3 e më tepër së bashku. Dhëmbët e kupës trekëndësh të ngusht. Kurora blu deri manushaqe.

VII – VIII.

Në vende shkëmbore dhe gur të zonës subalpine dhe alpine. Bimë endemike e Ballkanit. Në Kosovë është e përhapur në Malet e Sharrit (Shtëpia e Malorëve) dhe Alpet Shqiptare.

Shumëvjeqçare me rizomë të shëndoshë e pa stolone. Kërcelli 5 – 15 cm, i ngritur, i thjeshtë me hulliza.

Gjethet vizake - heshtore, me buzë urëza - urëza, leshtore.

Lulet të shumta, në vile pak a shumë të përbërë. Dhëmbët e kupës majëhollë, leshtorë, qartësisht më të shkurtër se kurora. Kurora ngjyrë qielli në lila, kambanore.

VI – VII.

Rritet në kullota të zonave malore deri alpine.

Shumëvjeçare barishtore, 20 – 70 cm, me kërcell të ngritur, të thjeshtë, me hulliza, i grathët, i kreshpët.

Gjethet e bazës vizake – pallake, që vijnë duke u ngushtuar drejtë bazës; kërcelloret gjatore – heshtore, më të sipërmet gjatore që zgjerohen në bazë, pa bisht.

Dhëmbët e kupës vezake, shytë, më të shkurtër se kurora. Kurora hinkëngjashme, blu e zbehtë lila, e grathët. Shtyllëza del përtej grykës së kurorës.

VI – VIII.

Në kullota të thata dhe pyje.



Campanula foliosa Ten. – Lulekambana gjetheshumë
Campanulaceae – Kambanore

Shumëvjeçare barishtore me qime të rralla ose gati e shogët. Kërcelli 15 – 80 cm, i ngritur, i thjeshtë, i kuqërremtë.

Gjethet e poshtme vezake-heshtore me buzë dhëmbëza-dhëmbëza; të sipërmet trekëndore - si zemër, kërcellpështjellëse.

Lulet në kaptina të dendur skajore dhe eventualisht të tjerat të vetmuara ose në tufëza në gjysmën e sipërme të kërcellit. Kupa me gyp 5 mm të gjatë dhe dhëmbë trekëndorë- - majëmprehtë. Kurora ngjyrë manushaqe.

VI – IX.

Rritet në livadhe të thata, shkurraja, buzë pyjeve, deri në zonën subalpine.



Campanula patula L. - Lulekambana e hapur
Campanulaceae - Kambanore

Shumëvjeçare barishtore, 20 – 40 cm, me kërcell të ngritur, të thjeshtë, cilindrik, pushlor përposh.

Gjethet pak a shumë pushlore. Të bazës vezake të gjera, si zemër ose rrotullare në bazë, me buzë të sharruara e me bisht 4 – 8 cm pak të flatruar. Kërcelloret me bisht të shkurtër, ndërsa kërcelloret më të sipërme pothuajse pa bisht.

Lulesa kaptinëz skajore. Dhëmbë e kupës si fëndyell, të qerpiktë, më të shkurtër se gypi i kurorës. Kurora manushaqe.

VI – VIII.

Rritet në livadhe malore dhe pyje. Subballkanike. Në Kosovë është e përhapur në Alpet Shqiptare, Malet e Sharrit.



Campanula glomerata L. - Lulekambana lëmshore Campanulaceae-Kambanore

Bimë barishtore dyvjeçare, 30 - 70 cm e lartë, me kërcej të ngritur hollakë, pak a shumë të degëzuar e me push të rrallë.

Gjethet heshtore deri vizake, shyta e me buzë ura - ura.

Lulesa melth i gjerë e me degë të hapura. Kupa me dhëmbë majemprehtë. Kurora hinkëngjashme, ngjyrë jargavani, e ndarë pothuajse deri në gjysmën e gjatësisë. Kapsula ovoide, e ngritur, me 10 nervura të dalura.

V - VII.

Në livadhe, pyje të rralla e shkorrete.

Bimë barishtore dyvjeçare, 20 - 70 cm e lartë, e grathët, me kërcell të ngritur e të thjeshtë.

Gjethet e bazës 10 - 15 cm të mëdha, heshtore, me buzë ura - ura, në bazë të ngushtuar në një bisht të gjatë; të sipërmet gjatore deri heshtore e pa bisht.

Lulesa e kokët e rrethuar me gjethe vezake braktengjashme. Lulet pa bishta. Kupa e mbuluar me qime të bardha, të kreshpëta. Kurora si gyp në formë hinke, ngjyrë manushaqe dhe e ndarë në vriguj të mprehtë.

IV - VI.

E përhapur kryesisht në zona të ulëta me bar e shkurraja. Subballkanike.



Campanula lingulata W. et K. - Lulekambana gjuhëzngjashme Campanulaceae - Kabanore

Shumëvjeçare barishtore 30 – 100 cm, me kërcell të ngritur, të thjeshtë, me push të rrallë.

Gjethet e bazës dhe kërcelloret e poshtme të cunguara ose si zemër në bazë, dhëmbë – dhëmbë, me bishtak të gjatë, të sipërmet heshtore, gati pa bisht.

Lulet të shumta, në lulesa njëanësore. Kupa me vriguj të spërveshur gjatë lulëzimit. Kurora hinkëngjashme, kaltëroshe – manushaqe.

VI – VIII.

Në pyje shkorrete, gjerdhe, vreshta deri në zonat malore.



Campanula persicifolia L. - Lulekambana gjethepjeshkë Campanulaceae - Kambanore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 - 80 cm e lartë. Rrënja boshtore dhe e trashur. Kërcelli i ngritur, i thjeshtë, me qime të spërveshura.

Gjethet bazale heshtore me buzë dhëmbëza - dhëmbëza, ndërsa ato kërcellore heshtore ose pothuajse 3 - këndëshe.

Lulet nga 1, me bishta, të grumbulluara në një lulesë në formë vileje me lule të pakta. Kupa gypore, me vriguj të ngritur të hapur, vizakë. Kurora 3 - 4 cm, me dhëmbë shytë. Fryti kapsulë.

V - VIII.

E përhapur në shkurrnaja e pyje me dritë.



Campanula rapunculoides L. – Lulekambana si fitemë Campanulaceae – Kambanore



Campanula rapunculus L. – Lulekambana fitemë
Campanulaceae – Kambanore

Dyvjeçare barishtore, 30 – 100 cm, me rrënjë të trashura boshtore. Kërcelli i ngritur, i shogët ose lehtësisht i kreshpët, i degëzuar në pjesën e sipërme.

Gjethet e bazës heshtore të përmbysëta – pallake, dhëmbëza – dhëmbëza, kërcelloret heshtore ose vizake.

Lulesa e degëzuar me lule pak a shumë të ngritura. Dhëmbët e kupës vizake, më të shkurtër se kurora. Kurora blu e zbehtë, rrallë e trëndafiltë – manushaqe ose e bardhërreme.

V – VIII..

Në livadhe, toka të punuara, vreshta deri në zonat malore.



Campanula trachelium L. - Lulekambana e zveskut
Campanulaceae - Kambanore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të ngritur, me 5 kënde të mprehtë ose pak të flatëruar, të grathët, të kuqërremtë, 30 - 100 cm të lartë.

Gjethet e bazës me bisht e llapë si zemër. Kërcelloret me bisht më të shkurtër, të flatëruar, llapë heshtore, dhëmbë - dhëmbë, të grathëta.

Lulet 1 - 4 në majë të degëve, me këmbëza (bishta) të shkurtra të përkulura ose të ngritura. Kupa dhe dhëmbë dhe e grathët. Kurora me gyp e dhëmbë trekëndësh, blu e zbehtë. Kapsula e varur, ovoide.

VI - IX.

Ndeshet në pyje e shkurraja.



Campanula versicolor Andrews – Lulekambana ngjyrë ndryshme Campanulaceae – Kambanore

Bimë barishtore shumëvjeçare 20 – 40 cm ose më shumë, zakonisht e shogët, me kërcell të përpjetëm ose të ngritur, i degëzuar si melth në pjesën e sipërme ose nganjëherë i thjeshtë.

Gjethet e bazës lëkurore, me buzë ura – ura ose dhëmbë – dhëmbë, me bishtak; të sipërmet pothuajse pa bisht, pykore në bazë.

Lulet me tufëza, që formojnë një lulesë të shkurtër e të dendur skajore. Dhëmbët e kupës heshtore të ngushta. Kurora 15 – 25 mm, blu, me njolla bazale më të errëta.

V – VII.

Në vende me gurë. Subballkanike.



Campanula bononiensis L. – Lulekambana e Bolonjës
Campanulaceae – Kambanore

Barishtore shumëvjeçare, 40 – 70 cm, me kërcell të ngritur e pushlor, të thjeshtë ose pjesërisht të degëzuar.

Gjethet vezake, majëmprehta me push të përhimtë përposh, të sharruara; të poshtmet të cunguara ose si zemër në bazë, me bishtak, kurse kërcelloret pa bisht.

Lulet të varura, me këmbëza shumë të shkurtra. Lulesa e gjatë, kallingjashme. Dhëmbët e kupës trekëndor-heshtorë të hapur, shumë më të shkurtër se kurora. Kurora 10-25 mm, e varur rruzullore.

VI – VIII.

Në pyje e shkorrete. Europianoqendrore-Siberianojugore.

Bimë barishtore shumëvjeçare. Rrënja kryesore e trashur, rruzullore – vezake ose në formë rrepe. Stolonet të shkurtër. Kërcejtë 15 – 50 cm, me 1 – 5 lule, të ngritur, të degëzuar.

Gjethet me puprri ose të lëmuara, me buzë pak a shumë ura – ura; bazalet heshtore – të përmbysëta, me bishtak, ndërsa kërcelloret zakonisht heshtore e pabisht.

Lulet hermafrodite. Dhëmbët e kupës heshtorë. Kurora si hinkë e gjerë, blu.

VI – VIII.

Në kullota ose vende shkëmbore të zonave subalpine dhe alpine. Endemike Ballkanojugore.



Campanula spatulata Sm – Lulekambana shpatullore
Campanulaceae – Kambanore



Edraianthus tenuifolius (Weldst. et. Kit.) A.D.C. – Edraiant gjethehollë Campanulaceae – Kambanore

Bimë barishtore shumëvjeçare 5 – 20 cm, me kërcell të drunjëzuar e të degëzuar që në bazë. Shtijet të përpjetme, të thjeshta.

Gjethet e bazës vizake të ngushta, zakonisht të qerpikta deri në majë, kërcelloret me pakicë, më të vogla, por si të bazës.

Lulet deri në 15, gati pa bisht, në lëmshukë skajorë. Braktetë vezake të gjera, që ngushtohen menjëherë, aq sa ose më të gjata se lulet. Dhëmbët e kupës vizake. Kurora cilindrike, kaltëroshe – manushaqe.

VI – VIII.

Në shkëmbinj të zonave subalpine dhe alpine. Endemike – Ballkanikeperëndimore.



Jasione orbiculata Griseb. - Jasione e rrumbullakët Campanulaceae - Kambanore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 5 - 15 cm e lartë. Kërcejtë të ngritur ose të përpjetëm, me pak gjethe kërcellore.

Gjethet vizake - heshtore, në buzë me qerpikë.

Lulet të vogla, në kaptinëza të rrethuara nga një ose më shumë radhë brakte të pështjellës. Braktetë e jashtme të pështjellës të shumta, vezake, të dhëmbëzuara dhe zakonisht me qime në buzë. Dhëmbët e kupës të ngushtë, vetëm në bazë pak zgjerohen. Lulet kanë ngjyrë vjollce në të bardhë ose vjollce në të kaltër.

VI - VII.

Rritet në kullota subalpine dhe alpine, në substrate silikate. Në Kosovë e përhapur në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare.



Legousia speculum - veneris (L.) Chaex -Leguzia pasqyrë e Venerës Campanulaceae - Kambanore

Bimë barishtore njëvjeçare, 10 – 40 cm, pushlore ose e grathët, zakonisht shumë e degëzuar.

Gjethet e poshtme heshtore të përmbysëta - pallake, të sipërmet heshtore, me buzë pak të valëzuar ose urëza - urëza.

Lulet të shumta, në melth të gjerë me gjethe. Kupa me vriguj vizake si fëndyell dhe me gyp 8 – 12 mm. Kurora shumë e hapur në formë disku, e trëndafiltë manushaqe.

IV – VII.

Rritet në ara të punuara, buzë mezhdave. Bar i keq i kulturave bujqësore.



Asyneuma canescens (Waldst. et Kit) -Asineuma e përhimt Campanulaceae – Kambanore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 1 – 15 cm, me kërcell të ngritur, të shogët.

Gjethet vizake deri gjatore - pallake, që ngushtohen menjëherë drejt bazës, me buzë të sharrëzuara ose urëza - urëza.

Lulesa rruzullore, me 2 - 7 lule. Braktetë rrotullare deri vezake. Kurora blu manushaqe e errët.

VI – VIII.

Rritet në shkëmbinj dhe kullota me gur të zonave subalpine dhe alpine.



Phyteuma confusum A.Kern. - Fiteuma jo e çartë Campanulaceae - Kambanore

Shumëvjeçare barishtore 30 – 100 cm, me kërcell të ngritur.

Gjethet kërcellore 4 – 6 cm, eliptike – vezake, me buzë ura – ura si sharrë, të grumbulluara në pjesën e poshtme të kërcellit e që zvogëlohen menjëherë në pjesën e sipërme.

Lulet në lëmshukë nga 2 – 4 së bashku, në një lulesë të gjatë. Dhëmbëzat buzëplotë. Kurora blu.

VI – VII.

Në vende me bar të zonave malore deri alpine.



Asyneuma limonifolium (L.) Jansen – Asineuma gjethelimoni Campanulaceae – Kambanore

Shumëvjeçare barishtore 10 – 100 cm, me kërcell të ngritur, zakonisht të thjeshtë dhe shpesh me qime të spërveshura.

Gjethet e bazës në rozetë (shpesh mungojnë në lulëzim), vizake – heshtore, majëmprehta e të valëzuara në buzë.

Lulet në lëmshuk nga 2 – 4 së bashku, pa bisht, në lulesa të thjeshta ose rrallë me ndonjë degëz. Kurora blu.

VI – VII.

Në shpate me gurë e vende shkëmbore të zonave malore e alpine.



Achillea ageratifolia S. S. - Barpezmi gjetheagjeratë
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare deri 40 cm e lartë. Kërcelli është i ngritur, me shumë gjethe, me qime të gjata të palosura mëndafshi.

Gjethet e rozetës me qime mëndafshi, gjatore - heshtore. Gjethet e kërcellit janë pa bisht, gjatore, në bazë të ngushta.

Lulesa është vastak i thjesht ose i përbërë. Lulet me ngjyrë intenzive të verdhë.

VII.

Bimë stenoendemike e Kosovës. Është zbuluar në vitin 1934. Rritet në Malet e Sharrit (Oshlak). Ka areal të kufizuar (vetëm në Oshlak) prandaj duhet mbrojtur me ligj.



Achillea canescens Form. – Barpezmi i bardhë
Asteraceae – Kompozite

Barpezmi gjetheagjeratë është bimë shumëvjeçare tufore me kërcej të ngritur, deri 30 cm të lartë.

Gjethet janë të përhimta me push të butë. Gjethet kërcellore të pakta.

Lulesa është e llojit kaptinëz. Pështjella e lulesës me brakte të mëndafshta. Lulet llapore 7 - 9 mm të mëdha, të bardha dhe me formë vezake.

VI - VIII.

Rritet në vende shkëmbore të zonave subalpine dhe alpine. Bimë endemike e Ballkanit.



Achillea alexandri - regis Bornm. et Rud.
- Barpezmi i mbretit Aleksandër
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, deri 50 cm e lartë. Kërcelli i drejtë, me qime të hirta të merimangëta.

Gjethet me qime të mëndafshta; në pjesën e poshtme të kërcellit të gjera – heshtore, dy herë pendore; kërcelloret të gjata – heshtore, pendore.

Kaptinat sajojnë lulesën vastak në bishta të gjatë. Lulet llapore të bardha, ovale.

V – VII.

Në vende shkëmbore të zonës alpine dhe subalpine. Në Kosovë është e përhapur vetëm në Pashtrik. Bimë endemike e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë. E zbuluar nga botanisti çek E. Formanek në vitin 1893.



Achillea chrysocoma Fryv. - Barpezmi ballukeartë
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, pushbutë deri e mëndafshtë. Kërcejtë deri 40 cm të lartë, të ngritur dhe të thjeshtë.

Gjethet dyfishpendore të prera. Vrigujt kanë trajtë vizake. Gjethet e sipërme pa bisht.

Lulesa është vastak me 15 e më tepër kaptinëza. Buzët e brakteve ngjyrë kafe të errët. Lulet llapore të verdha të shndritshme.

VI - VII.

Rritet në vende shkëmbore të zonave alpine e subalpine. Bimë endemike e Ballkanit. Në Kosovë është e përhapur në Luboten, Brezovicë, Koritnik, Livadicë, Kobilicë.



Achillea clypeolata Sibth. et Sm. – Barpezmi me mburojë
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare me push të butë të shkurtër. Kërcejtë deri 60 cm, të ngitur, të thjeshtë.

Gjethet pendore të prera, bazalet me bisht, kërcelloret pa bisht; vrigujt vezakë, me dhëmbë si sharrë.

Vastakët me shumë kaptina, pushbutë. Lulet llapore të verdha.

V – VII.

Në vende shkëmbore të zones subalpine. Endemike e Ballkanit. Bimë mjekësore.



Achillea lingulata W. et Kit. – Barpezmi gjuhësor
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë 10 – 40 cm, të thjeshtë, të ngritur, dendësisht pushlorë - të kuqërremë sipër.

Gjethet 2 – 5 cm, të thjeshta, pallake, pushlore, pa bisht.

Vastakët me 10 – 30 kaptinëza. Braktetë vezake, me buzë kafe të errëta. Lulet llapore të bardha.

VI – VIII.

Në livadhe alpine e shpate shkëmbore. Subballkanike.



Achillea millefolium L. - Barpezmi mijëfletësh
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të drejt ose pak të lakuar, të mbuluar me qime, 15 - 30 cm të lartë.

Gjethet e poshtme 2 - 3 herë pendore, ndërsa ato të sipërmet 1 - 2 herë.

Kaptinat janë mesatarisht të mëdha, 10 - 17 mm në diametër. Ato grumbullohen në lulesa pak a shumë ombrellore. Lulet llapore të bardha, 8 - 10 në numër.

VI - IX.

Rritet në vende shkëmbore dhe me bar të zonave subalpine. Në Kosovë është e përhapur në Malet e Sharrit, Alpet Shqiptare.



Achillea tanacetifolia All. – Barpezmi gjethekarajpeli
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, e lartë 10 - 80 cm. Kërcejtë të ngritur ose të përpjetëm.

Gjethet me vendosje të këmbyer, dyfish deri trefishpendore të çara. Në fillim leshtore më von me qime të rralluara.

Lulesa vastak. Vastakët me shumë kaptinëza. Në shtratin e një kaptinëze renditen lulet e jashtme llapore dhe të brendshme gypore. Lulet llapore, pes sosh, janë femërore me gjuhëza tredhëmbëshe. Lulet gypore hermafrodite, të bardha rrallë trëndafili. Fryti aken.

V - VII.

Rritet ne vende me bar, në çeltira pyjesh, e zakonshme. Bimë mjekësore dhe mjaltëse.



Achillea multifida DC. - Barpezmi i ndarë shumë Asteraceae - Kompozite

Bimë shumëvjeçare, 20 – 120 cm. Rizoma horizontale, e degëzuar. Kërcelli në pjesën e sipërme me qime të dendura.

Gjethet të shogëta ose leshtore.; të poshtmet me bisht, dy deri trefish pendore të ndara.

Kaptinëzat formojnë lulesën e dendur vastak. Lulet të bardha, të kuqe – trëndafili ose purpur.

VII – IX.

Në vende me shkurre dhe të ndriquara, buzë maleve.



Achillea grandifolia Friv. – Barpezmi gjethemadh
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë 30 – 100 cm, të ngritur, të degëzuar në pjesën e sipërme.

Gjethet kërcellore të mesit rreth 10 x 5 cm, vezake, pendore të çara thellë deri pendore të prera, me segmentë pendorë të çarë.

Vastakët me shumë kaptinëza. Lulet llapore të bardha.

VI – VII.

Në livadhe malore. Endemike e Ballkanit.



Achillea holosericea Sibth. Et Sm. – Barpezmi gjethemëndafshtë Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë 15 – 60 cm, të ngritur, të thjeshtë, pushlorë.

Gjethet pendore të çara, pak a shumë të mëndafshta; bazalet me bishtak; vrigujt vezake deri heshtore; kërcelloret pa bisht, vrigujt me buzë pak a shumë të plota.

Vastakët me 10 deri shumë kaptinëza. Lulet të verdha.

VI – VII.

Në vende shkëmbore të zonave alpine dhe subalpine. Endemike Ballkanike



Ambrosia artemisiifolia L. - Ambrosia gjethepelini
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore njëvjeçare 30 – 100 cm, e ngritur, e degëzuar, jo aromatike dhe me kërcej shpesh të drunjëzuar poshtë.

Gjethet me bishtak, shpesh 1 – fishpendore të prera, të blerta përposh; vrigujt heshtorë.

Të gjitha lulet gypore. Kaptinëzat me lule njëseksore; lulet femër në sqetullat e gjetheve më të sipërme, të vetmuara.

VII – IX.

Bimë ardhacake e natyralizuar, kryesisht në rajone bregdetare; ndeshet aty – këtu edhe në Kosovë.



Arctium tomentosum Mill. – Rrodhja pushbutë
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore dyvjeçare, 50 – 120 (-250) cm; kërcelli i degëzuar, i veshur me qime të hirta.

Gjethet bazale me bisht 10 – 15 cm të gjatë; ana e poshtme me qime të bardha leshtore, 30 – 40 x 16 – 28 cm, të plota ose me dhëmbë të rrallë.

Lulesa vastak. Lulet gypore të purpurta – trëndafili.

VII – VIII.

Në vende të thata ruderale, afër fshatrave, buzë rrugëve etj.



Calendula officinalis L. – Kalendula mjekësore
Asteraceae – Kompozite


Bimë një ose shumëvjeçare, e drunjëzuar vetëm në bazë. Kërcelli 20 – 50 (-70) cm, i ngritur, i hapur ose i shtrirë për tokë, shumë i degëzuar, në përgjithësi me gjethe pothuaj në majë.

Gjethet heshtorepërmbysët ose pothuaj vezakepërmbysët, gjatore ose pallake, majëmprehta ose shyte, pushlore-gjëndërore deri me push të merimangët.

Kaptinëzat zakonisht 4 – 7 cm në diametër. Gjethëzat shpesh 2 cm, të verdha ose portokalli.

IV – IX.

E kultivuar për zbukurim. Vendorigjina e panjohur. Bimë mjekësore.



Centaurea scabiosa L. – Kokoçeli barzgjebe
Asteraceae – Kompozite

Barishtore shumëvjeçare; kërcejtë deri 120 cm të lartë, me degëzim vastakor.

Gjethet të ashpra; të poshtmet me bishtak, 1 - 2 fish pendore të prera, rrallë të plota ose me dhëmbë.

Pështjella vezakengjashëm – rruzullore; braktetë vezake, të shumta, të shogëta ose me qimëri të merimangët; shtojcat kafe ose të zeza, të stërgjatura, me kinde kafe. Lulet purpur.

VI – VIII.

Në livadhe, vende shkëmbore etj. Euroaziatike.



Chondrilla juncea L. – Zeguni si zhukë
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore dy deri shumë -vjeçare, e përhimtë – e gjelbër. Kërcelli zakonisht i vetmuar, 30 – 80 cm. Në pjesën e sipërme i degëzuar. Degët pothuajse pa gjethe.

Gjethet të shogëta ose me disa qime të ashpra; bazalet, që thahen shpejt, pendore të çara, ato të kërcellit gjatore – heshtore, të plota ose të dhëmbëzuara.

Kaptinat të shumta me 9 – 12 lule, skajore, anësore ose sqetullore, të vetmuara ose në grupe nga 2 – 5 së bashku, pa bisht ose me një bisht të shkurtër.

VI – VIII.

Në vende barishtore të thata, ara etj. Eurimesdhetare-Jugsiberiane



Crepis vesicaria. L. – Shmanga fshikëzore
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, dyvjeçare ose njëvjeçare; kërcejtë 3 – 150 cm, zakonisht shumë të degëzuar.

Gjethet pushlore ose të shogëta; gjethet e bazës heshtore të përmbysëta, shyte deri majëmprehta, gjirake ose me dhëmbë të kthyer në drejtim të kundërt, të dhëmbëzuara ose me prerje të thella; gjethet e sipërme kërcellore heshtore, me veshëza kërcellpështjellëse.

Kaptinat të shumta, shpesh në një vastak të lirë. Pështjella pushbutë, shpesh me qime gjëndërore ose jogjëndërore.

V – VII.

Në vende me bar.



Hieracium racemosum W. et K. subsp. crinitum (Sm.)
Këmashna me vile Asteraceae – Kompozite

Barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë 10 – 80 (-100) cm, me disa deri shumë qime yllore dhe qime të thjeshta jogjëndërore.

Gjethet zakonisht të gjitha kërcellore, të poshtmet shumë më të gjera se të sipërmet, me disa deri shumë qime të thjeshta jogjëndërore, pak a shumë majëmprehta, gati të plota deri ura-ura apo dhëmbë-dhëmbë, të ngushtuara në një bishtak të flatëruar, të sipërmet ba bisht.

Kaptinëza disa deri shumë, në një melth të gjerë. Braktetë përgjithësisht vizake – heshtore. Gjuhëzat të verdha.

V – VIII.

Në vende të thata, gurishtore, në shkorreta etj. Europiane-Kaukazike



Inula ensifolia L. – Plenëra gjetheshpatë
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare 10 – 60 cm, e ngritur, e shogët ose pushbutë.

Gjethet të shogëta, me 3 – 7 (-13) deje paralele të dallueshme, të plota, të poshtmet vizake – heshtore ose heshtore, të sipërmet pa bisht, jo ose paksa kërcellpushtuese.

Kaptinëzat 3 – 5 cm në diametër, të vetmuara; braktetë të mëndafshta – leshtake në bazë, të jashtmet trikëndore – vezake me majë të hapur.

Lulet të verdha; të jashtmet (llapore) shumë më të gjata se pështjella.

VII – VIII.

Në zallishte, livadhe të thata, vende shkëmbore etj.



Lactuca saligna L. – Marule shelgore
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore një ose dyvjeçare. Kërcelli 30 – 100 cm, i shogët, i bardhërremë, i degëzuar.

Gjethet shpesh me gremça mbi dellin e mesit; të poshtmet të plota deri pendore të çara, me vriguj të ngushtë e të larguar; të sipërmet gjatore deri vizake, me bazë shigjetake.

Lulesa melth kalingjashëm me shumë kaptinëza. Kaptinëzat me 6 – 15 lule; gati pa bishta. Gjuhëzat të verdha të zbehta.

V – VIII.

Në vende barishtore dhe në të mbjella, anash rrugëve etj.



Matricaria caucasica (Willd) Poir. – Kamomili i Kaukazit
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë 15 – 50 cm, të thjeshtë, gati të shogët, të ngritur ose të përpjetëm.

Gjethet të shogëta; ato kërcelloret e poshtme dyfishpendore të prera në segment mjaft majëmprehtë.

Kaptinat 3 – 5 cm në diametër; braktetë e pështjellës gati trikëndore deri gjatore, me buzë të gjera cipëthat, të errëta – kafe. Lulet e periferisë zakonisht llapore, femërore të bardha; të brendshmet gypore, hermafrodite, të verdha.

VII – VIII.

Në kullota alpine. Subballkanike.



Onopordum illyricum L. – Xhixhëlla ilire
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore dyvjeçare deri 150 cm e lartë, me kërcej të verdhërreme, leshtorë; flatrat me dellëzim jo rrjetor.
Gjethet deri 55 x 15 cm, gjembore – të dhëmbëzuara, të pabisht, pendore të çara, me 8 -10 çifte vrigujsh të larguar.
Kaptinat rruzullore – ovoide; braktetë e pështjellës si tjegulla, gati të rrasura, ose të jashtmet dhe të mesit të përkulura në gjysmën e sipërme, lehtësisht të mysëta nga ana kurrizore. Kurora e purpurt.
VI – VIII.
Në djerrishte, rrënoja e buzë rrugëve. Stenomesdhetare



Petasites doerfleri Hayek – Llapua e Dorflerit
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcej 10 – 40 cm, me qimëri të merimangët të hollë në pjesën e poshtme dhe leshtore sipër, me rizoma të holla e luspa të shumta heshtore.

Gjethet kryesisht bazale, ura-ura të dhëmbëzuara, si zemër në bazë; bishtaku 2 – 10 cm, leshtor; gjethet kërcellore të pakta, të vogla, të pabisht.

Kaptinëza 3 – 10; braktetë të purpurta. Lulet të verdha të zbehta ose të kuqërreme.

VII – IX.

Në vende shkëmbore me lagështirë. Ndeshet në Alpet Shqiptare. Endemike Shqiptare



Saussurea alpina (L.) DC. – Sausurea alpine
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë të fuqishëm, horizontal, të errët. Kërcelli 2 – 50 cm.
Gjethet heshtore ose heshtore – vezake, sipër të shogëta, përposh me qime të bardha – të merimangëta, buzëplota ose me dhëmbë të imët e të rrallë me bishtak me flatra të ngushta; të sipërmet pa bishtak.
Kaptina cilindrike – vezake, në formë vastakore ose fshese. Kurora e kuqe – trëndafili.
VII – VIII.
Në kullota alpine dhe shpate gurishtore. Në Kosovë është vënë re në Vracë, Majë të Zezë, Kobilicë



Scolymus hispanicus L. – Rrëkualli
Asteraceae - Kompozite

Bimëbarishtoredyoseshumëvjeçare, 20 – 80 cm, pak a shumë me qime leshtore, Kërcelli i vetmuar, i degëzuar, me flatra të ndërprera, të dhëmbëzuara e me gjemba.
Gjethet bazale pendore të çara, me vriguj të dhëmbëzuar me gjemba; ato të kërcellit kërcellpushtuese, të gjembëzuar.
Kaptinat me lule të verdha, të gjitha llapore, të mbështjella nga 3 – 4 gjethe të dhëmbëzuara e me gjemba.
VI - IX.
Në vende të thata me gurë, në toka të papunuara, në gërmadha etj



Senecio doronicum subsp.glaberrimus (Rochel)
S. – Pulithi doronikë Asteraceae Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 – 60 cm. Kërçepi i shkurtër. Kërcejtë të trashë, të ngritur, të thjeshtë, rrallë të degëzuar, me qime të merimangëta ose të shogëta.
Gjethet e bazës rrotullake ose pykore, eliptike deri vezake, me dhëmbë të imët; kërcelloret gjatore të përmbysëta deri vizake – heshtore, të pa bisht.
Kaptinëzat 30 – 50 mm në diametër, të vetmuara ose rrallë në vastak. Lulet llapore të verdha të zbehta.
VI – VIII.
Në substrate silikate, vende shkëmbore. Në Kosovë është vënë re në malet e Sharrit (Vracë dhe Maja e Zezë). Europiane – Jugore.



Inula hirta L. – Plenëra kreshtake
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 50 cm e lartë. Kërcelli i drejtë me qime të ashpra, me 1 – 3 (-5) kaptina.
Gjethet vezake – të gjata; në pjesën e mesme dhe të sipërme të kërcellit të rrumbullakosur në bazë.
Kaptinat 2 – 5.5 cm në diametër; braktetë me renditje jo të rregullt, pothuaj në dy rreshta.. Lulet të verdha – ari.
VI – IX.
Në vende të thata me bar. Element floristik Euroaziatik.



Senecio bosniaca Beck – Pulithi i Bosnjës
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të ngritur, me qime leshtore – të ndërthurura, më vonë bëhet e shogët.
Gjethet bazale gjatore – vizake, gradualisht ngushtohen në bishtak të shkurtër, buzëplotë; gjethet e kërcellit poashtu gjatore – vizake.
Kaptinëzat në vastakë me 3 – 10 kaptinëza. Braktetë e pështjellës të gjelbra, me qime leshtake. Lulet të verdha. Akeni i shogët ose me qime të rralla.
VI – VII.
Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror në kuadër të kullotave subalpine dhe alpine. Ilirike.



Senecio scopolii Hoppe – Pulithi i Skopolit
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë 30 – 50 cm të lartë dhe të trashë.

Gjethet bazale vezake rrotullare ose pykore në bazë, pak a shumë të ngushtuara menjëherë në një bishtak, gati të shogëta përsipër, me qime të merimangëta – leshtore përposh, të holla dhe të buta.

Kaptina me diametër 30 – 60 mm, e vetmuar. Pështjella me qime të merimangëta – leshtore. Lulet llapore të verdha – të zbehta.

IV –VI.

Në vende të thata gëlqerore. Endemike e Ballkanit.



Dittrichia graveolens (L.) Greuter – Ditrike erërëndë
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore njëvjeçare 20 – 60 cm e lartë, dendësisht gjëndërore dhe me erë kamfori.
Gjethet ngjitëse dhe me erë të fortë, të poshtmet gjatore – heshtore, deri në 1 cm të gjera.
Kaptinat të vogla, me diametër 6 – 15 mm. Lulet të verdha, pastaj portokalli.
VII – X.
Në vende të thata barishtore, të punuara e djerrishte. Bimë mjejkësore dhe bar i keq për kulturat bujqësore



Antennaria dioica (L.) Geartner – Antenaria dioike
Asteraceae – Kompozite


Bimë barishtore shumëvjeçare dioike, deri 20 (-30) cm, pushbutë, me stolone të degëzuar e gjethe bazale në rozetë.

Gjethet bazale vezakepërmbysët – pallake, sipëfaqja e poshtme me push të butë të dendur, e sipërmja e shogët.

Kaptinëza 2 – 8, në një lëmshuk fundor. Braktetë e pështjellës në disa radhë. Lulet femërore fillngjashëm, gypore, trëndafili. Lulet llapore mashkullore, përsipër të trasha , zakonisht të bardha.

V – VII.

Në livadhe e vende gurishtore të thata, kryesisht në zonat alpine e subalpine. Bimë mjekësore.



Anthemis carpatica Wild. – Syviçja e Karpatit
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 60 - 100 (- 180) cm e lartë, me kërcell të ngritur, të trashë dhe të degëzuar.

Gjethet e poshtme 20 - 50 cm të gjera, trekëndore si zemër deri veshkëngjashme, me bisht. Gjethet kërcellore të sipërme të vogla dhe kërcellpushtuese.

Lulet të grupuara në kaptinëza cilindrike me 3 - 4 (6) lule. Lulet janë të gjitha hermafrodite dhe gypore me ngjyrë të kuqërreme - të purpurt. Fryti aken.

V - VIII.

Rritet në pyje, livadhe, kullota malore deri të ato subalpine.



Adenostyles alliariae (Gouan) A. Kerner - Bar hudhre Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të drunjëzuar. Kërcejtë të thjeshtë, me qime leshtore dendësisht të rrasura deri të shogët, 10 – 35 (-40) cm.

Gjethet të gjelbra, një – dyfishpendore të prera ose të ndara, me segmentë të plotë, dhëmbë – dhëmbë ose të vrigulluar. Vrigujt vizakë – heshtorë.

Kaptinat me bisht 3 – 11 cm. Pështjella gatirruzullore. Braktetë vezake – heshtore. Lulet e brendshme hermafrodite, të verdha.

VI – VIII.

Në vende me bar dhe në të çara shkëmbinjësh.



Anthemis montana L. – Syviçja e malit
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare me qime leshtore të rralla. Kërcelli në pjesën e sipërme i degëzuar, 30 – 90 cm.

Gjethet deri 14 cm, vezake gjatore, dyfishpendore të prera; segmentet pak a shumë të hapur, të larguar, gjatorë, krëhërakë ose dhëmbë – dhëmbë; vrigujt gjatorë.

Kaptinat të vendosura në formë vastaku, bishtat të gjatë jo të çomangët. Pështjella gjysmërruzullore. Gjuhëzat të bardha. Disku gati rruzullor në fryt.

V – VIII.

Në vende barishtore të thata, kryesisht në zona malore.



Anthemis triumfettii (L.) DC. – Syviçja e Triumfetit
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare me filiza jolulorë që formojnë pak a shumë jastëqe të dendura. Kërcejtë lulor 15 – 30 (-40) cm, me gjethe gati deri në mes.

Gjethet njëfishpendore të prera, fillimisht me qimëri të dendur, të bardhë e të rrasur, pastaj të shogëta ose pothuaj të shogëta; gjethet e poshtme 4 – 8 cm, me 3 – 4 segmentë në secilën anë.

Kaptina me bisht lulor të gjatë. Braktetë e jashtme të pështjellës vezake – trekëndore. Lulet llapore të verdha.

VI – VII.

Në vende shkëmbore me bar të zonave malore.



Anthemis tinctoria L. – Syviçja ngjyruese
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, me qime leshtore të rralla deri leshtake e bardhë. Kërcejtë 30 – 60 (-90) cm, shpesh me degëzim gativastakor sipër pjesës së mesit.

Gjethet përsipër gati të shogëta, përposh zakonisht leshtake, dyfish pendore të prera.

Kaptinat të vetmuara. Pështjella gungore, pak a ashumë leshtake. Gjuhëzat të verdha.

VI – VII.

Ndeshet në vende të thata me bar, toka ranore, shkorreta etj.



Arctium lappa L. - Rrodhja
Asteraceae - Kompozite

Bimë shumëvjeçare, 30 – 90 cm e lartë, aromatike, pak a shumë me qime të bardha si mëndafsh.

Gjethet dy deri trefish pendore të prera; vrigujt zakonisht shyt.

Kaptinat gjysmërruzullore, të varura, në lulesa melth. Kurora e shogët, e verdhëreme – kafe.

VII – IX.

Rritet në vende shkëmbore, vende me bar etj. Bimë mjekësore.



Artemisia absinthium L. - Pelini
Asteraceae - Kompozite


Bimë barishtore dyvjeçare, 90 – 150 cm. Kërcejtë, bishtat e gjetheve dhe të luleve pushlore deri gati të shogëta.

Gjethet bazale deri 50 cm, përgjithësisht vezake, të plota ose me dhëmbë të rrallë.

Kaptinat të vendosura në një lulesë në formë vastaku. Të gjitha luspat (braktetë) e pështjellës të shogëta, të praruara të gjelbra. Lulet gypore hermafrodite, të purpurta.

VI – VII.

Rritet në toka të papunuara, buzë rrugëve, pranë fshatrave. Bimë mjekësore.



Jurinea mollis (L.) Reich. – Jurinea butloshe
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumë vjeçare. Kërcelli 30 – 70 cm, me gjethe në gjysmën e poshtme.

Gjethet bazale pendore të çara; segmentët heshtorë, me buzë të përthyer ose valë-valë; gjethet kërcellore pendore të çara ose të plota dhe vizake; të gjitha gjethet me qimëri të merimangët.

Kaptinëza e vetmuar, rruzullore ose gjysmërruzullore. Braktetë e pështjellës heshtore, me qimëri të merimangët, të brendshmet shumë më të të gjata se të jashtmet. Lulet purpur.

V – VII.

Në vende të thata me bar etj.



Artemisia vulgaris L. - Pelini i rëndomtë
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 70 cm e lartë. Kërcelli i përpjetëm ose i ngritur, me qime të rrasura – pushlore deri leshtakë ose i shogët.

Gjethet të plota, bazalet dhe kërcelloret e posht-me pallake deri gati eliptike, që ngushtohen në një bishtak të gjerë; ato të mesit dhe të sipërmet gjatore – heshtore, pa bisht.

Kaptinat zakonisht të vetmuara. Braktetë e pështjellës në 2 (-3) radhë jo të qarta, gati të bara-barta. Lulet llapore 20 – 40, vjollcë – blu; lulet gy-pore të verdha.

VII – VIII.

Në kullota e vende shkëmbore të zonave të larta malore.



Aster alpinus L. – Aster i alpeve
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare shumë e hidhur, 50 - 200 cm e lartë. Kërcejtë janë za-konisht të kuq ose purpur.

Gjethet kanë llapë të zhvilluar mirë, njëfish pendore të çara, me veshëz në bazë. Përsipër janë të gjelbra , përposh pushbutë - të bard-hëreme. Gjethet e sipërme pa bisht.

Lulet japin kaptinëza të shumta duke dhë-në lulesën vile të degëzuar. Kurora zakonisht e kuqërreme në kafe.

VII - IX.

Rritet në vende me bar, buzë kanalesh, ugare, vreshta etj. Bimë mjekësore.



Aster albanicus Degen - Ylli shqiptar
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare , 15 - 35 cm e lartë.

Gjethet heshtore të përmbysëta deri pal-lake, gjëndërore dhe me qime të merimangë-ta – leshtore. Gjethet e poshtme me bishta.

Lulesa është kaptinë. Kaptinat në vastak të çlirët ose të vetmuara, me bisht të gjatë. Braktetë e pështjellës në tre radhë, të jasht-met e të mesit vizake – heshtore, me majë të fëndyelltë, të brendshmet majëmprehta, me buzë të gjera cipëthata. Lule llapore 12 – 14, vjollce.

VIII - X.

Rritet në vende shkëmbore me natyrë ser-pentinore. Bimë endemike e Kosovës dhe Shqipërisë. Në Kosovë mund të ndeshet në Koznik, Çeret, Mushtisht dhe vende tjera.



Aster linosyris (L.) Bernh. - Aster linosiri
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 70 cm e lartë, me kërcell të shtrirë të përpjetëm deri të ngritur, me gjethe të dendura.

Gjethet të ngushta, pa bisht, me 1 nervurë.

Kaptinëzat të vogla, në vastak të dendur. Luspat e pështjellës vizake - heshtore ose vizake. Lulet llapore mungojnë; ato gyporet të verdha, me gyp e me 5 vriguj.

VII - IX.

Rritet në vende me gurë, kullota të thata e pyje dushku.

Bimë njëvjeçare 10 – 150 cm e lartë. Kërcelli me shumë gjethe.

Gjethet të shumta, të ngushta, të poshtmet deri 10 x 1 cm, me bishtak, shpesh rënëse; të tjerat vizake, të paktën të sipërmet pa bisht.

Kaptinat më pak se 1 cm të gjera, të shumta, të grumbulluara në një lulesë në formë melthi të zgjatur e të degëzuar. Lulet në formë llape të bardha ose trëndafili.

VI – X.

Buzë rrugëve, në ara etj. Amerikane Veriore. E përhapur në tërë Evropën që nga shekulli i XVII. Bimë mjekësore dhe bar i keq i kulturave bujqësore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, e lartë 2 - 15 (-20) cm, zakonisht shtijore, me stolone të shkurtër.

Gjethet të grumbulluara në fund si rozetë, kanë formë vezake ose lopate, me nga një dell, ngushtohen gati përnjëherësh në një bisht aq të gjatë sa llapa.

Në maje të kërcellit shtijor zhvillohet lulesa kaptinëz. Ajo mban lule llapore përreth, gypore në qendër. Të parat janë me ngjyrë të bardhë, kurse nga ana e poshtme shpesh purpur në të kuqe. Lulet gypore të verdha.

II - XII.

Rritet në livadhe me lagështi mesatare, shkorrete, skaj rrugëve.



Bellis perennis L. - Lule dhensh
Asteraceae - Kompozite



Erigeron canadensis L. – Erigeroni i Kanadasë
Asteraceae – Kompozite



Erigeron uniflorus L. – Erigeroni njëlulesh
Asteraceae – Kompozite

Bimë baishtore shumëvjeçare, 3 – 12 cm e lartë, me rizomë. Kërcelli i drejtë, i mbuluar me qime të thjeshta.

Gjethet paksa të trasha, buzëve me qime qepallore. Gjethet bazale të plota, vezake – të zgjatura, të ngushtuara në pjesën e bishtit.

Kaptinat të vetmuara, me diameter 10 – 27 mm. Pështjella e mbuluar me qime të dendura; lulet e mesit dyseksore, në majë të kuqërremta. Lulet llapore vjollce – të bardha.

VII – IX.

Në vende shkëmbore dhe me bar të zonës subalpine dhe alpine.



Filago vulgaris Lam. – Filaga e rëndomtë
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore njëvjeqare 10 - 35 (-40) cm, me kërcell të ngritur ose të përpjetëm, me push të bardhë dhe në pjesën e sipërme i degëzuar në mënyrë dikotomike.

Gjethet vizake – heshtore, majëmprehta.

Kaptinëzat pak a shumë cilindrike, në kaptina të dendura rruzullore prej 20 – 30 kaptinëzash. Lulet të verdha.

V – VII.

Në toka të papunuara, buzë rrugëve, në kullota etj. Bimë mjekësore.



Gnaphalium sylvaticum L. – Gnafala e pyllit
Asteraceae – Kompozite

Bimë baishtore shumëvjeçare me push të butë, të përhimtë e të mëndafshtë, me disa filiza jolulebartës. Kërcejtë 20 – 50 (-70) cm, me gjethe të dendura.

Gjethet heshtore deri vizake, me përmasa që zvogëlohen gradualisht drejt majës së kërcellit, gati të shogëta përsipër, të ngritura të hapura.

Kaptinat të shumta të grumbulluara, të vendosura në sqetullën e gjetheve, duke formuar një lulesë në formë kalliri të gjatë. Braktetë e pështjellës vizake – gjatore të përmbysëta. Lulet 3.5 mm; ato femër rreth 70, ndërsa hermafroditet 3 – 4.

VI – VIII.

Në çeltira pyjesh, shkorrete e kullota.



Amphoricarpos neumayeri Vis. –
Amforikarpi i Neumajerit Asteraceae – Kompozite



Carduus acanthoides L. – Freshkulli si gjemb
Asteraceae – Kompozite



Carduus candicans Waldst. et Kit. –
Freshkulli i bardhemë Asteraceae – Kompozite

Barishtore shumëvjeçare me kërçep të shkurtër e të drunjëzuar; kërcelli 20 – 40 cm.

Gjethet bazale heshtore deri eliptike – gjatore, me majë deri gati shyte, që ngushtohen gradualisht në një bishtak të shkurtër, përsipër të gjelbra, pushbut – të bardha përposh.

Kaptinëzat 2 – 3 cm në diametër. Braktetë e pështjellës në disa radhë, ma buzë barishtore ose cipëthatë. Lulet më të jashtme femërore, të tjerat hermafrodite; kurora trëndafili ose e bardhë.

VI – VIII.

Në vende shkëmbore të zonave malore. Në Kosovë e përhapur në Alpet Shqiptare. Endemike e Ballkanit.

Bimë baishtore dyvjeçare deri 150 cm e lartë. Kërcelli me qime të rralla të merimangëta; flatrat deri 8 mm të gjera, pëllëmbore deri gjerësisht trekëndore, me një gjemb në majë.

Gjethet gjatore të përmbysëta, gati të shogëta përsipër, të shogëta përposh, vrigujt me një gjemb në majë.

Kaptinat gatirruzullore, të pabisht, të vetmuara ose në vile të vogla; braktetë e jashtme dhe të mesit të pështjellës të vendosura si tjegullat ose të hapura deri lehtësisht të spërveshura. Lulet purpur.

VI – VIII.

Në kullota, shpesh si bimë ruderale.

Bimë baishtore dyvjeçare deri 110 cm. Kërcelli me qime të merimangëta – leshtore; flatrat deri 15 mm të gjera, trekëndore, me vriguj në anën e sipërme, secili vrigullth me një gjemb në majë.

Gjethet heshtore të përmbysëta ose heshtore, gati të shogëta përsipër, të bardha – pushbuta përposh, me vriguj gjerësisht trekëndor, secili vrigull me një gjemb në majë.

Kaptinat gatirruzullore; bishti lulor deri 15 cm; braktetë e pështjellës si tjegullat; braktetë e jashtme gradualisht ngushtohen në një gjemb. Lulet purpur.

VI – VIII.


Në livadhe dhe shpate shkëmbore. Subballkanike.



Carduus kerneri Simonkai – Freshkulli i Kernerit
Asteraceae – Kompozite



Carduus nutans L. - Freshkulli
Asteraceae - Kompozite



Carlina acaulis L. - Ushonjëza e pakërcelltë
Asteraceae - Kompozite

Bimë shumëvjeçare deri 100 cm. Kërcelli gati i shogët dhe me flatra.

Gjethet heshtore të përmbysëta, me vriguj të shumtë thellësisht të vrigulluar; gjethet e poshtme me 22 – 25 çifte vrigujsh tripjesësh; kërcelloret me15 – 20 çifte vrigujsh tripjesësh, secili me një gjemb në majë.

Kaptinat vezëngjashme; bishti lulor 3 – 8 cm, me qime të dendura të merimangëta – leshtor. Braktetë e pështjellës vizake – të fëndyellta, me një gjemb në majë. Lulet purpur.

VI – IX.

Në livadhe e kullota të zonave të larta malore. Subendemike.

Bimë barishtore dyvjeçare, rrallë njëvjeçare, e lartë deri 150 cm. Kërcelli me qime të dendura të merimangëta deri leshtore; flatrat të valëzuara, trekëndore, me një gjemb në majë.

Gjethet nga poshtë me qime të dendura të merimangëta, me qime kaçurrela shumëqelizore, me 8 – 12 çifte vrigujsh, çdonjëri me një gjemb skajor.

Kaptinat me diametër 5 - 8 cm, gatirruzullore, të vendosura me bishta të gjatë pa flatra, të përkulura. Luspat e jashtme të pështjellës heshtore të gjera, në mes të ngushtuara në gjysmën dhe këtu të përkulura, të kuqe – vjollcë. Lulet gypore me ngjyrë të kuqe - violet.

VI - VIII.

Në vende të thata me bar, buzë rrugëve.

Bimë barishtore shumëvjeçare, shumë e shkurtër, e shtrirë, me rrënjë të trashë.

Gjethet e shtrira për tokë, deri 30 cm të gjata, pendore të çara, me bisht ose gati pa bisht.

Kaptina 5 - 13 cm në diametër, fundore. Braktetë e pështjellës gjemborë, të brendshmet të bardha të argjendta përposh, përsipër me nuancë purpur - kafe.

VI - IX.

Rritet në kullota e vende me bar, livadhe malore etj.Bimë mjekësore.



Carlina acanthifolia All. – Ushonjëza gjethedashtër
Asteraceae – Kompozite



Carlina vulgaris L. – Ushonjëza e rëndomtë, therre kali
Asteraceae – Kompozite



Centaurea albertii Rexhepi – Kokoqeli i Albertit
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, monokarpike, pa kërcell.

Gjethet vezake deri gjatore – eliptike, zakonisht pendore të çara me dhëmbë të gjembëzuar, të poshtmet me bisht, të sipërmet zakonisht pa bisht, nganjëherë përsipër leshtore, të paktën përposh pushbutë – të merimangëta.

Kaptina 10 – 15 cm në diametër, e vetmuar. Braktetë e jashtme të pështjellës ngjyrë kashte. Lulet ngjyrë jargavani.

VI – IX.

Në vende të thata me bar e kullota, kryesisht të zonave malore. Bimë mjekësore.

Bimë barishtore dyvjeçare,gati e shogët ose me qimëri të rrallë të merimangët. Kërcelli zakonisht 15 – 30 cm, i thjeshtë ose i degëzuar.

Gjethet kërcellore heshtore deri gati vezake valë-valë, me gjemba të fortë.

Kaptinat 15 – 25 mm në diametër, zakonisht të shumta. Braktetë e jashtme të pështjellës heshtore, më të shkurtra se të brendshmet; të brendshmet ngjyrë kashte.

VI – IX.

Në vende barishtore të thata e kullota.

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rrënjë të fuqishme boshtore, deri 150 cm e lartë. Kërcelli me qime të rralla, pak i degëzuar vetëm në pjesën e sipërme.

Gjethet e poshtme në rozetë. Kërcelloret pa bisht.

Kaptinat të vetmuara, rrallë here 2 – 4, të purpurta. Pështjella e rrumbullakët. Luspat e pështjellës të blerta – të verdhëreme, buza dhe maja e tyre e murrme, me shtojcë trekëndore – heshtore ngjyrë të zezë.

VI – VII.

Bimë stenoendemike e Kosovës. Ndeshet në Devë e Golesh. Rritet në vende shkëmbore dhe me bar të zonës kodrinore, vetëm në substrate serpentinore. Eshtë zbuluar nga botanisti kosovar Rexhepi në vitin 1980 (1977).



Centaurea atropurpurea Waldst. et Kit. –
Kokoçeli purpur i errët Ateraceae – Kompozite



Centaurea calcitrapa L. – Kokoçeli yllor
Asteraceae – Kompozite



Centaurea cyanus L. - Kokoçeli i kaltër
Asteraceae - Kompozite

Kërcejtë (30-) 100 – 150 (-200) cm, pak të degëzuar në gjysmën e sipërme, me gjethe në pjesën e sipërme.

Gjethet 1 (-2) – fish pendore të prera, gati të shogëta, jo lirake; segmentët vizake – heshtore.

Lulet purpur të errëta, rrallë të verdha, të jashtmet rrallë më të gjata se të brendshmet. Pështjella rruzullore; braktetë e pështjellës me shtojca; shtojcat trekëndore – heshtore, kafe të errëta, që mbulojnë plotësisht braktetë.

VI – VIII.

Në shpate shkëmbore të zonave malore.

Bimë e degëzuar qysh në bazë. Kërcejtë 20 – 100 cm, të përpjetëm deri të ngritur.

Gjethet e reja të përhime – leshtore, që bëhen gradualisht të blertërreme dhe kaçurrele – pushlore. Të poshtmet pendore të çara, majëmprehtë, të thara gjatë lulëzimit. Më të sipërmet heshtore.

Kaptinat të pabisht, të rrethuara nga gjethet e sipërme. Luspat e pështjellës mbarojnë në majë me gjemb të çarë më tresh në bazë, më të gjatë se 1 cm dhe me të tjerë më të vegjël. Lulet purpur të zbehta.

VI – VIII.

Në toka djerrë, buzë rrugëve, kullota të thata etj. Euri – Mesdhetare.

Bimë barishtore njëvjeçare, rrallë dyvjeçare, me kërcell të ngritur, të degëzuar, rritet prej 20 - 80 cm.

Gjethet e poshtme heshtore, me bishta, të plota ose me vriguj. Vrigujt anësor më të vegjël se ai skajor. Të sipërmet vizake - heshtore, të plota, pa bisht.

Lulesa kaptinëz. Luspat e pështjellës me dhëmbë të shkurtër si qerpik. Lulet e brendshme blu - manushaqe. Të jashtmet blu - të errëta rrallë të bardha ose purpur, të shrregullta, dybuzore, me vriguj në formë trekëndëshi.

V - VII.

Rritet në të mbjella si bar i keq si dhe në vende barishtore. Bimë mjekësore dhe ngjyruese.



Centaurea jacea L. - Kokoçeli i livadhit
Asteraceae - Kompozite

Bimë shumëvjeçare, 50 - 120 cm. Kërcejtë të ashpër, të thjeshtë ose pak të degëzuar nga mesi, të trashur poshtë kaptinëzës.

Gjethet të ashpra në buzë dhe përposh, të blerta, leshtore. Gjethet e bazës vezake, të plota, të dhëmbëzuara ose me vriguj pendorë; kërcelloret të pabisht, të plota ose të dhëmbëzuara.

Kaptinëzat në një vastak. Pështjella si vezë, shtojcat cipëthata, kafe të zbehta, pa halë. Lulet purpur, rrallë të bardha, të jashtmet pak a shumë rrezore. Fryti aken.

VI - VII.

Në shkorrete e vende barishtore, çeltira pyjesh. Bimë mjaltëse.



Centaurea kosaninii Hayek - Kokoçeli i Koshaninit
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 70 - 80 cm, me kërcell të ngritur e pak të degëzuar. Rizoma është e fuqishme (hyn thellë në tokë).

Gjethet të shogëta, të poshtmet me bishta, dy herë të ndara pendore. Në pjesën e sipërme të kërcellit gjethet janë shumë më të vogla.

Kaptinat të vetmuara, të mëdha, në bishta të gjatë. Braktetë e pështjellës të blerta, shyte, me pjesën skajore të verdhë në të murrme. Kurora ka ngjyrë të lules së pjeshkës.

VII - IX.

Rritet në vende shkëmbore me natyrë serpentinore dhe gëlqerore e kullota të zonave malore. Bimë endemike e Kosovës dhe Shqipërisë. Në Kosovë është e përhapur në Pashtrik, Brezovicë, Koznik, Godancë, Badovc.



Centaurea kotschyana Heuffel – Kokoçeli i Koshit
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcej 50 – 100 cm, zakonisht të thjeshtë.

Gjethet me qime kaçurrele; bazalet heshtore, me dhëmbë të larguara; kërcelloret lirake – pendore të prera; segmentët gjatorë deri vizakë – heshtor.

Pështjella 20 – 30 mm në diametër; shtojcat vezake – trekëndore, kafe të errëta ose të zeza, që mbulojnë tërësisht braktetë. Lulet purpur të errëta.

VI – VIII.

Në kullota të zonave malore.

Bimë baishtore shumëvjeçare me rizomë të shkurtër, të cungët, pa stolone; rrënjët deri 5 cm, boshtore, të shumta. Kërcelli 5 – 20 cm, i thjeshtë, i ngritur.

Gjethet të përhimta – pushbuta; të poshtmet vizake – heshtore, të plota rrallë ura – ura të dhëmbëzuara; kërcelloret vizake, të plota.

Kaptina e vetmuar. Pështjella si vezë; shtojcat kafe të errëta ose të zeza. Lulet e brend-shme purpur ose vjollcë; të jashtmet blu të errëta.

VI - VII.

Në vende me bar e gurishtore të zonave malore. Ballkanike.



Centaurea napulifera Rochel – Kokoçeli rrepembajtës Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 80 cm, me rizomë të gjatë mbitokësor e ndonjëherë dhe me stolone. Kërcelli me qime leshtore, i padegëzuar, rrallë në pjesën e sipërme me 1 - 2 degë.

Gjethet vezake, të plota, përposh me qime të merimangëta, ose më vonë bëhen të shogëta.

Kaptinat mbi bishta të shkurtër. Braktetë e pështjellës të blerta me shtesë të zezë formë krehëri. Lulet të kaltra - vjollcë.

V - VIII.

Rritet në vende me bar të zonës malore subalpine.



Centaurea montana L. - Kokoçeli i maleve Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 40 cm e lartë. Kërcelli i ngritur, zakonisht i thjeshtë, me qime kreshtore.

Gjethet janë pushpake, të dhëmbëzuara pak ose thellë. Në pjesën e poshtme të kërcellit gjethet janë me bishta, gjatore - vezake, të ngushta në bisht, në pjesën e mesme dhe të sipërme të kërcellit janë gjatore, pa bisht.

Kaptinat të vetmuara, skajore. Pështjella vezëngjashme - rruzullore; shtojcat mbulojnë braktetë; kindet rreth 20 - 30 në çdo anë. Lulet vjollce, rrallë të bardha.

V - VIII.

Rritet në kullota të thata e vende shkëmbore të zonës subalpine e alpine.



Centaurea nervosa Willd. – Kokoçeli dellor Asteraceae - Kompozite



Centaurea salonitana Vis. - Kokoçeli i Salonitës
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore deri 100 cm e lartë. Kërcelli pak i degëzuar.

Gjethet të ashpra, ato të poshtmet 1 deri 2 - fish pendore të prera, gjethet e mesit pendore të çara, me segmente heshtorë, të plotë ose të dhëmbëzuar.

Lulesa kaptinëz. Braktetë e pështjellës gjerësisht vezake, shtojcat e verdha të zbehta, majëmprehta ose shyte. Lulet të verdha të ndritshme. Fryti aken.

VI - VIII.

Rritet në vende shkëmbore e kullota.



Centaurea solstitialis L. – Ferrëbardha
Asteraceae – Kompozite

Bimë dyvjeçare, me kërcej 30 – 100 cm, të ngritur, shumë të degëzuar nga gjysma e poshtme, zakonisht të përhimtë – pushbutë; degëzat të gjata, të flatruara.

Gjethet të ashpra, me qime të merimangëta apo të përhime – pushbuta.; të poshtmet zakonisht lirake deri pendore të çara; të sipërmet vizake – heshtore, të plota, të stërgjatura mbi kërcell.

Kaptinat të vetmuara. Pështjella zakonisht si vezë – rruzullore; braktetë gjerësisht vezake, me gjemba të verdhërremë, i majës më i trashë dhe shumë më i gjatë se të tjerët. Lulet zakonisht të verdha.

VI – VIII.

Në toka të punuara, vende të thata, anash rrugëve. Bar i keq i kulturave bujqësore.



Centaurea splendens L. - Kokoçeli i bardhë
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 80 cm e lartë. Kërcejtë janë të drejtë, rrallë hipës ose shtrirës, me shumë degë.

Gjethet e poshtme 1 ose 2 - 3 herë pendore të prera deri me vriguj anësor. Segmentet vizake, të plota ose të dhëmbëzuara.

Kaptinat zakonisht janë më shumë se 10 në tufëza. Lulet kanë ngjyrë trëndafili të purpurt, rrallë të bardha.

VI - VIII.

Rritet në toka jopjellore, kullota e livadhe. Në Kosovë ka përhapje sporadike.



Centaurea stoebe L. - Kokoçeli stebe
Asteraceae - Kompozite



Carthamus lanatus L. – Kartami leshtak
Asteraceae – Kompozite



Chrysanthemum corymbosum L. - Krizantema vastakore
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore dy ose shumëvjeçare, 20 - 90 (- 120) cm e lartë, me rrënjë të drunjëzuara boshtore. Kërcelli i degëzuar gati si fshisë.

Gjethet të përhime ose të blerta. Në pjesën e poshtme të kërcellit me bisht, pendore të ndara, në pjesën e sipërme të kërcellit të plota.

Kaptinëzat në lulesa melthe në krye të degëve. Involukrumi ose pështjella vezake, e gjelbër, me pak qime.

VII - IX.

Rritet në biotope të ndryshme.

Bimë barishtore njëvjeçare, me qimëri pak a shumë leshtake dhe të merimangët. Kërcejtë 30 – 50 cm, të degëzuar, ngjyrë kashte.

Gjethet pendore të çara ose pendore të prera, me dhëmbë gjemborë.

Kaptinat të vetmuara. Braktetë e pështjellës në disa radhë, të vendosura si tjegullat; të jashtmet gjethengjashme, të brendshmet gjatore – heshtore, me një shtojcë të vogël skajore cipëthatë, të dhëmbëzuar deri gati të plotë. Kurora e verdhë, rrallë e bardheme.

VI – VII.

Në vende të thata gurishtore e me bar. Mesdhetarejugore.

Bimë baishtore shumëvjeçare, me kërcej 30 - 120 (- 150) cm të lartë, pak a shumë të degëzuar.

Gjethet pendore të çara deri pendore të prera, pushlore ose të shogëta. Segmentet të dhëmbëzuara. Gjethet e bazës me bisht, me 16 - 40 segmente të dhëmbëzuara. Gjethet kërcellore të ngjashme me ato të bazës, por më të vogla dhe të pabisht.

Kaptinëzat në një vastak të çlirët, me bisht lulor të gjatë. Braktetë të pështjellës kafe të ndritshme. Lulet llapore të bardha.

VI - VII.

Rritet në shkorrete, pyje të rralla, livadhe etj.



Chrysanthemum leucanthemum L. - Lulemargeritë
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell 10 – 100 cm të lartë, të thjeshtë ose të degëzuar, i shogët ose me qime leshtore.

Gjethet bazale 1.5 – 10 cm të gjata, në formë lopate e me bisht të gjatë, ato kërcelloret të ndryshme, gjatore - heshtore ose me vriguj të thellë deri pendore të çara.

Kaptina 2.5 - 4 (-9) cm në diametër, të vetmuara ose 2 - 10 së bashku. Lulet llapore të bardha.

VI – VIII.

Në vende me bar, livadhe e çeltira pyjesh e shkorrete dhe e kultivuar.



Crupina vulgaris Cass. – Krupina e rëndomtë
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore njëvjeçare. Kërcejtë 20 – 50 cm, me gjethe deri tek degët.

Gjethet bazale gjatore, të plota deri dhëmbë – dhëmbë, të ashpra, që bien shpejt; ato kërcelloret me vriguj të gjerë, vizake, dhëmbëza – dhëmbëza.

Kaptinëzat me 3 – 5 lule purpur. Braktetë e pështjellës të gjelbra, nganjëherë purpur në pjesën distale.

V – VI.

Në kullota të thata, vende me bar etj.



Cichorium intybus L. - Cikore
Asteraceae - Kompozite

Barishtore shumëvjeçare, 30 - 120 cm e lartë. Kërcelli i ashpër, i ngritur dhe i degëzuar. Degëzimet të përpjetme - të hapura.

Gjethet pendore të çara, me pjesë skajore më të gjerë. Të sipërmet pak nga pak zvogëlohen, të plota ose me disa dhëmbë, pa bisht, gjysmëkërcellpushtuese.

Lulesa kaptinëz. Braktetë në dy radhë. Lulet të gjitha llapore, të kaltra, rrallë të bardha. Fryti aken ngjyrë kafe të zbehtë.

V - IX.

Rritet në vende barishtore, kullota, anash rrugëve, nëpër djerrishte. Bimë mjaltëse, ushqimore dhe mjekësore. Kosmopolite.



Ptilostemon afer (Jacq.) W Greuter – Ptilostemoni afrikan
Asteraceae – Kompozite



Ptilostemon strictus (Ten.) W. Greuter –
Ptilostemoni i përpiktë Asteraceae – Kompozite



Cirsium appendiculatum Griseb. - Cirza me shtojcë
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore zakonisht dyvjeçare, 40 – 70 (-100) cm. Kërcelli me push të butë të bardhë të merimangët deri gati i shogët.

Gjethet gjatore të përmbysëta – heshtore, pendore të çara, gati të shogëta përsipër, nga faqja e poshtme me push të bardhë si bora; segmentet thellësisht 2 deri 3-vrigujsh me gjemba të trashë.

Kaptinat në një vastak të dendur skajor ose vile cilindrike. Braktetë e pështjellës si tjegullat. Baza e brakteve të jashtme me 0 – 2 (-4) gjemba të trashë, të spërveshura në braktetë e jashtme dhe të ngritura – të hapura në braktetë e mesit. Lulet të purpurta.

VI – VIII.

Në vende gurishtore e të çara shkëmbinjsh me natyrë gëlqerore.

Bimë barishtore shumëvjeçare (30-) 60 – 100 cm. Kërcelli me qime të rralla të merimangëta, me flatra gjembore të ngushta.

Gjethet zbritëse, ngushtësisht gjatore të përmbysëta, të vrigullta deri pendore të çara, me lesh të paktë të merimangët deri gati të shogët; segmentet dyvrigujsh, me gjemba.

Kaptinat të vetmuara ose në një vastak skajor; braktetë e jashtme dhe të mesit të fëndyelltë – gjemborë. Lulet të purpurta..

VI – VIII.

Në pyje gjetherënëse dhe shkorrete.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 100 - 190 cm e lartë. Kërcelli është i thjeshtë ose me degëzime të pakta, zakonisht me gjethe deri në majë.

Gjethet e poshtme eliptike. Të sipërmet paksa lëkurore, gjatore - heshtore, pendore të çara thellë. Vrigujt trekëndorë, të ngushta deri gjatore, me gjemba të fortë.

Kaptinëzat në lëmshuk skajorë nga (3 -) 6 - 8 (- 10) së bashku. Braktetë me gjemb shpues. Kurora e purpurt.

VII - VIII.

Rritet në vende me hije e livadhe me lagështirë. Endemike Ballkanike.



Cirsium arvense (L.) Scop. - Gjembi i arave
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 60 - 150 cm e lartë, me rizomë të gjatë. Kërcelli i degëzuar, me gjethe deri në maje.

Gjethet pa bisht deri gjysmë kërcellpushtuese, heshtore deri gjatore, të plota deri pendore të çara, të shogëta deri me qime të rralla të merimangëta përsipër. Vrigujt e gjetheve majëmprehta me gjemba 1 - 10 mm.

Lulet në kaptinëza të zhvilluara në maje të degëve, me bisht të shkurtër; lëshojnë erë mjalti. Braktetë me rrëvagë të dukshme dhe gjembtha të shkurtër. Kurora e purpurt e zbehtë. Në një bimë gjenden vetëm lule femërore ose vetëm lule mashkullore(bimë dioike).

V - IX.

Rritet në vende të punuara, çeltira pyjesh, vende djerrë. Bimë mjaltëse e mirë.



Cirsium candelabrum Griseb.- Cirza shandanore
Asteraceae – Kaptinore

Bimë barishtore dyvjeçare 150 – 200 (-300) cm, e shogët. Kërcelli shumë i degëzuar.

Gjethet lëkurore, heshtore deri gjatore, pendore të çara; segmentët trikëndorë, të vrigulluar; vrigujt të dhëmbëzuar, me gjemba të fortë.

Kaptinat në lëmshukë nga 4 – 12 së bashku, gati pa bisht në majë të degëve të shkurtra, me 2 – 8 gjethe mbartëse të ngushta, me gjemba. Kurora e bardhë ose e bardheme e verdhë.

VI – VIII. Në vende me bar, shkorrete, buzë pyjeve të zonave malore. Bimë endemike e Ballkanit.



Cirsium canum (L.) All - Cirza thinjake
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare 60 – 150 cm. Rrënjët me zhardhokë boshtakë. Kërcelli i thjeshtë ose pak i degëzuar, pa ose me pak gjethe braktengjashëm në pjesën e sipërme, me flatra të gjembëzuar përposh.

Gjethet barishtore të sheshta, heshtore deri gjatore - heshtore ose heshtore eliptike, zakonisht të dhëmbëzuara deri të vrigulluara, me qime të hapura - pushlore dhe paksa të merimangëta, shpesh gati të shogëta, me gjemba të butë.

Kaptinat të vetmuara, me bisht të gjatë. Kurora e purpurt.

VI – IX.

Rritet në livadhe me lagështirë dhe buzë lumenjve, sidomos në zonat e ulëta.



Cirsium eriophorum (L.) Scop. - Cirza leshtake
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore dyvjeçare, 60 – 150 cm. Gjethet përsipër me kreshta gjembake, përposh leshtake të merimangëta deri pushbuta; vrigujt heshtorë, me gjemba skajorë të fortë.

Kaptinat me diameter 4 – 7 cm, pak a shumë të vendosura 2 – 4 së bashku në vile të çlirëta ose në vastak, pak a shumë me bisht të gjatë, të mbështjella nga gjethet lulore që i kalojnë mjaft kaptinat. Pështjella me qime të dendura leshtake - të merimangëta. Braktetë e mesit zakonisht me një gjemb skajor të imët. Kurora e purpurt.

VI – VIII.

Ndeshet në livadhe, kullota, anash rrugëve etj.



Cirsium heterotrichum Pancic – Cirza qimendryshme
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare; rrënjët me zhardhok boshtakë. Kërcelli i thjeshtë ose me 1 – 3 degë, me hulli.

Gjethet vizake deri gjatore – heshtore, të dhëmbëzuara me gjembtha të hollë; përsipër me qime të rralla deri të dendura, përposh të merimangëta – leshtore; kërcelloret të larguara, më të vogla.

Kaptinëza 2 – 5, me bisht të shkurtër ose të grumbulluara në majë; braktetë të rrasura me gjembth 1 – 2 mm. Kurora e purpurt.

VII – VIII.

Në livadhe me lagështirë të zonave malore. Endemike Ballkanike.



Cirsium vulgare (Savi) Ten. – Gjemb gomari
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore dyvjeçare, 50 – 150 cm; këcelli i flatëruar.

Gjethet të stërgjatura gjatë gjithë ndërnyjes së kërcellit me qime të rralla, të merimangëta, deri pushbuta përposh; vrigujt heshtorë të ngushtë ose trikëndorë të ngushtë, me gjemb skajor.

Kaptinat në melthë ose vastakë. Braktetë e pështjellës ngushtohen në një gjemb skajor shpues. Kurora e purpurt.

VII – X.

Në toka të papunuara, buzë rrugëve etj.



Onopordon acanthium L. – Xhixhëlla dashtër
Asteraceae – Kompozite

Bimë baishtore deri 200 cm e lartë, me kërcej të verdhërremë me qime leshtore të rrasura; flatrat deri 15 mm të gjera.

Gjethet 35 x 20 cm, gjatore të përmbysëta – vezake deri gjerësisht heshtore ose vezake, të pa bisht, gjirake të dhëmbëzuara ose me 6 – 8 çifte dhëmbë trikëndorë me një gjemb skajor 5 – 10 mm, të përhimta të blerta dhe dendësisht pushbuta ose leshtore përposh.

Kaptinat gati rruzullore, të vetmuara ose në vile fundore nga 2 – 5. Kurora e purpurt ose e bardhë.

VII – VIII.

Në djerrishte, gjerdhe, gjatë rrugëve.



Crepis biennis L. – Shmanga dyvjeçare
Asteraceae – Kompozite


Bimë dyvjeçare me kërcej 20 – 120 cm.

Gjethet të ashpra, me qime të shkurtra; gjethet e bazës majëmprehta, me prerje të thella të kthyera në drejtim të bazës, me vriguj fundorë trekëndorë dhe anësorë të larguar, të ngushtuar drejt një bishtaku ngushtësisht të flatruar; kërcelloret e poshtme të ngjashme me ato të bazës; kërcelloret e sipërme heshtore deri vizake, të pabisht, pendore të çara deri të plota.

Kaptinat në një vastak të thjeshtë ose të përbërë. Lulet llapore të verdha.

VI – VIII.

Në vende gurishtore e barishtore të freskëta.



Crepis dinarica Beck – Shmanga dinarike
Asteraceae – Kompozite

Bimë baishtore shumëvjeçare. Kërcelli më shpesh i drejtë, i shogët ose me qime të rralla, pa ose me një gjethe.

Gjethet e rozetës deri 5 cm të gjata, vezake – heshtore, nga të dy anët me qime të rralla ose të shogëta.

Lulesa kaptinë. Ato (2 deri 5) qëndrojnë në majë të kërcellit. Pështjella cilindrike me segmente të murrme – të errët. Kaptina me shumë lule të bardha ose trëndafili - të çelët.

VI – VIII.

Rritet në vende malore me shkëmbinj gëlqeror. E përhapur në malet dinarike. Në Kosovë ndeshet në Alpet Shqiptare.



Crepis sancta (L.) Babcock – Shmanga e shenjtë
Asteraceae – Kompozite



Doronicum austriacum Jacq. - Doronika e Austrisë
Asteraceae - Kompozite



Doronicum columnae Ten. – Doronika me kolonë
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore njëvjeçare, 10 – 30 cm. Kërcejtë të shumtë.

Gjethet e bazës vezake të përmbysëta, të dhëmbëzuara, me prerje të thella të kthyera në drejtim të bazës, pendore të çara ose lirake; kërcelloret të pakta, vizake ose braktengjashme.

Braktet e pështjellës të shogëta ose me qime gjëndërore. Lulet llapore të verdha.

IV – VI.

Në vende të thata me bar e kullota.

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë deri 100 cm të lartë, të shogët ose leshtorë.

Gjethet bazale 9 - 13 x 6 – 8 cm, vezake, shyte, pjesërisht në trajtë zemre, me bisht. Gjethet e poshtme kërcellore violinëngjashme, kërcellpushtuese, ato të sipërmet vezake -heshtore, të plota ose të dhëmbëzuara.

Kaptinat në një vastak skajor. Lulet të verdha. Akenët e luleve anësore pa xhufkë.

VII – IX.

Rritet në vende me hije, buzë pyjeve të zonave të larta malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizoma të shogëta ose me tufa qimesh të mëndafshta të rralla. Kërcelli 12 – 60 cm, i shogët ose me push të rrallë.

Gjethet bazale vezake – rrotullare ose në trajtë zamre, me bishtak të gjatë 3 – 6 cm, të shogëta ose pushlore, ura – ura si dhëmbë, me dhëmbëza majëmprehta; gjethe kërcellore 3 – 4, të poshtmet kërcellpushtuese.

Kaptinat të vetmuara me lule të verdha. Braktetë e pështjellës vizake – heshtore, pushlore – gjëndërore.

V – VIII.

Në vende shkëmbore me hije të zonave malore.



Doronicum hungaricum (Sadl.) Rchb. – Doronika e Hungarisë
Asteraceae – Kompozite



Doronicum orientale Hoff. – Doronika lindore
Asteraceae - Kompozite



Echinops ritro L. - Ekinopsi ritro
Asteraceae - Kompozite

Bimë baishtore shumëvjeçare, 25 – 85 cm, me rizomë zhardhokor. Kërcelli me gjethe larg njëra tjetrës, i drejtë, zakonisht me një kaptinë, me qime gjëndërore.

Gjethet në pjesën e poshtme të shogëta, gradualisht të ngushtuara në bisht, eliptike. Gjethet e tjera gjatore – vezake, shpesh me qime.

Kaptinat të vetmuara, 4 – 6 cm në diameter. Lulet të verdha. Lulet e mesit hermafrodite.

IV – V (VI).

Në vende barishtore, pyje etj.

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë me tufa qimesh të mëndafshta shumë të dukshme. Kërcelli 20 – 50 cm, i shogët ose me push të rrallë.

Gjethet bazale vezake - rrotullare ose në trajtë zemre, me bishtak të gjatë zakonisht 6 – 12 cm të plota ose me dhëmbëza shyte. Gjethe kërcellore 1 – 2 (-3), zakonisht me buzë ura – ura jo të theksuara, kërcellpushtuese.

Kaptinat të vetmuara, të verdha. Braktetë e pështjellës vizake – heshtore.

IV – VI.

Në vende shkëmbore me lagështi dhe me hije të zonave malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë zakonisht të degëzuar, me push të butë të bardhë ose gati të shogëta dhe me qime gjëndërore.

Gjethet eliptike, një - dyfish pendore të prera, buzët të përveshura, përsipër të shogëta, përposh me push të bardhë; segmentet vizake - trekëndore, me gjemba.

Lulesa kaptinëz me ngjyrë të kaltër. Braktetë e pështjellës të thepta, me qerpikë. Fryti aken.

VII - IX.

Rritet në vende të thata me bar.



Echinops sphaerocephalus L. – Ehinopsi kokërruzullor
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë 50 – 160 (-200) cm, të thjeshtë ose të degëzuar, me push të butë – të merimangët.

Gjethet gjatore – eliptike deri vezake, një – dyfishpendore të çara, kërcellpështjellëse; segmentët trikëndorë, me gjemba të hollë e të shkurtër.

Lulesa 3 – 6 cm në diametër, e përhimtë ose e bardhë. Pështjella 15 – 25 mm; brakte 16 – 20 , të qerpikta. Kurora e bardhë ose e përhimtë.

VI – IX.

Në vende të thata e gurishtore, toka djerrë etj.



Erigeron acer L. – Erigeroni i thartë
Asteraceae – Kompozite

Bimë dyvjeçare 10 – 60 cm, me çime kaçurrele të dendura.

Gjethet bazale heshtore të përmbysëta – pallake, me bishtak, buzëplota ose lehtësisht të sharruara; gjethet kërcellore më të vogla, majëmprehta, buzëplota.

Kërcejtë lulorë zakonisht të ngritur dhe të vetmuar, të degëzuar përsipër dhe që formojnë një melth vastakor me deri 70 kaptina. Lulet tritrjatëshe; lulet llapore lila,pak më të gjata se lulet gypore. Xhufka e kuqërreme.

VI – VIII.

Në vende të thata me gurë, toka të papunuara.



Erigeron alpinus L. - Erigeroni alpin
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 - 35 cm, me kërcell të përpjetëm, leshtor, të thjeshtë e me një kaptinëz ose me 1 – 5 degë anësore që mbaron secila me nga një kaptinëz.

Gjethet bazale vizake deri pallake. Gjethet kërcellore vizake, pa bisht, majëmprehta.

Kërcejtë lulorë të përpjetëm deri të ngritur, me 1 – 3 kaptinëza. Pështjella kambanore. Lulet tritrajtëshe; ato llapore ngjyrë trëndafili ose purpur.

VI - VII.

Rritet në kullota malore e vende me gur.



Eupatorium cannabinum L. - Eupatore kërpore
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 - 180 cm e lartë, me kërcell të drejtë e shpeshherë të kuqërremtë dhe me push.

Gjethet të kundrejta, kryesisht pëllëmbore të çara treshe ose pesëshe. Vrigujt heshtorë deri vezakë, me dhëmbë të trashë, me bisht të shkurtër.

Kaptinëzat të vogla të grumbulluara në një lulesë në formë vastaku të degëzuar, me ngjyrë trëndafili. Lulet të gjitha gypore, hermafrodite, me 5 vriguj ose dhëmbë - dhëmbë.

VII - IX.

Rritet në vende me lagështi. Bimë mjekësore dhe mjaltëse e mirë.



Galinsoga parviflora Cav. – Galinsoga lulevogël
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të degëzuar, të shogët në pjesën e poshtme, deri 50 cm të lartë.

Gjethet të kundrejta, me bisht 1 - 2 cm e llapë vezake dhe majëmprehtë.

Kaptinëzat të vogla, gatirruzullore, në cima dikaze. Bishtat e kaptinëzave 2 - 4 cm. Lulet llapore femërore; gjuhëzat rreth 1 mm, gati aq të gjera sa të gjata, të bardha me 3 - 5 dhëmbë. Lulet gypore hermafrodite, të verdha.

VII - X.

Rritet në vende të shkreta, ara, vreshte e sipërfaqe tjera të mbjella me kultura bujqësore. Ka prejardhje nga Amerika Jugore.



Helianthus tuberosus L. - Mollë dheu
Asteraceae - Kompozite

Bimë baishtore shumëvjeçare me kërcej deri 2.8 m të lartë. Kërcejtë janë të mbuluar me qime të kreshpëta, të grathëta. Rizomat janë zhardhokore.

Gjethet të mëdha, vezake, të thepëta, të ashpra përsipër. Gjethet e sipërme pak më të vogla.

Lulesa është kaptinë, 4 - 8 cm në diametër, e ngritur dhe jo e vetmuar. Lulet llapore të jashtme shterpe, të verdha. Lulet e brendshme hermafrodite,të verdha.

VI - IX.

Bimë e kultivuar zbukurimi, por edhe e natyralizuar buzë gjerdheve e nëpër vreshta. Ka prejardhje nga Amerike Veriore.



Hieracium cymosum L. – Këmashna cimoze
Asteraceae – Kompozite



Hieracium guthnickianum Heg et Heer – Këmashna
Asteraceae – Kompozite



Hieracium murorum L. – Këmashna e mureve
Asteraceae - Kompozite

Barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë lulor 30 – 80 (-100) cm, me 1 – 4 gjethe si ato të rozetës.

Gjethet e rozetës kryesisht heshtore të përmbysëta, majëmprehta ose shyte, të zgjatura në bazë, zakonisht të plota, në të dyja anët të mbuluara me qime në formë yjesh.

Lulesa cimë –vastakore. Braktetë e pështjellës vizake – heshtore, me shumë qime yllore dhe të thjeshta jogjëndërore. Lulet llapore të verdha.

VI – VIII.

Në vende me bar dhe kullota, kryesisht të zonave malore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 60 cm e lartë, me stolone nëntokësore. Kërcelli i pasur me qime të shkurtëra dhe të gjata dhe gjëndërore.

Gjethet eliptike – heshtore me skaje të bardha, të mbuluara me qime. Gjethe kërcellore 1 – 5.

Lulesa e ngjeshur ombrellore, rrallë melth, me shumë kaptina. Involukrumi vezak. Gjethëzat me ngjyrë të mbyllët, anash e bardhë. Lulet ngjyrë ari ose portokalli. Lulet anësore të kuqe, të poshtmet në majë me vija të kuqe.

VII – VIII.

Në pyje bashk me Vaccinium myrtillus.

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë 20 – 50 (-80) cm, me disa deri shumë qime yllore dhe gjëndërore të paktën në pjesën e sipërme.

Gjethet bazale në forma të ndryshme, të plota deri thellësisht të rrypëzuara dhe me bazë në formë zemre; kërcellore 0 – 1 (-2), si ato bazale ose braktengjashëm.

Kaptina 4 – 15 deri shumë. Pështjella me brakte shyte deri majëmprehta, me shumë qime gjëndërore. Gjuhëzat të verdha, të shogëta ose me qime të thjeshta.

VI – IX.

Rritet në vende me hije, pyje etj.



Hieracium pilosella L. – Këmashna leshtore
Asteraceae – Kompozite



Hieracium praealtum Vill. – Këmashna shumë e lartë
Asteraceae – Kompozite



Hieracium waldsteinii Tausch – Këmashna e Waldshtainit
Asteraceae - Kompozite

Barishtore shumëvjeçare; stolonet zakonisht të shumtë, të gjatë, hollakë dhe me gjethe.

Gjethet e rozetës heshtore të përmbysëta, pallake ose eliptike, shyte ose majëmprehta, me disa ose shumë qime jogjëndrore të gjata në të dy faqet.

Shtijet 10 – 30 cm, secila me një kaptinë të vetme, me qime të dendura . Braktetë e pështjellës vizake – heshtore, majëmprehta. Gjuhëzat të verdha, zakonisht me një brez të kuq në faqen e jashtme.

V – IX.

Në çeltira pyjesh, kullota të zonave subalpine e alpine.

Barishtore shumëvjeçare, me stolone të gjata, me qime të pakta, 30 – 80 cm.

Gjethet e rozetës heshtorepërmbysëta, pallake ose eliptike, shyte ose majëmprehta, të shogëta deri me shumë qime të gjata të thjeshta, sidomos në nervurën e mesit; ato të kërcellit më të vogla, 1 - 3 të vendosura në gjysmën e poshtme të tij.

Lulesa me disa deri shumë kaptinëza zakonisht në një lëmshuk. Braktetë e pështjellës vizake deri vizake – heshtore, majëmprehta, pa ose me pak deri shumë qime të thjeshta jogjëndrore e gjëndrore. Gjuhëzat të verdha.

V – VII.

Në livadhe dhe vende barishtore e gurishtore.

Barishtore shumëvjeçare. Kërcelli 25 – 50 cm, me qime të dendura.

Gjethet të gjitha kërcellore, por ndonjëherë të grumbulluara afër bazës, vezakepërmbysëta, leshtore, me qime të dendura puplore, të poshtmet nganjëherë me bisht, të sipërmet braktengjashme.

Kaptina 4 - 7, në një melth të çlirët. Braktetë e pështjellës vizake - heshtore. Gjuhëzat të verdha.

VII – VIII.

Rritet në kullota shkëmbore - gëlqerore me lagështirë të zonave malore subalpine. Endemike e Ballkanit. Në Kosovë është e përhapur në Alpet Shqiptare, Malet e Sharrit.



Hypochoeris maculata L. - Hipokeri me njolla
Asteraceae - Kompozite

Bimë shumëvjeçare. Kërcejtë 20 – 60 (-100) cm, zakonisht të degëzuar, nganjëherë të trashur menjëherë poshtë kaptinës, të shogët, ose të grathët në pjesën e poshtme, me luspa të larguara nga njëra tjetra në pjesën e sipërme.

Gjethet gjatore të përmbysëta deri eliptike, të dhëmbëzuara deri pendore të çara, zakonisht kreshtake – të grathëta; gjethet kërcellore mungojnë ose të pranishme deri dy.

Kaptina 20 – 30 mm e gjerë . Lulet llapore të verdha të shndritshme.

IV – VII.

Në vende me bar e gurishtore të thata.



Inula conyza DC. – Plenëra kunëzua
Asteraceae – Kompozite

Bimë baishtore shumëvjeçare. Kërcejtë të shumtë, 15 - 75 (-90) cm të lartë, të thjeshtë ose pak të degëzuar, të grathët ose me qime të ashpra të rralla.

Gjethet zakonisht të gjitha bazale, 4 – 30 cm, eliptike deri vezake, gati të plota deri thellësisht të dhëmbëzuara, gati të shogëta deri të grathëta, shpesh me njolla të kafenjta. Gjethet kërcellore të pakta ose mungojnë.

Kaptinat gjithmonë të ngritura përpjetë. Lulet llapore me ngjyrë limoni - të verdha të zbehta.

VI – VII.

Haset në livadhe dhe çeltira pyjesh.



Hypochoeris radicata L. – Hipokeri rrënjak
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 120 cm e lartë, e ngritur, pushpakë deri pushbutë.

Gjethet e poshtme eliptike ose gjatore – heshtore, të sharrëzuara, të sipërmet pa bisht, pykore në bazë dhe nuk e pushtojnë kërcellin.

Kaptinat 1 cm në diametër. Pështjella 9 – 15 mm, cilindrike; braktetë pushpakë, të jashtmet trikëndore, me majë të përkulur. Lulet llapore më të shkurtra se pështjella.

VII – IX.

Në pyje gjethegjerë, vende të papunuara, etj.



Inula helenium L. – Plenëra greke
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 60 – 250 cm e lartë.

Gjethet të përhimta – pushbuta përposh, të poshtmet 40-70 x 10-25 cm, vizake eliptike, të sipërmet në trajtë zemre – kërcellpushtuese.

Kaptinat të mëdha; braktetë pushbuta, të jashtmet vezake, të përkulura, të brendshmet heshtore. Lulet të verdha. Lulet llapore shumë më të gjata se pështjella.

VI – VIII.

Në shkurrnaja me lagështirë, çeltira pyjesh, vende me bar, livadhe etj. deri në zonat malore. Bimë mjekësore.



Inula oculus - christi L. - Plenëra sykrishti
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të ngritur, leshtake e mëndafshtë, 15 - 6O cm e lartë.

Gjethet e poshtme me bishta, të sipërmet me veshëza dhe kërcellpushtuese, të mbuluara me qime si mëndafshi.

Lulesa kaptinëz. Braktetë e pështjellës me qime të mëndafshta. Lulet llapore e kalojnë shumë pështjellën.

V - VII.

Në vende gurishtore shkëmbore të thata deri në zonën alpine.



Inula salicina L. - Plenëra shelgore
Ateraceae - Kompozite

Bimë barishtore, e ngritur, e shogët ose me qime të rralla, 25 – 75 cm e lartë.

Gjethet lëkurore, vizake - heshtore deri vizake, të sipërmet pa bisht, kërcellpushtuese.

Lulesa kaptinë. Kaptinat të vetmuara ose 2 - 5 së bashku në vastak. Janë me ngjyrë të verdhë. Pështjella me brakte të qerpikta. Lulet llapore shumë më të gjata se pështjella.

VI –IX.

Rritet në çeltira pyjesh, livadhe me lagështirë, shkurrishta etj.



Lactuca serriola L. - Ogrishta
Asteraceae - Kompozite

Bimë njëvjeçare e shogët, 30 - 50 cm e lartë. Kërcelli shumë i degëzuar në pjesën e sipërme, i ngritur ose i përpjetëm.

Gjethet të këmbyera, 2 - 3 herë pendore të prera me segmente të shumtë, të mprehtë.

Kaptinëzat mesatare, me bisht 3 - 10 cm. Braktetë e pështjellës në dy ose më shumë radhë. Lulet llapore femërore të bardha. Lulet gypore hermafrodite, të verdha, me 5 vriguj. Fryti aken.

V - VIII.

Rritet në toka të punuara, oborre, vende me bar. Që nga lashtësia përdoret si bimë mjekuese.



Matricaria chamomilla L. - Kamomila
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore një ose dyvjeçare. Kërcelli deri 180 cm, i ngritur, i shogët ose kreshtak, i degëzuar.

Gjethet të ashpra, në nervurat kurrizore dhe anash me qerpikë si gjemba të vegjël; ato të bazës gati vezakepërmbysëta - gjatore, zakonisht pendore të çara thellë, kërcelloret më pak të vrigulluara.

Kaptinat të vendosura në një lulesë në formë melthi, piramidal ose kallingjashëm. Pështjella e hapur ose e spërveshur në fryt. Gjuhëzat të verdha të zbehta.

VII – IX.

Rritet në kopshte, buzë rrugëve, në vende djerr etj.



Cicerbita pancicii (Vis.) Beauverd – Cicerbita e Pançiçit Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë 60 – 130 cm.

Gjethet pak a shumë vezake, lirake - pendore të çara me një vrigull fundor të gjerë trikëndor dhe disa çifte vrigujsh anësorë.Vrigujt pak a shumë vale – vale, me dhëmbë të dukshëm, me bazë të ngushtuar në një bishtak të flatëruar.

Kaptinëzat në një melth të ngushtë pak a shumë vastakor.. Braktetë heshtore ose vi – zake – heshtore. Gjuhëzat të kaltra.

VI – VIII.

Në vende me lagështirë të zonave të larta malore. Endemike – Ballkanike.



Matricaria perforata Merat – Kamomila e shpuar
Asteraceae – Kompozite



Mycelis muralis (L.) Dumont – Miceli i murit
Asteraceae – Kompozite



Silybum marianum (L.) Gaertner – Gjembgomari
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore njëvjeçare. Kërcejtë 30 – 80 cm, të ngritur ose të përpjetëm, me degëzim vastakor përsipër dhe nganjëherë të degëzuar gjithashtu nga baza. Këcejtë dhe gjethet të shogëta, por nganjëherë,kur janë të reja, me push të rrallë.

Segmentët e gjetheve të ngushtë dhe me majucë të mprehtë.

Lulet e periferisë llapore, të bardha; të brendëshmet gypore, të verdha.

V – IX.

Në toka të punuara, në djerrishte etj.

Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, me kërcej zakonisht të vetmuar e të degëzuar, 20 – 100 cm e lartë.

Gjethet të vrigulluara; kërcelloret pak a shumë kërcellpushtuese. Gjethet e poshtme lirake – pendore të çara, me bisht të gjatë të flatëruar. Vigujt skajorë shpesh shigjetake, 3 – pjesëshe dhe më të mëdhenjë se vrigujt anësor. Gjethet e mesit të kërcellit dhe të sipërmet të pabisht dhe bëhen gradualisht më të vogla.

Kaptinat të shumta në melth të madh dhe të hapur. Lulet gjuhësore të verdha.

VII – VIII.

Rritet në pyje me lagështirë, vende shkëmbore të lagështa e të freskëta.

Bimë barishtore një ose dyvjeçare me kërcej 20 – 150 cm, të shogët ose lehtësisht pushlorë – të merimangët, të blertë.

Gjethet të këmbyera, me nervura të bardha, me gjemba të forte në buzë; gjethet bazale pendore të çara, me bisht; kërcelloret më të vogla dhe të ndara jo thellë, kërcellpushtuese me veshëza, me gjemba të verdhërreme – të bardha.

Kaptinat të vetmuara; bishti lulor i gjatë, i ngritur; braktetë me vendosje si tjegullat që ngushtohen në gjemba të fortë e therrës.

VI – VIII.

Buzë rrugëve, në djerrishte, gjerdhe. Bimë mjekësore.



Petasites albus (L.) P. Gaertner – Llapua i bardhë
Astreaceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare.

Gjethet rrotullare – në trajtë zemre, përposh leshatake, përsipër pak a shumë të shogëta kur janë të vjetra; vrigujt bazalë zakonisht të afruara.

Kaptinëza 5 – 40 në shtijet mashkullore, l3 – 45 në ato femër. Braktetë të gjelbërta të zbehta. Lulet të verdhëreme – të bardha, të gjitha gypore.

IV – V.

Buzë përrenjëve e burimeve.



Bidens tripartita L. – Dydhëmbëshi tripjesësh
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore njëvjeçare 10 – 60 (-100) cm, gati e shogët deri me qime të ashpra.

Gjethet zakonisht me 3 vriguj, më rrallë me 5 vriguj ose jo të vrigulluara., me dhëmbë të trashë; bishtaku i shkurtër, i flatruar.

Kaptinat të vetmuara. Kaptina më e gjerë se e gjatë me lule tubore të verdha; braktetë e jashtme të pështjellës 5 - 8, zakonisht gjethengjashme; të brendshmet vezake, të murrme dhe me buzë të gjelbra.

VII – X.

Në vende me lagështirë. Bimë mjekësore dhe ngjyruese.



Leontodon crispus Vill. – Dhëmbëluani kaçurel
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërçep të pjerrët të degëzuar dhe rizoma vertikale të gjata. Kërcej 1 - 6, 10 – 40 cm të lartë, të thjeshtë ose të degëzuar.

Gjethet të shumta, dhëmbë – dhëmbë deri pendore të çara, me qime të shumta të çara dysh deri shtatësh.

Kaptina l (-3); braktetë gjatore – heshtore, pak a shumë majëmprehta. Gjuhëzat të verdha, nganjëherë të kuqërreme – purpur në faqen e jashtme. Krezat të verdha.

V – VII.

Në vende të thata gurishtore, vende me bar etj.



Leontodon hispidus L. – Dhëmbëluani i grathët
Asteraceae – Kompozite



Picris echioides L. – Cifuri si shëlligë
Asteraceae – Kompozite



Pulicaria dysenterica (L.) Bernh. – Plenra dizenterike
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërçep të cungët vertikal ose të pjerrët. Kërcej 1- shumë, 10 – 60 cm, zakonisht të thjeshtë, me shumë qime të thjeshta jogjëndërore të bardha.

Gjethet heshtorepërmbysëta, shyte deri majëmprehta, gjirake me dhëmbë deri pendore të çara.

Kaptina me gjuhëza të verdha të shndritshme. Krezat të verdha. Akenët ngjyrë kafe; xhufka kafe e zbehtë.

V – X.

Në kullota e vende shkëmbore.

Bimë një ose dyvjeçare. Kërcejtë 30 – 90 cm, me qime të ashpra shpesh të fryra në bazë dhe me disa gjemba hollakë.

Gjethet me qime të shumta jo të barabarta, të ashpra. Qimet më të gjata të trashura ose të fryra në bazë dhe shpesh me gjemba të rrallë. Gjethet bazale eliptike deri heshtore, të ngushtuara në bazë në një bisht të flatruar, të sipërmet të pabisht, kërcellpushtuese.

Kaptinat të shumta. Luspat e jashtme të pështjellës shumë më të mëdha se të tjerat, vezake si zemër. Gjuhëzat të verdha. Të jashtmet shpesh me një vijë të kuqërremtë në pjesën e jashtme.

VI – VIII.

Në djerrishte e vende të punuara.

Bimë barishtore shumëvjeçare me stolone. Kërcelli i degëzuar, leshtak ose pushbutë, 2O - 60 cm i lartë.

Gjethet gjatore - heshtore. Të poshtmet me bisht të cilat thahen gjatë lulëzimit, të tjerat pa bisht, kërcellpushtuese. Gjethet përsipër të gjelbra dhe të ashpra, në anën e poshtme të përhime.

Lulesa kaptinë. Kaptinat të shumta, të verdha, me lule llapore dhe gypore. Braktetë e pështjellës vizake.

VII - X.

Rritet në vende barishtore me lagështirë.



Scorzonera laciniata L. – Skorzonera e rripëzuar
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rrënjë boshtore vertikale. Kërcelli 20 – 30 cm i lartë, i padegëzuar ose i bigëzuar, me gjethe bazale.

Gjethet të plota, vizake, majëmprehta, me qime të gjata dhe të bardha.

Lulesa kaptinë; gjuhëzat të verdha, të kuqërreme në faqen e jashtme. Fryti aken.

V – VII.

Çeltira pyjesh, kullota etj.



Scorzonera villosa Scop. – Scorzonera leshtore
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore, 50 – 60 cm, një – dyvjeçare, ose nganjëherë shumëvjeçare. Kërcejtë përsipër me rrëvaga të imëta.

Gjethet bazale pendore të prera me pjesë vizake ; ato kërcelloret të ngjashme me bazalet, por shpesh të plota.

Lulesa kaptinë. Pështjella deri 40 mm në fryt. Gjuhëzat të verdha në faqen e jashtme.

V – VI.

Në livadhe dhe vende të thata me bar.



Scorzonera rosea W. et K. - Skorzonera e trëndafilt Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 15 - 60 cm e lartë me rrënjë gjatore - penjëzore. Kërcelli është i thjeshtë, i drejtë ose i përkulur, me një kaptinë.

Gjethet të shogëta, heshtore deri heshtore lineare.

Kaptinat janë të mëdha, deri 5 cm të gjera. Pështjella vezake. Lulet ngjyrë trëndafili në të kuqe të çeltë. Lulet anësore 2 herë më të gjata se lulet qendrore.

VI - VIII.

Rritet në kullosa, livadhe, vende shkëmbore me natyrë serpentinore ose gëlqerore.



Tragopogon pratensis L. – Lulebrigje e livadhit
Asteraceaea – Kompozite



Senecio carpathicus Herbich – Pulithi karpatik
Asteraceae – Kompozite



Senecio fuschsii Gmel. - Pulithi i pyjeve
Asteraceae - Kompozite

Bimë baishtore njëvjeçare deri shumëvjeçare me një kërçep cilindrik. Kërcelli 30 – 70 cm, shpesh i thjeshtë, gati i shogët.

Gjethet vizake – heshtore dhe pak a shumë kërcellpushtuese në bazë.

Bishti i lulesës jo i sheshtë. Braktetë e pështjellës rreth 8. Lulet llapore të verdha.

V – VIII.

Në vende të thata me bar, anash rrugëve etj.

Bimë barishtore shumëvjeçare 15 – 30 cm, me rizoma të holla të degëzuara dhe kërcej të ngritur, me gjethe në të gjithë gjatësinë e tyre.

Gjethet e bazës dhe kërcelloret e poshtme 2 deri 3 – fish pendore të prera, me segmentet e fundit vizakë dhe rakid të ngushtë.

Kaptinat të vetmuara, shumë të bukura, me diameter deri 40 mm. Lulet llapore heshtore, të verdha deri portokalli – të kuqe.

VII – VIII.

Në kullota alpine. Endemike Alpino – Dinarike

Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 - 120 cm e lartë me rizomë të shkurtër boshtor. Kërcelli i drejtë, me pak kënde, i shogët.

Gjethet e poshtme gjatë kohës së lulëzimit bijnë. Gjethet e kërcellit gjatore – heshtore, të dhëmbëzuara. Në pjesën e sipërme të kërcellit gjethet janë lineare.

Kaptinat të shumta, me diametër 20 - 35 mm. Pështjella cilindrike ose këmbanore. Lulet llapore të verdha.

VI - VIII.

Rritet në vende me bar dhe shkorrete të zonës subalpine.



Senecio jakobaea L. - Pulithi i Jakobit
Asteraceae - Kompozite



Senecio pancicii Deg. – Pulithi i Panqiqit
Asteraceae – Kompozite



Senecio rupester W. et K. – Pulithi i shëmbinjëve
Asteraceae – Kompozite

Bimë dyvjeçare ose shumëvjeçare, 30 – 150 cm. Kërcejtë gati të shogët deri me qime tufa - tufa, të degëzuar vetëm në lulesë.

Gjethet e bazës dhe ato të poshtmet kërcellore 10 – 20 cm, lirake - pendore të çara, me bisht; kërcelloret e mesit dhe të sipërmet 1 - deri 2 - fish pendore të çara, gjysmëkërcellpështjellëse.

Kaptinat në një vastak disi të dendur. Lulet llapore të verdha. Fryti aken.

VI – IX.

Rritet në vende të thata me bar. Bimë helmuese.

Bimë baishtore shumëvjeçare. Kërcelli i drejt, i shogët.

Gjethet me qime të pakta të merimangëta. Gjethet e poshtme me bisht, vezake, të dhëmbëzuara; kërcelloret lirake, me rezhde vezake dhe me 2 – 3 rezhde anësore më të vogla. Të sipërmet heshtore, pendore të çara.

Kaptinat 3 – 4 cm në diametër. Lulesa vastak me 2 – 6 kaptina. Lulet llapore ngjyrë portokalli.

VI – IX.

Në vende me bar, skaj përrojeve të brezit të lartë dhe sub të lartë të pyjeve.

Bimë dyvjeçare deri shumëvjeçare me erë të keqe, 20 – 60 cm e lartë.

Gjethet nga sipër janë gati të shogëta, nga poshtë me qime. gjatore - ovale, të ndara pendore në 2 – 6 palë vriguj jo të njejtë, të dhëmbëzuar.

Kaptinat 2 – 3 cm në diametër, në lulesë vastak të degëzuar. Bishtat e kaptinave me shumë luspa. Pështjella cilindrike. Lulet të verdha të çelta.

V – VIII.

Rritet në vende ruderale afër tëbanave, në vende malore dhe subalpine.



Senecio subalpinus Koch – Pulithi subalpin
Asteraceae – Kompozite



Senecio sulphureus Baumg. -
Pulithi i verdhë si squfuri Asteraceae – Kompozite



Senecio vernalis W. et K. – Pulithi pranveror
Asteraceae – Kompozite

Bimë baishtore shumëvjeçare, 30 – 70 cm, me kërcej të ngritur, zakonisht të degëzuar vetëm në lulesë.

Gjethet gradualisht të zvogëluara në madhësi në drejtim të kërcellit. Gjethet e bazës dhe ato të poshtme kërcellore si zemër, të shogëta përsipër. Gjethet e sipërme kërcellore të rripëzuara ose gati pendore të prera dhe me veshëza në bazë.

Kaptinat në vastak. Lulet llapore të verdha ose portokalli - të verdha.

VI – VIII.

Në pyje e vende me lagështi.

Bimë baishtore shumëjeçare 30 – 130 cm, me kërcej me qime të merimangëta – me push shajakor, shpesh të shogëta ose gati të shogëta poshtë.

Gjethet e bazës 10 – 25 x 2 5 cm, vezake – heshtore, gati të shogëta përsipër, me qime të merimangëta – me push shajakor përposh; kërcelloret vizake – heshtore, të pabisht.

Kaptinat në një vastak të çlirët. Lulet llapore të verdha si squfuri.

VI – VIII.

Në vende të thata barishtore ose me shkëmbinj të zonave malore.

Bimë barishtore njëvjeçare me lartësi deri 50 cm, jo e degëzuar ose me degëza gati të ngritura. Kërcejtë e rinjë si dhe gjethet të pajisura me qime të merimangëta-leshtore, në pjekuri gati të shogët.

Gjethet e bazës pak a shumë pendore të çara me bisht të gjerë e rakid të dhëmbëzuar. Gjethet kërcellore të mesit dhe të sipërmet kërcellpështjellëse.

Lulet në kaptinëza me diametër 2 – 3 cm. Braktetë e pështjellës 8 – 10 mm, të shogëta, të një ngjyre ose me maje të zezë. Lulet periferike llapore të gjinisë femërore dhe të verdha. Lulet e brendshme gypore hermafrodite, poashtu të verdha. Akenet pak a shumë cilindrike.

IV – IX.

E hasim në vende ranore, toka të punuara, djerrishte etj.



Senecio vulgaris L. – Pulithi i rëndomtë
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli i ngritur, në fillim me qime, më vonë i shogët.

Gjethet sipër gati të shogëta, në faqen e poshtme leshtore, të buta. Gjethet bazale gjatore – eliptike; kërcelloret gjatore - heshtore, pa bisht, më të sipërmet vizake.

Lulesa me 5 - 10 kaptina. Pështjella e murme - purpur. Lulet intenzivisht të verdha; ato llapore mungojnë.

V – VIII.

Rritet në vende shkëmbore - gurishtore të zonës subalpine dhe alpine. Bimë endemike e Ballkanit. Në Kosovë është e përhapur në Luboten, Oshlak, Kurvallë (Alpet Shqiptare).



Senecio wagneri Deg. – Pulithi i Vagnerit
Asteraceae - Kompozite

Bimë njëvjeçare deri 30 centimetra e lartë, gati e shogët ose paksa me qime. Kërcejtë me degëzim të çrregullt.

Gjethet pendore të çara jo në mënyrë të rregullt, me vriguj të dhëmbëzuar. Gjethet e mesit dhe të sipërmet kërcellpushtuese.

Kaptinëzat të shumta, të pabisht. Bishti lulor i zgjatur në fryt. Pështjella cilindrike me luspa në majë të zeza. Frytet me qime.

II - XI.

Në toka djerrë, vende të punuara, buzë rrugëve etj.



Solidago serotina Ait. - Solidago i madh
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 – 250 cm, me rizomë zvarritëse dhe me stolone. Kërcelli i shogët, i padegëzuar dhe me shumë gjethe.

Gjethet vizake, llapa në bazë e plotë, më lartë e sharrëzuar.

Kaptinat në bishta të shkurtër 5 – 6 mm, të vendosura në anën e sipërme të degëve të lakuara duke formuar lulesën melth. Lulet janë të verdha – ari.

VII – X.

E kultivuar si bimë dekorative dhe e natyralizuar. Ka prejardhje nga Amerika Veriore.



Sonchus arvensis L. – Rrëshyelli i arave
Asteraceae – Kompozite

Barishtore shumëvjeçare me rizomë. Kërcelli i ngritur, gati i shogët, 10 – 80 cm i lartë.

Gjethet të këmbyera, shpesh të dhëmbëzuara, heshtore të përmbysëta, me bisht 5 – 8 cm të gjatë e të flatëruar. Gjethet kërcellore zvogëlohen progresivisht duke u ngritur lartë. Kaptinat të grumbulluara në një melth me shumë vile. Lulet llapore të verdha, lulet gypore hermafrodite.

VI – X.

Në pyje dhe shkorrete.



Sonchus asper (L.) Hill. – Rrëshyelli i ashpëra
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcejtë 30 – 150 cm, të thjeshtë ose të degëzuar, fyl.

Gjethet të shogëta, me buzë dhëmbë – dhëmbë, të poshtmet të plota deri pendore të ndara, me vriguj trikëndor, të sipërmet më të gjera, pendore të ndara deri pendore të prerë, me veshëza rrotullare dhe shpesh dhëmbë – dhëmbë.

Kaptina dhe pjesa e sipërme e bishtit të saj të shogëta. Brakte të pështjellës 38 – 50. Gjuhëzat të verdha.

VI – IX.

Në vende me bar, toka të punuara, buzë rrugëve etj. Bar i keq i kulturave bujqësore dhe mjaltëse e mire.



Solidago virgaurea L. – Solidago shufërartë
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore një ose dyvjeçare, e shogët, por baza e kaptinës dhe pjesa e sipërme e kërcellit shpesh me qime. Kërcelli 30 – 80 (- 120) cm, nganjëherë i degëzuar.

Gjethet e sipërme të plota deri pendore të prera, me veshëza rrotullare.

Lulesa kaptinë me ngjyrë të verdhë. Braktetë e pështjellës në tre radhë. Fryti aken me xhufka pak a shumë të rënëshme.

V - X.

Rritet në toka të punuara, vende djerr etj. Bimë mjaltëse.



Sonchus oleraceus L. – Rrëshyelli perimesh
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore një ose dyvjeçare. Kërcelli 30 – 140 cm, i thjeshtë ose i degëzuar, shpesh me qime gjëndrore në pjesën e sipërme dhe nganjëherë me pushë të butë të bardhë në bazë të kaptinës dhe në pjesën e sipërme të bishtit të saj

GJethet të shogëta, të poshtmet të plota. Të sipërmet më të gjera, pendore të çara deri pendore të prera, me veshëza majëmprehta.

Lulesa kaptinë. Gjuhëzat rreth aq të gjata sa gypi i kurorës, të verdha.

V – X.

Në toka të punuara e vende djerrë. Bimë mjaltëse dhe bar i keq i kulturave bujqësore.



Tanacetum macrophyllum W. et K. – Karajpeli gjethemadh Asteraceae - Kompozite


Bimë barishtore shumëvjeçare 40 – 100 (- 150) cm e lartë.

Gjethet pendore të çara deri pendore të vrigullta, nga ana e sipërme të shogëta, përposh me qime. Gjethet e kërcellit pa bisht, dyfish ura – ura.

Lulet në kaptinëza, kurse këto të fundit në vastak të përbër. Lulet llapore të bardha. Akenët pesëbrinjëshe.

VI – IX.

Rritet në vende me lagështi dhe pyje të zonave malore.



Stenactis annua (L.) Nees - Rrezengushti
Asteraceae - Kompozite

Bimë barishtore dy ose shumëvjeçare, 20 - 90 cm e lartë. Kërcelli është i drejtë, në pjesën e sipërme i degëzuar.

Gjethet kërcellore janë pa bisht. Kanë formë vizake dhe janë buzëplota.

Lulesa kaptinë. Kaptinat 15 - 20 mm në diametër. Kaptinën terminale e tejkalojnë kaptinat anësore. Pështjella me fletëza vizake - gjatore. Lulet e mesit kanë ngjyrë të verdhë, kurse lulet llapore janë të bardha.

VI - XII.

Rritet në vende me lagështi, livadhe, çeltira pyjesh etj. Ka prejardhje nga Amerika Veriore, e cila është natyralizuar.



Tanacetum parthenium (L.) Schultz Bip. – Karajpeli partenian
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, mirë e zhvilluar dhe aromatike. Kërcejtë 30 – 120 cm, të degëzuar në pjesën e sipërme, shpeshherë të veshur me të kuqe.

Gjethet pendore të prera deri pendore të çara (si të fieret), të shogëta deri me qime të rralla, me pikla gjëndërore. Ato të sipërmet të ngjashme me të poshtmet, por të pabisht.

Kaptinëzat në një vastak të dendur. Janë të përbëra vetëm prej luleve gypore hermafrodite me ngjyrë të verdhë.

VII – IX.

Rritet skaj rrugëve, brigje të lumenjëve, nëpër shkorrete; shpejt përhapet dhe mbulon sipërfaqe të tëra. Bimë me shije të hidhur dhe e helmët.



Taraxacum officinale Weber – Luleshurdha
Asteraceae – Kompozite

Bimë baishtore shumëvjeçare pa aromë të forte, 30 – 80 cm.

Gjethet pendore të çara deri pendore të prera, të verdheme – të blerta; bazalet dhe kërcelloret e poshtme pak a shumë vezake, me 3 – 7 segmentë gjatorë, gati pendorë të ndarë, ura – ura ose të plotë.

Kaptinat në një vastak të dendur. Lulet llapore të bardha, femërore.

VI – VII.

Në shkorrete të zonave malore dhe vende shkëmbore. Ballkanike.



Tanacetum vulgare L. –
Karajpeli i rëndomtë
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, 15 - 30 cm.

Gjethet 5 – 40 cm, të plota deri shumë të rripëzuara, të shtrira mbi sipërfaqen e tokës. Vrigujt pak a shumë trekëndor, bishti shpesh i flatëruar. Shtijet të trasha, të ngritura, zakonisht leshtore.

Kaptinat shpesh të mysëta. Braktetë e pështjellës vizake – heshtore, pak a shumë të rimta të gjelbra. Gjuhëzat të gjata, të ngushta, të verdha, zakonisht me një shirit kafe. Akenët ngjyrë kafe.

III – IX.

Rritet në livadhe e vende me bar. Bimë mjekësore.



Telekia speciosa (SchreberBaung. – Telekia e bukur
Asteraceae – Kompozite



Tussilago farfara L. – Thundërmushka
Asteraceae – Kompozite



Xantium italicum Mor. – Ksanta e Italisë
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore shumëvjeçare, e cila mund të arrijë lartësi deri 200 cm. Kërcelli i degëzuar që mbaron me një lulesë vastak me 2 - 8 kaptina.

Gjethet e poshtme të mëdha deri 30 cm. Bishti i shkurtër kurse llapa ka trajtë vezake, si zemër në bazë, me buzë ura - ura të sharruara. Gjethet e sipërme pa bisht.

Kaptina me diametër 5 – 6 cm, pështjella gjysmërruzullore. Lulet llapore të verdha, ndërsa lulet gypore janë me ngjyrë kafe në të verdhë.

VI – IX.

Rritet në vende me lagështi, buzë burimeve të zonës malore deri te ajo subalpine. Në Kosovë e përhapur në Alpet Shqiptare, Malet e Sharrit (Mushtisht) etj.

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë. Nga rizoma në fillim të marsit zhvillohen shtije të shumta deri 20 centimetra të larta. Shtijet me luspa të purpurta, në majë kanë nga një kaptinë me ngjyrë të verdhë.

Gjethet shfaqen pas lulëzimit, të gjitha bazale, të ngjashme me gjurmën që lë thundra e mushkës. Kur janë të reja me push, më vonë pushi mbetet vetëm në faqen e poshtme.

Lulesa kaptinë. Braktetë e pështjellës vizake – heshtore, të purpurta. Kaptina me lule llapore në periferi dhe lule gypore në qendër, të verdha. Fryti aken. Frytet me xhufka të shumta.

II - IV.

Rritet në vende me lagështirë, buzë përrenjëve.

Bimë barishtore njëvjeçare, 30 - 120 cm e lartë. Kërcelli zakonisht i degëzuar. Degët shpesh me vija ose pika vjollce apo ngjyrë kafe.

Gjethet me bisht të gjatë. Llapa përgjithësisht vezake deri trekëndore, e plotë ose me 3 – 5 vriguj me dhëmbë të trashë.

Kaptinëzat në lëmshuk sqetullorë. Pështjella e verdhë ose ngjyrë kafe në kohën e pjekurisë, e mbuluar me gjemba të trashë.

VII – IX.

Rritet në ara, vende djerrë, buzë kanaleve etj. Bimë helmuese dhe bar i keq i kullotave.



Xantium spinosum L. – Ksanta gjembake
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore njëvjeçare, 15 – 80 cm e lartë. Kërcelli i degëzuar, me 1 – 2 gjemba të vendosura në sqetullën e gjethes. Gjembat janë të forta, të verdha dhe të ndara tresh.

Gjethet pa bisht ose me bisht të shkurtër. Llapa e plotë ose e ndarë në 3 ose 5 vriguj, e gjelbër – e errrët përsipër, përposh e bardhë ose e përhimtë – pushbutë.

Kaptinëzat mashkullore në lulesa skajore, kurse femëroret në sqetull të gjetheve. Fryti eliptik - gjator, i mbuluar me gjemba hollak me majë të kthyer si grremça.

VII - X

Rritet buzë rrugëve, në ara e gërmadha. Bimë kosmopolite, helmuese dhe bar i keq për kulturat prashitëse.



Xeranthemum anuum L. – Kserantema një vjeçare
Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të ngritur, të degëzuar që nga baza, 25 - 75 cm të lartë.

Gjethet vizake deri gjatore, me push të butë, të bardhë e të dendur në faqen e poshtme, përsipër me push të rrallë.

Kaptinëzat fundore, të vetmuara. Braktetë e jashtme dhe të ndërmjetme të pështjellës me thumb, të shogëta. Të brendshmet gjatore të hapura, ngjyrë trëndafili.

VI – VIII.

Rritet në vende të thata me bar e gurishtore. Bimë mjekësore.



Xeranthemum cylindraceum Sibth et
Sm. – Kserantema cilindrike Asteraceae – Kompozite

Bimë barishtore njëvjeçare. Kërcejtë 15 – 65 cm, me degëza të ngritura- të hapura.

Gjethet vizake deri eliptike – gjatore, me push të but të bardhë e të dendur në faqen e poshtme, përsipër me push më të rrallë.

Kaptinat vezëngjashme. Braktetë e jashtme të pështjellës shyte ose buzëngrëna, me një njollë të bardhërreme; të ndërmjetme gatimajëmprehta; të brenshmet trëndafili gati të ngritura.

VI – VIII.

Në toka të punuara, vende të thata me bar etj.



Butomus umbellatus L. – Bliqini
Butomaceae – Bliqinore

Bimë barishtore shumëvjeçare 20 – 60 cm e lartë, me kërcell hollak, të ngritur dhe i mbuluar vetëm në gjysmën e poshtëme nga bazat millore të gjetheve.

Gjethet vizake, që zgjerohen në bazë në mill vemesor qelqor.

Vileja 10 – 20 cm, cilindrike jo shumë e dendur. Tepalet të verdha me nervurën qendrore të gjelbër. Fryti kapsulë, gatirruzullor.

V – VI.

Në shpate të thata dhe me gurë. Bimë mjaltëse e mire. Mesdhetare.



Asphodeline liburnica Rchb. – Sjerusha e Liburnës
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 40 – 150 cm e lartë.

Gjethet bazale, të përdredhura, vizake, millore në bazë.

Lulet formojnë lulesën ombrellë. Ombrella në një bisht të gjatë dhe përbëhet prej 25 - 30 luleve. Bishtat e luleve 5 - 10 cm dhe jo të barabartë. Sepale 3, ngjyrë trëndafili, nga jashtë të gjelbëreme. Petale 3, pak më të gjera se sepalet, trëndafili të bardha. Fryti rrëshekth.

IV - VI.

Rritet në kanale me ujë, buzë ujërave të ndenjura, ligatina etj.



Alisma plantago – aquatica L. – Këlkaza e ujit Alismataceae – Alismatore

Bimë barishtore shumëvjeçare ujore, 30 – 120 cm e lartë.

Gjethet zakonisht ajërore, deri 30 x 12 cm, por shpesh edhe më të vogla. Llapa e gjethes eliptike – vezake deri heshtore, në bazë në formë zemre.

Lulet në melthe shumë të degëzuara dhe mjaftë të hapura, të vendosura në disa qerthuj njëri pas tjetrit. Rrethlulja 6 -pjesëshe. Petalet të bardha ose purpur të bardha.

VI – VII.

Rritet në vende moçalore, buzë kanaleve etj. Bimë helmuese.



Anthericum liliago L. – Mjekërdhiza lulezambaku
Liliaceae – Zambakore

Kërcelli 20 – 70 cm, i shogët.

Gjethet vizake, të sheshta ose pjesërisht të hullizuara, të gjitha bazale.

Lulesa vile me 10 – 20 lule. Tepalet 10 – 15 mm, të bardha, të hapura. Bishtat lulore të artikuluara rreth mesit. Pistili dhe thekët më të shkurtra se rrethlulja. Kapsula ovoide, pak a shumë me majucë. Farat 3 mm, trekëndore, të zeza.

V – VI.

Në shpate me diell e vende të thata dhe me gur.

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli i shogët, cilindrik, 40 – 90 cm.

Ghethet vizake; kërcelloret të reduktuara ose mungojnë.

Lulesa melth me degë të këmbyera që progresivisht shkurtohen. Tepalet të bardha, 9 – 14 mm. Bishtat lulore të artikuluar rreth bazës. Pistili më i gjatë, ndërsa thekët aq të gjata sa rrethlulja. Kapsula gatirruzullore.

VI – VII.

Në livadhe të thata, shpate shkurrake me diell, pyje pishe etj



Anthericum ramosum L. – Mjekërdhiza e degëzuar
Liliaceae – Zambakore



Asphodelus albus Mill. - Badra e bardhë
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 80 – 120 e lartë. Rrënjët kanë pjesë të fryra cilindrike si qepujka. Gjethet të sheshta si të preshit, të gjitha bazale, deri 60 cm të gjata dhe 1.5 cm të gjera.

Në maje të kërcejve lulor ose shtijave zhvillohen lulet e bardha të grupuara në lulesa vile. Bishtat lulore 10 – 16 mm, para lulëzimit të ngritura (më pranë kërcellit lulor). Gjatë lulëzimit ato hapen e më pas përsëri pak a shumë të afruara. Fryti kapsulë ovoide.

IV – VIII.

E ndeshim në livadhe e kullota malore. Bimë mjaltëse dhe zbukuruese.

Bimë barishtore shumëvjeçare me bulb. Bulbi dardhëngjashëm ose ovoid, me tunikë të murrme të errët, lëkurore ose vemesore dhe me një qafë të gjatë.

Gjethe tre deri katër që zhvillohen pas lulëzimit, heshtore, të shogëta.

Lule 1 – 3. Segmentet e perigonit shyte deri majëmprehta, rozë deri lila – purpur, të ndryshme për kah forma dhe madhësia. Anteret të verdha. Fryti kapsulë ovoide.

VIII – X.

Në livadhe me lagështi, çeltira pyjesh. Bimë mjekësore dhe helmuese.



Colchicum autumnale L. – Xhërrokulli vjeshtor
Liliaceae – Zambakore



Colchicum hungaricum Janka – Xhërrokulli i Hungarisë
Liliaceae – Zambakore

Bulbi gjator, me tunikë të murrme, si letër deri gatilëkurorë dhe me një qafë të shkurtër.

Gjethe dy deri tre, vizake – heshtore, majëmprehta, me qerpikë të rrallë në buzët dhe me faqen e sipërme të mbuluar tërësisht ose pjesërisht me qime të shkurtëra.

Lule (1-) 3 – 6 (-8). Tepalet purpur – rozë ose të bardha, eliptike të ngushta, majëmprehta. Pjalmoret të purpurta – të zeza. Kapsula gatirruzullore.

XII – IV.

Në vende shkëmbore dhe në kullota të thata.



Erythronium dens - canis L. - Kuqëla dhëmbëqeni
Liliaceae - Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare bulboze. Bulbi vezak - cilindrik. Kërcelli 10 – 20 cm i lartë.

Gjethe dy, me 3 - 5 nervura, vezake - eliptike, të rimta dhe me njolla të purpurta, kërcellpushtuese.

Lulja e vetme, e varur, me 6 petale të lira, të përkulura nga prapa, ngjyrë purpur – rozë. Thekë 6, të lirë, me pjalmore kaltëroshe. Shtyllëza e çarë trish.

III – IV.

Rritet në pyje e shkurrishta të zonës subalpine



Gagea bohemica (Zauschn.) - Gagea e Bohemisë
Liliaceae – Zambakore

Bimë baishtore shumëvjeçare. Dy bulbe të mbuluar me një tunikë të përbashkët. Kërcelli i ngritur, i padegëzuar, i shogët ose me qime, 4 – 5 (-10) cm.

Gjethet 1 – 3; braktetë me qime. Tepalet intensive të verdha. Kapsula vezake – e përmbysët.

III – IV.

Në vende ranore, kodrina barishtore të rrahura nga dielli, kryesisht në vende të ulëta.



Lilium albanicum Griseb. – Zambaku shqiptar
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 90 cm e lartë; bulbi i madh 3 – 8 cm, vezak, me luspa heshtore dhe të verdha. Kërcelli i fuqishëm, i drejt dhe i shogët.

Gjethet të shpeshta përgjatë kërcellit gati deri te lulja, heshtore, që vijnë duke u zvogëluar nga poshtë lart kërcellit.

Lulesa vile me 1 – 4 lule. Tepalet të verdha – ari, përsipër me njolla të errëta.

VI – VII.

Në kullota dhe livadhe të zonës malore deri alpine. Në Kosovë ndeshet në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare.



Lilium candidum L. – Zambaku i bardhë
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 80 cm.

Gjethet si fëndyell, majëmprehta, me 7 dejëza, gjysmëkërcellpushtuese, me qerpikë vetëm në buzë.

Lulet të vetmuara, rrallë 2 – 3 dhe të varura.Tepalet të verdha – ari, të harkuara deri të spërveshura. Thekët shumë të dalur e të varur. Anteret ngjyrë portkalli.

VI – VII.

Në livadhe e kullota subalpine dhe alpine. Endemike Ballkanike.



Lilium jankae A. Kern. – Zambaku i Jankut
Liliaceae – Shpatore

Kërcelli 50 – 150 cm.

Gjethet e poshtëme vizake deri heshtore – vizake, deri 25 cm të gjata, të sipërmet vijnë duke u zvogëluar progresivisht, me 3 – 5 nervura, të shogëta përposh.

Vileja me 5 – 10 lule aromatike, nganjëherë me brakteza dhe me këmbëza të ngritura ose të hapura. Tepalet të ngritura, të bardha, me majë të spërveshur. Pjalmoret të verdha.

V – VI.

E kultivuar si bimë zbukurimi. Mesdhetare.



Lilium martagon L. – Zambaku martagon
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare bulboze. Kërcelli lulor 50 – 100 cm i lartë.

Gjethet në qerthuj me nga 4 – 8. Kanë formë heshtore me 7 – 9 nervura.

Lulesa vile. Vileja me 6 – 20 lule. Bishti i lules qëndron i varur. Pjesët e rrethlules heshtore, të spërveshura, ngjyrë vjollce ose karmin – vjollcë, përsipër me njolla të errëta. Thekët shumë të dalur me antere të verdha portokall ose të kuqe – purpur.

VI – VII.

Rritet në pyje veçanërisht me ah, livadhe malore, shkurrishta etj.



Muscari botryoides (L.) Miller – Pështriku vilengjashëm
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 30 cm. Bulbi vezak – dardhëngjashëm, i vetmuar, rrallë me pak bulbëza, me tunikë gjelbëroshe – të murme.

Gjethet 2 – 3 (-5), pallake, të ngritura ose të ngritura - të harkuara, zakonisht më të shkurtra se shtija.

Vileja fillimisht e dendur e më pas cilindrike e çlirët, 1 – 7 cm e gjatë. Rrethlulja rruzullore ose si qesje, ngjyrë blu, me grykë të bardheme dhe dhëmbë të spërveshur. Lulet shterpë të pakta, më të vogla e më të zbehta.

IV – V.

Rritet në livadhe e kullota malore deri alpine.



Muscari commutatum Guss – Pështriku
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 15 – 20 e nganjëherë deri 35 cm e lartë. Bulbi ka formë vezake dhe me shumë bulbe anësore të vegjël.

Gjethet 8 – 20 cm të gjata, 2 – 4 mm të gjera. Rriten në gjatësi të njejtë me lulesën ose më të gjata.

Shtija lulore është e drejtë, 5 – 15 cm e gjatë. Lulesa në fillim e ngjeshur, më vonë bëhet më e rrallë. Lulet me ngjyrë të kaltër.

IV – V.

Rritet në vende me bar dhe shkëmbore.



Muscari comosum Mill. – Pështriku cuflor
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore me rizomë zvarritëse. Kërcelli është i ngritur, i shogët, 9 – 27 cm.

Gjethet distike, shpatëngjashme. Të sipërmet më të vogla dhe të rralla.

Vilet të dendura , me 5 – 13 lule të vogla. Pjesët e rrethlules të verdhë, të lirë, yllorë gjatë lulëzimit. Fillet leshtake. Fryti kapsulë.

V – VI.

Në vende me lagështi të zonës alpine. Bimë endemike e Ballkanit. Në Kosovë është e përhapur në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare.

Bimë barishtore shumëvjeçare bulboze, 30 – 80 cm e lartë.

Gjethe 4 – 6, vizake – të hullizuara që thahen në lulëzim.

Lulesa e gjatë në formë vileje, me shumë lule (20 – 50 lule). Tepalet të verdheme nga brenda, gjelbëroshe nga jashtë dhe me një shirit gjelbërosh në të errët në anën kurrizore. Pjalmoret të verdha të zbehta.

V – VII.

Në pyje dushqesh, shkorrete dhe toka të papunuara.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 80 cm e lartë. Bulbi 3 – 4 cm, rruzullor ose vezak si dardhë, me tunikë ngjyrë rozë.

Gjethe 3 – 5, bazale, vizake, zakonisht më të shkurtra se shtija.

Lulet në vile skajore, disa pjellore disa jopjellore. Lulet e poshtme pjellore kambanore, të hapura në lulëzim. Rrethlulja e tyre ngjyrë vjollce, me dhëmbëza të verdha. Lulet shterpe në pjesën e sipërme të shtijes duke formuar një tufë të vogël fijesh (cufël) ngjyrë vjollce. Fryti kapsulë ovoide.

IV – VI.

Rritet në vende të thata me bar dhe toka të punuara, vreshta.



Narthecium scardicum Kosh. – Narteca e Sharrit
Liliaceae – Zambakore



Ornithogalum pyrenaicum L. – Munikëla e Pirenejve
Liliaceae – Zambakore



Orinthogalum umbellatum L. - Munikëla ombrellore
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 15 cm e lartë, me bulb të bardhë rruzullor me disa bulbe të vegjël anash.

Gjethet bazale kanë trajtë vizake, të hullizuara në anën kurrizore me nga një shirit të bardhë, të shogëta, më të gjata se shtija.

Lulesa vastakngjashme, me 10 – 20 lule. Pjesët e rrethlules vezake – eliptike, të bardha, me shirit të gjelbër në anën kurrizore. Fryti kapsulë. Farat të shumta, rruzullore ose të flatëruara.

IV – V.

E ndeshim në shpatije mali, në vende me bar, kodrina vreshtesh.



Paris quadrifolia L. – Shtarca katërgjethëshe
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 10 – 40 cm e lartë, me rizomë. Kërcelli është i ngritur, cilindrik, i rimtë dhe në pjesën bazale paksa me ngjyrë vjollce.

Në majë të kërcellit gjenden të zhvilluar 4 gjethe (rrallë 5) të vendosura në një qerthull me nervurë në formë rrjete. Ato janë 5 – 16 cm, eliptike – heshtore, majëmprehta, me bisht të shkurtër.

Në majë të kërcellit zhvillohet një lule e vetmuar mbi një bisht të ngritur në mes të qerthullit të gjetheve. Petalet të verdhë – gjelbëroshe. Fryti rrushk, rruzullor, i rimtë - i zi.

VI – VII.

Rritet në pyjet e ahut në zona të larta.



Polygonatum multiflorum (L.) All. - Poligonata shumëlulëshe Liliaceae - Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 - 80 cm e lartë, me rizomë. Kërcelli cilindrik, i ngritur, i shogët.

Gjethet të këmbyera, eliptike ose gjatore - vezake, të shogëta, pa bisht ose me bisht të shkurtër. Përsipër me ngjyrë të gjelbër - të errët, përposh të gjelbër - të përhime.

Lule 2 - 6, pa erë. Rrethlulja pjesërisht e ngushtuar në mes. Fillet e thekëve me push të pakët. Fryti rrushk rruzullor, kaltërosh i zeshkët.

V - VII.

Ritet në pyje me hije, sidomos në dushkaja dhe ahishte. Bimë helmuese.



Polygonatum odoratum (Miller) Druce – Poligonata erëmirë
Liliaceae – Zambakore

Bimë shumëvjeçare bulboze. Kërcelli 10 – 40 cm, dy herë më i gjatë se gjethet e pjekura.

Gjethet bazale shfaqen në pranverë, zakonisht të ngritura, të shogëta, vizake dhe të hullizuara.

Lulesa vile. Vileja me 6 - 25 lule, piramidore. Tepalet rozë - blu deri lila, me nervurë qendrore ngjyrë të gjelbër. Farat elipsoide, të zeza, në fund me rudha.

VIII – IX.

Rritet në kullota e në vende barishtore të thata.



Scilla autumnalis L. – Boçka vjeshtore
Liliaceae - Zambakore

Kërcelli 15 – 60 cm i lartë, i ngritur, me kënde.

Gjethet pak a shumë të ngritura, të rimta përposh, eliptike, të sipërmet më të vogla, pa bishta ose me bishta të shkurtër.

Lulet (1-2) të varura. Rrethlulja gypore, e bardhë, me 6 dhëmbë gjelbëroshe dhe jo e ngushtuar në mes. Fryti rrushk rruzullor, kaltërosh-i zi.

IV – VI.

Në pyje, shkorrete dhe vende të thata shkëmbore.



Polygonatum verticillatum (L.) All. –
Poligonata qerthullore
Liliaceae – Zambakore

Kërcelli 20 – 60 cm, i ngritur, me kënde. Bulbi shumëvjeçar, rruzullor.

Gjethet e mesit dhe të sipërmet në qerthuj nga 3 – 8, vizake ose heshtore të ngushta, të shogëta përsipër, pa bisht ose me bishtak të shkurtër.

Lulesa vile me nga 1 – 2 lule të varura. Fryti rrushk rruzullor, i kuq që bëhet i purpurt i errët.

VIII - IX.

Në pyje, shkorrete dhe vende shkëmbore. Bimë helmuese.



Scilla bifolia L. - Boçka dygjethëshe
Liliaceae - Zambakore



Tulipa kosovarica Shuka L., Tan K., Krasniqi E. –
Tulipani kosovar Liliaceae - Zambakore



Tulipa sylvestris L. – Tulipan pyjesh
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare me bulb. Bulbi ovoid deri rruzullor. Kërcelli i shogët, i lëmuar, cilindrik, 10 - 20 cm i lartë.

Gjethe në përgjithësi dy, vizake, me mille që pështjellin gjysmën e poshtme të kërcellit.

Lulesa vile me 6 - 12 lule, gatinjëanësore. Braktezat zakonisht mungojnë. Bishtat e luleve në pjesën e sipërme progresivisht zvogëlohen. Tepalet blu - manushaqe. Kapsula gatirruzullore.

IV - VI.

Në livadhe e pyje gjethegjerë.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 15 – 30 (-40) cm e lartë. Bulbi dardhëngjashëm, me tunikë ngjyrë kafe, i shogët. Kërcelli i shogët, i drejtë, i padegëzuar, me 3 – 5 gjethe.

Gjethet heshtore, me këllëf në bazë.

Lulet të vetmuara. Tepalet (6) të kuqe; në pjesën bazale të bardha, nganjëherë ngjyrë gështenje – të purpurt. Thekë 6; filli i bardhë, ndërsa anteret ngjyrë gështenje e mbylltë.

V – VI.

Bimë endemike e Kosovës. Për herë të parë është gjetur në rajonin e Mirushës në terrene serpentine nga E. Krasniqi më 2002. Përhapja në Kosovë: rajoni i Mirushës (Llapqevë – Mrasor), Guriq, Llapushnik (Mali Drenicë).

Bimë barishtore shumëvjeçare. Bulbi dardhëngjashëm, me tunikë vemesore të murrme. Kërcelli 25 – 40 cm.

Gjethet të rimta e majëmprehta, kërcelloret dy, të vendosura në gjysmën e poshtme të kërcellit.

Tepalet të verdha – portokall, eliptike majëmprehta. Kapsula gatirruzullore.

V –VI.

Në livadhe dhe kullota të thata malore.



Veratrum album L. - Shtara e bardhë
Liliaceae - Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me rizomë të shkurtër dhe të trashë. Kërcelli është i fuqishëm, i drejtë, fyl, 50 - 170 cm i lartë.

Gjethet e pjesës së poshtme dhe të mesme të kërcellit vezake - eliptike, 10 - 20 cm të gjata, 6 - 10 cm të gjera. Gjethet e sipërme vijnë duke u shkurtuar dhe ngushtuar.

Lulesa melth shumë i degëzuar. Segmentet e rrethlules të bardhë nga jashtë dhe gjelbëroshe nga brenda.

VII - VIII.

Rritet në livadhe e kullota subalpine, sidomos në vende me lagështi. Bimë helmuese dhe mjekësore.



Veratrum nigrum L. – Shtara e zezë
Liliaceae – Zambakore


Bimë barishtore shumëvjeçare, 50 – 150 cm e lartë.

Gjhethet kërcellore të shogëta, të poshtmet eliptike të gjera që bëhen më të vogla dhe më të ngushta përsipër.

Lulesa melth, e degëzuar përposh. Segmentët e rrethlules eliptikë deri gjatorë – eliptikë, të kuqërremtë të murrëm deri të zeshkët.

VI – VII.

Në shkurrnaja, buzë pyjeve dhe livadheve malore.



Fritillaria macedonica Bornm. – Luleena maqedonase
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare bulboze. Kërcelli 15 – 30 cm.

Gjethe 5 – 6, më të poshtmet gati të përkundërta, gjatore deri heshtore, majëshyte; të sipërmet tre në një qerthull.

Lulet të vetmuara, të varura. Rrethlulja kambanore e gjerë. Pjesët e rrethlules me ngjyrë të purpurt të zbehtë, me njolla pak a shumë të dalluara si tabela e shahut.

V – VII.

Në kullota dhe vende me lagështi të zonave të larta malore. Endemike e Ballkanit.



Gagea pusilla (Schmidt) Schult. – Gagea e vockël
Liliaceae – Zambakore



Asparagus acutifolius L. – Shpargulli gjethemprehtë
Asparagaceae – Asparagore

Kërcelli 30 – 150 cm, i drunjëzuar, pak a shumë lianoz, dimërues; krcelli i ri rrvaga-rrvaga dhe i gjelbërt. Degët e vegjël kanë pamjen e gjetheve (kladodet ose gjethet e rrejshme), si gjilpëra, të ashpra e çpuese, në tufa nga 4 – 12, që zhvillohen në sqetullën e gjetheve. Gjethet e vërtetë janë të imët dhe luspor.
Lulet janë të vegjël. Rrethlulja e gjelbër e verdheme. Fryti rrushk gatirruzullor, i helmët, i gjelbër. Në vjeshtë frytet bëhen të zeza.
V – VI.
Në shkorrete, pyje fletore, gjerdhe e vende të thata. Mesdhetare.

Bimë barishtore shumëvjeçare me bulb. Kërcelli i ngritur, i padegëzuar, i shogët.
Gjethja e bazës e vetmuar, vizake, pjesërisht e hullizuar; gjethet kërcellore 2 – 3, të përkundërta, heshtore, zakonisht të shogëta.
Lulet 1 – 3, me 6 tepale të lira e të verdha.
III - IV.
Në toka të thata me bar dhe vende me gurë. Europianejuglindore – Siberianejugore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 100 cm e lartë, me rizomë të zhvilluar mirë dhe kërcell të degëzuar.

Filokladet të grumbulluara në tufëza nga 10 – 20 sosh. Ato janë të holla në formë filli.

Lulet 1 – 2 së bashku. Bishtat e luleve të holla. Thekët më të shkurtër se perigoni. Anteret të rrumbullakëta. Fryti rrushk i kuq, me 2 – 6 fara.

IV – V.

Rritet në shkorrete e pyje të dushkut. Në Kosovë ka përhapje sporadike.



Asparagus tenuifolius Lam. - Ferrmiu gjethehollë Asparagaceae – Asparagore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli 30 – 60 cm, ngjyrë jeshile e errët, pak a shumë i drunjëzuar, me 7 – 20 degë. Degët e vogla kanë pamjen e gjethes dhe quhen kladode. Kladodet vezake majëmprehta deri heshtore, me gjemb në majë.

Gjethet kërcellore të vogla, cipëthata.

Lulet njëseksore, të vetmuara në qendër të kladodeve (degëve të vogla që kanë pamjen e gjetheve), gati pa bisht në sqetullën e një brakteze. Fryti rrushk. Rrushku 1 cm në diametër, rruzullor, i kuq i çelët.

Lul. II – IV; fryt. IX – XI.

Në shkurrnaja e pyje të rralla termofile.



Ruscus aculeatus L. – Rrushkulli gjembor
Asparagaceae – Asparagore

Shkurrëz 20 – 80 cm. Kërcejtë të thjeshtë; filokladet (degët e vogla me pamje të gjethes) eliptike, të mëdha 5 – 12 x 1.5 – 4 cm, në majë shyte.

Gjethet e reduktuara në luspa heshtore të ngushta.

Lulet njëseksore, në tufëza nga 3 – 6 në qendër të filokladit, me një luspë sqetullore. Fryti rrushk, 10 – 15 mm, gatirruzullor, i kuq i çelët.

IV – V.

Në pyje fletore, veçanërisht me ah dhe e kultivuar si bimë zbukurimi. Euri – Mesdhetare.



Ruscus hypoglossum L. – Rrushkulli nëngjuhës
Asparagaceae – Aparigore

Bimë barishtore me cikël dyvjeçar të zhvillimit; nëse kultivohet me anë të qepujkave ka cikël trevjeçar. Bulbi ose qepa shpesh rruzullor i shtypur.

Gjethe deri 10, deri 40 cm të gjata, lehtësisht të fryra në anën e sipërme, fyle.

Ombrella 4 – 9 cm në diametër, gati rruzullore. Lëpusha shpesh me 3 flegra. Rrethlulja yllore, segmentët të bardha me vija të gjelbra. Thekët dalin jashtë rrethlules.

VI – VIII.

E kultivuar si perime. Bimë ushqimore dhe mjekësore. Ka prejardhje nga Azia e Mesme.



Allium cepa L. - Qepa Alliaceae - Qepore



Allium flavum L. – Qepa e verdhë
Alliaceae – Qepore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me bulb vezëngjashëm. Kërcelli cilindrik, i rimtë, 20 – 40 cm i lartë.

Gjethe 2 – 3, vizake të ngushta, që pushtojnë me millet një pjesë të kërcellit.

Lulet në ombrellë fundore e cila në fillim përmbyllet në një lëpushë me dy flegra të pabarabarta, gati trikëndore në bazë. Rrethlulja kambanore, e verdhë.

VI – VII.

Rritet në vende gurishtore të thata. Euri – Mesdhetare.



Allium paniculatum L. - Qepa melthore
Alliaceae - Qepore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Bulbi 1 – 2 cm në diametër, me bulbëza të kuqërreme të zeza. Kërcelli 25 – 90 cm, cilindrik.

Gjethe 2 – 5, vizake, që pushtojnë me millet 1/3 – 1/2 e poshtme të kërcellit. Lëpusha rreth 1.5 cm, me sqep të shkurtër, e rënëshme.

Ombrella 1 – 5 cm në diameter, gatirruzullore, me shumë lule, pa qepujkëza. Rrethlulja vezëngjashme, segmentet e jashtme heshtorë ose gati vezakë, purpur – të errët, të brendshmit gatigjatorë ose vezakë, me një vijëz të mesit purpur. Thekët të mbyllur brenda rrethlules.

V – VII.

Në vende me bar dhe shkëmbinj gëlqerore të zonave malore.



Allium scordoprasum L. – Qepa preshhudhër
Alliaceae – Qepore



Allium sibiricum L. - Qepa siberiane
Alliaceae - Qepore

Bimë barishtore shumëvjeçare bulboze, 10 – 60 cm. Kërcelli lulembajtës cilindrik, fyl përbrenda. Qepujkat gjatore - cilindrike, të grumbulluara përreth një rizome të shkurtër.

Lulesa ombrellë; rruzullore. Lëpusha me dy flegra, e barabartë ose më e shkurtër se lulesa, me ngjyrë të ndryshme. Rrethlulja kambanore, në fillim ngjyrë trëndafili, pastaj vjollcë. Nervura kryesore e murrme.

VI – VIII.

Rritet në livadhe me lagështi dhe pranë burimeve të zonës subalpine dhe alpine. Në Kosovë ndeshet në Malet e Sharrit.



Allium sphaerocephalon L. - Qepa kokërruzullore
Alliaceae - Qepore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Bulbi vezëngjashëm, bulbëzat të bardha ose të verdhëreme. Kërcelli 30 – 90 cm, cilindrik.

Gjethe 2 - 6, gjysmëcilindrike, të hullizuara, që pushtojnë me millet. Lëpusha deri 2 cm, zakonisht me dy flegra.

Lulesa ombrellë. Ombrella 1 – 6 cm në diametër, gatirruzullore, e dendur. Rrethlulja kambanore, trëndafili në të pupurt. Thekët dalin jasht rrethlules. Pjalmoret të kuqërreme para çahjes.

VI – VII.

Rritet në vende të thata shkëmbore e nëpër ranishte bregdetare.



Allium victorialis L. – Qepa e bardheme
Alliaceae - Qepore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 30 – 70 cm. Rizoma është e gjatë. Qepujkat të mbuluara me tunikë të murrme të çelët. Kërcelli i drejtë, nën mesin e tij mban 2 - 3 gjethe.

Gjethet gjatore - vizake, 10 – 20 cm të gjata, 2 – 3 cm të gjera.

Lulesa me shumë lule, gjysmërruzullore - rruzullore. Lëpusha njëpjesëshe, rrallë dypjesëshe, membranore. Rrethlulja ka ngjyrë të bardheme deri të verdhë - blertë.

VI – VII.

Rritet në pyje dhe kullota të zonës subalpine dhe alpine. Në Kosovë ndeshet në Malet e Sharrit.



Allium albanicum C. Brullo, S. Brullo – Qepa shqiptare
Alliaceae – Qepore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Bulbi vezëngjashëm – i rrumbullakët, i bardhë. Kërcelli 14 – 28 cm, cilindrik.
Gjethe 3, të sheshta, të shogët, me shirita, 10 cm të gjatë. Lëpusha me flegra të barabartë.
Ombrella me 10 – 12 lule gjysmësferike, 2 -3 cm në diametër, bishtat të pabarabartë. Rrethlulja e bardhë në rozë. Segmentet e brendshme me një vijëz të mesit purpur.
VI – VII.
Rritet në vende të thata e shkëmbore me natyrë serpentine.
Bimë endemike e Kosovës (qafa e Prushit) dhe Shqipërisë (afër Beratit). Është zbuluar në vitin 2019 nga botanistët italian Brullo.

Bimë barishtore shumëvjeçare. Bulbi rreth 1 cm në diametër, gati vezëngjashëm, në tufa. Kërcelli 10 – 30 cm.
Gjethe 3 – 6, në trajtë filli., që pushtojnë me millet 1/4 - 1/2 e poshtme të kërcellit. Lëpusha me dy flegra të hapura.
Ombrella me 3 – 12 lule. Rrethlulja kambanore; segmentet trëndafili, ose të bardhë me një nervurë të mesit të errët, heshtorë, majëmprehtë.
VII – IX.
Në vende të thata e shkëmbore me natyrë gëlqerore. Europiane - Juglindore



Allium moschatum L. – Qepa erëmyshk
Alliaceae – Qepore



Convallaria majalis L. - Lotzonja
Liliaceae – Zambakore

Bimë barishtore shumëvjeçare, me shtije dhe rizomë zvarritëse të degëzuar. Kërcelli 20 – 30 cm me mille të gjelbra ose vjollcë.

Gjethe 2, me llapë majëmprehtë..

Lulesa vile. Lulet të bardha ose rozë, aromatike, të varura. Rrethlulja pak a shumë kambanore dhe me tepale të ngjitura në rreth 2/3 e gjatësisë së tyre. Fryti rrushk i kuq.

V – VI.

Në pyje dhe shkurrnaja. Bimë mjekësore.

Bimë barishtore shumëvjeçare, 35 - 60 cm e lartë. Bulbi ka formë rruzullore me cipë të murrme të çelët.

Gjethet gjerësisht vizake. Shtija dycepatare, sa ose pak më e shkurtër se gjethet, e zgavërt, e shtypur.

Lulet të varura duke formuar një lulesë ombrellë me 3 – 5 (-7) lule. Segmentet e rrethlules të bardha me një njollë të gjelbër në majë.

IV - V.

Rritet në livadhe me lagështirë. Bimë helmuese dhe farmaceutike.

Bimë barishtore shumëvjeçare me bulb, 10 - 20 cm e lartë.

Gjethe 2, në formë vizake, të rimta.

Shtija lulore me një lule të përkulur. Lëpusha me dy flegra të bashkuara. Lulet të vetmuara, të bardha. Rrethlulja me pjesë jo të barabarta. 3 të jashtmet të bardha dhe 3 të brendshmet po të bardha, por më të shkurtra dhe me një njollë të blertë në majë.

II - IV.

Rritet në pyje të rralla e livadhe. Bimë helmuese dhe mjekësore.



Galanthus nivalis L. - Lule bore
Amaryllidaceae - Amarilidore



Leucojum aestivum L. - Bilbilbardha
Amaryllidaceae - Amarilidore



Narcissus poeticus L. - Narcisi poetik
Amaryllidaceae - Amarilidore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 20 - 50 cm e lartë. Ka një kërcell shumë të shkurtër dhe të fryrë i cili quhet bulb nga i cili zhvillohen gjethet dhe shtija.

Gjethet të gjitha bazale, pak a shumë ngjyrë qielli të mbyllur në të hirtë.

Lulet të vetmuara. Kanë një mbështjellës cipëthatë që quhet lëpusha. Shtrati lulor është në formë gypi mbi buzët e të cilit dalin segmentet e rrethlules me ngjyrë të bardhë, të cilat kanë formë vizakë - rrotullarë. Parakurora ose korona ka ngjyrë të verdhë me buzë të kuqe.

IV - V.

Rritet në livadhe me lagështi.



Crocus albiflorus Kit. – Krokusi i bardhë
Iridaceae – Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Mbulesa e bulb-zhardhokut me pejza paralele ose paksa e rrjetëzuar.

Gjethe 2 - 4, 4 - 8 mm të gjera, të pranishme në lulëzim, me një hullizë qendrore të bardhë.

Lule1 (-2), të bardha; braktetë vemesore. Gypi i rrethlules i bardhë ose i purpurt. Pjalmoret të verdha. Shtyllëza zakonisht shumë më e shkurtër se thekët.

III – VI.

Në kullota e pyje të rralla, kryesisht në zonat malore.



Crocus dalmaticus Vis – Krokusi i Dalmacisë
Iridaceae - Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Mbulesa e bulb – zhardhokut me pejza të rrjetëzuara.

Gjethe 2 – 7 , 1 – 2 (-3) mm të gjera, të pranishme në kohën e lulëzimit.

Lule 1 – 3, vjollcë, me grykë të verdhë, zakonisht të argjendta ose të verdheme nga jashtë dhe shpesh me damarë purpur të errët. Gypi i rrethlules 3 – 10 cm, i verdhë. Pjalmoret të verdha. Shtyllëza e verdhë deri portokalli e kuqe, e ndarë në 3 degëza. Çdo degëz mjaft e zgjeruar dhe me kinde ose e vrigulluar.

I – IV.

Në shkorrete e kullota shkëmbore të zonave malore. Subendemike.



Crocus chrysanthus Herbert – Krokusi luleari
Iridaceae – Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Mbulesa e bulb – zhardhokut e lëmuar, si kartë deri lëkurore.

Gjethe 3 – 5, të pranishme në lulëzim.

Lule 1 – 3 , të verdha, nganjëherë me gyp të rrethlules të purpurt ose kafe. Braktetë dhe braktezat vemesore, të bardha. Pjalmoret të verdha. Shtyllëza e verdhë deri portokalli – e kuqe, e ndarë me tre degëza. Fryti kapsulë.

II – VI.

Në vende shkëmbore, me borë të zonave të larta malore.



Crocus flavus Weston – Krokusi i verdhë
Iridaceae – Shpatore

Bimë shumëvjeçare, deri 30 cm e lartë. Mbulesa e bulb – zhardhokut ngjyrë kafe, e përbërën nga pejza paralele.

Gjethe luspore 4 – 5. Gjethe bazale 4 – 8, të pranishme në kohën e lulëzimit, me pak qime ose leshtore. Lule 1 – 5, ngjyrë portokalli. Pjesa e jashtme e gypit të rrethlules me vija ngjyrë vjollce. Segmentet e rrethlules të rrumbullakëta, pak të mprehta në majë.

V – VII.

Rritet në kuadër të pyllit të dushkut, në toka shkëmbore serpentine.



Crocus heuffelianus Herb. – Krokusi i Hojfelianit
Iridaceae – Shpatore

Bimë shumëvjeçare, 15 – 35 cm e lartë. Bulb – zhardhoku me mbulesë të hajthme dhe pak të dallueshme.

Gjethe 2 – 3, heshtore, 3 -7 mm të gjera, me një hullizë qendrore të bardhë, të pranishme në kohën e lulëzimit.

Lulet të vetmuara. Rrethlulja me ngjyrë vjollce – të çelët, rrallë e bardhë; vrigujt në pjesën e sipërme me njolla vjollce të errët. Kreza më e lartë se pjalmoret, ngjyrë portokalli. Kapsula e vogël, gjatore.

III – IV.

Në livadhe ahishtesh, deri në zonat subalpine.



Crocus kosaninii Pulev. – Krokusi i Koshaninit Iridaceae – Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Mbulesa e bulb – zhardhokut me pejza shumë të holla.

Gjethe 2 – 7, të pranishme në kohën e lulëzimit, me një hullizë qendrore të bardhë.

Lule 1 – 3, vjollce – blu, rrallë të bardha e me njolla purpur – blu në bazë, gryka e bardhë. Braktetë dhe braktezat gati të barabarta, vemesore, të bardha dhe shpesh me njolla të gjelbërta. Pjalmoret të verdha.

IV – VI.

Rritet në vende shkëmbore, kullota alpine e vende ku shkrin bora. Endemike e Ballkanit.



Crocus scardicus Kosan. - Krokusi i Sharrit Iridaceae - shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 15 cm e lartë. Qepujka deri 1 cm e gjerë, e mbuluar me tunikë të rrjetëzuar.

Gjethet luspore 4 (-5), në pjesën e sipërme të blerta. Gjethe 2 – 4; 1 – 2 mm të gjera. Spata e bardhë në fund të kërcellit. Braktetë vemesore i tejkalojnë gjethet bazale.

Lulet të vetmuara, rrallë dy, ngjyrë vjollce të lehtë, ose krejtësisht të bardhë. Gypi i rrethlules ngjyrë vjollce të errtë në pjesën e sipërme; gryka e verdhë. Shtyllëza zakonisht më e gjatë se thekët.

II – IV.

Në pyje, çeltira pyjesh të dushkut (rrethina e Kaqanikut). Endemike e Ballkanit.



Crocus veluchensis Herbert – Krokusi i Velukenit Iridaceae – Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare deri 10 cm e lartë. Mbulesa e zhardhok - qepës e hollë, rrjetore, shumë a pak leshtore.

Gjethet shfaqen së bashku me lulen. Kanë formë heshtore - vizake, pa një hullizë qendrore të bardhë.

Lule të vetmuara, portokalli - të verdha, zakonisht të purpurta në drejtim të bazës. Anteret të verdha. Shtyllëza portokalli sa ose më e gjatë se thekët, e ndarë në tre degëza të shkurtra.

V – VII.

Rritet në vende të zonës alpine ku shkrin bora. Në Kosovë është e përhapur në Malet

e Sharrit, si sugjeron edhe emri i llojit. Bimë endemike e Ballkanit.



Crocus biflorus Mill. – Krokusi dylulesh
Iridaceae – Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare, 5 – 10 cm e lartë. Mbulesa e bulb – zhardhokut lëkurore; qepujka në pjesën e poshme me unaza të tërthorta.

Gjethe 3 – 5 (-9), 2 – 3 mm të gjera, me një hullizë qendrore të bardhë.

Lule 2, rrallë herë 1 – 4. Segmentet e rrethlules të bardha , nga jashtë ngjyrë vjollcë.

II – III.

Rritet në livadhe të thata, vende gurishtore, shkurrnaja etj.



Crocus neapolitanus (Ker) Aschers – Krokusi
Iridaceae – Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Mbulesa e bulb – zhardhokut me pejza rrjetor.

Gjethet e ngushta, heshtore – vizake, të shogëta, me një hullizë qendrore të bardhë. Shfaqen së bashku me lulen.

Lulet të vetmuara. Rrethlulja ngjyrë manushaqe ose manushaqe e çelët.

II – V.

Në livadhe, pyje halor, deri në zonat alpine



Iris gramínea L. - Shpatorja si barishte
Iridaceae – Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë, 15 – 30 (-40) cm e lartë. Kërcelli i shëndoshë, më i shkurtër se gjethet.

Gjethet 35 – 100 cm të gjata dhe 5 – 10 mm të gjera; në kohën e lulëzimit të përkulura.

Në majë të kërcellit zhvillohen një ose dy lule. Segmentet e jashtëm të rrethlules me nervura purpur dhe të bardha.

V – VI.

Në pyje të dushkut. E rrallë



Crocus vernus (L.) Hill – Krokusi i pranverës
Iridaceae – Shpatore

Bimë shumëvjeçare, 9 – 20 cm e lartë. Mbulesa e bulb – zharkokut (tunika) e lëmuar, me unazën ndarëse në pjesëm e poshtme.

Gjethe 3 – 5, që shtrihen deri në bazën e rrethlules në kohën e lulëzimit. Skajet e gjetheve me puprri.

Braktetë dhe braktezat në bazë të rrethlules. Lule 1 – 3, të bardha, nganjëherë vjollce. Gypi i rrethlules shpesh bëhet ngjyrë vjollce. Anteret të verdha, shtyllëza portokalli – e kuqe.

III – V.

Në pyje të dushkut dhe në çeltira pyjesh të zonës kodrinore.



Crocus weldenii Hoppe et Furn. – Crocusi i Veldenit Iridaceae – Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Mbulesa e bulb-zhardhokut me pejza paralele ose paksa të rrjetëzuara.

Gjethe 2 – 4, (2-) 4 – 8 mm të gjera, të pranishme në lulëzim, por shpesh shumë të shkurtra.

Lule 1 (-2), të purpurta, vjollcë ose rrëvaga – rrëvaga; braktetë vemesore, të bardha, rrallë me damarë të gjelbër ose purpur. Gypi i rrethlules 2.5 – 15 cm, i bardhë ose i purpurt; segmentët heshtorpërmbysët deri vezakepërmbysët, shyt. Pjalmoret të verdha. Shtyllëza me 3 degëza; çdo degëz shumë e zgjeruar dhe me kinde në majë

III – VI.

Në kullota e pyje të rralla, kryesisht në zonat malore.



Gladiolus palustris Gaudin - Gladiola e kënetave Iridaceae - Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare me zhardhok - qepë. Lëkura e zhardhok - qepës e përbërë nga penjëza të trasha, të lira e të rrjetëzuara.

Zakonisht me dy gjethe bazale në formë shpate dhe një gjethe kërcellore braktengjashme.

Lulet zigomorfe në një lulesë kalli të thjeshtë. Kalliri njëanësor, deri me 6 lule. Rrethlulja e kuqe deri e kuqe - purpur me 6 segmente të vendosura në dy qerthuj. Segmentet vezake deri heshtore që zgjaten poshtë në një thonjëz. Gypi i hipanthit (lloj shtrati lulor) zakonisht i lakuar dhe ka formë hinke.

V - VI.

Rritet në livadhe me lagështirë.



Iris pumila L – Shpatorja xhuxhe
Iridaceae – Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare, pa gjethe në dimër. Kërcelli jo më shumë se 1 cm.

Gjethet deri 15 cm x 17 mm, të drejta ose disi kosërake.

Lulet të vetmuara, të verdha , blu ose purpur. Lëpushat 5 – 10 cm, përsipër cipëthata, rrotullare ose me karenë në pjesën e poshtme. Farat rruzullore, kafe të zbehta.

V – VI.

Në vende të thata shkëmbore.



Iris reichenbachii Heuff. – Shpatorja e Rajhenbahut
Iridaceae – Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Kërcelli 18 – 27 (-35) cm i lartë.

Gjethet 19 – 33 cm të gjata, 9 – 15 (-20) mm të gjera.

Në majë të kërcellit zhvillohen një ose dy lule. Perigoni i verdhë, vjollcë ose i kaltër. Segmentet e rrethlules të verdha.

IV – VI.

Në livadhe të thata dhe kullota.



Iris pseudacorus L. – Badra e ujit
Iridaceae – Shpatore

Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë. Kërcelli 60 – 120 cm,lehtësisht i shtypur, që mban disa gjethe.

Gjethet disi të rimta, me dellin e mesit të dalur.

Lule 4 – 12, të verdha, të poshtmet në një këmbëz të gjatë gati të ngritur. Rrethlulja me segmente të brendshme dhe të jashtme. Segmentet e jashtme më të mëdha, në bazë me nervura ngjyrë portokalli - në të kuqe. Fryti kapsulë.

IV – VI.

Rritet në vende me shumë lagështi, me ujë, ligatina etj. Bimë ngjyruese.



Juncus effusus L. – Kulmaku i përhapur
Juncaceae – Zhukore

Bimë tufore e dendur me kërcej 50 – 150 cm, millet bazalë shpesh të kuqërremë – të murrme. Kërcelli dhe gjethet të lëmuar, palca e vazhdueshme. Brakteja më e poshtme e gjatë, me një mill të ngushtë.

Lulesa shumëlulëshe, e dendur ose e çlirët; lulet zakonisht të murrme të zbehta. Kapsula si vezë deri rruzullore.

V – VII.

Në vende me lagështirë e këneta. Kërcejtë e tharë të kësaj gjinie përdoren për thurje (shporta, fshesa), për të mbuluar çatitë e kasolleve etj.



Luzula pilosa (L.) Willd. – Luzula leshtore
Juncaceae – Zhukore

Bimë tufore, me stolone të shkurtra, 15 – 30 (-40) cm e lartë.

Gjethet e bazës 5 – 10 mm të gjera, me qerpikë të rrallë deri të dendur, të sheshtë.

Lulesa me degëza të holla të pabarabarta, të hapura dhe të spërveshura në fryt. Pjesët e rrethlules gati të barabarta, majëmprehta, zakonisht të murrme të errëta. Pjalmoret më të gjata se fillet. Kapsula si vezë, shumë e gjerë poshtë, e verdheme e blertë.

IV – VI.

Në pyje të rralla dhe shkurrnaja.



Luzula sylvatica (Huds.) Gaud. – Luzula pyjore
Juncaceae – Zhukore

Bimë e shëndosh, tufore e çlirët, me stolone, 40 – 80 (-100) cm.

Gjethet e bazës 7 – 20 mm të gjera, të shtrira, me qerpik të rrallë deri të dendur.

Lulet në grupe nga 2 – 5. Braktetë e lulesës shumë më të shkurtra se lulesa. Anteret deri 6 herë më të gjata se fillet. Kapsula afërsisht e barabartë me pjesët e rrethlules, vezake.

V – VII.

Rritet në pyje të pasura me humus e të freskëta.



Dioscorea balcanica Kosanin – Groshë e egër
Dioscoreaceae – Dioskorore

Bimë barishtore shumëvjeçare me zhardhokë cilindrikë. Kërcejtë deri 60 cm, të hapur ose të përpjetëm, të padegëzuar.

Gjethet pak si zemër në bazë, të këmbyera ose gati të përkundërta, majëmprehta, me 9 nervura të degëzuara, me bishtak të gjatë deri 7 cm.

Lulet në lëmshukë tuforë të përbërë nga kalli të çlirët, të gjelbëreme. Kalliri frytor deri 7 cm, i varur.

IV – V.

Në shkorrete e pyje të rralla e të përziera, e rrallë. Bimë endemike e Kosovës dhe Shqipërisë. Në Kosovë e ndeshim në Pashtrik dhe rrëzë Koritnikut.



Tamus communis L. - Pejza
Dioscoreaceae - Dioskorore

Liane shumëvjeçare përdredhëse deri 4 m e lartë, me zhardhokë të mëdhenjë, cilindrik deri vezëngjashëm. Kërcejtë nganjëherë të degëzuar.

Gjethet me bisht, në formë të theksuar zemre, të mprehta në majë.

Lulet në vile sqetullore, të gjelbëreme, mashkullore të ndara prej femërore. Rrethlulja e luleve mashkullore kambanore, thekë 6. Rrethlulja e luleve femërore me 6 segmente të ngushtë e të imët. Fryti rrushk, i kuq, rrallë i verdhëremë.

IV - V.

Pejza ose rrush gjarpri ndeshet në pyje e gjerdhe të zonës së pyjeve.



Anacamptis pyramidalis (L.) Rich. – Anakampta piramidale Orchidaceae – Salepore

Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell hollak, 20 – 60 cm të lartë. Zhardhokë dy, ovoidë ose gatirruzullorë.

Gjethet e poshtme 8 – 25 cm, heshtore – vizake, të sipërmet më të vogla ose braktengjashme.

Lulesa fillimisht konike, më pas zgjatet deri në 7 cm. Lulet trëndafili në të purpurt. Buzëla trivrigujshe, gati të barabartë midis tyre. Shpori 12 – l4 mm, fillngjashëm.

V – VI.

Takohet në pyje të rralla, shkorrete e në vende barishtore.



Cephalanthera longifolia (L.) Fritsch – Cefalantera gjethegjatë Orchidaceae – Salepore

Zhardhokët thellësisht të çarë dysh ose katërsh. Kërcelli deri 30 cm, i ngritur, me 2 deri 5 gjethe.

Gjethet zakonisht me njolla të errëta në të dyja faqet, të poshtmet heshtore deri vezake përmbysëse, të sipërmet heshtore, më të sipërmet rrallë arrijnë lulesën.

Vileja ovoide deri gjatore. Tepalet e jashtme gjatore heshtore, shyte. Buzëla e pandarë ose me tre vriguj të dobët. Shpori i spërveshur.

V – VII.

Në vende me bar të zonave malore.



Cephalanthera rubra Rich. – Cefalantera e kuqe
Orchidaceae – Salepore

Bimë me rizomë të shkurtër zvarritëse. Kërcelli 20 – 45 cm, i ngritur.

Gjethet heshtore, të sipërmet vizake.

Lulet në kalli të çlirtë, me 10 – 20 lule. Tepalet të bardha, të jashtmet heshtore,majëmprehta, të brendshmet pak më të shkurtra dhe shyte. Shpori mungon.

IV – VI.

Në pyje fletore, dushkaja dhe ahishte.



Dactylorhiza cordigera (Fries) Soo - Daktilorhiza kordigerë
Orchidaceae – Salepore

Kërcelli 20 – 80 cm, i ngritur, rrëvaga-rrëvaga dhe me push gjëndëror përsipër.

Gjethet pa bisht, heshtore. Braktezat heshtore.

Lulesa deri 12 cm, e çlirët, me 3 – 10 (-12) lule. Lulet trëndafili në të kuqe, të hapura, shumica më të gjata se braktetë. Tepalet e jashtme të hapura, heshtore, me push gjëndëror nga jashtë; të brendëshmet vezake – heshtore, kryebashkuara. Shpori mungon.

VI – VII.

Në pyje dhe shkorrete.



Dactylorhiza majalis (Rchb.) Hunt et Sum. – Daktilorhiza gjethegjerë Orchidaceae -Salepore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Zhardhoku i shtypur, i ndarë thellë në (2 -) 3 - 4 vriguj me rrënjë bukur të trashura. Kërcelli 15 - 65 cm i lartë, jo fyl, nën lulesë shpesh me ngjyrë të kuqërremt – vjollce.

Gjethe 6 - 9 me njolla ngjyrë kafe.

Lulet ngjyrë trëndafili ose të purpurt. Braktetë janë të mëdha me nervura si rrjetë. Buzëla me tre vriguj të parregullt, me pika ngjyrë vjollce – të kuqe .

VI-VII.

Rritet në vende me lagështirë, sidomos në çeltira pyjesh.



Dactylorhiza sambucina L. – Daktilorhiza si shtog Orchidaceae – Salepore

Bimë barishtore shumëvjeçare. Zhardhokët janë të shtypur, thellë të ndarë pëllëmbore në 3 - 5 vriguj të gjatë. Kërcelli zakonisht fyl, 10 - 50 cm i lartë.

Gjethet janë të gjata ovale, më të gjera në mes, me njolla të errëta.

Lulesa është në formë kalliri, 4 - 8 cm e gjatë. Braktetë kanë nervurë rrjetore. Lulet vjollce - të purpurta. Buzëla e ndarë në tre vriguj. Shpori cilindrik - konik.

VI - VII.

Rritet në livadhe dhe kullosa me lagështi.



Dactylorhiza maculata (L.) Soo – Daktilorhiza me njolla Orchidaceae – Salepore

Kërcelli 10 – 30 cm, zakonisht me 3 – 4 gjethe në gjysmën e poshtme. Zhardhokët gjatorë – cilindrikë, gati të plotë ose me vriguj të shkurtër.

